Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
12

FJALORI I LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS

THEIR FINEST HOUR

Në përpilimin e këtij Fjalori që e keni në dorë, në të cilin trajtoj persona, ngjarje dhe koncepte të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, jam munduar t'u përmbahem kritereve të veçanta.

Kur është fjala për personat, jam munduar t'i përfshijë këto kategori:

–Të burgosurit politikë që janë dënuar si anëtarë të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës,

– Emrat e personave të cilët përmenden në veprën e shkruar dhe të publikuar nga Jusufi vetë dhe nga letrat e tij, të publikuara më vonë. Në këtë grup shumica absolute janë figura pozitive dhe me të cilat është personifikuar lufta e popullit shqiptar për çlirim. Por këtu kam marrë edhe shembuj me anën e të cilëve personifikohet dhuna kundër popullit shqiptar.

Personave të Socialdemokracisë së Serbisë ua kam kushtuar një vëmendje, ashtu siç ua ka kushtuar Jusufi.

Në fjalor nuk përmenden të gjitha ato figura të popullit shqiptar që kanë shërbyer si inspirim për luftën tonë. Nuk e kam bërë këtë (me ndonjë përjashtim të vogël) sepse

personalitetet e shquara të historisë së popullit shqiptar janë aq të njohura sa që unë në këtë mes nuk kam pasur të them asgjë të re, asgjë të panjohur.

– Emrat e shokëve të rrethit të Shtutgartit që Jusufit e Bardhoshit u kanë qëndruar afër prej janarit 1980 deri në mars 1981.

– Emrat e shokëve që kanë dalë në skenë dhe që ju kanë përgjigjur të gjitha thirrjeve për tetë demonstratat, prej prillit gjer në korrik 1981.

– Emrat e shokëve të cilët kanë ardhur në Untergruppenbach për ngushëllime, pas atentatit të 17 janar 1982 dhe në fund

-Emrat e grupit më të rëndësishëm, më të madh që e kanë përbërë atë masë të mjaftueshme kritike pas të cilës Flaka e pashuar e Lëvizjes në Untergruppenbach nuk është shuar kurrë, ku hyjnë aktivistë nga shumica e qyteteve të Gjermanisë, Zvicrës, Turqisë, Belgjikës, SHBA, Suedisë, Australisë, Argjentinës e vendeve të tjera, përmes të cilëve janë vendosur kontaktet me rrugë të ndryshme, janë kryer aktivitete të ndryshme, dhe tek të cilët, në vitet 1982-1983 ka mbërri *Zëri i Kosovës*, me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës:

"Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme."

Sa i përket temave një pjesë janë marrë nga vepra e botuar e Jusufit. Pjesën tjetër, më të madhe, ka të bëjë ngjarje dhe me renditjen e koncepteve të ndryshme nga fusha e sociologjisë, dhe pak nga politika e filozofia.

Kur jemi tek çështjet e koncepteve sociologjike dhe filozofike, mendoj se lexuesit nuk kanë të drejtë ta kërkojnë atë rigorozitet, origjinalitet apo precizitet, siç kanë të drejtë ta kërkojnë prej meje, kur është në pyetje Historia e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, nga dhjetori 1979 deri në korrik 1985. Lexuesi duhet ta ketë parasysh emrin e këtij libri, "Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës". Pra ky libër nuk është fjalor i sociologjisë dhe nuk është tekst i përpiluar që t'u shërbej studentëve të sociologjisë.

Termat e sociologjisë, që jepen këtu, janë të përkthyera, të cilat kanë marrë formën e tyre në vitet 1970 e 1980, në gjuhët e mëdha, dhe gjenden në listat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Lexuesit duhet ta kenë parasysh se terminologjia e trajtuar nganjëherë është terminologji e tillë ku zgjidhja e shumë problemeve gjuhësore mund të bëhet vetëm nga grupe autorësh që janë të lidhura me institucionet e arsimit të lartë. Tek të gjitha konceptet e sociologjisë termin në anglishte, **me germa të plota** të vogla e kam lënë ashtu si janë në anglisht. Në disa raste kam bërë përkthimin e termit e në shumë raste e kam lënë ashtu siç është dhe jam marrë me përkthimin e përmbajtjes së atij koncepti.

Futja dhe përdorimi i tremave të sociologjisë e filozofisë ka për qëllim që të shërbejë si ndihmesë për thellimin e kuptimit të Historisë së Lëvizjes së Jusuf Gërvallës. Ata që kanë kërkesa më të mëdha nga këto fusha me siguri që edhe janë të furnizuar me literaturën përkatëse.

Pas publikimit të serisë së librave të mi për Rilindësit e Shtutgartit, në disa raste, disa shokë më kanë thënë se mirë ke shkruar sa i përket kohës e viteve 1980-1984, por mos harro se ne aktivitet të madh dhe të pandalshëm kemi bërë deri më 1999 e ti për atë kohë nuk kishe shkruar fare.

Kjo është e vërtetë. Por ky qëndrim i imi i ka shkaqet e veta. Pasi kam qenë si aktor në qendër të aktivitetit që është bërë në Shtutgart në vitet 1981-1984, unë jam ndalë më së shumti në këtë periudhë, qoftë nga dëshira ime, qoftë nga e drejta dhe obligimi moral, qoftë nga fakti kur për këtë kam qenë i detyruar. Në këtë drejtim detyrën time të domosdoshme e kam kryer. Unë kam shumë respekt për punët e mira që janë bërë edhe pas viteve 1984 e 1985, dhe pikërisht në shenjë respekti nuk merrem me trajtimin e asaj

epoke. Pse? Sepse nëse them diçka në formë të kritikës negative, të tjerët mund të thonë se po flet keq për të vetmin shkak se nuk ka qenë vetë pjesëmarrës në ato punë. Nëse them diçka pozitive apo shumë pozitive, do të ekzistonte rreziku me ra në pozitë të keqe, pasi njerëzit e aktorët tjerë mund të thonë, se mundohet me u bërë biber i secilës çorbë, me u bërë hisedarë në meritat dhe mundin e të tjerëve. E është pikërisht e kundërta. Ajo pjesë që e kam më mjafton, dhe nuk kam arsye të lakmoj në pjesën e mundin e të tjerëve. Në qoftë se unë e kam parashtruar në mënyrë besnike aktivitetin e shumicës së shokëve për vitet 1980-1984, atëherë me këtë u është lehtësuar puna të gjithë atyre që duan të merren jo vetëm me atë kohë por edhe t'i gjejnë shtyllat e periudhës së viteve 1985-1999.

Kjo do të thotë se, si në shkrimet e më parme, edhe në këtë libër, jam ndalur vetëm për atë epokë e cila për mua dhe shumë të tjerë konsiderohet si THEIR FINEST HOUR.

A

accomodation *akomodim*, proces apo rezultat i tij, që do të thotë se, kur ekziston konflikti në mes dy apo më shumë individëve apo grupeve, ai konflikt zgjidhet apo zbutet përmes lëshimeve reciproke.

acculturation *akulturim* proces apo rezultat i tij, me ç'rast dy apo më shumë kultura të ndryshme ndeshen dhe gjatë atij procesi në masë më të madhe apo më të vogël marrin elemente prej njëra tjetrës.

achieved rol *rol i arritur, rol* të cilin individi e ka në një grup ose në një shoqëri dhe mbajtja - ruajtja e rolit është e lidhur me veti ose atribute që individi të paktën deri në njëfarë mase i ka krijuar vet. E kundërta është *rol atribues*, i cili i ipet në bazë të kritereve që individi nuk mund t'i kontrolloj. P. sh. roli si politikan është rol i fituar, ndërsa ai si grua është *atribues*.

achieved status *status i arritur* Status të cilin një individ e ka në grup apo në shoqëri, të cilin ai e ka arritur përmes sjelljeve të tij apo i ka krijuar disa atribute që çmohen. E kundërta e kësaj është *status atribues*, i cili bazohet në kritere mbi të cilat individi nuk ka ndonjë kontroll. Profesioni dhe shkollimi në shoqëritë perëndimore janë të lidhura, si rregull, me statusin e arritur që individi do ta ketë në shoqëri. Në shoqëri të ndryshme potencohen në mënyra të ndryshme *statusi i arritur* dhe ai *atribues*. Në shoqëritë industriale potencohet si rregull statusi i krijuar, ndërsa ai atribues dominon në ato feudale.

achievement motive Individi ka një nevojë të çmohet-lavdërohet prej të tjerëve dhe mund të ketë një mendim të lartë për vetveten. Nyja e lidhur me këtë nevojë është (achievment motive), që do të thotë se individi lufton për të bërë diçka që është e vështirë, sidomos në gara me të tjerët. Ai don të kryej detyrën në mënyrë sa më të plotë dhe sa më të shpejt dhe lufton për t'i mundur kundërshtarët me të cilët ai është në garë. Ai në mënyrë të vetëdijshme kërkon aso detyrash, të cilat, po që se kryhen, sjellin shpërblim të madh, qoftë kur ky shpërblim është material apo përbëhet nga vlerësimi i lartë prej të tjerëve.

acquired drive nevojë e fituar quhen në përgjithësi ato nevoja të cilat nuk janë të lindura. Të gjitha nevojat, që janë të karakterit social, llogariten në këtë grup, si dhe disa fiziologjike si p. sh. nevoja për alkool, droga dhe duhan.

acting crowd grup individësh të cilët papritmas fillojnë veprime të përbashkëta. Ata nuk përbëjnë grup, nuk kanë norma të përbashkëta, apo lidhje tradicionale me njëri tjetrin. Nuk kanë strukturë të organizuar dhe janë pa udhëheqës. **Acting crowd** dallohet nga *mob* (ku përdoret dhuna) pos të tjerash në atë se sjelljet e saj nuk është e domosdoshme të jenë të karakterit të dhunshëm.

action reserch hulumtim i cili përveç asaj që ka qëllim të mbledh informacion për ndonjë fenomen social, sjell tek veprimi praktik për ta ndryshuar atë situatë sociale që është në varshmëri me çështjen në fjalë. Sociologjia aplikative bazohet kryesisht në hulumtimet e këtij lloji.

adaptive culture pjesa e një *kulture*, që në mënyrë të kjartë pasqyron se elementet e saj janë të formuara për t'i përgjigjur atyre kërkesave që ambienti fizik i ka parashtruar, kushtëzuar.

ADEMI REMZI, (3 qershor 1952 – 15 gusht 1998), në vitet 1980-1983, në Gjermani ka pasë këtë adresë: Remzi Ademi, Marktstr. 29, 7129 Brackenheim, West Germany

Lindi më 3 qershor 1952. Shkollën fillore e kreu ne fshatin e lindjes ne Zhur. Me pas u regjistrua ne gjimnazin e Prizrenit.

Remziu si një ndër të parët në rrethin e Shtutgartit merr vesh për daljen e Jusuf Gërvallës jashtë. Ai merr kontakt me Jusufin qysh në muajt e parë pas daljes së Jusufit në Ludvigsburg, por kontaktet e tij më të shpeshtohen edhe më shumë kur Jusufi e Bardhoshi vendosen në Untergruppenbach, fshat ky i cili gjendet 20 kilometra larg nga qyteza e Remziut, Brackenheimi. Në mesin e shokëve të Vëllezërve Gërvalla, gjeografikisht, Remzi Ademi ka qenë më së afërmi. Por afërsia gjeografike nuk ka qenë asgjë në krahasim me atë afërsi që i ka bashkuar puna e tyre. Remziu në verën e vitit 1980 pranohet nga Jusuf Gërvalla, si anëtar i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës.

Remzi Ademaj, me kurorë në dorë gjatë ceremonisë së varrimit
të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, më 5 shkurt 1982
në varrezat e Bad Canstatit në Shtutgart.

Remziu me punën e tij është dalluar sidomos pas atentatit të 17 janarit kur u vranë Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Ai ka qenë njëri ndër ata që më së shumti ka

qenë i pranishëm në familjen Gërvalla në javët dhe muajt pas 17 janarit. Si tregues të kësaj flasin e shënimet për rrethin e gjerë që kishte Remzi Ademi sidomos në Mynhen.

Më 5 shkurt 1982 e ka lexuar fjalimin kryesor "Ju u bëtë pronë e brezave" të shkruar nga Xhafer Durmishi, me rastin e varrimit të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, fjalim e i cili i botua në numrin 3 të Zërit të Kosovës, që doli nga shtypi në mars 1982.

Me iniciativë të Remziut maqina e shkrimit e Jusuf Gërvallës dhe Xhafer Durmishi i cili në atë kohë punonte me atë maqinë në nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" u vendosën në banesën e Remziut, në gusht 1982, në Marktstr. 29, në Brackenheim. Në Branckenheim, në këtë adresë Remziu ka banuar në katin e dytë të shtëpisë, ndërsa në katin e parë ka banuar Selim Dulla. Aty u përgatit për botim numri i dytë i revistës "*Zëri i Kosovës*" si organ i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.

Më 11 nëntor 1983 me rastin e mbajtjes së një koncerti të organizuar nga konsullata jugosllave e Shtutgartit, pas brohoritjes së parullës "Kosova-Republikë" agjentët e konsullatës jugosllave sulmojnë ata që brohorasin këtë parullë, me ç´rast krijohet një tollovi e madhe e vjen gjer tek përleshja fizike me agjentët jugosllavë. Me këtë rast arrestohet bërthama e organizatorëve të Shtutgartit dhe dënohen me kohëzgjatje të ndryshme burgimi. Në këtë grup, në mesin e atyre që u dënua me dënimin më të madh ishte Remzi Ademaj, që u dënua me 5 javë burg.

Më 11 dhjetor 1985, për hir të Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Remziu niset për në kufirin italo-jugosllav me detyrë që të merr pjesëtar të familjes Gërvalla dhe t'u ndihmoj të dalin në Gjermani apo Zvicër. Në këtë detyrë arrestohet dhe pas procedurave të ndryshme bien në duart e policisë jugosllave dhe dënohet me 6 vjet burg. Adresa e fundit e Remziut përmes të cilës kam komunikuar është: Remzi Ademaj, Brackenheimerstr.13, D- 7129 Göglingen-Frauenzimmer.

ADEMI ALI lindi me 12 korrik1945 në fshatin Pestovë, rrethi i Vushtrrisë. Në vitin 1968, ai i merr rrugët e mërgimit, së pari në Austri. Pas Austrisë, Aliu në vitin 1970 kalon në Gjermani. Ali Ademi, në Hamburg i ka takuar atij rrethi që shpirtërisht, për historinë, për kulturën shqiptare e për Aleksandër Moisiun, është ushqyer nga Isak Gutaj. Nga afër me te, ne shokëve të Shtutgartit na ra të njihemi pas 17 janarit 1982. Gjatë jetës së tij në Hamburg, përveç mësimeve të shumta, në mënyrën më të përsosur e mësoi dialektin e Tetovës, dhe ishte person shumë i dashur për tetovarët.

Aliu për 18 vite nuk u takua më të afërmit e tij, mbeti pa vizituar Pestovën. Vdiq në tetor 2008.

adolescence pjesë e ciklit jetësor të individit që është e njëkohshme me pubertetin dhe përfundon me atë kur ai nga shoqëria konsiderohet i rritur.

adjustment përdoret kryesisht në psikologji dhe në psikologjinë sociale, ku paraqet përshtatjen e individit ndaj ambientit social dhe fizik. Nocioni haset edhe në sociologji, ku me adjustment synohet adaptimi i ndonjë njësie sociologjike në ambientin e vet. Në atë rast përdoret si sinonim për adaptim.

aesopian language gjuhë e cila i përdorë ato fjalë dhe fraza të cilat normalisht janë të një gjuhe, por atyre u jepet një përmbajtje, që dallohet prej normales. Gjuha përdoret që të mund të dërgohen mesazhe që nuk kuptohen nga të tjerët përveç atyre që i kanë të njohura ato.

AFËRDITA. Veprën letrare të Jusuf Gërvallës, e cila është botuar në katër vëllime, në

Prishtinë, më 2010, me një parathënie të Sabri Hamitit, nga kallnori 1992, e kam studiuar në tërësi në atë mënyrën time. Megjithatë, në tërë punimet e mia deri më sot, me disa përjashtime, janë ndalur vetëm tek vepra politike e Jusufit, pasi atë e konsideroj më të rëndësishmen, dhe jo vetëm unë por edhe vetë Jusufi, veprimtarinë e tij në Gjermani e ka konsideruar më të rëndësishmen në jetën e tij. Në këtë fjalor, nga vepra letrare kam marrë vetëm shkrimin për AFËRDITËN E MUSHTISHTIT, pasi ai përveç vlerave kulturore e artistike ka një peshë të jashtëzakonshme kombëtare dhe politike. Ky shkrim është marrë libri: Jusuf Gërvalla, Vepra, Publicistika, Vëllimi 3, Prishtinë 2010, faqe 215-217.

"AFËRDITA" E MUSHTISHTIT
(SHKURTE FEJZA DHE SHYHRETE BEHLULI)

Në një kohë si kjo, kur shoqëri të njohura kulturore-artistike, për shkaqe të ndryshme objektive (më së shpeshti të natyrës materiale) dhe shoqëri të tjera me traditë relativisht më të shkurtë se të qendrave tona të mëdha, thuaja po tërhiqen nga jeta publike dhe aty këtu po pasivizohen për një kohë të gjatë, nga ana tjetër, nëpër disa qendra fare të vogla, e më së shpeshti nëpër disa fshatra të Krahinës sonë, po lindin shoqëri të reja me përkushtim të kultivimit të programeve kulturore e sidomos muzikës popullore.

Një mori shoqërisht të tilla mundën të vërehen edhe në Festivalin muzikor të të rinjve, të mbajtur muajin e kaluar në Prizren. Ndër to do të mund të përmendim shoqëritë kulturore-artistike "Sythi i ri" e Suharekës, "Ndërtimtari" e Vuçiternës, "Katarina Josipi" e Zymit, e të tjera. Një gjë është karakteristike për të gjitha shoqëritë e tilla: duke mos pasur përvojë aq të gjatë në këtë lëmi dhe duke qenë akoma të ballafaquara me pengesa të ndryshme materiale, që një ditë do të mund të bëjnë të veten, ato ushtrojnë me vetëmohim të madh, "gëlltisin" me përpikëri këngët e zgjedhura për repertor, dhe i përgjigjen çfarëdo ftese për pjesëmarrje në ndonjë manifestim muzikor, gjë që entuziazmin e tyre e ngrit në nivelin më të lartë.

Shembull i përshtatshëm në këtë drejtim është Shoqëria kulturore-artistike "Afërdita" e Mushtishtit, e cila vepron në kuadër të shkollës fillore të këtij fshati të Komunës së Suharekës. Shoqëria u formua para do kohe, me iniciativën e arsimtarëve të shkollës, të cilët, për të bërë çfarëdo organizimi të kohës së tyre të lirë, shtrëngoheshin të zbrisnin në Suharekë, e, meqë edhe këtu jeta kulturore është fort e varfër, atëherë në Prizren. Së shpejti u tubuan disa arsimtarë, i morën në dorë instrumentet muzikore, i tubuan edhe disa nxënës, dhe ia nisën punës. Ushtruan me ngulm. Dolën disa herë para publikut të fshatit dhe nuk patën si të mos e ndiejnë veten të sigurt kur erdhi koha të paraqiteshin edhe në një manifestim të madhe: në Festivalin muzikor të të rinjve, në Prizren.

Dhe, pse të ngurronin këta amatorë të vyeshëm!?

Më 26 maj, në Shtëpinë e kulturës në Prizren, kur në skenë akoma gjendeshin amatorët e "Sythit të ri" të Suharekës, që e kishin hapur programin e mbrëmjes popullore të Festivalit të të rinjve, anëtarët e orkestrës dhe këngëtarët e reja të "Afërditës" së Mushtishtit rrinin prapa kulisave si para një sprove të madhe: a do të ketë vallë edhe këtu peshën e vet programi i tyre siç e kishte në fshat? Si do të shkoj puna me muziktarët e parryer sa duhet? Me komplekse të tilla, amatorët e Mushtishtit i filluan dhjetë minutat e tyre në skenë. Pa pompozitet, po me njëfarë vetëbesimi që nuk vërehet në sy të parë, ia thanë valles së parë. Priu me harmonikë udhëheqësi i shoqërisë, Ibrahim Hamiti, e ndoqën arsimtarët e tjerë, me violina e mandolina dhe vogëlushja Shkurte Fejza, me daire. Pastaj doli në skenë interpretuesja e vogël Shyhrete Behluli, nxënëse e klasës VI fillore. Me një zë tërheqës, me një qëndrim prej një këngëtarje të rryer, ia tha këngës.

Pastaj e këndoi edhe këngën tjetër, i lëshoi radhën moshatares së vet Shkurtes, dhe kështu mbaruan edhe dhjetë minutat e programit.

Ishin këto dhjetë minuta, që e habitën publikun e Prizrenit, i cili kishte pritur fare pak ose aspak nga një shoqëri e panjohur.

"Këngëtare si Shyhretja e Shkurtja, ka shumë në Mushtisht, dhe në raste të tjera, edhe atyre do t'u vijë radha të paraqiten para publikut, na tha udhëheqësi i shoqërisë Ibrahim Hamiti. Nëse na pranojnë në Ferizaj në Festivalin amator "Kosovarja këndon", besoj se përfytyrimi për shoqërinë tonë do të jetë më komplet". (Jusuf Gërvalla, Vepra, Publicistika, Vëllimi 3, Prishtinë 2010, faqe 215-217)

affinity *afinitet* 1. Në kultur-antropologji përdoret nocioni për të treguar relacionet farefisnore tek të cilat vihet përmes martesës. Një shembull për këtë është kur burri përmes martesës vjen në relacion farefisnie me farefisët prej gjaku, të gruas.
2. Në psikologji përfytyrimin se duhet të ekzistoj barazia në mes objekteve, për të bërë të mundur që individi të krijoj asociacione për to.
3. Në filozofi shpreh relacionet në mes objekteve që i takojnë të njejtës klasë.

agent provocateur person i cili në fshehtësi është i punësuar, nga pushteti, për t'i nxitur personat apo grupet tjera të kompromentohen dhe në këtë mënyrë t'i ekspozoj ata për përbuzje sociale apo për t'i ndjekur me ndihmën e ligjeve të pushtetit. Qëllimi me këtë është eliminimi i personave apo grupeve, kundër të cilave veprimet provokative janë të drejtuara.

agglomeration 1. ndërtesa banimi që janë të koncentruar në një sipërfaqe të vogël.
2. Populllsi që përmes banimit të vet është e koncentruar në një sipërfaqe të vogël.

aggregate individ që janë të tubuar në një rreth gjeografik. Ata nuk kanë lidhshmëri tjera dhe në këtë mënyrë nuk përbëjnë *grup*.

agrarian radicalism Disa grupe që merren me bujqësi dhe ndërmarrje anësore kanë tendencë që në masë të madhe të votojnë për partitë e majta. Kjo vlen më së shumti për bujq që e mbjellin vetëm një kulturë bimore dhe punëtorë të prerjes së drunjve. Të dyja grupet kanë të ardhura të pasigurta pasi janë të mvarura nga çmimet e tregut të një produkti të vetëm. Kjo do të thotë se të gjitha lëvizjet e çmimeve në atë mall ndikojnë në të ardhurat e tyre. Radikalizmi agrar është përshkruar më hollësisht nga S. Lipset në *Political Man* (1959).

agrarian society *shoqëri agrare – ideal type* që pos tjerash karakterizohet në atë se veprimtaria ekonomike është e ndërtuar rreth pasurive të patundshme të bujqësisë, ka një shkallë të lartë të urbanizimit në krahasim me shoqërinë hurtikulurale, se një pjesë e kufizuar di shkrim e lexim, dhe religjioni është i lidhur fort me aparatin shtetëror. Një shembull për tipin e kësaj shoqërie është Rusia nga vitet 1500-1700.

agricultural ladder 1. Lëvizshmëri vertikale (*mobilitet*) tek populllsia që merret me bujqësi.
2. Proces për ata që janë të inkuadruar në bujqësi. Ai fillon me atë kur ndokush e fillon punën si argat me pagesë dhe mbaron me atë kur ata vetë bëhen pronarë të tokës bujqësore.

AGUSHI ELFI lindi më 1944, në fshatin Goden i Vogël, komuna e Gjilanit. Është mërgimtar i vjetër, që i takon brezit të parë, që morën botën në sy. Më 1969 shkoi në Gjermani dhe pas tri vjetësh, pra më 1972, u vendos në Zvicër. Që në vitin 1970 filloi ta lexonte revistën "Shqipëria e re", të cilën pastaj e dërgonte në Kosovë për ta lexuar rinia studentore. Ngjarjet e vitit 1981 e gjejnë në Gjenevë. Pas atentatit të 17 janarit 1982, së bashku me **Shaqir Shabanin** dhe shokë të tjerë është ndër të parët që vjen në Untergruppenbach, dhe nga ata që ndihmon më së shumti.

Elfi Agushi jeton në Gjenevë dhe, si gjithnjë përpiqet të jap maksimumin për ndërtimin e Kosovës së idealeve të tij. (Ismet Rashiti, Rrëfanë lirie, Prishtinë 2010, f. 160-164)

AHMETAJ DINË – Dinë Ahmetaj; Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Dinë Ahmetaj, profesor nga f. Gllogjan, KK – Deçan, i lindur më 16 nëntor 1947, në të njejtin fshat, me profesion profesor i gjuhës dhe letërsisë anglo-amerikane. ... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh."*

AHMETI EJUP Veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ejup Ahmeti, 18 Rue Acasias Nr.205, CH-1225 Geneve. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

AHMETI XHEZAIR Veprimtar në SHBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Xhezair Ahmeti, 1830 Brooklyn, N. Y. 11210 USA. Ka qenë një ndër pikat në SHBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

AJDINI RAMAZAN Veprimtar në SHBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ramazan Ajdini, Il. Kristin Dr. 822 Schaumburg. Ill. 50195 USA. Ka qenë një ndër pikat në SHBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

AKSIOMË Parim a përgjithësim i nxjerrë nga përvoja, që nuk ka nevojë për vërtetim dhe që merret si pikënisje për një arsyetim ose për argumentimin e parimeve të tjera shkencore; një e vërtetë e qartë dhe e pranuar prej të gjithëve.

Jusuf Gërvalla*: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme."*

ALBANIAN KOSOVAR YOUTH in The Free World. Rinia kosovare në Botën e lirë: Organizatë në SHBA që në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: 439 West 46 Street NewYork N.Y. 10036 USA. Ka qenë një ndër pikat në SHBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej saj ka qenë 5.

alienation ndjenjë kur e ndien veten të huaj. Nocioni është përdorë nga Karl Marks në *Nationalökonimie und Philosophie* (1844). Ai mendon se punëtorin në shoqërinë kapitaliste e ndien veten të huaj, për shkak se puna nuk i jep mundësi për një ekzistencë kuptimplote. Ajo nuk i jep kënaqësi, për shkak se ai nuk ka kontroll mbi atë produkt që e prodhon. Marksi mendon gjithashtu se individi do të ndihet i huaj edhe para vetvetes.

Nocioni alienation është përdorur edhe në shumë kuptime tjera pos kësaj. Një përpjekje për të përcaktuar përmbajtjen e këtij nocioni është bërë nga M. Seeman, në një artikull në *American Sociological Review* (1959:6), On the meaning of the alienation. Ai mendon se ka pesë kuptime të nocionit alienation:

1. pafuqishmëri; individi nuk mund të ndikoj në ato vendime, që kanë të bëjnë me zhvillimin në ambientin e tij social,
2. pakuptimshmëri; individit i duket se i mungojnë udhëzimet për veprimet e tij,
3. panormësi; individi e përjeton gjendjen e tij në atë mënyrë, sa atij i duhet të përdori mjete të paligjshme për të arritur qëllime të caktuara në rrethin e tij kulturor,
4. izolim; individi nuk mund t'i pranoj qëllimet e caktuara të mjedisit kulturor,
5. E ndien veten të huaj para vetvetes, individi nuk arrin të inkuadrohet, të krijoj marrëdhënie pune, që ia forcojnë vetëbesimin.

Të gjitha këto rrethana, sipas Seeman, e kanë origjinën tek ajo strukturë sociale, veçanërisht tek ajo pjesë që është krijuar përmes industrializimit.

alloplastic adjusment *përshtatje aloplastike* formë e adaptimit, kur individi përpiqet t'i arrij qëllimet e tij duke e ndryshuar mjedisin e tij.

amalgamation shkrirje e dy apo më shumë kategorive biologjike, që dallohen qartë, në një të vetme. Kjo shfaqet si rregull kur dy raca ndërveprojnë intensivisht me njëra tjetrën.

ambivalence *ambivalencë* Tek individi vijnë në shprehje dy apo shumë ndenja kundërthënëse emocionale ndaj një objekti të caktuar.

ambivert lloj personaliteti që qëndron në mes atyre që janë *introvert* dhe *extrovert*.

amentia Kapacitet i ulët mental. Si rregull do të thotë një IQ nën 70.

AMET TUS, veprimtar në Belgjikë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Tus Amet, Rue de skater ventes 53, 1080 Bruxelles Molemberk. Ka qenë një ndër pikat në Belgjikë prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

amnesty *amnesti* falje e njëkohësishme e një grupi personash të cilët si rregull gjenden të burgosur për shkak të veprave të natyrës politike.

AMNESTY INTERNATIONAL është një organizatë vullnetare NGO (OJQ=Organizatë Jo-Qeveritare) që vepron për të drejtat e njeriut. Puna bazohet në Deklaratën e përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e njeriut, të 10 dhjetorit 1948, si dhe konventave në fuqi, për të drejtat e njeriut. Më 28 maj 2011, Amnesty ka festuar 50 vjetorin e saj, sepse atë ditë, më 28 maj 1961, në *The Observer* është publikuar një artikull që ka qenë krisma e fillimit të luftës për të drejtat e njeriut. Më parë Amnesty ka punuar vetëm me të drejtat politike, kurse sot puna është zgjeruar dhe përfshinë luftën kundër shkeljeve të rënda të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Amnesty e konsideron veten të pamvarur në pikëpamje politike dhe religjioze.

Jusuf Gërvalla: *"Puna e parë që bëra, u bëra një telefon shokëve të ambasadës shqiptare në Vjenë. I njoftova për çështjen time dhe i luta të më ndihmojnë me ndonjë këshillë për të mos bërë ndonjë gabim ideologjik a taktik gjatë strehimit tim në këtë vend kapitalist. Ata, si zakonisht, u treguan të kursyer, po megjithatë patën njëfarë*

mirëkuptimi. Pastaj, sipas marrëveshjes që kishim së bashku me ty, unë informova Organizatën e Amnestisë Ndërkombëtare dhe Radio Londrën për gjendjen e vështirë në Kosovë dhe për burgosjet masive politike të shqiptarëve. Me sa di, Radio Londra s'ka marrë gjë para sysh, kurse Amnestia I. e dërgoi menjëherë tek unë përfaqësuesen e vet nga Londra dhe mori përsipër për përkujdesjen për të gjithë ata të burgosur politikë shqiptarë, për të cilët unë ia dola ndërkohë të mbledh ndonjë shënim." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 258)

anarchy *anarki* gjendje kur aparati i pushtetit të shoqërisë nuk funksionon dhe aty ku mungojnë apo nuk janë zhvilluar rregulla kohezive të pranueshme, që i drejtojnë-rregullojnë relacionet sociale.

anarchism *anarkizëm* drejtim filozofik dhe politik, që qëndron për heqjen e rregullimeve politike dhe të llojeve të tjera në shoqëri që kanë të bëjnë me relacionet shoqërore. Mendohet se një rregullim është i panevojshëm, pasi individët bashkëveprojnë më së miri, kur nuk vjen ndonjë presion prej së jashtmi. Ekzistojnë dy qëndrime lidhur me të drejtën mbi pronën. Ai individual, sipas të cilit të mirat materiale duhet të jenë pronë e individit dhe të administrohen nga individi dhe ai komunist, sipas të cilit të mirat materiale duhet të jenë pronë dhe të administrohen nga grupe vullnetare, në formën e bashkësive prodhuese dhe konsumuese.

androcentrism Vetit dhe sjelljet burrërore përbëjnë kriterin me rastin e vlerësimit të individit.

androcracy Shoqëria dominohet nga burrat dhe pushteti i tyre bazohet kryesisht në forcën fizike.

ancestor cult grup i vogël, shpesh herë vetëm familja apo farefisi, e krijojnë një njësi religjioze me rastin e adhurimit të stërgjyshërve të vdekur.

ancestor worship ritual fetar që ka të bëjë me adhurimin e të parëve, stërgjyshërve. Ky adhurim bazohet në besimin se stërgjyshërit mund të ndikojnë në situatën jetësore të të gjallëve.

anomy *anomi* 1. Panormësi.

2. Sipas përshkrimit të E. Durkheim në *Suicide* (1897) anomi do të thotë kur ekzistojnë norma kundërthënëse në shoqëri, me fjalë tjera ato norma që ekzistojnë janë dobët të integruara. Kontrolli social është i ulët. Kjo shoqëri sjellë, pos të tjerash, deri tek ajo që Durkheim e quan vetëvrasje anomike.

3. Sipas përshkrimit të R. Mertonit në *Social Theory and Social Structure* (1957) anomi është një gjendje në shoqëri ku objektivat e caktuara që aprovohen në aspektin social dhe kulturor për grupe të mëdha nuk janë në përputhshmëri (nuk janë të arritshme), me ato mjete që kanë karakter institucional, në të cilat ata kanë qasje. Kjo gjendje e frustruar tek e cila vjen në këtë mënyrë, për shumë individ, sjell tek përpjekje të ndryshme për ta zgjedhur atë.

anomic society *shoqëri anomike* shoqëri në të cilët anëtarët komunikojnë shumë pak apo aspak me njëri tjetrin dhe shumë pak marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme të saj. Shkalla e integrimit është e ulët.

anxiety *ankth* një ndjenjë alarmi, tensioni dhe pakëndshmërie përball një rreziku të pritur, origjina e të cilit (rrezikut) është kryesisht e panjohur për individin dhe që mund të gjendet brenda ose jashtë vetë atij. Ankthi dallohet nga frika, pasi frika është një përgjigje emocionale rëndom ndaj një kërcënimi të jashtëm, për natyrën e të cilit (kërcënimit) individi është i vetëdijshëm.

aspirations level *nivel i ambicjeve* ai nivel në të cilin gjendet një caku, aspirata, ambicia të cilin individi dëshiron ta arrij. Sa poshtë apo sa lartë gjendet aspirata mvaret prej shumë faktorëve, pos tjerash mjedisit social në të cilin vepron individi. Ku e cakton nivelin e ambicies pjesërisht është e pamvarur nga ajo që quhet realisht për t'u arritur.

antagonistic cooperation do të thotë se dy apo më shumë grupe ose individ bashkëpunojnë për ta arritur një qëllim të përbashkët, edhe pse ka fusha të tjera të interesit në të cilat ata janë kundërshtar - antagonist. Nocioni është futur në sociologji nga W. G. Sumner në *Folkways* (1906).

anticipatory socialization individi përvetëson parafytyrimet, vlerat dhe normat që janë të shfaqura, apo i ka një grup anëtar i të cilit ai nuk është, por që dëshiron të bëhet. Sjellja e tillë i ka dy funksione për individin:

1. ai e ka më të lehtë të fitoj anëtarësi në grupin referues, nëse ai para se të bëhet anëtar i mëson normat e grupit, etj.
2. ai e ka më të lehtë t'i përshtatet grupit të ri, kur apo nëse bëhet anëtar. Për t'u arritur këto përparësi duhet që shoqëria apo grupet në fjalë të jenë relativisht të hapura, në mënyrë që individi me të vërtetë të ketë mundësi të bëhet anëtar.

Në raste tjera *anticipatory socialization* mendohet se është një ngarkesë, barrë negative, sidomos kur sistemi i vlerave, i grupit aktual dallohet shumë prej grupit në të cilët dëshirohet të bëhet anëtarësimi.

ANTITEZË 1. Gjykim që i kundërvihet një teze, tezje apo daje. 2. Vënia përballë e dy nocioneve a mendimeve për t'i dhënë shprehjes forcë e qartësi. 3. Diçka a dikush që i kundërvihet tërësisht diçkaje a dikujt tjetër.

antropocentrism parafytyrimi se njeriu është në qendër të gjithçkafit dhe se të gjitha objektet tjera janë të dorës së dytë në krahasim me te.

antropogeography i kushton rëndësi studimit të faktorëve gjeografik që kanë ndikim në sjelljen e njeriut.

antroplology *antropologji* Shkenca që studion veçoritë e përbashkëta biologjike dhe kulturore të zhvillimit të njeriut.

antropolotry adhurimi i njerëzve sikur ata të ishin zotëra.

aposteriori-probability probabiliteti se një ngjarje do të ndodhë bazohet në ngjarje faktike që veç kanë ndodhur në mënyrë frekuentive lidhur me fenomenin në fjalë dhe jo siç është rasti tek *apriori probability.*

apriori probability ai probabilitet sipas të cilit një ngjarje mund të ndodh në bazë të kalkulimeve teorike dhe jo siç është rasti tek *aposteriori probability* në bazë të observacioneve faktike.

ARBEITERWOHLFAHRT (AWO) Bashkimi për Mirëqenien e Punëtorëve (AWO) është organizatë e decentralizuar bamirëse gjermane, e ndërtuar në bazë të anëtarësimeve personale në shoqata lokale. Me rreth 145.000 të punësuar me orar të plotë është një ndër punëdhënësit më të mëdhenj në Gjermani. Detyra e tij kryesore është t'u ndihmoj në pikëpamje sociale njerëzve në gjendje të vështirë.

Bardhosh Gërvalla ka qenë i punësuar në Arbeiterwohlfart. Zyra e tij e punës ka qenë në: Solitudestr. 44, Ludwigsburg, Telefoni: 07141-26091

Është themeluar më 13 dhjetor 1919, pikërisht 60 vjet para se Jusuf Gërvalla më 14 dhjetor 1979 detyrohet të arratiset nga Kosova. Pas marrjes së pushtetit prej Adolf Hitlerit, organizata ndalohet. Disa aktivist të saj vazhduan punën në ilegalitet, siç ishte Joan Kirchner, i cili u ndihmonte aktivistëve të rrezikuar te lëvizjes punëtore të shkonin në ekzil.

Pas Luftës së Dytë Botërore AWO, në Hanover, formohet si një Organizatë ndihmëse (Hilforganisation), e pavarur në pikëpamje politike dhe religjioze. Në zonën e okupuar nga Bashkimi Sovjetik, dhe më vonë në Republikën Demokratike Gjermane (DDR) veprimtaria e saj ndalohet. Pas ribashkimit AWO vepron në të gjithë vendin. Zyra qendrore e AWO është në Berlin.

artifact 1. Çdo objekt që është krijuar nga njeriu.

2. Në sociologji, shpesh rezultate empirike deri tek të cilat ka ardhur nëpërmes vetë mënyrës së mbledhjes së të dhënave, apo gjatë procesit të përpunimit të të dhënave. Kjo do të thotë se rezultatet nuk kanë ndonjë korrespondim në mjedisin social në të cilin është bërë hulumtimi.

assimilation proces kur një grup, rëndom i përbërë nga ndonjë pakicë apo nga imigrant, largohen nga kultura e vet me rastin e kontaktit me kulturën dominuese të shoqërisë. Nëse grupi tërësisht është asimiluar, ai nuk dallohet prej sjelljes së anëtarëve tjerë të shoqërisë.

assosiation bashkim individësh me një qëllim dhe rregulla të përbashkëta, të cilat drejtojnë relacionet në mes anëtarëve dhe anëtarëve dhe ambientit të jashtëm social. Edhe pse asociacioni mund të ketë aq anëtar sa edhe tërë shoqëria, ajo nuk është shoqëri ai nuk mund pos tjerash të siguroj vazhdimësinë e vetë përmes *reprodukimit*. Shoqatat dhe organizatat janë shembuj të asociacioneve.

asymmetric relation *relacion asimetrik* do të thotë se nga A pason B por nga B nuk mund të ketë si pasojë A. Relacionet e pushtetit janë të kësaj natyre. Nëse individi A ka pushtet mbi individin B, nuk është e mundur të vlej raporti i kundërt në të njejtën kohë. E kundërta e kësaj është *symmetric relation*.

atavism *atavizëm* rishfaqja e një vetie tek një individ që më parë ka ekzistue tek ndonjë stërgjysh i të parëve, por jo tek gjenerata e prindërve.

atomism pikëpamje sipas të cilës sjellja, apo vetit e një grupi duhet të shpjegohen duke u nisur nga ata individ që e përbëjnë grupin dhe se grupi nuk ka ndonjë mendim apo ekzistencë, që është e shkëputur prej anëtarëve individual të tij. E kundërta është *realism*.

attitude consistency, ajo gradë në të cilën *attityd-komponetet* kanë të njejtën valencë apo kompleksitet.

attitude interconnectedness shkallë me të cilën një atityd tek një individ është e lidhur me një apo më shumë atityda të tjera tek ai. Ajo mund të jetë e izoluar apo të jetë pjesë përbërëse

attitude *atityd* orientim i qëndrueshëm ndaj një objekti në botën e parafytyrimeve të individit. Ajo është e ndërtuar prej tri komponenteve të ndryshme.

1. Komponenta kognitive në të cilin përfshihet parafytyrimi i individit rreth objektit.
2. Komponenta afektive apo emotive përfshin qëndrimin emocional ndaj objektit.
3. Komponenta e gatishmërisë së veprimit ka të bëjë me atë se individi në një apo tjetër mënyrë duhet me qenë i gatshëm për të vepruar ndaj objektit. Komponentet e atitydës mund të ndryshojnë mvarshmërisht nga drejtimi që ato kanë ndaj objektit. Drejtimi në fjalë mund të jetë pozitiv ose negativ. Nëse të gjitha komponetet kanë të njejtin drejtim, atëherë atityda është në ekuilibër. Drejtimi i atitydës me emër tjetër quhet edhe valenca e atitydës. Komponetat mund të kenë shkallë të ndryshme të kompleksitetit, fillimisht duke qenë të ndërtuara prej vetëm një elementi e deri tek një shumë e tërë elementesh. Atityda ka shumë veti të tjera siç janë stabiliteti, ndikimi, intensiteti, forca, dukshmëria e jashtme dhe e brendshme. Një atityd e caktuar mund të jetë e izoluar prej atitydave tjera të individit apo mund të jetë e lidhur me disa të tjera duke krijuar kështu një lëmsh. Ato atityda që e përbëjnë një lëmsh të tillë mund të jenë në ekuilibër, p.sh. të gjitha mund të drejtim pozitiv ndaj objekteve të ngjashme, ose në ç'ekuilibër, p. sh. disa kanë drejtim pozitiv e disa drejtim negativ ndaj objekteve të ngjashme. Drejtimi i atitydës mund të ndryshoj. Kjo mund të bëhet ose në drejtim kongruent ose inkongruent. Si rregull atë është më lehtë me e ndryshua në drejtim kongruent, p.sh. një atitydë pozitivë me e bërë edhe më pozitive, se sa në drejtim inkongruent, p. sh. një atityd më parë pozitive me e kthye në atityd me drejtim negativ.

egoinvolvment of attitude Nëse një atityd është pjesë e pandashme e personalitetit të individit ajo është fuqishëm e lidhur me përjetimin e un-it të tij. E kundërta vlen nëse ajo nuk konsiderohet si pjesë e pandashme.

influence of atittude Një atitydë që ndikon në veprimet e shumë individëve thuhet se është me ndikim të madh dhe e kundërta vlen nëse ajo ndikim vetëm në disa.

stability of atittude atityda është stabile nëse ajo është e qëndrueshme për një kohë të gjatë dhe e kundërta vlen nëse ajo zhduket lehtë.

strength of atittude atityda është e fortë nëse ajo është vështirë të ndryshohet dhe e dobët nëse ndryshohet lehtë.

visibility of attitude Një atityd është e dukshme nëse në bazë të sjelljes së individit mund të vihet në përfundim se ai ka një atityd të caktuar.

valence of attitude drejtimi që një atityd-komponentë mund të ketë. Variacionet e saj mund të jenë prej shumë negative deri te shumë pozitive, ndaj objektit që i drejtohet atityda.

authority Në shoqëri apo nga shoqëria e drejtë legjitime dhe me këtë e pranueshme për të ushtruar pushtet. Ai apo ata që kanë autoritet munden që në mënyrë direkte ose indirekte të kenë ndikim në veprimet e individëve tjerë. Mjetet të cilat qëndrojnë në dispozicion për ta ushtruar këtë ndikim mund të jenë të karakterit fizik ose psikik p.sh. dhunë ose propagandë. Autoriteti mund të jetë legjitimuar në mënyra të ndryshme. Kështu Max Weber p. sh. mendon se kjo mund të bëhet në ti mënyra të ndryshme:

1. Autoriteti është tradicional, kur ushtrimi i pushtetit bazohet në parafytyrimin e atyre mbi të cilët ushtohet pushteti, se ky ushtrim gjithmonë është bërë sipas një mënyre të caktuar. Ky lloj autoriteti shfaqet para së gjithash tek sistemet sociale statike.
2. Autoriteti është karizmatik, nëse ata mbi të cilët ushtrohet pushteti e përjetojnë atë që ka pushtet si të thirrur për ta pasur atë. Ky lloj vjen në shprehje më së shumti në situata revolucionare.
3. Autoriteti është racional-ligjor nëse bazohet në rregulla abstrakte, por të pranueshme. Ky lloj shfaqet më së shumti në shoqërinë industriale. Sipas Weber-it organizata burokratike përshkohet nga ky lloj autoriteti.

authoritarian personality karakterizohet pos tjerash nga një shkallë e lartë e konformizmit, përuljes, agresivitetit, rigjiditetit, etnocentrizmit dhe kontroll të fortë të emocioneve. E kundërta është personaliteti demokratik. Ky lloj personaliteti është përshkruar nga T. W. Adorno dhe të tjerë në *The Authoritarian Personality* (1950).

authoritarian leadership lidership ku ai që udhëheq luan një rol dominant, kur qëllimet apo caqet e grupit përcaktohen dhe kur zgjidhen mjetet për t'i arritur ato qëllime. Pak ose aspak nga detyrat e lidershipit delegohen tek anëtarët e tjerë të grupit. E kundërta e kësaj është lidershipi demokratik.

autarchy *autarki* njësi sociale që vet i plotëson të gjitha kërkesat funksionale që i shtrohen asaj njësie.

autoplastic adjustment një formë e përshtatjes sipas të cilës individi i riformon dëshirat e kërkesat e tij në atë drejtim që ato të mund të plotësohen në atë mjedis në të cilin ai jeton.

AUTORIZIM ***Po të autorizohem nga Lëvizja****;* Jusuf Gërvalla*: "Kur është fjala për materialet që mora, përveç atyre me tituj "Në Kosovë dy njerëz u ngjallën" dhe "Adem Dema-Demaçi, simbol i rezistencës shqiptare", mendoj se të tjerët nuk kanë elemente të mjaftuara për një revistë çfarë e mendoj unë "Zërin e Kosovës". Në ta gjenden të* ***meta ideopolitike*** *dhe janë shkruar jo në nivel. Përveç kësaj, sidomos tash na duhen materiale me elementin e aktualitetit kosovar. Mendoj se në revistë duhet t'u përgjigjemi* ***një për një sulmeve jugosllave*** *dhe demagogjisë së vrullshme titiste. Dhe për këtë kemi se ku kapemi. Dhe, një pjesë të mirë të përgjigjeve të tilla, që do të bënin një punë sqaruese si për popullsinë tonë, ashtu edhe për të tjerët, e marr përsipër ta shkruaj unë vetë,* ***po të autorizohem për këtë nga Lëvizja****. Një gjë është fare e sigurt: tash e tutje, i forcuar moralisht, nuk do të kursehem për punë ditë as natë dhe besoj se puna nuk do të mbetet*

pa rezultate." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 265)

AVDULLAHU ENVER, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Enver Avdullahu 3.Rue des Pitons Ch-1205 Geneve tel 295205. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

AVDYLI BRAHIM. – BRAHIM AVDYLI: "*Për t`a njohur më mirë Kosovën, nga pikëpamja ime, si idhëtar dhe anëtar i LNÇKVSHJ-së, duhet të dimë se si është konceptuar më parë termi Kosovë, në përgjithësi. Në bazë të shpjegimeve të LNÇKVSHJ-së dhe atij shqiptar të asaj kohe, përveç se nën administrimin osman, në të cilën i kishte pesë vilajete, duke e përfshirë edhe vilajetin e Selanikut, ku kombi shqiptar ishte komb i mirëfilltë, termi "Kosovë" shprehte të gjitha territoret shqiptare nën Jugosllavinë1, e jo në përgjithësi vetëm territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës."* (KOSOVA ËSHTË NJË KOSOVË TJETËR NGA KJO QË E KEMI NJOHUR, www.pashtriku.org, 6 prill 2013)

Pamje nga demonstrara në Gjenevë, më 30 Maj 1981.
(Brahim Avdyli në ballë të demonstruesve)

Brahim Avdyli: "*I takoj plejadës së krijuesve të fundviteve shatëdhjetë dhe fillimviteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar (XX). Ka lindur me 05 shtator të vitit 1960 dhe i rritur në Morinë të Malësisë së Gjakovës, në një vend me tradita kulturore dhe kombëtare. Që në vitet e hershme të rinisë është dhënë pas dy prirjeve të veçanta: pas artit të fjalës dhe pas lëvizjes konspirative për lirinë dhe bashkimin e popullit shqiptar. Ndër të parët është vënë në krah të luftës çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në mes viteve 1990-1995 ka botuar revistën periodike gjithëshqiptare në Zvicër „Qëndresa" dhe ka qenë Kryeredaktor i saj. Shkollën fillore „Ganimete Terbeshi" e ka kryer në Morinë dhe në Ponoshec, sikurse gjimnazin „Hajdar Dushi" në Ponoshec dhe në Gjakovë me rezultat të shkëlqyeshëm. Fakultetin*

Filologjik e ka kryer në Universitetin e Prishtinës në Prishtinë, Drejtimi i Letërsisë dhe i Gjuhës Shqipe dhe jam Profesor i Letërsisë. Pas Universitetit ka kryer kursin pasuniversitar në Akademinë Diplomatike Shqiptare për Maradhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomacinë dhe ka filluar studimet pasuniversitare në Universitetin e Strugës, Fakultetin e Shkencave Politike, Drejtimi i Maradhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë, me ç`rast i ka përfunduar dhe ka mbrojtur temën e magjistraturës në lëminë e mërgatës shqiptare të Zvicrës. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (LSHK); anëtar i Shoqatës së Krijuesve Shqiptarë të Zvicrës (SHKSHZ), etj., dhe anëtar i Autorëve të Zvicrës (AdS)." (ILIRËT QENË TË PARËT NË EVROPË, www.pashtriku.org, 12 maj 2013)

AVDULLAHU MIFTAR, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Miftar Avdullahu, B. D. Santei Gorge 44 Geneve Suisse. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

AZIRI AZIR, veprimtar në Belgjikë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Azir Aziri, Chee de Haeht 486 1030 Brukselles Belgien. Ka qenë një ndër pikat në Belgjikë prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 15.

B

BACI HAXHI; Kushëri i afërt i Jusuf Gërvallës që për shkaqe ekonomike është larguar nga Duboviku dhe është vendosur në Jesenice ku ka jetuar, punuar dhe vdekur.

Jusuf Gërvalla: "*Kah ora dy pas mesnate, tashmë ditë e shtunë, i trokita në derë Skënder Blakajt. Me veturën e tij shkuam në Pejë, e morëm Salih Kastratin, dhe u nisëm për Jesenice, në kufirin jugosllavo-austriak. Rrugës kaluam mirë. Ata më lanë në oborr të **Bacit Haxhi**, kështu ishim marrë vesh dhe shkuan."* (Shënime nga Ditari*)*

BAJRAMI VEBI, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Vebi Bajrami, Günder Schharovskistr.6 (e dhëna e qytetit mungon). Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

BAKALLI MAHMUT –Mahmut Bakalli, politikan, lindi në Gjakovë më 19 janar 1936 dhe vdiq në Prishtinë më 14 prill 2006. Shkollimin e mesëm e kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin e shkencave politike e kreu në Beograd. Punoi si pedagog në Universitetin e Prishtinës, ishte Kryetar i Komitetit komunal të LK të Prishtinës, pastaj edhe kryetar i Komitetit krahinor të Lidhjes së "komunistëve" të KSAK-së si dhe anëtar i Kryesisë së Komitetit Qendrorë të Lidhjes së "Komunistëve" të Jugosllavisë nga viti 1971 deri më 1981.

BALLI i popullit**.** Jusuf Gërvalla: **"***Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme."*

Fjalët "*Në ballë të këtij populli*" shihet se kanë të bëjnë vetëm me BALLIN, por pjesa e dytë "*dhe te këmbët e këtij populli",* paraqet universalitetin e qëndrimit njerëzor ndaj detyrës, dhe duket sikur pjesa e dytë është edhe më e fuqishme, sikur pjesës së parë

i humb krejtësisht forca nëse i mungon pjesa e dytë. Nga kjo rrjedhë se fjalët e Jusuf Gërvallës e kanë atë gjerësi e atë thellësi që kurrë BALLI nuk e ka pasë.

band wagon teknik propagandistike sipas të cilës kur argumentohet për një ide, duhet thënë se ideja në fjalë veç është aprovuar prej një numri të madh njerëzish.

BAQAJ IMER, aktivist i rrethit të Deçanit, jeton në Suedi. Në një kohë të vitit 1981 e 1982 ka qenë refugjatë në Itali, në kampin Latina. Për ta vizituar nga Untergruppenbachu ka shkuar Bardhosh Gërvalla, kah fundi i tetorit 1981. Më 14 janar 1982, Jusufi ia dërgon këtë letër Imer Baçaj.

Jusuf Gërvalla: "*I dashur shok, Imer! 14 janar 1982*

Sapo morëm një letër nga ana jote. Po të përgjigjemi edhe në letrën e parë.

Më vjen shumë mirë që dukesh pak më i stabilizuar sa i përket gjendjes në kamp. Aq më mirë që së shpejti bëheshke edhe me dokumente udhëtimi. Shpresoj se nuk do të ikësh gjëkundi pa u parë me ne. Ne me gjithë qejf do të vinim të shiheshim edhe atje, por edhe ne jemi të zënë me punë, edhe rruga është shumë e largët dhe po bëhen shumë shpenzime.

Unë po vërej se je një njeri që nuk lëshohesh verbër në marrëdhënie me njerëz. Por, megjithatë mosha jote s'ka pasur si të pajisë edhe me përvojën e duhur për njohjen e plotë të njerëzve në situata të vështira si kjo jona. Konkretisht, personi, për të cilin më njoftoje ne letrën e fundit e i cili thotë se është i lindur në Shqipëri, ose dredhon për arsye të cilat për ty e ne janë të panjohura, ose është provokator dhe agjent i rrezikshëm. Nga Duboviku s'kemi kurrfarë të dhënash për ndonjë familje a njeri që të ketë dalë në Shqipëri, herët as vonë. Përveç kësaj nga të gjithë emrat që përmend ai person duke thënë që janë nga Duboviku vetëm një është real, ai i Emrush Berishës, i shpërngulur në Pejë. Duke u nisur nga shumë arsye, ne e diskutuam me shokë dhe vendosëm të të njoftojmë që prej atij njeriu, ndonëse personalisht nuk e njohim, ti duhet të ruhesh sa prej gjarprit. Asnjë e mirë s'mund të dalë prej tij, vetëm të këqija. Ai që ka dalë nga Shqipëria për t'i ndihmuar kosovarët, e të tillë sot nuk ka, të jesh i bindur, këtë sekret kaq të rëndësishëm nuk do ta thoshte ty, as të tjerëve.

Prandaj, sytë në ballë. Mos u largo në mënyrë të prerë prej tij dhe shtiru sikur nuk je informuar gjë për të. Largimi të bëhet dalëngadalë dhe në mënyrë të padiktueshme. Ndryshe, ai mund të bëhet i rrezikshëm aty për aty dhe të të dëmtojë menjëherë, në qoftë se ka menduar të të dëmtojë më ngadalë. Ne nuk dimë ku e ka ai forcën, por duhet ta ketë te armiku ynë, nuk ia dimë "misionin", por mund të jetë "mision" shumë i rrezikshëm. Aq më parë, pasi ti thua se ai është shumë i ngritur në pikëpamje ideopolitike. Do të thotë se ka mundësi të jetë ndonjë kuadër i lartë e i rëndësishëm i UDB-së.

Më në fund, duke të përcjellë të fala vëllazërore e revolucionare, të urojmë stabilizim edhe më të madh të gjendjes dhe syçeltësi edhe më të madhe.

J. Gërvalla (Shënim, dhjetor 2012: Këtë letër në vitin 2012 ma përcolli Imer Baqaj përmes Asllan Muharremit)

BARIÇ HENRIK. Jusuf Gërvalla: "*Ç'është e vërteta, fusha e interesimeve serbe në lëmin e gjuhësisë e të etnologjisë, nuk është gjithaq e ngushtë. Por, është gjithashtu e vërtetë se interesimi i shkencës serbe për studimin e gjuhësisë shqiptare ka qenë fare i kufizuar, për të mos thënë se ka munguar krejtësisht. (As M. Shuflaj as H. Bariç njohës të gjuhësisë, historisë dhe të kulturës materiale të shqiptarëve, nuk ishin serbë, po kroatë.)"* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 17)

BASHA XHAFER, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Xhafer Basha, Unterbiberger str. 26, 8000 München 83. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

BASHKIMI si gazetë e Frontit të Kuq. Në vitin 1979, del nga shtypi gazeta Bashkimi si organ i FRONIT TË KUQ. Si përfaqësues i Frontit paraqitet Ibrahim Kelmendi.

Në fillim të vitit 1980, Jusuf Gërvalla, pa e ditur të vërtetën se kush mund të qëndroj pas Frontit të Kuq i përgatit, komplet me punën e tij dy numra të gazetës Bashkimi si organ i Frontit të Kuq (në shkurt dhe prill 1980). Në fund të dhjetorit 1980 Jusufi e përgatitë krejtësisht me punën e tij numrin e fundit të Bashkimit, i cili është i vetmi numër që del si organ i Frontit të Kuq Popullor. Pas dërgimit të Hysen Gegajt me Sadik Blakajn në Kosovë, Jusuf Gërvalla, ka baza të mjaftueshme për dyshimin e tij se kush mund të qëndroj pas Frontit të Kuq dhe e ndërprenë përjetësisht bashkëpunimin me gazetën Bashkimi.

BASHKIMI KOMBËTAR SHOQRIA "BAJRAM CURRI" *P.B. Box 36, Hastings Vic. 3915 Australia.* Shoqëri patriotike në Australi. Pas 17 janarit 1982 u vendos kontakti dhe filloi koordinimi i punës në mes aktiviteteve në Evropë dhe Australi. Shembulli i parë i këtij koordinimi ishte organizimi i njëkohshëm i demonstratës së 26 qershorit 1982 në Bern të Zvicrës dhe në Sydnei të Australisë, në ditën e parë të fillimit të punimeve të Kongresit XII të Lidhjes së "komunistëve" të Jugosllavisë. Kryetar i kësaj Shoqërie ka qenë Rilind Bytyçi.

BEADINI ALIVEBI, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Alivebi Beadini Motenburgerstr.12 Hamburg 50. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10. Në banesën e tij në Hamburg, për disa muaj, pas 17 janarit 1982 ka qëndruar Naim Haradinaj.

BEÇIRI SELAMI, veprimtar në Francë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Selami Beçiri, Rue du Ruissen N. 92, 75018 Paris. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

BEGA REIS, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Reis Bega, 99 Medison Av. New York N.Y. 10016 USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 3.

BEGISHOLLI AVDI, – Avdi Begisholli, një prej aktivistëve më të dalluar, i orëve të para, në Dusseldorf. Së bashku me Zymer Kryeziun, në shumicën e çështjeve të aktiviteteve kanë qenë instanca e fundit në Klubin "Emin Duraku" të Dusseldorfit. Shokë dhe këshilltar i afërm i Vëllezërve Gërvalla dhe i Kadri Zekës. Një prej personave kryesor që kanë mbajtur lartë moralin në Untergruppenbach, pas 17 janarit 1982.

BEHXHETI B., veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Bedzeti B. Dotmumnderstr.69, 4000 Düseldorf. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

BELALLARI SITKI, veprimtar në Austri. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sitki Belallari, Fa.Wallner Martingasse 16, 2700 Wr. Neuestadt Austri. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

BELLA VITA (RESTAORANTE) 1409 York Avenue New York, N.Y. U.S.A. Restoran në Nju Jork në vitet 1982-1983. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

BERISHA AZEM – Azem Berisha nga Korbliqi aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

BERISHA HAXHI - Haxhi Berisha nga Prapaqani, shok i rrethit më të ngushtë të Jusufit. Me porosi të Jusufit ka bërë futjen e numrave 3 dhe 4-5 të revistës së Liria në Kosovë. Aktiviteti i tij është i gjerë dhe hap pas hapi mund të thuhet se ka ndjekur të gjithë punën e Jusufit e Bardhoshit, në vitet 1980-janar 1982. Shok i shkathët për shumë çështje të ndryshme praktike në rrethin e Jusufit, në Shtutgart. Në vitet 1983-1985 ka jetuar në rrethin e St. Gallenit në Zvicër. Në St. Gallen ka qenë forca kryesore organizative për formimin e Klubit "Xheladin Zeqiri" dhe disa klubeve tjera në Zvicrën Lindore. Gjatë viteve në Zvicër ka bashkëpunuar afër me shokë si Xhemil Beçiri, Elmaz Ademi, Hysen Zyberi, Januz Mustafa, Imer Berisha, Demë Mustafaj, Asllan Muharremi, Xhemajl Dauti, Hasim Mjaku (që ka banuar në Kontanz, në pjesën gjermane të këtij qyteti kufitar në mes Gjermanisë dhe Zvicrës) dhe me disa lidhje farefisnore të Hafiz Gagicës, emrat e të cilëve nuk më kujtohen. Jeton në Suedi.

BERISHA IMER, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Berisha Imer 1 Walker Court Greinwich, conn.606830 USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 2.

BERISHA IMER, – Imer Berisha, argjendar në Prishtinë, në fund të viteve 1970 e në fillim të viteve 1980. I biri i Ramadan Berishës nga Majaci. Ka pasë lidhje me Sabri Novosellën. Ka zhvilluar aktivitet me rrethin e Qerkin Pecit, duke shërbyer si lidhje në mes Qerkinit dhe Sabri Novosellës.

BERISHA QERIM, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Qerim Berisha, 1123 Berndard Drive, Westbury, USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

BERISHA TAFIL, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Tafil Berisha, Malemsaijmstr. 35, 7253 Reningen, W-Germany. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

BILALLI M. H., veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: M. H. Bilalli, 48 Fairviev Av. New York N.Y. 10016 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 3.

BEWEISLAST (gjemanisht); *Barra e vërtetimit në drejtësi*; Anglisht: *Legal burden of proof.* Brenda të drejtës penale (gjermanisht: *criminalrecht*, ku prokurori e përfaqëson shtetin), është gjithmonë prokurori ai e cili e ka barrën e vërtetimit, pra gjithmonë është detyrë e prokurorit që ta vërtetoj fajin e të akuzuarit. Kjo do të thotë se i akuzuari konsiderohet si i pafajshëm derisa e kundërta të vërtetohet nga prokurori. Ky presupozim i pafajësisë vlen në shkallë të ndryshme tek shumica e vendeve demokratike dhe është i vulosur në deklaratën e përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB) për të drejtat e njeriut.

Për prokurorin thuhet se ia ka arritur t'i vërtetoj thëniet (akuzat) e tij nëse ato janë të bazuara "jashtë dyshimit të arsyeshëm".

"*Kushdo që është i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet*." (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; pika 1 e nenit 11; www.ohchr.org)

Në të drejtën civile, ku rregullohen çështjet kontestuese, ai që i drejtohet gjyqit e ka barrën ta vërtetoj se ka të drejtë. Pas parashtrimit të çështjes prej tij, barra e vërtetimit i kalon palës tjetër, të cilës i jepet rasti t'i sjell argumentet veta.

BILALLI ESAT, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Esat Bilalli, 270,6 The Palisades NY.06750 N.Y. U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5

.

BLAKAJ MUHARREM – Muharrem Blakaj lindi më 6 janar 1959 në fshatin Vrellë, komuna e Burimit (ish Istogu) është një shkrimtar shqiptar. Autor i romanit "Atentat brenda germës L", CH-St. Gallen, 2007, roman i cili ka të bëjë me atentatin në Untergruppenbach, më 17 janar 1982.

BLAKAJ SADIK, – Sadik Blakaj, agjent i UDB-së nga komuna e Burimit (ish Istogu). Sipas shokut të tij Ibrahim Kelmendi, një ndër agjentët më të pastër se loti që ka pasur UDB-ja ndonjëherë.

Ibrahim Kelmendi: "*Sadik... Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija...*" (Letër për Sadik Blakaj, 21 janar 1981; Faridin Tafallari, T.- Dhimbje, Qëndresë", Tiranë 1997, faqe 407)

BLAKAJ SKËNDER – Skënder Blakaj, shok i Jusuf Gërvallës qysh nga vitet e fëminisë. Së bashku me Salih Kastratin, më 14 dhjetor 1979 e ka përcjell Jusufin deri në Slloveni. Intelektual i njohur. Nuk më ka rënë të lexoj deri më sot ndonjë trajtim më të detajuar sa i përket kohës së njohjes së tij me Jusufin.

blue colar worker klasifikim amerikan i zanateve në të cilin përfshihen punëtorët e industrisë, kryepunëtorët dhe punëtorët në sektorin e hotelierisë dhe turizmit. Në këtë kategori nuk përfshihen punëtorët e bujqësisë, minatorët dhe punëtorët që kryejnë shërbime nëpër shtëpia.

BOBAJ AVDULLAH – Avdullah Bobaj nga Korisha, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

BOBAJ SHABAN, Shaban Bobaj, aktivist i rrethit të Shtutgartit, nga Korisha afër Prizrenit. Një prej shokëve të rrethit të ngushtë të vëllezërve Gërvalla.

bourgeoisie, fillimisht një përcaktim për qytetarët e lirë në qytetet mesjetare franceze. Përmes Marksit dhe të tjerëve fjala ka marrë përmbajtje nënçmuese si emërim për klasën sunduese ekonomike në sistemin e kapitalizmit.

brahman, kasta më e lartë (priftërinjtë) në sistemin hinduist të kastave.

brainstorming mendohet në diskutime në formë grupi për të ardhur deri tek idetë. Në një diskutim të tillë pjesëmarrësve u ndalohet të paraqesin kritika negative kundër ideve të paraqitura. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit nxiten që të paraqesin shumë ide dhe në mënyrë të lirë e pa pengesa të kenë mundësi të lidhen me idetë e të tjerëve në grup. Vlerësimi i grumbullit të ideve bëhet në një proces të mëvonshëm.

BUCHANDLUNG, Badhausstr.35 2503 Biel-Bienne, Suisse. Adresa e *Zërit i Kosovës*, në vitet 1982-1983 dhe më vonë.

BUCHANDLUNG, Hausmannstr 107, 7000 Stuttgart BRD. Librari, vendtakim për pushime, pirje kafeje e diskutime, e komunistëve gjerman, në të cilën kemi qëndruar shumë herë.

buffert state një shtet relativisht i vogël dhe i dobët që gjendet në mes dy shteteve të mëdha.

BULAN ISA, shok i Jusufit dhe Bardhoshit. Person që ka ndihmuar shumë, por nuk ka dashtë të paraqitet haptas dhe ka kërkuar nga Jusufi që të tjerët të mos dinë për te. Në vitet 1981-1983 ka banuar në këtë adresë: Isa Bulan, Karl-Theodorstr. 4 D-6908 Wiesloch.

bureaucracy *burokraci* fillimisht gati një emërtim për një shtet që udhëhiqet prej nëpunësve. Tani fjala përdoret në të paktën në tri kuptime:

1. si përcaktim i detyrave administrative dhe procedurave të punës.
2. si term kolektiv për administrues dhe nëpunës dhe
3. si term nënçmues për ngecje administrative dhe joefektivitet.

Sociologët e kanë trajtuar burokracinë në kuptimin e parë, d.m.th. si term për procedurën e punës së administratës. Mendimi i Max Weberit është se një burokraci e zhvilluar në mënyrë të plotë i ka këto shenja dalluese:

1. kufijtë e përgjegjësisë për çdo nëpunës (juridiksion) janë të rregulluara me kujdes në ligje dhe rregullore statutore,
2. detyrat zyrtare (office) janë rigorozisht të ndërtuara në mënyrë hierarkie me përcaktime precize se kush përgjigjet para kujt,
3. vendimet administrative bazohen në dokumente të shkruara dhe zbatohen në përputhmëni me procedura e rregulla të qarta e të pandryshueshme pa marrë parasysh personin me të cilin ka të bëjë vendimi i marrë,
4. zyrtarët mbajnë që një jopersonal ndaj klientëve duke i trajtuat ata si raste në të cilat relacionet personale nuk guxojnë të ndikojnë në rezultatin e vendimeve,

5. zyrtarët punësohen në bazë të kompetencës të cilën e kanë arritur me marrjen e diplomave të parapara.

bureaucratic dysfunctions pasojat e elementeve të një sistemi burokratik që kanë tendencë ta bëjnë këtë më pak efektiv apo që japin shkaqe për konflikte. Edhe pse është potencuar se ndërtimi hierarkik i rendit të vendimmarrjes në një burokraci i kontribuon rritjes së disiplinës dhe koordinimit, është gjithashtu shumë e mundur që ajo të ketë si rezultat edhe rrethanën se zyrtarët e niveleve të ulëta të ngurrojnë tërësisht në marrjen e përgjegjësive. Që ngritja në shkallët e karrierës në bazë të kritereve objektive është një princip i rëndësishëm burokratik, por ky princip mund të bëhet shkak për konflikte kur vjen radha që vlera e kritereve të ndryshme objektive të vlerësohet-gjykohet, p. sh. kur mosha - senioriteti qëndron përball meritave të bazuara në provime e diploma.

BUZUKU RIFAT, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Rifat Buzuku, Rohrwegg 44, 3470 Hökster. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

BYTYÇI IBUSH dhe **SADIJE** familje në qendër të aktiviteteve kryesore të Lëvizjes në Paris, Francë. Në vitet 1982-1984 kanë banuar në këtë adresë: Ibush dhe Sadije Bytyçi, 6 Rue de Cailles, 94450 Limeil Brevannes.

BYTYÇI RILIND, kryetar i Shoqërisë Bajram Curri në Australi dhe udhëheqësi kryesor i aktiviteteve shqiptare në vitet 1979-1983 si dhe për shumë vite më vonë. Adresa e tij në vitet 1982-1983 ka qenë: Rilind Bytyqi, Bashkimi Kombëtar Shoqëria ”Bajram Curri”, P.O. Box 36, Hastings VIC 3915, Australia

BYTYÇI SEJDI, veprimtar shqiptar në Nju Jork që ka treguar interesim dhe kujdes të veçantë për atë që ka ndodhur në Shtutgart në janar 1982. Në vitin 1982, ka pasur këtë adresë: Sejdi Bitici, 157 east 57th street, new york n.y. 10022, USA

BYTYÇI SYLEJMAN, veprimtar në Gjermani, së bashku me gruan e tij Leme Bytyçi. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sylejman Bytyçi, Kirch winkelstr. 5, 5031 Peine. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

C

caesarism sistem diktatorial i përshkuar nga teket dhe preferencat personale të ushtruara nga një udhëheqës ushtarak në një vend gjysmëfeudal, me ekonomi dhe shkollim të pazhvilluar.

CAMAJ SHOTE DHE NUE, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Nue Camaj+Pjeter B. 510 East 86 Street NewYork, N.Y. 10028 USA. Kanë qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

CANA ZEKIRIA, u lind më 15 mars të vitit 1934 në Gjakovë. Vdiq më 10 janar 2009. Ka qenë historian dhe veprimtar i dalluar shqiptar.

Punën në Institutin Albanologjik e filloi më 10 nëntor 1967. Nga viti 1968 deri më 1976 ishte sekretar shkencor i Institutit Albanologjik. Më 1975 kreu studimet pasuniversitare në Beograd, duke mbrojtur temën e magjistraturës "Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1909-1912 dhe qëndrimi i Serbisë ndaj kësaj lëvizje", ndërsa më 1984, në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, mori titullin doktor shkencash, duke mbrojtur temën "Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare 1903-1913".

Me rastin e kthimit të eshtrave në Kosovë dhe rivarrimit të Vëllezërve Gërvalla në fshatin e tyre të lindjes, në Dubovik, më 24 shkurt 2002, Zekiria Cana ishte zgjedhur nga familja e Jusufit, si kryeplak e udhëheqës i ceremonisë së varrimit.

capital *kapitali* 1. objekte materiale që përdoren gjatë prodhimit të mallrave dhe shërbimeve. Në këtë kuptim kapitali është një nga ata të ashtuquajturit faktor të prodhimit. Faktorët tjerë janë toka, puna dhe organizata.
2. Në përdorim më të përditshëm fjala kapital përdoret në shumë kuptime tjera.

capitalism kapitalizëm 1. Në kuptimin e tij të përgjithshëm më së afërmi kapitalizmi definohet si tip ekonomiko-shoqëror që karakterizohet nga ajo se *kapitali* konsiderohet si një prej katër faktorëve të prodhimit, tre faktorët tjerë janë toka, puna dhe organizata, të cilët luajnë një rol dominues nëse krahasohen me ekonomitë tjera.
2. Por, më shpesh, me kapitalizëm mendohet një tip ekonomiko-shoqëror kur kapitali i cili është në pronësi private luan një rol dominues në krahasim me ekonomitë tjera.
Në bazë të definicionit të parë (nën numrin 1) p. sh. Bashkimi Sovjetik ka qenë vend kapitalist po aq sa edhe vendet tjera industriale të zhvilluara. Në bazë të definicionit të dytë (nën numrin 2) Bashkimi Sovjetik ka qenë shtet jo-kapitalist sepse atje principialisht nuk është lejuar kapitali në pronësi private.

card stacking teknik propagandistike ku nënvizohet fuqishëm ajo çështje për të cilën propagandohet dhe lihen në heshtje faktet që flasin kundër çështjes në fjalë.

cartel marrëveshje në mes ndërmarrjeve ose organizatave të pavarura me qëllim të eliminimit të konkurencës në mes veti.

casual crowd mendohet në një tubim njerëzish të cilët rasti i sjell që të jenë së bashku për shkak se shkaku për të cilin janë tubuar u intereson individëve. Në përgjithësi ka shumë pak afërsi psikologjike tek një grup i tillë. Publiku në një sallë filmi mund të thuhet se është një shembull tipik i "casual crowd".

category populacion individësh, objekte apo diçka tjetër të cilat me ndihmën e një forme të definicionit kufizohen-ndahen prej ndonjë apo populacioneve tjera.

catharsis metodë trajtimi shëndetësor, apo përjetim që ndikon tek individi që ai të lirohet nga vështirësitë e tij emocionale duke u dhënë atyre shprehje me fjalë ose me veprime praktike.

caucus fjalë anglosaksone për tubimet e udhëheqësve të një partie politike për të zgjedhur kandidat dhe për ta përcaktuar strategjinë në fushatat zgjedhore. Fjala përdoret edhe për trajtimet e çështjeve të brendshme partiake në mes anëtarëve të partisë që janë delegat në

parlamentin e vendit, për të vendosur se cilin drejtim duhet ta mbaj partia në çështjet e ndryshme.

cell *celulë* njësia më e vogël në një organizatë të fshehtë revolucionare. Sistemi me celula do të thotë se organizata është e ndarë në shumë grupe të vogla të cilat nuk janë në kontakt të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën. Kjo bëhet për t'iu larguar zbulimit të organeve shtetërore.

centrism gjykim apo vlerësim i diçkafit duke u nisur nga vetëm një këndvështrim prej shumë të mundshmëve.

cerebrotonic personality një person shumë i ndieshëm dhe intelektual i cili është në të njejtën kohë i tërhequn në vetvete dhe i përmbajtun.

character veti të personalitetit, të mësuara (*learning*) të cilat pasqyrojnë normat dhe vlerat e një shoqërie.

charisma *dhunti* Në literaturën sociologjike, që nga trajtimi i kësaj teme nga Max Weber, ka marrë atë kuptim sipas të cilit ajo paraqet një kompleks vetish të cilat bëjnë që një person ta ndiej veten absolutisht të bindur në drejtësinë dhe pagabueshmërinë e ideve të tij, të bashkangjitura me një pasion për t'u përpjekur që t'i bind edhe të tjerët për vlerën e ideve të tij. Shprehja diçka më e përditshme *fantast* është gati sinonime me personalitetin karizmatik në kuptimin sociologjik.

charismatic leader *lider karizmatik* një lider i cili është aq i bindur mbi rëndësinë e tij dhe pikëpamjeve të tij të pagabueshme sa ai e ndjen se nuk është vetëm e drejta e tij por edhe obligimi i tij moral vu në jetë idetë e tij dhe për t'i udhëhequr njerëzit tjerë. Tek lideri karizmatik ekziston shpesh parafytyrimi se qëllimi e arsyeton mjetin dhe ai si rregull është shumë jotolerues ndaj pikëpamjeve që janë të ndryshme nga të atij. P. sh. sistemi shoqëror i nacizmit është bazuar shumë tek ideologjia karizmatike e liderit.

civilization *civilizim* 1. shoqëri që kontrollohet nga ligjet të cilat zbatohen nga organe civile,
2. çdo shoqëri e caktuar pa marrë parasysh shkallën e thjeshtësisë apo kompleksitetit,
3. një shoqëri e komplikuar, e shkolluar, që përdorë metale, ka teknologji maqinash dhe ekonomi të bazuar në paranë.

civil code *kodi civil* ligjet që rregullojnë marrëdhëniet në mes personave privat.

civil action proces gjyqësor për zgjidhjen e kontesteve të cilat rregullohen në bazë të *kodit civil.*

class criterion *kriter klasor* veti sociale, ekonomike apo e ndonjë lloji tjetër që përdoret për ta përcaktuar përkatësinë klasore të një personi.

class consciousness *vetëdije klasore* Në traditën marksiste përcakton atë proces përmes të cilit anëtarët e një klase shoqërore vijnë tek qartësia se i takojnë një klase të veçantë me identitet dhe me vend të caktuar në histori. Brenda sociologjisë termi vetëdije klasore përdoret për të përshkruar se deri në çfarë shkalle një individ nga një kategori e caktuar

njerëzish e përjeton situatën e tij jetësore, atitydat dhe vlerat në mënyrë të njejtë me anëtarët tjerë të së njejtës kategori. Shpesh, vetëdija klasore në këtë kuptim përdoret si metodë për të bërë një klasifikim social të njerëzve gjatë hulumtimeve përmes intervistimeve, në të ashtuquajturat *identifikim subjektiv klasor*, dhe *matje objektive e përkatësisë klasore*.

classic ecology mendim sipas të cilit shoqëritë njerëzore zhvillohen në bazë të të njejtave ligje që vlejnë në botën e gjerë biologjike. Konkurenca subsociale mbi hapësirën për ekzistencë thuhet se vendosë për atë se sa anëtarë një shoqëri mund t'i ketë, në cilat vende individët dhe ndërmarrjet do të lokalizohen etj. Si themelues i shkollës klasike në ekologji llogaritet Robert E. Park.

classic penelogi, teori që merret me çështjen se si shoqëria duhet t'i trajtoj njerëzit që bëjnë krime, që do të thotë se matja e shkallës së dënimit duhet të jetë në mënyrë direkte në proporcion me llojin e krimit. Sipas penologëve klasik, nuk duhet të merret parasysh personi i cili ka bërë krim dhe as krimet e mëparshme. Përfaqësuesi më i njohur i kësaj teorie ka qenë juristi italian Beccaria.

class struggle *lufta klasore* Në traditën marksiste dhe sindikaliste me klaskamp mendohet në konfliktet e paevitueshme që gjatë zhvillimit historik shfaqen në mes klasave eksploatuese dhe atyre të eksploatuara. Tek Marksi lufta klasore është mekanizmi më i rëndësishëm që qëndron pas dialektikës materialiste, atij principi sipas tij (Marksit) e shpjegon krejt zhvillimin historik. Në sociologjinë jomarksiste klaskampi ka kuptim më pak të përcaktuar. Në përgjithësi termi përdoret për t'i përshkruar të gjitha konfliktet në mes grupeve në shoqërinë me shtresa.

clique *klikë* është një subgrup në kuadrin e një grupi më të madh, anëtarët e së cilës preferojnë të shoqërohen me njëri-tjetrin për shkak se kanë simpati për njëri-tjetrin apo kanë interesa të përbashkëta. Klikat krijohen spontanisht dhe kanë strukturë informale. Ato përshkohen nga ndjenja "ne", ndërveprimi si dhe komunikimi është i lehtë dhe pa pengesa. Një klikë me fjalë tjera është një *grup primar*. Drejtime të ndryshme shkencëtarësh të sociologjisë dhe psikologjisë gjatë studimeve të klikave u kanë kushtuar rëndësi të ndryshme vetive të lartpërmendura. Në *sociometri* zbulimi dhe studimi i klikave është një çështje e rëndësishme teknike. Identifikimi bëhet në bazë të hulumtimit se cilët anëtarë të grupit kanë shumë zgjedhje reciproke.

closed class system sistem shoqëror i klasave në të cilin është vështirë për një individ ta ndërroj pozitën e tij klasore.

closed shop ndërmarrje që punëson vetëm punëtor të organizuar në bashkime profesionale.

coalition *koalicion*, bashkime të përkohshme të grupeve (politike) për të arritur disa qëllimeve të caktuara.

cognition (*njohje dhe perceptim*) term i cili përdoret për ta përshkruar vetëdijen në të gjitha aspektet e saj dhe që përfshin *preceptionin*, *mësimin* (learning), memorjen, gjykimin, veprimtarinë menduese, fantazimin dhe shumë procese tjera. Fjalë që janë afër në kuptim është botëkuptim apo njohurit e një personi që ai i ka për mjedisin e tij. Duhet të kihet parasysh se këtu nuk është fjala për dituri në kuptimin absolut apo objektiv, por

për atë se çka personi e kupton për dituri. Në konceptet siç janë *atityda*, *opinioni*, *vlera* dhe *ideali* thuhet se kognicionet përfshihen si një elementi i rëndësishëm përskaj *emocioneve*.
Elementi kognitiv mund të ketë shumë variacione vetish. Për këtë shkak flitet për *strukturën kognitive*.

Kognicion është një koncept i rëndësishëm tek ata socialpsikologë të cilët e potencojnë se sjelljen duhet shikuar duke u bazuar në sfondin (background) e individit – definimin e situatës sociale, e cila në një shkallë të madhe mvaret nga përvojat e mëparshme të tij (individit). Koncepti përdoret më rrallë nga ata social-psikologë që në shkallë të madhe janë të orientuar kah *stimulus-respons teoria* dhe *behaviorizmi*.

cognitive dissonance kognicione tek një individ të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe që janë në kundërthënie me njëra-tjetrën, p. sh. tek një person i cili në shkollë ka mësuar për ta lidhur sistemin politik të një shteti me demokraci dhe liri, dhe kur përmes shtypit ose përvojës direkte e sheh se në atë demokraci lulëzon korrupsioni, bëhet ndjekje e personave për shkaqe politike, për shkaqe të pikëpamjeve të tyre dhe dukuri tjera të ngjashme. Një tip i veçantë i cognitive disonace shfaqet kur anëtarët e një grupi e hetojnë se kanë mendime të ndryshme për ndonjë çështje. Ato procese të cilat japin shkaqe për cognitive disonance trajtohen pos tjerash nga L. Festinger në *A Theory of Cognitive Dissonance* (1957).

cognitive structure kombinimi special i vetive që vlejnë për *kognicionin* e një individi lidhur me diçka në botëkuptimet e tij. Një kognicion mundet p. sh. të ketë variacione në shkallën e kompleksitetit. Në kognicionet e disa personave lidhur me jetën politike mundet p. sh. të përfshihet një njohje me themel mbi pozitat e partive të ndryshme, ideologjitë e partive dhe qëndrimin e tyre në çështje konkrete. Kongnicionet e individëve të tjerë mbi dukurinë e njëjtë (jetën politike) mund të përfshijë vetëm parafytyrime të zbehta lidhur me partitë politike. Në ekstremin me shkallën më të ulët të kompleksitetit kognicionet e kanë tek ai person që nuk mund të bëjë ndonjë dallim në mes partive.

Një veti tjetër tek kognicionet ka të bëjë me atë se deri në çfarë shkalle të lartë parafytyrimet janë të lidhura me njëra-tjetrën. Tek disa individ p. sh. kognicionet politike janë fortë të lidhura me kognicione ekonomike ose religjioze, ndërsa tek të tjerë janë relativisht të izoluara prej tyre. Nëse kognicionet që janë të lidhura me njëra-tjetrën nuk janë kundërthënëse atëherë thuhet se mbretëron *kognitiv konsonans*. Nëse kognicionet janë kundërthënëse, thuhet se mbretëron *kognitiv dissonans*. Një teori, balancë teoria, i kushton rëndësi të madhe reaksioneve të individit me rastin e përjetimit të *kognitiv disonans*.

cohesion koncept social-psikologjik gjatë studimit të grupeve. Me grup-kohezion shprehet rrethana se deri në cilën shkallë anëtarët e një grupi janë të motivuar për të qëndruar (brenda) në grup. Forca unifikuese, kohezive mund të kenë burimin tek vetit brenda vetë grupit (p. sh. forca atraktive e grupit) ose prej vetive rrethanave që gjenden jashtë grupit (p. sh. presioni prej mjedisit). Në mesin e atyre që e kanë trajtuar kohesionin si koncept janë L. Festinger, S. Schachter dhe K. Bach në *Social Pressures in Informal Groups* (1964).

cohort të gjithë ata individ të cilët brenda një intervali të caktuar kohor e kanë përjetuar një ngjarje të veçantë. Në rastin më të rëndomtë me kohort mendohen personat të cilët kanë lind gjatë një periudhe të përbashkët.

collectivism *kolektivizëm* mendohet në parafytyrimet, qëllimet dhe metodat tek ata që kërkojnë kontroll politik krejtësisht të centralizuar mbi rrethanat sociale (sidomos ekonomike).

collective feeling *ndjenjë kolektive* kur shumë individ e ndajnë të njejtën ndjenjë, p. sh. kur publiku në një teatër qesh rreth ndonjë mahie në skenë apo kur e njejta publikë përfshihet nga paniku nëse jepet alarmi për shpërthimin e zjarrit në ndërtesën e teatrit. Një shembull tjetër për *collective feelling* është ajo valë e patriotizmit që vjen tek një popull kur kërcënohet nga jashtë.

collective representation koncept i krijuar nga Emile Durkehim i cili me këtë mendon një simbol që ka të njejtin kuptim për të gjithë anëtarët e një kolektivi.

colonialism *kolonializëm* në kohën tonë paraqet një raport mvarshmërie kur një shoqëri dominohet politikisht, ekonomikisht dhe kulturalisht nga një shoqëri tjetër.

colonization *kolonizim* lloj i shpërnguljes masive që rezulton në atë se një shtet merr kontroll politik mbi një territor të ri. Kolonizimi dallohet prej imperializmit sepse tek kolonializmi shpërnguljet janë shumë më masive se sa tek imperializmi. Pastaj duhet të bëhet dallimi në mes kolonizimit nga *imigration* ku tek imigrimi kemi shpërnguljet të cilat bëhen vetëm prej një shteti politik në tjetrin.

commensalism, fjalë me prejardhje latine që etimologjikisht ka domethënien: të ngrënësh në të njejtën tavolinë (prej një çanaku).

1. Në ekologji fjala është shndërruar në një term për të shprehur raportin konkurues në mes personave që kanë pozicione të ngjashme e të specializuara në një sistem të integruar për ndarjen e punës, p. sh. në mes ndërmarrjeve ndërtimore në një regjion dhe fabrikantëve të cilët shesin shtëpia të gatshme të prodhuara në fabrikat e tyre. Në këtë kuptim termi qëndron për diçka që është gati e kundërt me *simbiozën*.
2. Por shumë shkrimtarë ekologjik këtë term i përdorin si sinonim me simbiozën.
3. Termi përdoret nganjëherë për të përcaktuar atë relacion social (*social relation)* që ekziston në grupe në të cilat anëtarët ndodhen bashkarisht pa qëndruar në mes veti në ndonjë marrëdhënie kontrate ndaj njëri-tjetrit, p. sh. të tillë mund të konsiderohen mysafirët e një hoteli apo nxënësit që e ndjekin një ligjëratë.

common sense një masë e madhe njohurive praktike që rrjedhin nga observimet e shumta gjatë situatave dhe përvojave të përditshme.

common low paraqet ligjin e shkruar ose të drejtën zakonore të pakodifikuar që bazohet në idetë popullore se çka është e drejt e çka është gabim. Burimi i ideve të tilla shpesh është i mjegulluar.

communalism, pikëpamja se shoqëria duhet të përbëhet nga shoqëri lokale vetëdrejtuese dhe se vetëm një minimum i pushtetit duhet të koncentrohet në njësi politike më të larta.

communication distorsion ato ndryshime të përmbajtjes informative që ndodhin kur informacioni bartet prej një personi tek një tjetër. Përveç ndodhjes së ndryshimeve të

pastra të domethënies, mund të ndodhë që përmbajtja p. sh. të bëhet më konkrete dhe më e detajuar.

communication organization ato rrugë apo kanale përmes të cilave informacioni rregullisht kalon (apo presupozohet se kalon) në të gjitha llojet e grupeve dhe organizatave të mëdha.

communism në aspektin sociologjik rëndom paraqet një *tip ideal* të një sistemi socioekonomik ku nuk ekziston prona private.

commuter person i cili banon në një vend tjetër prej atij në të cilin punon. Kjo do të thotë se ai çdo ditë pune duhet të udhëtoj në mes shtëpisë dhe vendit të punës. Nga pikëpamja e rrethit ku punon ai është *in-commuter*, dhe ai e shton popullsinë ditore të rrethit ku punon. Nga pikëpamja e rrethit ku banon ai është një *out-commuter*, dhe ai e zvogëlon popullsinë ditore të rrethit ku banon. Nëse një shoqëri ka një tepricë neto të in-commuter popullsia e saj ditore është më e madhe se sa popullsia e natës. E kundërta vlen kur kemi neto-mungesë. Rasti i parë, me tepricë ditore ndeshet veçanërisht tek qytetet e mëdha dhe rasti i dytë në viset rurale.

comparative anthropology *antropologji krahasuese* drejtim në mesin e social-antropologëve metoda e të cilëve është që në mënyrë sistematike të mbledhin të dhëna mbi elementet e kulturës prej shumë kulturave. Gjatë analizimit kulturat e ndryshme krahasohen me njëra-tjetrën. Gjatë përpunimit të të dhënave shpesh përdoren metoda statistikore. Qëllimi është që të shihet se cilat elemente kulturore janë korresponduese me njëra-tjetrën. Rëndom për këtë përdoren arkiva të tipit *Human Relations Area File* pranë *Yale-University* në të cilin janë të mbledhura të dhëna prej qindra kulturave. Antropologët komparativ kritikohen nga social-antropologët e orientuar kah funksionalizmi. Këta të fundit mendojnë se aspekti tërësor dhe rrethanat strukturore humbin kur kulturat analizohen me metoda statistikore kvantitative. Më i njohuri në mes antropologëve komparativ është Georg P. Murdock.

camparative sociology *sociologji krahasuese* metodë përmes së cilës bëhet krahasimi me njëra-tjetrën i elementeve tek shoqëritë apo grupet në mënyrë që të arrihet në konkluzione për rregullshmëritë-ngjashmëritë dhe dallimet - përjashtimet.

compartmentalization kur një individ beson dhe aprovon dy apo më shumë ide që logjikisht e përjashtojnë njëra-tjetrën.

compartmentalization term që përdoret për të përshkruar një mekanizëm mbrojtës i cili shfaqet tek një *self-role-conflict* dhe ka domethënien se një person e mbron pikëpamjen e tij duke ia mbushur vetes mendjen se dy fenomene nuk kanë të bëjnë me njëra-tjetrën p. sh. një prift afër një fushëbeteje e mbron pasivitetin e tij ndaj të këqijave të luftës duke thënë se misioni i religjionit nuk bënë të përzihet me çështjet e kësaj bote ("Jepja Cezarit atë që i takon Cezarit dhe Zotit atë që i takon Zotit.").

compensate *kompensim* 1. Si koncept sociologjik kompensim do të thotë se bëhet një përpjekje për ta parandaluar një trend të padëshirueshëm të zhvillimit social, përmes ndonjë mase me ç'rast sjelljet tjera alternative do të bëheshin më tërheqëse për ata që janë të përfshirë në çështje. P. sh. shtimi i lartë i shtesave

fëminore mund të jetë një masë që merret për të bërë kthesë në një trend të uljes së nativitetit tek një popull.
2. Si term psikologjik kompensim do të thotë kur një individ përpiqet ta mbaj ekuilibrin psikik i cili pengohet nga mangësi personale në një fushë duke iu kushtuar shumë vëmendje dhe përdorë aftësitë dhe talentet e tij në një drejtim tjetër.
3. Si koncept fiziologjik kompensim do të thotë reagim organik në atë mënyrë që tensionet, frustracionet apo lëndimet luftohen apo nevoja të njohura organike plotësohen. Një shembull për kompensim fiziologjik është ngrënia e ushqimit kur jemi të uritur. Me *mbikompensim* mendohet tek kompensimi që çohet më larg se sa që e ka kërkuar paraqitje e nevojës fillestare.

compensatory princip teori sipas të cilës natyra, individi apo shoqëria është e krijuar në atë mënyrë që prishja e ekuilibrit në një drejtim, më pak apo më shumë automatikisht çon në një kundërveprim i cili më në fund e kthen prapë gjendjen e ekuilibrit.

competition *konkurencë* relacion në mes grupeve dhe individëve që synojnë drejt të njejtave qëllime dhe kur mjetet për t'i arritur këto qëllime janë shumë të kufizueshme.

complex *kompleks* 1. Psikologjikisht do të thotë se një konstelacion apo sistem impulsesh apo idesh të ngjyrosura emocionalisht, kujtime, atityda etj. janë të tufëzuara në mes veti në atë mënyrë që ato asociacohen tek ndonjë ndjenjë e thellë dhe themelore, pamje imagjinare apo qëllim.
2. Në kuptimin psikiatrik kompleks do të thotë e njëjta gjë si më lartë, por këtu asociacioni tek ndenja e thellë dhe themelore në ndonjë mënyrë është i prishur, ka pengesa, është i ndrydhur apo edhe krejtësisht i imagjinuar, dhe për këtë thuhet se është shkak për sëmundje psikike.
3. Në kultur-antroplogji kompleks do të thotë *konfigurim* i *vetive kulturore* të cilat përmes asocimit janë të lidhura me ndonjë parafytyrim themelor, qëllim apo traditë të cilën anëtarët e një grupi e kanë.

concentration *koncentrim*, *proces ekologjik* përmes të cilit mendohet tendenca kur në një rreth të caktuar shtohet dendësia e popullsisë apo ndodhë shtimi i dendësisë në ndonjë kuptim tjetër. E kundërta është *dekoncentrim*.

condominium rreth që administrativisht është përgjegjës para dy qeverive.

confederation një bashkim i organizatave të pavarura apo grupeve me qëllim të arritjes së ndonjë interesi të përbashkët për palët e përfshira (në konfederatë).

configuration një objekt i cili me rastin e vrojtimit shihet, kuptohet, si tërësi dhe jo si kombinim i përbërë prej pjesëve të ndryshme të dallueshme.

conflict group grup bashkimi dhe uniteti i të cilit kryesisht është rezultat i asaj se grupi është në konflikt me një grup tjetër.

conformity *konformizëm*, në bazë të R. Merton sjellja e rëndomtë për individin. Ka domethënien se ai i pranon synimet e përcaktuara kulturore dhe ato mjete që janë të pranueshme për arritjen e synimeve në fjalë.

conformity konformitet sjellje të cilat bëhen në atë mënyrë që rregullat e kërkojnë. Shembull për konformitet është mostejakilimi i *normës së prodhimit* të cilën e ka përcaktuar një grup pune. Konformizmi shpërblehet me status të lart në grup. E kundërta e konformizmit është *sjellja devijuese*.

confucianism feja zyrtare në Kinë para marrjes së pushtetit nga komunistët. Duke e ndjekur atë etikë që Konfuciusi e ka krijuar arrihet lumturia. Adhurimi i stërgjyshërve është një shenjë dalluese e religjionit.

congenial group *grup* i cili përbëhet nga individ me parafytyrime, vlera dhe interesa të ngjashme dhe që takohen dhe e kalojnë kohën së shoqërisht me njëri-tjetrin.

conquest *pushtim* Përveç kuptimit të rëndomtë të këtij termi ai ka një kuptim tjetër më special, si një nga katër llojet e *imigrimit* të përshkruara nga Henry Pratt Fairchild në librin e tij *Immigration: A World Movment and its American Significance* (1925). Me pushtim Fairchild mendon rrethanën kur një popull me një nivel kulturor më të lart, me mjete jopaqësore vendoset dhe merr dominimin në territore me nivel kulturor më të ulët. E kundërta është *invadim, kolonizim, imigrim.*

conservatism *konzervatizëm* 1. drejtim pikëpamjesh që sheh një vlerë shumë të rëndësishme në institucionet ekzistuese të një shoqërie dhe përpiqet që t'i ruaj ato. Në bazë të këtij definicioni një Marksist-Leninist në Bashkimin Sovjetik ka qenë konzervativ ndërsa një Marksist-Leninist në ShBA është revolucionar. 2. Në kuptime politike dhe ideologjike me konzervatizëm mendohet një drejtim pikëpamjesh i cili e sheh veten si ruajtës i disa institucioneve dhe vlerave, p. sh. monarkisë, kishës, armatës, ekonomisë private, familjes. Në bazë të këtij definicioni Marksizëm-Leninizmi i Bashkimit Sovjetik na del se ka qenë lëvizje radikale.

cooperation *kooperim* 1. Në ekologjinë klasike ka domethënien e ndërveprimit në mes dy apo më shumë organizmave që reciprokisht rrisin ato resurse shumë të kufizuara prej të cilave një apo të gjithë mvaren, apo reciprokisht e zvogëlojnë ndonjë rrezik në mjedis i cili rrezikon njërin apo të gjithë. Kooperacioni në kuptimin ekologjik nuk do të thotë se ata që janë të involvuar në te e kanë planifikuar apo organizuar bashkëpunimin.
2. Në jetën e përditshme termi përdoret rëndom për të përshkruar një bashkim më pak apo më shumë të organizuar të individëve të cilët me anë të bashkëpunimit në ndonjë fushë duan të krijojnë përparësi të cilat nuk kishin mund me i arritë sikur të kishin vepruar veç e veç.

co-optation proces me ç'rast një organ udhëheqës apo një elitë pranon anëtarë të rinj në rrethin e vet për ta siguruar pozitën e saj në një situatë kur ekzistenca e saj është e rrezikuar.

coordination *koordinim* organizim, planifikim dhe integrim i fazave të ndryshme të punës në një punë më të madhe me shumë pjesëmarrës.

corporation *korporatë* organizatë socio-ekonomike e përbërë prej individëve dhe që kanë të drejta të sanksionuara me ligj për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve. Shoqatat aksionare janë forma më e rëndomtë e korporatave.

correlation *korrelacion* tregon se sa shumë ndryshimi i një variable ndiqet nga ndryshimi tek një tjetër variabël.

coup d'etat puç shteti.

creative synthesis proces mental në të cilin idetë apo dituritë e njohura kombinohen në një mënyrë që nuk është bërë më parë.

criminology studimi i sjelljeve kriminale. Bëhet përshkrimi i formave të ndryshme të sjelljeve kriminale, përhapja e tyre gjeografikisht dhe ndër popullsinë, karakteristikat sociale dhe psikologjike tek personal e përfshirë në krime etj. Teoritë kriminologjike merren me lidhjet kauzale në mes faktorëve të ndryshëm sociologjik e psikologjik dhe kriminaliteti dhe pse disa sjellje janë kriminale në disa shoqëri e në disa të tjera jo.

crisis *krizë* çdo ndërprerje në zingjirin e rregullt dhe të pritur të ngjarjeve që vlejnë për një individ, grup apo shoqëri. Një krizë do të thotë se traditat prishen dhe kjo prishje kërkon nga individi apo grupi i goditur prej krizës mobilizim të forcave për t'iu përshtatur situatës së re apo për t'i zhdukur shkaqet që kanë sjellë tek kriza. Flitet për kriza të herëpashershme (të përsëritshme) dhe singulare (të papërsëritshme). Me të herëpashershmet mendohet në kriza që përsëriten me një shkallë të rregullshmërisë gjatë ciklit jetësor së individit apo grupit, p. sh. lindje, pubertet, martesë dhe vdekje. Me kriza singulare mendohet në kriza që ndodhin rrallë dhe në formë të parregullt, si p. sh. dridhje toke, papunësi, shpërthim lufte etj.

crisis patriotism Termi përdoret nganjëherë për shkallën e rritur të unitetit i cili shpesh shfaqet kur ekzistenca e një grupi rrezikohet nga forca të brendshme apo të jashtme.

crosspicketing kur dy apo më shumë bashkime profesionale mundohen të anëtarësojnë të njejtën kategori të punëtorëve.

cross pressure, kur një individ apo grup ndien lojalitet ndaj një grupi apo individi, nën një mënyrë apo tjetër i ekspozohet presionit prej dy apo më shumë individëve apo grupeve tjera të cilat në mes veti kanë vlera apo pritje të ndryshme. Pos tjerash është vërtetuar se personat që i ekspozohet presionit të kryqëzuar (nga shumë drejtime) në lidhje me zgjedhjet politike, shpesh reagon duke mos votuar fare.

cultural antropologji studimi në radhë të parë i kulturave primitive apo teknikisht të pazhvilluara. Në mesin e kultur-antropologëve ekziston një jounitet i madh lidhur me atë se çka duhet të përfshihet në kultur-antropologji. Disa duan që në këtë shkencë të përfshihen edhe kulturat me teknikë të avancuar me motivin se objekte primare të studimit janë sistemet kulturore të cilat shihen ngushtë të lidhura me sistemet sociale, por megjithatë të dalluar prej tyre. Të tjerë, kryesisht të socialantropologët britanik thonë se sisteme kulturore të veçanta nuk ekzistojnë fare. Shumica e kulturantropologëve mund të thuhet se de facto studiojnë çështjet se si vetitë e ndryshme kulturore dhe *modelet kulturore* ndryshojnë, përhapen gjeografikisht apo prej një shtrese në një tjetër. Në disa vende termi socialantropologji përdoret në vend të kultur-antropologji.

cultural conflict *konflikt kulturor* 1. konflikt që mund të lind në mes dy grupeve me kultura të ndryshme. Parakushtet për ardhjen tek konflikti janë që grupet të

jenë në kontakt me njëra-tjetrën dhe anëtarët e njërit grup i definojnë veprimet e grupit tjetër si kërcënim ndaj vlerave e normave që e përbëjnë thelbin e kulturës së grupit të tyre.

2. Konflikti-kulturor nganjëherë përdoret si sinonim për konflikt-vlerash me domethënien se një individ apo një grup detyrohet të zgjedhë në mes alternativave të ndryshme të veprimit, alternativa të cilat, veç e veç, janë të përfshira në shumën e vlerave që individi apo grupi i ka.

cultural landscape *peizazhi kulturor* natyrë e cila nga njeriu është ndryshuar në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë nevoja dhe kërkesave të tij.

cultural minority *minoritet kulturor* një grup apo një *agregat*, që ka një kulturë unike në një shoqëri që e ka një kulturë tjetër. Shpesh minoriteti kulturor i nënshtrohet diskriminimit në aspekte të ndryshme nga grupi dominues. Termi është gati sinonim me *ujdhesë kulturore*.

culturalshock tensione që shfaqen tek individi kur ai përnjëherë ndeshet para problemit se si t'i përshtatet një kulture (për individin) të re, p. sh. gjatë shpërnguljes së banorëve të viseve rurale në një qytet të madh.

cultural traits njësit më të vogla në të cilat një kulturë mund të ndahet. Në cultural traits mund jenë një parafytyrim special apo një traditë që dominon në një grup.

culture *kulturë* Definicioni klasik për kulturën është dhënë nga Tylor i cili kulturën e ka definuar si "*tërësi komplekse që përbëhet prej diturive, parafytyrimeve, artit, moralit, ligjeve, traditave dhe çdo tjetër aftësi apo traditë që njeriu e ka marrë përmes tjerëve në cilësinë e të qenunit anëtarë i shoqërisë*." Këtij definicioni i janë bërë vërejtje se përmban vetëm një numërim të një pjese të vetive që një kulturë i ka. Veti tjera për të cilat thuhet se një kulturë i ka, është qëndrimi se kultura është një abstraksion dhe produkt i sjelljes, se ajo është e mësuar, se ajo është selektive, se ajo përfshinë ide, mozaiqe dhe vlerësime dhe se ajo bazohet në simbole.

A. Kluckholm, kultur-antropolog amerikan, mendon se kultura përbëhet nga modele sjelljesh të cilat fitohen apo u përcillen të tjerëve përmes simboleve, para së gjithash përmes procesit të socializimit. Të ashtuquajturat *artefakte* ai i sheh si sende në të cilat modelet e sjelljes njerëzore janë trupëzuar. Por bërthama e kulturës sipas tij përbëhet nga idetë tradicionale dhe veçanërisht ato që janë të lidhura me vlerat. Mund të nënvizohet se antropologët anglez të traditës (shkollës) funksionaliste definicionin e kulturës e hedhin poshtë me arsyetimin se ai është tepër i gjerë dhe me këtë i papërdorshëm gjatë analizimit të shoqërisë.

culture evolution ai zhvillim dhe ndryshim përgjatë të cilit vetitë kulturore kalojnë gjatë historisë. Antropologu i viteve 1800 L. H. Morgan mendon se shoqëritë kalojnë nëpër stade të ndryshme të zhvillimit,

-(1) stadi primitiv (savagery stage),
-(2) stadi i barbarizmit dhe
-(3) stadi i civilizimit.

Për çdo stad kryesor Morgan ka lokalizuar nënfaza të ndryshme. Morgan së bashku me antropologët e viteve 1800 përbëjnë shkollën evolucioniste brenda kulturantroplogjisë. Kjo shkollë prej drejtimeve të ndryshme është kritikuar për determinizëm, gjeneralizime të tepruara dhe se në mënyrë të njëanshme kulturën

Perëndimore e sheh si pikën më të naltë të çdo zhvillimi. Në social-antropologjinë moderne gjendet një drejtim, i quajtur neoevolucionism në të cilin, duke iu ikur hendeqeve në të cilat evolucionistët kanë ra, bëhet përpjekje për gjeneralizimin e vetive kulturore në zhvillimin kulturor. W. R. Goldschmidt është një përfaqësues i njohur i kësaj shkolle.

cumulative crisis, konflikt apo prishje që është zhvilluar gradualisht dhe bëhet më serioze për çdo hap që të involvuarit e ndërmarrin. Një grindje kur një fjalë e nxjerrë tjetrën dhe që më vonë përfundon në armiqësi totale mund të merret si shembull për një krizë kumulative.

cyclothomic personality person që karakterizohet nga ndryshime periodike të disponimit prej një ekstremi në ekstremin tjetër.

Ç

ÇABEJ EQREM, Eqrem Çabej lindi më 6 gusht të vitit 1908 në Gjirokastër dhe vdiq më 13 gusht të vitit 1980 në Romë. Ishte kurora e shkencës, arsimit dhe kulturës shqiptare. Mësues i Popullit.

ÇALISKAN NAMUK, shtetas i Turqisë me prejardhje shqiptare apo nga viset shqiptare. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Namuk Çaliskan, Gökalp Mahlesi 44/2, sok.No.33-D-1, Zeytinburgnu. Istanbul. *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës i është dërguar për ta informuar me gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi.

D

DAUTI LUFTI, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Lutfi Dauti, 55 Cathrineav Weternbury. Conn 06704 USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 100.

decoder *pranues* term i cili paraqet atë person i cili në një proces komunikimi është pranues i një mesazhi nga një *emitues*.

deduction *deduktim* përfundim në të cilin konkludimi rrjedh si domosdoshmëri logjike prej apo më shumë parakushteve. Nëse premisat pranohen si të vërteta, atëherë logjikisht, konkluzionet që rrjedhin prej tyre duhet patjetër të jenë të vërteta.

de facto population ata individ të cilët gjenden në një rreth gjeografik të caktuar, në momentin kur bëhet regjistrimi i popullsisë. Pra i takon asaj popullsie pa marrë parasysh a je apo nuk je i regjistruar në rrethin në fjalë. E kundërta është *de jure population*

de jure population ata individ të cilët janë të regjistruar në një rreth gjeografik të caktuar. Ata që janë fizikisht të pranishëm por nuk janë të regjistruar, nuk llogariten. E kundërta është *de facto population*

de facto government ajo qeveri e cila ka pushtet në shoqëri. Kjo vlen pamvarësisht rrethanës se qeveria në fjalë a ka ardhë në pushtet me mjete ligjore apo jo.

defence mechanism *mekanizëm mbrojtës* sjellje individuale që shfaqen në situata që përjetohen si kërcënuese, shkaktojnë ankth apo në ndonjë mënyrë tjetër janë frustruese. Në vend që të pranohen situata të tilla individi mbrohet duke e mohuar të vërtetën e situatës ose e shtrembëron atë të vërtetë. Mekanizmat më të rëndomtë mbrojtës janë *represion, agresion, sublimim, racionalizim, mbikompenzim*. Koncepti e ka origjinën nga psikoanaliza.

de jure government qeveri e cila ka ardhur në pushtet me mjete ligjore.

definition of the situation mënyra se si individi e kupton situatën e tij, pa marrë parasysh faktin se a ka individi të drejtë apo jo në interpretimin e tij. Nocioni është përdorë për herë të parë nga W. I. Thomas dhe F. Znaniecki në *The Polish Peasant in Europe and America* (1918). Ata mendojnë se nëse një person e përjeton situatën e tij si të vërtetë, atëherë ajo (situata) është e vërtetë edhe në pasojat e saj. Nëse, p.sh. e përjeton se do t'i ekspozohesh dhunës fizike, atëherë reagimi do të jetë sikur kjo të kishte me qenë e vërtetë, dhe pamvarësisht nga se a ka diçka të vërtetë në këtë, merret një pozicion mbrojtës.

DEMA- Demaçi **ADEM –** Adem Dema-Demaçi lindi më 26 shkurt 1936 në Prishtinë. Për angazhimin e tij politik, Adem Dema-Demaçi vuajti 28 vjet me radhë në burgjet e Jugosllavisë. Ai quhet edhe Nelson Mandela i Evropës.

Jusuf Gërvalla: "*Gjyqi jugosllav e ka dënuar tri herë me burg të rëndë Adem Demën, luftëtarin më të paepur kosovar për idealin kombëtar dhe njerëzor në Kosovën e pasluftës: më 1958, me 5 vjet burg, nga të cilat i ka mbajtur 3; më 1964 me 15 vjet, nga të cilat i ka mbajtur 10; dhe më 1975 po me 15 vjet burg të rëndë, nga të cilat i kanë mbetur edhe 10 vjet. Pra, deri më tash, shëndetin dhe rininë e heroit tonë të gjallë, burgjet dhe UDB-ja fashiste kanë pasur rast ta thithin si shushunja, për tetëmbëdhjetë vjet të gjatë me radhë. (Ademi vetë sapo ka shkelur në moshën 45 vjeçe!) Të tri herët është dënuar për "vepër armiqësore kundër popullit dhe shtetit". Në gjykimin e fundit, në shtator 1975, patrioti ynë pat deklaruar haptazi, pa hezitime dhe me domethënie të thellë: "Megjithëqë… plotësisht i pafajshëm, unë gjithmonë kam qenë dhe kurdoherë kam për të qenë – deri në vdekje – për idealin kombëtar e njerëzor; dënimi që po më bëhet mua është dënim për bindje dhe mendime, e jo për vepër, dhe kjo gjë është, me sa di unë, kundër ligjit dhe në kundërshtim me të gjitha normat ndërkombëtare e njerëzore.*" (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 2)

A. Duka:- I keni njohur në atë kohë Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën?

Adem Dema-Demaçi: Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur, ndërsa Kadri Zekën jo." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 150-156)

Adem Dema-Demaçi

DEMA LEFTER, veprimtar në Argjentinë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Mr. Lefter Dema, Monroe, 2146-3-B, 1428 Buenos Aires, Argentina. Ka qenë pika në Argjentinë, prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

DEMAJ DEMË, – Demë Demaj, punëtor në rrethin e Shtutgartit. Përmes tij në një pjesë të rrethit të Shtutgartit është bërë introduktimi i Ibrahim Kelmendit dhe Sadik Blakajt. Ibrahim Kelmendi dhe Sadik Blakaj i janë prezantuar Faridin Tafallarit nga Demë Demaj.

Faridin Tafallari: *"Ibrahim Kelmendin e kam njohur në verë të vitit 1979. Ai atë ditë ishte me Dem Demajn në Nagold dhe unë duke punuar me taxi në stacionin e autobusëve. U afrua një njeri dhe më foli në gjuhën Gjermane. Kërkoi lekë të metalta për të ja ndërruar, se i duheshin për të telefonuar, meqë në atë kohë telefonat funksiononin vetëm me lekë (pfening) të metalta… Pas pak erdhën tek unë të dy së bashku dhe Dema ma prezantoi se, ai ishte Ibrahim Kelmendi, gjë që më kishte folur edhe më parë për veprimtarinë e tij patriotike…*

Në nëntorin e vitit 1980 erdhi udbashi kriminel Sadik Blakaj. Këtë e solli Demë Demaj." (www.albaniapress.com, 17 janar 2013)

DEMAJ ISA – Isa Demaj, i lindur më 12 janar 1946 në fshatin Shkrel KK Pejë. Ka kryer Fakultetin filozofik – grupi i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, më 4 qershor 1980 është dënuar me 4 vjet burg.

DEMI ISAH, – Isah Demi, aktivist i rrethit të Shtutgartit, i cili i ka ndihmuar Jusufit në disa çështje e udhëtime. Shok i rrethit të Faridin Tafallarit.

Shukri Demiri -me uniformën e policisë së Turqisë

DEMIRI HAJRIZ, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Hajriz Demiri, C.2.25.D.68 Manhaim 1, Tel +49.621.21526. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

DEMIRI SHUKRI,– Demiri Shukri, i lindur në rrethin e Kumanovës i shpërngulur në Turqi, ku ka punuar si policë. Aktivist i dalluar. Jeton në Suedi. Në vitet 1982-1983 e ka shpëtuar Sabri Novosellën nga një plan kidnapimi, prej UDB-së. Për këtë janë dënuar dy veta në gjykatat e Turqisë.

demography *demografi* studimi i popullsisë, madhësisë së saj, përbërjes dhe zhvillimit. Gjithashtu studiohen lidhshmëritë në mes faktorëve demografik dhe faktorëve tjerë si p. sh. ekonomik dhe social. Në kuadrin e demografisë hyn edhe

krijimi i teorive lidhur me relacionet në mes faktorëve të ndryshëm demografik dhe në mes këtyre dhe faktorëve të tjerë. Ato metoda që përdoren në demografi si rregull janë kuantitative.

democratic leadership *lidership demokratik* do të thotë se anëtarët e grupit aktivisht marrin pjesë në diskutim dhe në vendimet mbi synimet e grupit dhe për atë se cilat mjete do të përdoren për arritjen e synimeve. Ky lloj lideri delegon pushtet tek anëtarët.

demotic grup grup që mbahet lidhur (unik) prej lidhëzave tjera dhe jo të lidhjeve të gjakut.

depression depresion 1. gjendje tek individi në të cilën e ndien veten të stërlodhur dhe melankolik. Depresioni mund të jetë shenjë e një sëmundje psiqike apo është e tillë (sëmundje) në vetvete, pra pa ndihmën e faktorëve tjerë. Bëhen dallime në mes depresioneve neurotike dhe psikotike,
2. situatë në të cilën aktiviteti ekonomik në shoqëri zvogëlohet. Kjo ka si pasoj uljen e prodhimit dhe rritjen e papunësisë.

DERGJA E QYQEVE; Jusuf Gërvalla: "*Atje ku ranë bijtë e bijat e tua, nga një mij u ngritën në vend të tyre. Ty s'të ka prekur* ***dergja e qyqeve*** *– shterpërimi. As trimërinë s'e ke shterpë e të rastit. Nëse barbari s'të la t'ua bësh gjëmën as t'ua mburrësh plagën djemve të tu, s'ka gjë. Nesër, në liri, varret e djalërisë trime kosovare do të përjetësohen me kurora lavdie të dëshmorëve të orëve të para, kurse plaga që mori kjo djalëri, do të ndriçojë si pishtar në rrugën e lumtur të ardhmërisë. Sot nuk qenka e thënë të shërohen në spitale plagët e trimave të tu. Barishtet e malit do t'i shërojnë edhe më mirë. Kurorat e lashta e të larta të bjeshkëve të tua, Kosovë, do të bëhen strehë e sigurtë për kokat heroike të bijve e bijave të tua. S'ke rritur djem në të linjta. Janë djem që s'ia varin plagës ata. Mjaft që ti t'ua tregosh shtegun e luftës."* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, f. 2)

DERVISHAJ ALI – Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Ali Dervishaj, student nga f. Gllogjan, KK – Deçan, i lindur më 16 shkurt 1960, në të njejtin fshat. ... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh."*

DERVISHI TEJFAR, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Tejfar Dervishi, 74 4t4 Ave. Paterson. N. J. 07524 USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

determinism *determinizëm* grup teorish sipas të cilave objektet apo ngjarjet janë të përcaktuara në natyrën e tyre në bazë të ndonjë ligjshmërie. Mund të dallohen determinizmi kausal, sipas të cilit ekziston një lidhje direkte, shkaku pse diçka ka ndodhë, dhe determinizmi jokausal sipas të cilit, p. sh. ekziston vetëm mundësia apo probabiliteti në relacionin shkak-pasojë.

deterministic teory *teori deterministe* ka këtë mënyrë sqarimi: nëse ndodhë A do të ndodh edhe B.

deterred gratification pattern *shtyrje e plotësimit të nevojave* Ndodhë kur e shtyn për të ardhmen plotësimin e menjëhershëm të një nevoje në mënyrë që ta plotësoj këtë në një kohë të mëvonshme. Në këtë vonesë hyn pritja, shpresa se në të ardhmen do të krijohet

mundësia për t'i plotësuar nevojat në një shkallë më të madhe se sa që është e mundur në situatën momentale. Kështu, kur në vend që t'i konsumoj të gjitha të ardhurat, e kursen një pjesë të tij, e bënë këtë me shpresën se në të ardhmen do të ketë mundësi që t'i kënaq më shumë nevoja dhe më të shtrenjta, se sa që është e mundur për t'u bërë në gjendjen momentale. Kjo mënyrë e sjelljes lidhet shpesh me vlerat e klasës së mesme.

DEVA RAIZ, shtetas i Turqisë me prejardhje shqiptare apo nga viset shqiptare. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Raiz Deva, Zefer Mahlesi, Marangoz Bursa. *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës i është dërguar për ta informuar me gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi.

diagnostic study ka për qëllim të hulumtoj shkaqet e një gjendje të keqe dhe duke u nisur nga rezultatet e fituara dhe informata tjera të propozoj masa për zbutjen apo eliminimin e gjendjes së vështirë.

dialectic materialism *materializmi dialektik* metoda e marksizmit për shpjegimin e zhvillimit të shoqërisë. Ajo është dialektike pasi bazohet në rezonimin se konflikti në mes dy fenomeneve sociale, tezës dhe anti-tezës, sjellë deri tek shkrirja e tyre në sintezë. Metoda është materialiste në kuptimin se ajo potencon se zhvillimi mvaret nga marrëdhëniet në prodhim dhe organizatës së prodhimit. Një lloj i caktuar i mjeteve të prodhimit dhe ndarja e punës jep shkak për formën e një organizimi të prodhimit. Me kalimin e kohës vjen tek konflikti në mes këtyre dy elementeve, tezës dhe anti-tezës, që bëhet shkak për një ndryshim social, sintezën.

DIBRANI N., veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: N. Dibrani, Untenführungstr. 18 4600 Olten. CH. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

DIBRANI SHEFQET; Aktgjykim: " *SHEFQET DIBRANI, i biri i Aliut dhe i Kadës e gjinisë Ferizi, i lindur më 14.09.1944, në fshatin Dumnicë e Ultë komuna e Vuçitërnës, ku ka edhe vendbanimin, shqiptar, shtetas i RSFJ, i pa martuar, ka të kryer SHNE - dega për vegëltar, punëtor në fabrikën "Poliester" në Podujevë, shërbimin ushtarak nuk e ka rregulluar, i pa dekoruar, me gjendje të varfur ekonomike, (...) kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05.08.1982, ...*

Gjykon

Të akuzuarin Shefqet Dibranin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 5 (pesë) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit....

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË E TITOS

P-nr. 9/83, - më 27.05.1983"

differentiation proces *proces diferencimi* i cili sjell tek një gjendje, apo është vetë gjendja që përshkohet nga specializimi dhe heterogjeniteti në shoqëri. Si shembull për këtë mund të merret rritja e madhe e ndarjes së punës në profile të ndryshme, që ka sjellur tek një numër i madh grupesh ku secili grup lufton për interesat e veta.

DINAJ DEMË, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Dem Dinaj, Am Buchagn str. 32 D-5963 Venden 1 Krs OLPE. Ka qenë një ndër pikat prej nga

është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

direct observation *vrojtues direkt* metodë për mbledhjen e informacionit ku një vrojtues, observues regjistron praninë apo mungesën e atyre sjelljeve që atij i interesojnë, tek individi apo grupi i cili hulumtohet. Kjo metodë ndeshet si në laboratore ashtu edhe në mjedise reale.

disintegration *dezintegrim* shkapërderdhje e një njësie të mëparshme integruese. Kjo mund të vlej për personalitetin e një individi, për një grup, një institucion apo tërë shoqërinë.

distributive justice do të thotë se individi ka një paramendim se si shpërblimet duhet të shpërndahen në shoqëri. Deri tek rezultati i paramendimit në fjalë vihet duke bërë krahasime se si po shpërblehen individët tjerë dhe nëse paramendimet e pranueshme për ndarjen e shpërblimeve, apo të kuptuara si të drejta prishen, atëherë vjen deri tek tensionet. Në një situatë ku ekziston *distributive justice*, duhet që popullsia të ndahet sipas një apo shumë kritereve, të cilat në pikëpamje sociale janë të pranueshme. Pajtueshmëria lidhur me atë se cilat kritere do të vlejnë arrihet kur individët kanë mundësi të krahasojnë grupet apo individët në bazë të kontributeve të tyre dhe shpërblimet të cilat ata marrin për këto kontribute.

Nëse dy apo më shumë grupe ose individ marrin shpërbim për sjellje e cila vlerësohet në mënyra të ndryshme, në bazë të *distributive justice* ajo sjellje që vlerësohet më shumë shpërblehet më shumë.

DOLLARËT PËR DJELMOSHAT Jusuf Gërvalla: "*Djelmoshave të tjerë në Romë, Besniku u kishte lënë 200 dollarë, këtu e kemi një shok të njërit prej tyre dhe prandaj shpresojmë se do ta fitojmë besimin e tyre dhe t'i bëjmë shokë edhe ata."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

DULLA SELIM, – Selim Dulla, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit që ka bërë punë të mëdha për Jusufin e Bardhoshin, por nuk e ka reklamuar veten kurrë. Sikur të kisha të dhëna konkrete biografike dhe ndonjë fotografi, tek Selim Dulla do të ndalesha më gjatë. Ka banuar në një ndërtesë së bashku me Remzi Ademajn në: Marktstr. 29, D-7129 Brackenheim.

DURAKU XHEMAJL, veprimtar në Suedi. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Xhemajl Duraku, Månskensgatan 43, 26035 Ödåkra, Sweden. Ka qenë një ndër pikat në Suedi prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Në banesën e tij, në fillim të qëndrimit të tij në Suedi ka qëndruar Naim Haradinaj.

DUSHICA HESAT, Hesat Dushica aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit, dhe shok i Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës.

E

ecological process *proces ekologjik* proces sipas të cilit shpërndarja e popullsisë në një rreth të caktuar ndryshon apo qëndron e pandryshuar. Procese ekologjike janë p. sh. centralizimi, decentralizimi, segregimi etj.

ecological distance *distancë ekologjike* shpenzimet dhe koha që nevojitet për të arritur prej një vendi në një tjetër.

economic man 1. fillimisht një parafytyrim se njeriu është i tillë se ai vepron vetëm në interesin e vet mbi baza racionale, për ta maksimizuar kënaqësinë dhe minimizuar dhembjen. Përfaqësues të kësaj pikëpamje mbi njeriun kanë qenë ekonomisti Adam Smith dhe filozofi Jeremy Bentham,
2. tani me nocionin economic man mendohet një model abstrakt lidhur me atë se si një individ kishte me vepruar ekonomikisht po të ishte ishte ai plotësisht racional dhe gjithashtu të kishte njohuri të plota për tregun.

economic determinism *determinizëm ekonomik* teori në bazë të së cilës forcat dominuese në jetën sociale dhe në ndryshimet sociale janë ato ekonomike. Teoria bazohet në Karl Marksin.

economic sociology studimi i institucioneve ekonomike në një shoqëri dhe relacioni i tyre me institucione tjera. Studimi i efekteve të reklamës dhe sjelljet e konsumatorëve nganjëherë trajtohen si fenomene ekonomike-psikologjike e nganjëherë si fenomene ekonomike-sociologjike.

effectivness *efektivitet* shkalla e arritjes së qëllimeve të një organizate. Efektiviteti mundet të matet me njësi fizike, psikologjike, sociale apo me ndonjë kombinim të këtyre faktorëve që u përmendën. Nëse qëllimi i një grupi politik është ta merr pushtetin në një shoqëri atëherë ai është efektiv nëse ia arritë këtij qëllimi.

efficiency *produktivitet* ajo masë e resurseve që përdoret për prodhimin e një produkti. Si resurset ashtu edhe produktet mund të jenë të karakterit material ose jo-material. Nëse ato janë të llojit të dytë (jo-material), matja e produktivitetit mund të jetë e vështirë për t'u kryer. Produktiviteti dhe *efektiviteti* janë shpesh në proporcion në drejtë me njëri-tjetrin, por mund të ndodh, që një organizatë produktive të jetë jo-efektive. Një ndërmarrje, që ka produktivitet të lartë dhe që ka si qëllim një fitim të caktuar, me rastin e rënies së konjukturës ka me shkua me humbje, d. m. th. efektiviteti është negativ.

EFTHIM ALEKS, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Aleks Efthim 13330 Nadine St. Huntigton W. Mi 48070 U:S:A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

EGRIU ANIFETE – Anifete Egriu (21 nëntor 1939 – 3 prill 1998), bashkëshortja e atdhetarit Din Egriu dhe nëna e dëshmorit, snajperistit dhe luftëtarit të shquar në betejen legjendare të Koshares, Naxhi EGRIU, apo siç e thërrisnin bashkatdhetarët tanë në SHBA, Shote Galica e Dibrës, e cila së bashku me bashkëshortin e saj - Din Egriun, me Flamurin kombëtar dhe me plis të bardhë merrte pjesë në çdo protestë a demonstratë, në

SHBA e gjetkë. Deri sa disa dilnin të maskuar, ajo së bashku me Dinin, që treti gjithçka për komb, Kosovë dhe Atdhe, qëndronin në ballë të çdo demonstrate.

EGRIU DIN, veprimtar në ShBA, burri i Anifete Egriut. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Din Egriu 10 Ocean Parkway Brooklyn, N.Y. 11218 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

Reshat Sahitaj: *"Baca Din ishte njëri prej tyre që Atdheun e kishte të vulosur në zemër. Banesa e tij në Bruklin, ishte një copëz e Atdheut që e ruante me fanatizëm. Muret e dhomave të stolisura me flamurin kombëtar dhe me fotografi si të: Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës ishin në ballë përkrah Skënderbeut, Azem Bejtës e Shote Galicës e shumë e shumë fotografi të patriotëve shqiptarë. Baca Din i tëri ishte shndërruar në Atdhe, madje edhe të posa ardhurit në Nju Jork në banesën e tij gjenin mikpritjen, bujarinë shqiptare dhe një copëz të vendlindjes se tyre.*

Edhe pas 25 viteve, ende të freskëta i kam kujtimet për veprimtarinë e Bacës Din. Herë pas here e hapi arkivin e letrave të shkruara të asaj kohe dhe kur e shoh shkrimin e tij, ndalëm, e lexoj, e përkëdheli letrën dhe më shpëtojnë dy pika loti. E shfletoj albumin e fotografive dhe më ëndje kaloj orë të tëra duke e shikuar Bacën Din.

Anifete dhe Din Egriu

Për një çast me sillet ndërmend banesa e tij, fjalët dhe aktiviteti i tij. Me sillën ndërmend rrethi i aktivistëve të asaj kohe që e formonin bërthamën e patriotizmit në Nju Jork siç ishin: Ismail Gjonbalaj, Luigj Gjokaj, Demush Zeqiraj, Rrok Nikçi, Xhavit

Kabashi, Ndue Camaj, Gjeto Sinishtaj, Ramiz Llapatinca, Gjergj Dedvukaj, Ahmet Zherka, Muharrem Dovolani, Sadik Kryeziu e shumë e shumë aktivistë tjerë të cilët bashkë me Bacën Din e krijuan Klubin e parë shqiptar "Jusuf Gërvalla" në qendër të Bronxit. Themelimi i klubit shqiptar "Jusuf Gërvalla", sinjifikonte dhe paralajmëronte një fazë të re të organizimit tonë. Deri aso kohe pjesa më e madhe e klubeve shqiptare ishin klube jugosllave. Klubi "Jusuf Gërvalla" ishte një ndarje nga klubet jugosllave. Pikërisht ato kohë do ta bënim filmin televiziv "Procesi" të shkruar nga Jusuf Gërvalla e dorëshkrimin e të cilit e kisha unë e më vonë u botua si libër. Klubi "Jusuf Gërvalla", do të shquhej për aktivitete kombëtare me organizmin e demonstratave dhe organizimin e mërgatës duke hapur shkollën shqipe e shumë tubime tjera informative për ngritjen dhe vetëdijesimin kombëtar të mërgatës në Nju Jork...

Vepra e Din Egriut, Tasim Lenës, Lutfi Dautit, Anifete Egriut do mbesin të përjetshme sepse këta nuk vepruan për interesin e tyre personal, por për atë të përgjithshëm." (Din Egriu, Në shenjë përkujtimi; www.dervina.com, 26 prill 2008)

elite *elitë* në kuptimin e gjer ai grup i personave që në një shoqëri i ka pozitat më të larta. Ky nocion para së gjithash është zhvilluar në sociologu italian V. Pareto, për të cilin nocioni elitë është çështje qendrore. Populllsia e një shteti ndahet në dy shtresa, jo-elitën dhe elitën. Elita ndahet në elitën drejtuese dhe jodrejtuese.

empathy *empati* aftësia për ta kuptuar dhe përjetuar sjelljen e të tjerëve duke pasur përbazë përvojat personale.

empirical *empirik* Me këtë fjalë mendohet në atë se kryesisht observimet bazohen në përvojën e shqisave të ndijimit dhe pikënisja është logjika induktive. P.sh. mund të niset nga qëndrimi se dielli ka me lindë edhe nesër, duke e bazuar këtë në faktin se vet e ka parë duke lindur, në të gjitha mëngjeset tjera.

empiricism *empirizëm* doktrinë e cila thotë se të supozimet, premisat, duhet të bazohen në hulumtime empirike. Percepcioni, sipas përfaqësuesve të kësaj shkolle (Bacon, Locke, Hume) është baza e të gjitha njohurive. Një shkollë më moderne që më së afërmi i bashkohet empirizmit është *pozitivizmi*.

employee-oriented leader udhëheqës ose kryepunëtor i cili gjatë udhëheqjes së punës më së tepërmi u kushton rëndësi interesave të atyre që i udhëheq. Mbikëqyrja karakterizohet nga bashkëpunimi, demokracia në grup dhe aprovimi i metodave të reja të punës. E kundërta është *production oriented leader,* (udhëheqës të cilit në radhë të parë i intereson produktiviteti).

emulation, një proces kur personat e suksesshëm në pikëpamje sociale merren si shembull se si duhet me u sjellur, apo sjelljet e tyre imitohen nga ata që nuk janë të suksesshëm.

ENGELS - FRIEDRICH ENGELS, lindi më 28 nëntor 1820 në Barmen (tani pjesë e Wupertal-it), Nordrhein-Westfalen, Gjermani, vdiq më 5 gusht 1895 në Londër. Ka qenë një komunist dhe teoricienë gjerman, i cili së bashku me Karl Marksin është themelues i marksizmit.

Engels: "*Formimi i një fronti revolucionar të përbashkët është i pamundshëm, nëqoftëse proletariati i kombeve shtypëse nuk përkrah drejtpërdrejt dhe në mënyrë të*

vendosur lëvizjen çlirimtare të popujve të shtypur kundër imperializmit të "atdheut" të vet, sepse 'nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë".

epistemology, teoria e diturisë, njohjes, studimi i burimeve të diturisë, kufijve, vlershmërisë dhe raportet e brendshme të saj.

E SËMURA E BALLKANIT Jusuf Gërvalla: "*E sëmura e Ballkanit, Jugosllavia, këmba këmbës po i afrohet shtratit të një vdekjeje të turpshme. Ekonomia e saj, e bazuar në pjesën më të madhe mbi ndihmat dhe mbi kapitalin e huaj, po gremiset nga minuta në minutë. Standardi jetësor ka rënë aq poshtë, sa vetëm që s'kanë kumbuar kambanat e falimentimit të plotë. Dinari është zhvlerësuar dhe është bërë si një paçavure qerepi, kurse inflacioni s'di të ndalur. Dhe sa më shumë që thellohet kriza, aq më shumë vete e nxiton hapin anarkia në treg, e të mos flasim për çmimet; qeveria e Beogradit nuk po gjen dot frenj për t'ia ndalur turrin kalit të hazdisur të çmimeve, i cili po e ha dizginin si i flamosur*." (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 3)

estrangement, një rritje e distancës sociale, një ftohje emocionale në relacionet individ - individ ose individ - grup. Stadi që e pason estrangement-in është *konflikti*.

ethnic group *grup etnik* një grup social brenda një sistemi më të madh social, i cili ka apo supozohet se ka disa karakteristika të veçanta. Këto mund të jenë gjuhësore, religjioze ose racore, të cilat shpesh kanë të bëjnë me anëtarët e grupit apo me prejardhjen gjeografike të stërgjyshërve të tyre. Në rastet më të shpeshta kemi të bëjmë me një kombinim të karakteristikave të përmendura.

ethnocentrism *etnocentrizëm* atityd që e konsideron grupin e vet më superior se të gjitha grupet e karakterit të njejtë. Grupi vetjak është qendra e gjithçkafit. Shpesh, ky term përdoret për të përshkruar relacione racore. Termen është fut në përdorim nga W. G. Summer në librin e tij *Folkways* (1907).

etnography *etnografi* studimi përshkrues (deskriptiv), rëndom, i shoqërive primitive.

ethnology *etnologji* shkenca e studimeve krahasuese në mes shoqërive njerëzore. Kohëve të fundit kufiri në mes entografisë dhe etnologjisë është zbehur gjithnjë e më shumë.

evolutionism drejtim antropologjik i cili ka potencuar se të gjitha kulturat njerëzore, parimisht, kalojnë nëpër të njejtat procese, pasi njerëzit janë të njejtë çdokund dhe në të gjitha kohët. Evolucionistët, me përfaqësuesit e vet kryesor - anglezin Edward Tylor dhe amerikanin Louis Morgan, teoritë e tyre i mbështetnin në gjetjet identike tek kultura krejtësisht të ndryshme. Morgani e konstruktoi një model që do të vlente për të gjitha shoqëritë dhe zhvillimet kulturore. Mendim i tij ishte se njeriu, fillimisht në gjendje të egër, kur u bërë zbulimi i përdorimit të enëve të poçerisë (vorbave e vegshave) erdhi një stad që Morgan e quan barbari, që pastaj u zavendësua me stadin e civilizimit. Shkolla evolucioniste, në kohën tonë ka pak përkrahës. Vetitë identike kulturore shpesh shpjegohen me *diffusion*. Shkollat dominuese antropologjike tani janë *funksionalizmi* dhe *strukturalizmi*.

explicit culture forma e sjelljeve më të rëndomta dhe tipike në një shoqëri. Formë e kulturës e cila vërehet në mënyrë direkte nga studiuesi. Kultura eksplicite përcaktohet nga *kultura implicite*.

expresive leader Në një grup shpesh gjenden dy funksione të udhëheqësit; udhëheqësi instrumental i cili në radhë të parë koncentrohet për detyrat e grupit dhe udhëheqësi ekspresiv, detyra e të cilit është zgjidhja e tensioneve në grup. Shpesh herë të dy funksionet janë të bashkuara në një person, por është i rëndomtë edhe rasti kur një individ merret me udhëheqjen instrumentale dhe tjetri me atë ekspresive. Familja e tipit të Botës Perëndimore udhëhiqet përgjithësisht në formën instrumentale nga babai dhe në atë ekspresive nga nëna.

expresive orientation Për një grup thuhet se ka orientim ekspresiv nëse veprimtaria e tij kryesisht është e drejtuar me ekzistencën e vazhdimësinë e vet dhe jo me ndonjë synim tjetër. Kryesorja, pra nuk është, siç është rasti tek *instrumental orientation*, veprimtaria e grupit, por vetëm mirëqenia dhe atmosfera në grup. Shembuj për grupe me orientim ekspresiv janë "*shokët e vjetër të Normales së Elbasanit*".

external system norma dhe sjellje që priten në sistemin e madh apo të gjerë social, në kuadrin e të cilit hyn grupi i vogël, për ndryshim nga *internal system - sistemi intern* kur normat dhe sjelljet e pritura janë të krijuara brenda grupit të vogël. Sipas George Homans, i cili e ka bërë introduktimin e këtij termi në *The Human Group* (1950), aktivitetet që kanë të bëjnë me synimet e grupit përcaktohen kryesisht nga sistemi ekstern, ndërsa aktivitetet integruese, pra ato aktivitete që kanë për qëllim për ta mbajt grupin të bashkuar, përcaktohen nga sistemi intern.

extrovert personality Vëmendja dhe interesat e individit janë të drejtuara kryesisht ndaj fenomeneve sociale eksterne (të jashtme). E kundërta e kësaj është *introvert personality*, ku interesimet janë të drejtuara kryesisht nga vetvetja.

F

Fabian Society , organizatë me orientim socialist në Angli, i cila rëndësinë më të madhe e ka pasë në fund të viteve 1800 dhe në fillim të viteve 1900. Përmbajtja ideologjike është karakterizuar nga orientimi elitist, burokratik dhe jo-revolucionar. Njëri prej anëtarëve më të njohur të saj dallohet Bernard Shaw.

face-to-face group grup i asaj madhësie kur të gjithë anëtarët gjatë ndërveprimit të tyre kanë mundësi të dallojnë secilin pjesëmarrës, anëtarë të grupit.

facility secili objekt në shoqëri që mund të përdoret për të arritur një qëllim. Nuk është e domosdoshme që mjeti i përdorur të jetë i ligjshëm. Ato mjete që përdoren për t'ia arritur një qëllimi të njejtë, në kultura të ndryshme, mund të jenë të ndryshme. Në shoqërinë industriale, paraja dhe pasuria janë mjete me ndihmën e të cilave mund të arrihen shumica e qëllimeve. Një objekt është facilitet vetëm për aq kohë sa mund të përdoret për arritjen e një qëllimi.

fad një sjellje e re që përhapet shpejt dhe zhduket shpejt. Si rregull, ajo është sjellje kolektive dhe përhapet përmes sugjestionimit apo imitimit.

family cycle, stadet e ndryshme nëpër të cilat një familje kalon. Ajo paraqitet, krijohet përmes martesës, rritet përmes lindjeve, zvogëlohet kur fëmijët shpërngulen nga shtëpia dhe pushon së ekzistuari kur anëtarët e saj vdesin.

family disorganization do të thotë se bashkësia familjare shkapërderdhet kur një apo disa anëtarë të saj nuk munden apo nuk duan t'a kryejnë atë rol të cilin e kanë. Vdekja dhe ndarja-shkurorëzimi janë dy nga shkaqet-llojet më të shpeshta të shkapërderdhjes. Por ka rrethana që qojnë në dezorganizim edhe kur nuk është fjala për vdekje apo shkurorëzim, kur lidhjet emocionale në mes anëtarëve të familjes nuk funksionojnë - prishen, apo komunikimi në mes tyre është i një shkalle të ulët, e mund edhe të mos ekziston fare.

family of orientation ajo familje në të cilën individi është i lindur. Ajo familje të cilën ai eventualisht është bashkëkrijues quhet familja e vet.

family, sociology of studimi i familjes si institucion social dhe çfarë relacionesh ka ajo me institucionet tjera. Interesimi drejtohet tek llojet e ndryshme të familjes dhe funksionet e tyre në rrethana të ndryshme, ndarjen e roleve, familjen si një faktor të rëndësishëm në procesin e socializimit etj.

fatalism *fatalizëm* koncept sipas të cilit është jashtë mundësive të njeriut për të kontrolluar një lloj të ngjarjeve.



“FATI I LULEVE”, një vepër monumentale për jetën dhe veprën e Jusuf Gërvallës, shkruar nga bashkëveprimtari, Kadri Rexha

"...Në librin “Fati i luleve” Kadri Rexha, përmes një metodologjie të përparuar shkencore ka marrë në shqyrtim dhe ka trajtuar me sukses jetën dhe veprën e Jusuf Gërvallës, familjes së tij, shokëve të idealit, bashkëveprimtarëve të shumtë, duke na sjellë mori të dhënash, fakte, argumente krejtësisht reale, duke pasqyruar me besnikëri deri edhe detaje të hollësishme nga jeta e këtij heroi të kohës sonë.

Ka qenë e vështirë për autorin të vendos për të shkruar një vepër të tillë, meqë jo vetëm njëherë autorë të shumtë, madje edhe me përvojë, kanë marrë mundin për të ndriçuar jetën e kolosëve, por nuk ia kanë arritur, sepse të shkruhet një libër për një personalitet, që ka lënë gjurmë të thella në historinë e lëvizjeve çlirimtare, gjithmonë ka qenë dhe mbetet një punë e vështirë. Duke sqaruar motivet për ta shkruar

këtë vepër, autori në "prolog" të librit ka shkruar: "Dëshira për shkruar për Jusuf Gërvallën nuk më ka lindur rastësisht, më parë se të jetë përgjigje e kërkesës së shokëve dhe miqve të mi, si edhe e shumë shqiptarëve që i takova nëpër qelitë e errëta të burgjeve, më tepër se të jetë ndjenjë e fortë e detyrës, për të shkruar për figurat e shquara të historisë dhe kulturës sonë kombëtare..... janë kujtimet e mia borxhe dhe amanet, që i bart si barrë në qenien time vite me radhë".

Kadri Rexha ka pasur edhe mbështetjen e bashkëmendimtarëve të Jusufit, për ta ndriçuar biografinë e tij. I gjendur përballë këtij "presioni" të dobishëm, duke konsideruar me të drejtë se ka qenë dhe ka mbetur kurdoherë besnik i idealeve për çlirim dhe bashkim kombëtar, ai i rreket punës me seriozitetin e duhur, dhe për një kohë të gjatë ka grumbulluar të gjitha ato materiale të domosdoshme për të shkruar këtë monografi, pa pretenduar se ka arritur t'i thotë të gjitha.

Jusuf Gërvalla, Kadri Rexha (në mes) dhe Skënder Blakaj
Shtëpia e studentëve, 1 korrik 1972

Duke qenë se në kohën kur kishte filluar ta shkruante monografinë, Kadriu tashmë ishte emër i njohur, jo vetëm për qarqet tona letrare e publicistike, por një emër shumë i nderuar edhe në radhët e Lëvizjes sonë Kombëtare, ai kishte projektuar idenë për shkrimin e monografisë dhe pas disa viteve, i përballur me të gjitha vështirësitë, me të cilat ndeshet çdo autor i ndërgjegjshëm dhe serioz, kishte arritur që në vitin 1993 ta nxjerrë në dritë këtë monografi, ndër më të realizuarat e letërsisë sonë të këtij zhanri.

... Duke analizuar të dhënat nga origjina e heroit, nga familja, shkollimi, mërgimi në Slloveni, kthimi sërish në Kosovë, puna, angazhimi atdhetar, veprimtaria legale dhe ilegale në dobi të kombit e atdheut, aspirata për liri dhe bashkim kombëtar, ikja për të mos rënë në kthetrat e UDB-së e deri te martirizimi..., jeta dhe vepra e Jusuf Gërvallës

është ndriçuar në kohë dhe hapësirë, në sinkroni dhe diakroni, me një vizion të qartë dhe shumë relevant, në mbështetje të fakteve të shumta dhe të pamohueshme. Si e tillë, e përpunuar në të gjitha segmentet, kjo vepër radhitet ndër veprat më të arrira të këtij zhanri të letërsisë sonë bashkëkohore.

Mendoj se autori i këtij libri ka arritur të përmbarojë monumentin e tij shkrimor, në radhë të parë duke u mbështetur në përkushtimin e vet atdhetar, pastaj edhe fatit, që ishte bashkëkohës dhe bashkëveprimtar me Jusuf Gërvallën si dhe pajisjes me një kulturë të gjerë njohëse, shumë dimensionale, të cilën e disponon ky studiues meritor i letrave tona.

Në sintezat që autori ka nxjerrë pas punës së tij të gjatë në hartimin e këtij libri, ka vërejtur me vëmendje se " Jeta dhe vepra e Jusuf Gërvallës nuk janë dy fenomene që kundërshtohen... por ato shkojnë e shkrihen në një fokus duke e dhënë kështu sintezën e njeriut me gjithë urtësinë, njerëzinë, bukurinë dhe madhështinë e tij... ai besonte se njeriu në jetën e tij është farkëtues i fatit të vet..." Veprat si kjo na bindin në vërtetësinë e këtij konstatimi." (Ahmet Qeriqi, www.radiokosovaelire.com)

FERIZI ME SHOKË E FAREFIS Jusuf Gërvalla**:** ***"****Kërkonin prej meje makinën tjetër të shkrimit, atë të punës (makinën ilegale e kishin gjetur). Atë makinë e kisha në banesë të Muhamet Tërnavës, e Muhameti ishte zyrtarisht në Gjermani. Pasi nuk e gjetëm të vëllain, që të na e çelte derën e banesës, inspektorët e SPB-së shkuan dhe e morën një mjeshtër, e çelën derën me dhunë, e morën çantën, dhe ata i vunë derës dry të ri, e çelësat m'i dhanë mua.*

Pastaj më çuan deri në banesë, ku i gjeta Bacën Mujë, Idrizin, Ferizin e Ramizin. Këta ndenjën sa ndenjën, e u çuan." (Shënime nga Ditari)

fetish *fetish* objekt për të cilin mendohet se ka fuqi magjike. Duke e pasur në posedim, apo vetëm prekja e një objekti të tillë i sjell fat personit. Fetishet mund të jenë gur të formave të ndryshme, dhëmbë shtazësh, bujashka druri, etj.

FILOZOFI (dashuri për diturinë) Nuk ekziston ndonjë definicion i përgjithshëm dhe i pranueshëm i fjalës filozofi, por disa përkufizime që përmenden më poshtë mund të shërbejnë si pika orientimi:

1. Filozofia pjesërisht mund të kuptohet si një *teori* dhe pjesërisht si *mënyrë e jetesës* apo një aktivitet i veçantë i filozofit. Nëse vëmendja përqendrohet tek filozofia, si aktivitet atëherë ajo mund të përcaktohet si *synim kah dituria*, do me thënë një mënyrë e caktuar jetese, e harmonishme dhe me plotë dituri. Në filozofinë e Indisë, Kinës si dhe në një pjesë të madhe të asaj evropiane, ky lloj kuptimi i filozofisë kuptohet si themelor, dhe në këtë mënyrë filozofia ndërthuret së bashku me një qëndrim etik jetësor të caktuar, religjiozitet apo terapi.

Në të kundërtën e kësaj, filozofia mund të ndahet krejtësisht, filozofia si mënyrë e jetese, duke e bërë një dallim të qartë në mes filozofisë si një teori i veçantë në njërën anë dhe filozofit në anën tjetër. Në këtë rast filozofi kuptohet si person që filozofinë e ka profesion, do me thënë është punëtor me pagë apo shkrimtar i lirë, i cili merret me një punë të caktuar teorike. Një kritikë ndaj qëndrimit të tij personal ndaj punës së tij si filozof do të mund të hidhej poshtë si *argumentum ad hominem*. Një shprehje ilustruese, edhe pse jo identike do të ishte: *Mos më shiko se çka jam duke bërë por ndëgjom çka jam duke thënë.*

Shumica e filozofëve e shohin veten, se ata ndodhen dikund në mes të këtyre dy qëndrimeve ekstreme.

2. Në rastet kur filozofia konsiderohet si teori, ajo është në kuptimin më të gjerë identike me një apo ndonjë formë tjetër të botëkuptimit.

Në bazë të një kuptimi më të ngushtë mbi filozofinë, filozofia dhe një botëkuptim vërtetë merren me të njejtën çështje, *lëndë*, por kanë qëndrime të ndryshme ndaj saj. Lënda në të dy rastet është realiteti i vrojtuar si tërësi, çështja mbi themelet e realitetit, botën, vendin e njeriut në botë, mundësitë e njeriut për të fituar dituri dhe mundësitë e tij të veprimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tij. Por, përderisa një botëkuptim vetëm sa e paraqet pikëpamjen e tij mbi tërësinë, një filozofi *është e detyrueshme të argumentoj* për teoritë e saj. Kjo do të thotë një kufizim-përkufizim i lëndës për të cilën filozofi mund të deklarohet, në cilësinë e tij si filozof. Deri ku shkon kufiri, dhe çka është një argument i qëndrueshëm, është një prej problemeve themelore të gnoseologjisë.

Në bazë të skepticizmit kërkesa për argumentim filozofik do të thotë distancim nga pjesa më e madhe e filozofisë tradicionale. Në vitet 1900 diçka të ngjashme kanë thënë pos tjerësh Wittgenstein dhe më vonë Rorty. Kërkesa për argumentim, do të thotë se filozofia konsiderohet si një formë e shkencës. Në kohën antike filozofia, pjesërisht ka mund të jetë kulmi i shkencave, dhe pjesërisht një *shkencë rreth themeleve të gjithçkaje* (teoria e Aristotelit mbi *prote philosophia*, "filozofinë e parë" =metafizikën). Me paraqitjen e zhvillimin e shkencave të veçanta përveç matematikës (e cila qysh gjatë antikës është dalluar në një grupim të pavarur) gjatë fundit të viteve 1700 dhe fillimit të viteve 1800, është bërë një detyrë e ngutshme të bëhet dallimi në mes filozofisë dhe shkencave. Tradicionalisht bëhet dallimi në mes matematikës dhe shkencave empirike në njërën anë dhe *filozofisë apriori* në anën tjetër, që sjell tek shtrimi i pyetjes se çka mendohet me dituri apriori. Shpesh herë bëhet shmangia prej këtij problemi duke e përcaktuar filozofinë si reflektim mbi shkencat dhe jetën.

3. Filozofia mund të ndahet në mënyra të ndryshme. Stoikët dhe Epikuri e bëjnë një ndarje në *logjik* (duke përfshi edhe gnoseologjinë), *fizikë* (duke përfshi shkencat natyrore dhe *metafizikën*, do me thënë atë që më vonë është zhvilluar në atë që quhet *filozofi natyrore*, dhe *etik* (duke përfshi filozofinë e vetëdijes dhe psikologjinë. Në bazë të një klasifikimi tjetër të rëndomtë filozofia përbëhet nga logjika, gnoseologjia, metafizika dhe etika. Shumë filozof, në mesin e tyre Aristoteli dhe Kanti bëjnë dallimin në mes ***filozofisë teorike*** (*logjikë, metafizikë, gnoseologji* dhe *semantik*) dhe ***filozofisë praktike*** (*teoria e vlerave, etika, estetika, filozofia e së drejtës* dhe *filozofia e religjionit*).

fine arts *artet e bukura* aktivitete autorësh që rezultojnë në piktura, skulptura, libra, pjesë teatrale, muzikë etj. ku përdoren teknika të zhvilluara sa i përket formës, fjalëve etj. Ky aktivitet ka rezultuar në krijimin e zanateve dhe organizatave të ndryshme, që në një mënyrë apo tjetër i mbron interesat e shkrimtarëve, muzikantëve, skulptorëve etj.

fission përçarja e një grupi në dy apo më shumë grupe më të vogla. E kundërta është *fussion.*

FLAKA E PASHUAR E LËVIZJES
në Untergruppenbach

Lista e atyre që ndihmuan luftën dhe e mbajtën FLAKËN TË PASHUAR në Kështjellën e Vëllezërve Gërvalla dhe me këtë e nuk ia lejuan UDB-së Serbe dhe vrasësve të saj ta shuaj si subjekt edhe Lëvizjen e tyre Nacionalçlirimtare:

Shokët e Remzi Ademajt	1990 DEM
Shokët e Remzi Ademajt nga Mynheni	6240 DEM

Shokët e Remzi Ademajt nga Heilbroni	2520 DEM
Shoku i Remzi Ademajt	260 DEM
Shoku i Remzi Ademajt – kroat	50 DEM
Shokët e Remzi Ademajt	200 DEM
Shokët e Remzi Ademajt	386 DEM
Shokët e Remzi Ademajt nga Mynheni	920 DEM (bashkërisht 12566 DM)
„Shoqëria Vullneti“	11970 DEM
Klubi „Emin Duraku“ i Dyseldorfit	9480 DEM
	26500 BEF
	700 FRF
	150 DEM
Vëllezërit nga Berni	1410 SFR
	2000 SEK

(bashkërisht 21960 DEM - pa valuta tjera)

Miku i Hasan Malës nga Manhajmi	200 DEM
Shokët e Shaqir Shabanit nga Manhajmi	210 DEM
Shokët e Mynhenit, Abdyl Pacolli	330 DEM
Hetem Fejza me shokë	300 DEM
Tezaku i Hysenit	50 DEM
Shokët e Murat Kryeziut	500 DEM
Shoku i bacit Jahë	20 DEM
Shokët nga Sindelfingeni	120 DEM
Shokët nga Zvicra	500 DEM
Shokët nga Cyrihu	200 DEM
Shokët nga Berna	200 DEM
Shokët e Shtutgartit	500 DEM
Shoqëria Bernhauzen	300 DEM
Shoqëria Ahmet Sadikut nga Frankfurti	490 DEM
Shokët nga Mynheni	600 DEM
Shokët nga Ludvigsburgu	330 DEM
Ramadani dhe shoku i tij	200 DEM
Shoku i Nami Ramadanit	100 DEM
Shokët nga Manhajmi	250 DEM
Shokët nga Bitighajmi	1100 DEM
Shoku i Zhujit	100 DEM
Shoqëria Mörs – 3 Replenstrase 14	2200 DEM
Solidariteti Bremen	1300 DEM
Solidariteti “Fronti Popullor”	240 DEM
Ramadan Kurtishi me shokë.	
Këta shokë dhanë gjithsej	930 DEM
Shokët nga Zvicra	980 DEM
	+250 SFR+2130 dinarë
Shokët nga Manhajmi	330 DEM +100 BFR
Miku i Zhujit	300 DEM
Shokët e Zhujit	170 DEM
Shokët e Ahmet Sadikut	
nga Dajmler Benz kontributi i librave	140 DEM
Shokët nga Manhajmi	250 DEM
Frankfurti	970 DEM

Shoku i Mynhenit	100 DEM
Shoku i Nami Ramadanit	20 DEM
Shokët e Zvicrës	1100 SFR
Shoku i Ulqinit	140 DEM
Shokët e Zhujës	600 DEM
Shokët e Murat Kryeziut	200 DEM

Fqinjët gjermanë nga Untergruppenbach 790 DEM (bashkërisht 16260 DEM)
Në mënyrë anonime, përmes shokëve të vet janë dhënë 50786 DM (Marka Gjermane) 2760 SFR (Franga Zvicerane= 3353 DEM, 26600 BEF (Franga të Belgjikës) =1412 DEM, 700 FFR (Franga Franceze)=259 DEM
2000 KR (Korona Suedeze)=774 DEM, 2310 dinarë
Shuma totale së bashku me valutat tjera 56584 DEM

Osman Shemsiu e Shaip Bukoshi	400 DEM
Skënderi me një shoqe nga Ludvigsburgu	200 DEM
Hysen Gërvalla	200 DEM
Rifat Kadriu	620 DEM
Sylejmani nga Boni	100 DEM
Zymber Kryeziu	1200 DEM
Ademi	100 DEM
Ahmeti	100 DEM
Ramushi	100 DEM
Shaqir Shabani	140 DEM
Ademi me një shok, ka shitur fotografi dhe atë shumë e ka dhënë për ndihmë	10 DEM +50 SFR
Elfi Agushi, Gjenevë (nga Ferizaj)	500 DEM
Jahir Jahiri	500 DEM
Qemal Haxhillari	200 DEM
Vezir Kelmendi	100 DEM
Drejtori i shkollës Gjermane	100 DEM
Fahredin Tafallari	500 DEM
Nami Ramadani	1000 DEM
Fetahu	200 DEM
B. Ramadani	100 DEM
Latifi	500 DEM
Fazliu	200 DEM

Mahmut Agushi përmes postës	1000 DEM
Muhameti	100 DEM
Zhuji	200 DEM
Niman Osmani	200 DEM
Besim Rexha	100 DEM
Shokët: Smajl Jashari, Arif Jasiqi, Magllan Jahaj, Zenel Gjocaj, Muhamet Dukaj, Mustafë Mazrekaj, Nysret Hajdari nga Beningeni/ nga Prishtina	530 DEM
Nuhi Sylejmani nga Sindelfingeni/ nga Llojani	500 DEM
Shabani	100 DEM
Mustafë Bajraktari	100 DEM
Dinë Salihu	100 DEM

Haxhi Berisha	100 DEM	
Isa	50 DEM	
Sami Ramadani nga Smira	100 DEM	
Halim Hasanaj	100 DEM	
Ragbi nga Zyrihu	900 DEM	
Halili nga Mynheni	200 DEM	
Rizah Hoxha	100 DEM	
Eshref Morina	100 DEM	
Kamber Bajram Alija	20 DEM	
Sonja me një shoqe	1300 DEM	
Besim Rexhaj	700 DEM	
Përmes postës Selim Bega nga Franca	386.84 DEM	
Zymer Basha	200 DEM	
Ramë Hysaj nga Erlageni	100 DEM	
Rifat Kadriu nga Mynheni	100 DEM	
Hajrullah Rugova	100 DEM	
Kadri Ipek	200 DEM	
Shuma totale	14756,86 DEM	
	+ 50 Frangat Zvicerane	
	14817,61 DEM	
Shuma totale (nga ata që ndihmuan pa i dhënë emrat e mbiemrat)	56584 DEM	79%
Shuma totale (nga ata që ndihmuan dhe emrat tyre u shënuan me pëlqimin e tyre)	14817 DEM	21%
	71401 DEM	

Lista e atyre që e kanë mbajtur të pamposhtur, Kështjellën e qëndresës në Habichthöhe 40, FLAKËN TË PASHUAR, është marrë nga: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 157.

Nuhi Sylejmani*: "Shuma e mbledhur gjatë periudhës **19 janar 1982, deri më 25 prill 1982**, arrinte shifrën rreth 70.000 marka. Këto mjete në masë të madhe u shfrytëzuan për shërbime juridike, shpenzimet e varrimit, për avokatin e familjes Gërvalla, për shtypin e numrit dy dhe tre të „Zërit të Kosovës“, për leje demonstratash, **për udhëtime zyrtare në Vjenë e Stamboll,** për kthimin e Saime Jusufit në Zvicër, udhëtimin përfundimtar të familjes së Jusuf Gërvallës në Shqipëri, kthimin e familjes së Bardhosh Gërvallës në Kosovë etj."* (Vrasja e trefishtë, f.156)

FLAMURI Jusuf Gërvalla: "*Tani më thuaj Kosovë, cili flamur është fituar e mbrojtur pa gjak? Vetëm i bardhi fitohet me përunjësi e bindje, me kurrizin të kërrusur. Por, flamuri i bardhë është qefini i atdheut dhe i popullit. Vetëm turpi, ligështia e vdekja bëjnë strehë nën palën e tij të urryer. Kursena prej tij, Kosovë! Flamuri ynë ka qenë dhe mbetet i kuq, i përgjakur, njëri dhe tjetri: ai me shkabën dykrenare dhe ai me drapër e çekan!"* (*Zëri i Kosovës*, nëntor 1981, faqe 1-2)

folk culture karakteristika të saj janë se bazohet në relacione faresinore, kontrolli social është informal, është i drejtuar nga tradita do me thënë statik, ka një teknologji të thjeshtë, ndarja e punës është e nivelit të ulët, dhe ndikimi i religjionit është i madh.

folklore *folklor* material kulturor i pashkruar në formë të gojëdhënave, këngëve, kashelasheve, fjalëve të urta etj. Në disa kuptime folklori përcakton traditat dhe botën kulturore të popullsisë bujqësore.

FORCAT INTERNACIONALISTE Jusuf Gërvalla: *"Po kështu kam edhe një përgjigje tjetër edhe një plotësim tjetër. Kur është fjala për saktësimin, se sa do të mund të na ndihmojnë forcat përparimtare, forcat internacionaliste në botë! Por sa do të mund të na ndihmojë vendi ynë amë Shqipëria Socialiste! Po ndalem te pika e parë, për forcat internacionaliste, nuk duhet të kemi iluzionin, se populli shqiptar, është populli më fisnik në botë, se populli shqiptar ka dallime të mëdha me popujt e tjerë në botë. Duhet të jemi realist dhe të themi se populli shqiptar është një prej popujve të botës, për të cilin vështirësitë, tragjeditë kombëtare, gjatë historisë e kanë prurë deri në këtë shkallë, sa ai sot të tregojë një afinitet për të qenë një popull luftarak, për të qenë një popull fisnik, për të qenë një popull i cili respekton të drejtat e të tjerëve, i cili s'ka kurrfarë aspiratash për të shkelë të drejtat e të tjerëve, i cili shumë i donë dhe madje nuk mund të jetojë pa të drejtat e liritë e veta*." (E botoi për herë të parë Faridin Tafallari në shkrimin: ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981; www.albaniapress.com, 22 nëntor 2008)

FORMULA E LIRISË Jusuf Gërvalla: *"Ideja e madhe komuniste mori krahë në Gjermani, me Marksin në ballë. U avancua dhe u materializua në Revolucionin e madh rus, të cilit i priu Lenini dhe të cilin e çoi përpara Stalini. Po pasi braktisi stepet e paskajshme, e pezmatuar në tradhtinë e akullt hrushoviane, ideja e madhe komuniste u strehua dhe nguliti në Shqipërinë e "vogël". Këtu gjeti prehje dhe truall të përshtatshëm për lulëzim të plotë. Së këndejmi fshikullon sot pa mëshirë imperializmin dhe social-imperializmin, "eurokomunizmin" fodull. Këtu u bë fener për proletariatin, të nënshtruarin, të kolonizuarin. Kudo në botë. Sepse, si thotë poeti, Shqipëria është një magje lirish, që formulën e lirisë nuk e mban sekret*." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, f.6)

formal controll, ajo pjesë e kontrollit social në shoqëri e cila është e lidhur me lidhur ligjet, gjykatat, policinë etj. Mbikëqyrja tjetër e zbatimit të normave të shoqërisë bëhet përmes *kontrollit jo-formal*.

formal organization sistem i roleve dhe pozitave ku të drejtat dhe detyrat janë formalisht-zyrtarisht të përshkruara ashtu siç është edhe forma e komunikimit në mes tyre. Përmes vijave komanduese, udhëzimeve me shkrim etj. mbahet në jetë bashkëveprimi social. Shembuj organizatash të këtij lloji janë shkollat, spitalet, ndërmarrjet etj. Në kuadrin e një organizate formale mund të ketë një *strukturë jo-formale.*

formal social distance distanca sociale në mes individëve, e cila bazohet në rregulla apo ligje speciale. Sistemi i kastave i Indisë është një shembull tipik me nënvizim të fuqishëm të distancës formale sociale. Një shembull i tillë është p. sh. kur dikend nuk mund ta thirrësh në emrin të cilin ia ka dhënë nrikulla.

formal leadership person i cili në një *organizatë formale* ka ndonjë pozitë udhëheqëse. Se pozicioni i tillë ka domethënien e pozitës udhëheqëse është e shprehur në rregullat e shkruara (explicite) apo të nënkuptuara (implicite) të formuara nga organizata, si dhe

përgjegjësitë dhe të drejtat që lideri i ka. Lideri formal, nuk do të thotë se domosdoshmërisht është lideri faktik që e udhëheqë veprimtarinë. Ky funksion mundet tërësisht apo pjesërisht të merret nga një udhëheqës jo-formal, udhëheqës që qëndron në prapaskenë.

fraction *frakcion* grup opozitar që mund të shfaqet në një shoqëri apo në një grup si shkak i një konflikti brenda të njejtit grup. Frakcionet, si rregull nuk janë të gjata, dhe përcaktimi i kufirit se kush mund të definohet si anëtar i një fraksioni është shpeshherë i lëvizshëm.

frame of reference 1. sistem teorik që përmban koncepte dhe definicione, por të cilat nuk kanë lidhje - relacione logjike me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, pra, nuk është e mundur të nxirren, formulohen hipoteza ekzakte nga një sistem i tillë teorik. Rëndësia e *frame of reference* qëndron në ate se me ndihmën e tij, mundet përafërsisht me u përkufizua ajo fushë të cilën duami ta përshkruajmë apo sqarojmë. Shumica e sistemeve teorike brenda sociologjisë janë të këtij lloji. Ato teori të cilat kanë natyrë më ekzakte, për dallim të kundërt me *frame of reference*, si rregull kanë fusha të ngushta ku mund të aplikohen,
2. ai sfond-prapaskenë ndaj të cilës vendoset një objekt nga individi kur ai e gjykon-vlerëson atë.

frictional unemployement, shkak i papunësisë tek e cila vjen kur personat të cilët e kanë përfunduar një marrëdhënie punësimi, janë të papunë për një kohë, deri sa ta gjejnë një punë tjetër. Quhet gjithashtu papunësi e përshtatjes. Lloje tjera të papunësisë janë *papunësia konjukturale, papunësia strukturale,* dhe *papunësia sezonale.*

FRONTI I KUQ, Ibrahim Kelmendi*: "Xhahili propozoi ta emërtonim 'Fronti i Kuq', duke arsyetuar se duhet të ndjekim shembullin e organizatave çlirimtare "Brigada Rosa", "Rote Army Fraktion", etj."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe 41)

Fronti i Kuq- Roter Frontkämpferbund Gjermanisht **- Roter Frontkämpferbund**, në përkthim si "Aleanca e luftërarëve të Frontit të Kuq" ose "Lidhja e luftëtarëve të Frontit të Kuq", zakonisht e quajtur ***Rotfrontkämpferbund (RFB)*** ka qenë një organizatë e skajit të majtë e lidhur me Partinë Komuniste të Gjermanisë (KPD) gjatë kohës së Republikës së Weimar -it, e formuar në vitin 1924.

Lideri i saj ka qenë Ernst Thälmann. Zyrtarisht ka qenë organizatë e pavarur nga partitë politike dhe legalisht e regjistruar si shoqatë. Organizata është ndaluar më 1929 nga qeveria Socialdemokrate. Gazeta e "Aleanca e luftëtarve të Frontit të Kuq" (***Rotfrontkämpferbund (RFB) ka qenë*** "Die Rote Front", - Fronti i Kuq.

Në pika të shkurta mund të thuhet se politika e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që i ka dirigjuar Partitë tjera komuniste deri në imtësitë më të vogla individuale, në periudhën 1924-1929 nuk ka bërë dallime të mëdha në mes partive socialdemokrate dhe partive borgjeze. Kjo taktikë përmes Frontit të Kuq ka pësuar katastrofë në vitin 1933 me ardhjen e Hitlerit në pushtet.

Pas vitit 1933 është heq dorë nga politika e Fronteve të Kuqe, dhe është dhënë orientimi kah **Frontet Popullore**. Frontet popullore janë formuar në disa vende pas vitit 1933 e në vitet gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Fronti Popullor (Narodni Fronti) i UDB-së në Jugosllavi është formuar në vitin 1945. Fronti Popullor i UDB-së, i Jugosllavisë në Kongresin IV (që i ka zhvilluar punimet nga

22-25 shkurt 1953) e ka ndërruar emrin në Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Jugosllavisë.

Më 16 shtator 1942, **Fronti Nacional-Çlirimtar** u themelua me iniciativë të Partisë Komuniste të Shqipërisë me synim bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një luftë çlirimtare kundër pushtimit italian (dhe më vonë atij gjerman). Më 29 nëntor 1944 vendi u çlirua dhe FNÇ zhvilloi kongresin e parë më 5 gusht 1945. FNÇ u riemërua në **Fronti Demokratik**. Enver Hoxha u zgjodh kryetar dhe këtë detyrë e mbajti deri më 1982. Nga viti 1987 e deri në Tërmetin e Berlinit dhe disa pastërmeteve Frontin e udhëhoqi Nexhmije Xhuglini.

Në vitin 1979 në Gjermani është formuar Fronti i Kuq, dhe sipas atyre që kanë qëndruar pas tij është emërtuar nga UDB-ja.

Prej themelimit e deri në kohën tonë UDB-ja serbe dhe Tanjug-u sa herë u jepet rasti flasin me nostalgji për Frontin e Kuq, si organizatën më të rrezikshme për UDB-në serbe dhe Jugosllavinë.

Cila është anatomia e kësaj propagande?

Kur Tanjug -u dhe UDB-ja me mediumet serbe e kanë trumpetuar me tërë forcën Frontin e Kuq, para opinionit Gjerman e Zviceran, kurrë nuk e kanë pasur ndërmend që para këtij opinioni të përkujtojnë e të krijojnë asociacione me kohën e Narodni Frontit të Jugosllavisë dhe as me Frontin Demokratik të Enver Hoxhës, por vetëm e vetëm me kohën e **Rotfront** -it të Gjermanisë (Republikës së Weimarit) të viteve 1924-1929 si paralojë, si stërvitje, para ardhjes së Hitlerit në pushtet.

Nga analiza e këtyre rrethanave konkluzioni është i qartë: Gjermanisë, Zvicrës dhe opinionit perëndimor evropian i thuhet se shqiptarët nuk luftojnë për të drejtat e tyre kombëtare, por qëllimi i tyre është që me aq forca sa kanë ta kthejnë, Gjermaninë dhe Evropën në vitet 1924-1929.

Kur Jusuf Gërvalla arratiset nga Kosova në dhjetor 1979 e mbërrin në Gjermani, ai nuk pret derisa të kthjelltohet tërësisht horizonti, pasi kohëra me horizont krejtësisht të kthjelltuar për të gjithë vështirë se ekzistojnë. Ai menjëherë hynë në veprim dhe pa dyshuar në prapaskenat e Frontit të Kuq e ndihmon gazetën Bashkimi deri në numrin e janarit 1981.

Ibrahim Kelmendi, në dhjetor të vitit 1980 e dërgon Hysen Gegën me Sadik Blakajn në Kosovë. Ibrahimi thotë se Hyseni ka shkuar pasi ka dashur të bëhet *kurban* i Frontit të Kuq. Pas këtij rasti Jusuf Gërvalla, Frontin e Kuq, e bën *kurban* të Hysen Gegës. Pas këtij rasti Jusuf Gërvalla, ndërprenë çdo bashkëpunim e marrëdhënie me gazetën Bashkimi, me Frontin e Kuq e me Ibrahim Kelmendin. Jusuf Gërvalla, e bën këtë në bazë të dyshimeve të forta se në qendër të Frontit të Kuq qëndron UDB-ja. Gazeta Bashkimi nuk del pas janarit 1981. Në praktikë Fronti i Kuq përfundon në janar 1981. Në teori përfundon para tetorit 1981, kur Ibrahim Kelmendi ia bashkangjet Frontin e Kuq, Frontit Popullor për Republikën e Kosovës, të Kadri Zekës - të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës.

Jusuf Gërvalla hyn në luftë në mes forcave shumë të fuqishme dhe jo krejtësisht të dukshme. Këto forca të fuqishme, prapa të cilave kanë qëndruar qeveri e shtete, e politika kriminale nuk ekzistojnë më sepse kanë ra në kurthat e veta, në kurthat që kanë qenë të planifikuara për të tjerët.

Frontet kanë qenë e kanë shkuar. Shumë organizata të vetëquajtura komuniste kanë qenë e kanë shkuar. Jusuf Gërvalla ka qenë i rrethuar nga shtete, Fronte e organizata

komuniste, dhe i patrembur e i pathyer ka lundruar në mënyrë të pagabueshme nëpër valët e ndërgjegjes së tij.

Shkrimet e fjalët e tij kanë mbetur si një monument i asaj kohe. Këto shkrime ashtu siç u kanë mbijetuar organizatave e sistemeve politike të kaluara është shumë e sigurt se do të mbijetojnë; si përpjekje e ndihmë për ndërtimin e së tanishmes dhe së ardhmes.

Pas 17 janarit 1982, në moshën 23 vjeçare jam ndeshur me të gjitha valët e me të gjitha ato forca që e kanë rrethuar Jusuf Gërvallën. Kam vepruar në bashkëpunim me shokë e duke u udhëhequr nga ndërgjegjja e edukata ime që e kam marrë prej ditëve të fëminisë. Botëkuptimi im për botën është në bazat e filosofisë - ***Western Philosophy***. Megjithate, ka shokë që mendojnë ndryshe dhe më kanë thënë se ndoshta një dorë e padukshme gjithmonë ka qëndruar afër meje, ashtu siç ka qëndruar pas Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla "*Në fillim të qëndrimit këtu, më ofroi bashkëpunim me gazetën „Bashkimi", organ i Frontit të Kuq Popullor, njëri nga bashkëpunëtorët e saj. Meqë gazeta edhe më parë shkonte në popull, madje në një gjendje të keqe, unë e pashë të udhës dhe të lejueshme dhe bashkëpunova me të në disa numra.*" (Letër Sabri Maxhunit-Novosellës, 14 prill 1981)

FRONTI POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS apo "TË GJITHË NË FRONT! TË GJITHË PËR FRONTIN!" Ethem Çeku, të cilit i pëlqejnë krahasimet dhe simbolika me ditët finale të Luftës së Dytë Botërore, në librin e tij *Shekulli i ilegales*, Prishtinë 2004, në faqe 77-78, si respektues i madh i Frontit të Kuq, flet për rëndësinë e madhe që ka pasur krijimi i Frontit të Dytë, flet për FRONTIN POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS dhe për *Personalitetin unifikues të Lëvizjes Kaçake*, nipin e Dajës Sejdë.

Në dhjetor 1981, Kadri Zeka ia dërgon Jusuf Gërvallës thirrjen "***TË GJITHË NË FRONT! TË GJITHË PËR FRONTIN!"***, Jusufi i përgjigjet me këtë letër:

Jusuf Gërvalla: "*Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).*

*Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ku thuhet se **është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë**, së paku deri në këtë çast, **ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët**.*

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konseguencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta.

Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha,. me manovrime nga ana juaj.

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave." (Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 277)

Hasan Mala: *"Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e **Frontit**, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 256-257)

Jusuf Gërvalla*: "Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si* ***akt të kryer*** *në* ***thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"****, të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 284)

frustration *frustracion* një gjendje që shfaqet tek individi, kur rrugët për realizimin-plotësimin e nevojave dhe synimeve të tij bllokohen. Gjendja tensionuese mund të shkaktohet prej pengesave nga faktorët e jashtëm ose të brendshëm, të cilat mund të kenë shkaqe sociale apo jo-sociale. Deri tek paraqitja e gjendjes së frustracionit nuk është e domosdoshme që bllokimi i arritjes së synimeve dhe plotësimit të nevojave të jetë total, por mjafton që një pjesë e tyre të jenë të bllokuara. *Mekanizmat mbrojtës* kundër frustracionit janë p. sh. *sublimimi, regresioni, racionalizimi, autizmi* apo sjellja agresive.

full employement të gjithë personat që kërkojnë punë edhe gjejnë punë.

function *funksion* Se një fenomen social ka një funksion mendohet në atë se ai ka kuptimin e ruajtjes së atij sistemi të cilit i takon. Kështu p. sh. ka sociologë që mendojnë se religjioni ka funksion integrues. Bëhet dallimi në mes *funksioneve manifeste* dhe *funksioneve latente*. Tek funksionet e llojit të parë individët janë të vetëdijshëm për pasojat që fenomeni ka dhe ato janë të paramenduara pikërisht që të kenë ato pasoja. Një dallim tjetër bëhet në mes funksionit, i cili nganjëherë quhet eufunksion dhe disfunksion. Ky i fundit (disfunksioni) ka një pasojë negative sistemin social. Koncepti i funksionit përdoret më së shumti tek *funksionalizmi*.

functionalism *funksionalizëm* përshkrim për pikëpamje sociologjike dhe kulturantropologjike që nisen nga ajo se institucionet sociale janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe strukturat e krijuara në këtë mënyrë janë mjete të cilat sistemet sociale i kanë në dispozicion për të arritur qëllimet e tyre. Në këtë mënyrë çdo sistem social do ta ketë një funksion pozitiv për sistemin. Tek funksionalistët ekziston një mënyrë e mendimit, e shprehur ku më pak e ku më shumë, përmes së cilës sistemet sociale shikohen si analoge me sistemet organike. Disa funksionalist e shohin shoqërinë si një sistem në ekuilibër, ku çdo pengesë - prishje sjellë tek ndryshime në strukturë e cila e rikrijon ekuilibrin. Në kulturantropologji ky lloj rezonimi është parashtruar nga B. Malinovski dhe A. Radcliff-Brown ndërsa në sociologji nga T. Parsons.

functional imperatives Në bazë të *shkollës së funksionalizmit* çdo *sistem social* është i detyruar t'i përballoj katër lloje të problemeve për të mundur të mbijetoj. Këto janë të ashtuquajturat imperativet:

1. përshtatje ndaj mjedisit social dhe fizik,
2. arritjen e qëllimeve të sistemit,
3. Integrimin, dhe
4. mbajtjen-arritjen e qëndrueshmërisë së stabilitetit të brendshëm.

Katër të ashtuquajtura *functional subsystem* zgjidhin secili për vete nga një prej këtyre problemeve.

functional subsystem në bazë të *funksionalizmit* çdo sistem social duhet të përballet me katër probleme themelore,

1. përshtatjen

2. zgjidhjen e tensioneve të brendshme,
3. arritjen e qëllimeve të veta dhe
4. të jetë i integruar.

Për secilën prej këtyre fushave problematike ekzistojnë subsisteme funksionale. Ai subsistem i cili ka të bëjë me arritjen e qëllimeve quhet "*the polity*". Këtu nuk llogariten vetëm instancat ekzistuese politike. Këtyre u shtohen edhe forma të ndryshme të *pressure group* (grupeve që bëjnë presion në vendimmarrësit*)***.** Funksionin e zgjidhjeve të tensioneve të brendshme, para së gjithash e ka familja, por edhe elemente tjera që kanë *funksione socializuese* mund të llogariten këtu si p. sh. shkollat, grupet religjioze apo spitalet. Ai subsistem që ka të bëjë me përshtatjen është ekonomia e marrun në kuptimin e gjerë të fjalës, d. m. th. të gjitha elementet që prodhojnë mallra apo shërbime. Subsistemi integrues përbëhet kryesisht nga ato grupe në shoqëri të cilët krijojnë rregulla të shkruara apo të pashkruara dhe bëjnë që këto të ndiqen, të përmbahen. Subsistemet funksionale *nuk përbëhen* nga grupe faktike por *nga aktivitete* të këtyre grupeve faktike që kanë rëndësi për secilin problem themelor të sistemit social.

FUQI (gjermanisht **macht**, anglisht **power**) *pushtet/fuqi,* në shkencat shoqërore, ose veprim, p. sh. ushtrim i pushtetit ose aftësi, do me thënë resurse të pushtetit. Pushteti ushtrohet kur një aktor A e shtyn aktorin B të veproj në bazë të vullnetit të A, edhe nëse veprimi është në kundërshtim me vullnetin dhe interesat e B. Bazat e aftësisë së A për të ushtruar pushtet janë resurset e pushtetit, përmes të cilave A mund ta shpërblej apo ta dënoj B. Shembuj për këtë janë mjetet e dhunës dhe të detyrimit, fuqia punëtore, e drejta e votës, kontrolli mbi resurset ekonomike siç janë paraja dhe mjetet e prodhimit si dhe shpërblime dhe dënime simbolike siç janë lavdatat dhe kritikat.

Veti të rëndësishme tek resurset e pushtetit janë pos tjerash lloj-llojshmëria (cilat lloje të ndryshme të veprimeve tek B mund të ndikoj A?), koncentrimi i pushtetit dhe shpenzimet për ushtrimin e tij. Brenda një organizate, në bazë të disa kushtëzimeve pushteti mund të delegohet tek përgjegjës në nivele të ndryshme brenda organizatës. Shpenzimet për ushtrimin e pushtetit të A ndaj B mvaret pjesërisht prej sjelljeve të B. Ushtrimi i pushtetit i bazuar në mjetet e detyrimit dhe të dhunës më së shpeshti sjellë tek reaksionet negative tek B dhe për këtë bëhet jostabil. Resurset ekonomike rëndom kuptohen si më neutrale nga B, ndërsa mjetet simbolike të pushtetit konsiderohen si legjitime. Ai ushtrim pushteti, i cili prej të gjitha palëve të përziera aprovohet si ushtrim legjitim praktikohet të përshkruhet si autoritet. Në një shoqëri shteti është i vetmi ushtrues legjitim i pushtetit përmes mjeteve të dhunës.

fusion 1. bashkimi i dy a më shumë grupeve të ndara në një të vetëm. E kundërta është *fision*.

2. kur dy apo më shumë kultura shkrihen në një të vetme, e cila ka të gjitha vetitë e atyre kulturave që janë të përfshira në një proces të tillë. Nganjëherë kjo konsiderohet si një formë e *akulturimit*.

G

GAGICA HAFIZ – Hafiz Gagica, veprimtar i dalluar i rrethit të Jusufit e Bardhoshit. Më 15 janar 1983 në banesën e Hafiz Gagicës, gjegjësisht babait të tij Sinan Gagicës, në Karlstr. 11, D-7140 Ludwigsburg është formuar Qendra Ekzekutive e Lëvizjes për Republikë.

GALICA AZEM Azem Galica (1889 - 1924) Luftëtar i shquar popullor për çlirim e bashkim kombëtar, për një regjim shtetëror demokratik në Shqipëri, organizator i Lëvizjes dhe luftës kundër pushtuesve të ndryshëm gjatë viteve 1912 - 1924.

Veprimtarinë e tij patriotike e filloi në vitet 1910-1912, kur mori pjesë në kryengritjet antiosmane. Pas shpalljes së Pavarësisë luftoi në fillim, më 1912-1915 kundër pushtuesve serbë, dhe më pas, më 1915-1918 kundër pushtuesve austriakë e bullgarë. Gjatë Luftës së Parë Botërore drejtoi luftën e çetave kundër rivendosjes në Kosovë të pushtetit të borgjezisë serbomadhe. Pati përkrah tij deri në fund gruan e vet Shote Galica. Sipas direktivave të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, në vitin 1919 mori pjesë në organizimin dhe drejtimin e Kryengritjes së Rrafshit të Dukagjinit, më 1921-1923 mbrojti Zonën Neutrale të Junikut, që shërbente si bazë e kryengritësve të Kosovës e të Malësisë dhe përkrahu kryengritjen e malësorëve të Shqipërisë së Veriut kundër regjimit reaksionar feudo-borgjez. Në vitin 1924 Azem Galica dërgoi luftëtarë për të marrë pjesë në Revolucionin demokratikborgjez të Qershorit. Vdiq nga plagët që mori në luftimet e përgjakshme të korrikut 1924, për mbrojtjen e zonës së lirë të Drenicës, "Arbanisë së vogël".

GALICA SHOTE - Shote Galica, emëruar në lindje si Qerime (Halil) Radisheva, (1895 - 1927) Ishte luftëtare e shquar e çetave kryengritëse kosovare për çlirimin dhe bashkimin kombëtar të të gjitha viseve shqiptare dhe për një regjim shtetëror demokratik në Shqipëri, Heroinë e Popullit. Pa përfillur terrorin e armikut dhe ligjet e ashpra të fesë e të kanunit luftoi heroikisht për 12 vjet me radhë kundër pushtuesve serbë, austrohungarezë e bullgarë.

Shote Galica mori pjesë në më shumë se 40 aksione të rëndësishme kundër armikut. Kundërshtoi me konsekuencë politikën e dhunës e të terrorit të regjimit shovinist të Beogradit ndaj popullsisë shqiptare, shpronësimin e shpërnguljen e saj dhe kolonizimin sllav të trevave shqiptare. Më 1919 mori pjesë në Kryengritjen e Rrafshit të Dukagjinit, ndërsa më 1922-1923 luftoi për mbrojtjen e Zonës Neutrale të Junikut, e cila shërbente si bazë për kryengritjen e Kosovës e të Malësisë. Në korrik 1924 mori pjesë në mbrojtjen e zonës së lirë të Drenicës (Arbanisë së Vogël). Në korrik 1924 pas vdekjes së të shoqit Azem Galicës, vazhdoi luftimet në krye të çetës së tij. Së bashku me qindra luftëtarë të Kosovës në dhjetor të 1924 luftoi kundër ushtrive intervencioniste serbe e bjellogardiste dhe forcave të Ahmet Zogut. Humbi në luftime nga masakrat e shovenistëve serbë 22 anëtarë të familjes. Më 3 korrik 1927 Shote Galica u vendos në Shqipëri. Vdiq në Fushë Krujë.

garrison state, *shteti-kazermë* 1. Vend i cili përherë është në gjendje gatishmërie për luftë.

2. Shtet diktatorial jeta politike dhe ekonomike e të cilit organizohet sikur të kishte qenë një organizatë ushtarake.

Nocioni gjendet në titullin e librit të H. Lassevell, *The Garrison State*.

GASHI AGIM, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Agim Gashi, 1927 Stepher Dr. Montgomery, Ili.60538 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

GASHI BAJRAM. Jusuf Gërvalla: "*Nuk jemi në gjendje të informojmë konkretisht për Bajram Gashin, milic me shërbim në Cërmjan: a ishte ai me të vërtetë anëtarë i ndonjë grupi a organizate patriotiko-revolucionare nga ato që veprojnë në viset shqiptare të*

pushtuara. Ne kemi gjurmuar dhe kemi konstatuar, se ai nuk përket së paku në asnjë nga tri organizata me të cilat ne zhvillojmë bashkëpunim.

Prandaj, nuk është e ndershme ta përvetësojmë këtë njeri të vyer, duke e quajtur sekush si anëtar të vet, ndonëse konkretisht neve do të na bënte nder. Por, nga ana tjetër – ç'është shumë më me rëndësi, ne kemi informata thuaja të sigurta se Bajram Gashi nuk është i implikuar në ndonjë plan të errët të UDB-së, e cila, duke burgosur gjoja njerëz nga radhët e veta, shpeshherë ka ditur të ngreh kurthe për forcat tona përparimtare, duke i ngashënjyer ato me provokime nga më të ligat.



Bajram Gashi-Komiteti i Drenasit-LNÇKVSHJ (pashtriku.org, janar 2024)

Milici Bajram Gashi, sipas të gjitha gjasëve, është vetëm një nga deti i tërë i njerëzve tanë të ndershëm, që, edhe pse kanë qenë në punë te okupatori, mendjen dhe zemrën i kanë pasur në rregull, do të thotë në anën e drejtësisë e të njerëzisë. Ai, me gjasë, nuk mundi t'i durojë më pa kundërshtim prapësitë e armikut kombëtar dhe klasor. E cekim edhe – klasor, sepse ai ishte lexues i zellshëm e i flaktë i literaturës marksiste-leniniste dhe rezononte me ndershmërinë e me mprehtësinë me të cilën e kishte pajisur ajo literaturë dhe ideja e pastër komuniste. Bir i një familjeje të këputur fshatare të Drenicës heroike, ai ishte shtrënguar të shfrytëzonte bursën e sekretariatit të punëve të brendshme dhe të kryente edhe shkollën e mesme në Vushtrri ku dalin kuadro të milicisë. Por, ai e kish pasur gjithmonë të qartë se nuk mund t'ia kthejë shpinën kombit të vet dhe

ndershmërisë shqiptare e njerëzore. Si siguroi rrogën e parë, ai u regjstrua në SHLP të Gjakovës, ku ishte duke ndjekur me sukses ligjëratat në grupin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, derisa e arrestuan. Kolegët e tij milicë, si marrim vesh, me kohë i paskëshin ngjitur atij edhe një nofkë tërheqëse, Bajram Kukësi, ngase ai e paskësh dëgjuar rregullisht radion shqiptare.

Një ditë, më 24 të nëntorit që shkoi, "marksistët" titistë, që kanë alergji të madhe ndaj marksizëm-leninizmit të vërtetë dhe ndaj shqiptarizmit, vendosën ta arrestojnë edhe Bajramin dhe ta hedhin në edhe atë në qelitë e akullta ku i hedhin "armiqtë e popullit". Meqë poshtërsia e UDB-së nuk do të ishte e plotë po të kishte kufi, ata po i mbajnë në sirtar rrogat e tij, që vazhdojnë të vijnë ende nga qendra (ai ka të drejtë të marrë së paku gjashtë rroga pas arrestimit, për aq kohë sa mund të zgjasin hetimet). Kështu, familja e tij, e cila varet kryekëput prej rrogës së tij, tash ka mbetur në rrugën e madhe. Kjo është vetëm një nga mizoritë e shumta të armikut tonë, tërbimi i të cilit ka marrë hov të pandalshëm, deri në – vetëpërmbysjen e tij të plotë.

Tuna mos e ndaltë armikun mizor!

Kurse ne, që e kemi për detyrë e që po kujdesemi ta shtyjmë sa më shpejt kah varri i sigurt, mund të jemi të kënaqur që kësaj radhe konkretisht po bindemi se armikut po i hyn tmerri dhe koka iu ka mbushur mjegull, edhe kur është fjala për kuadrot e "veta", të cilat kujdeset t'i mbajë me presion në rrugën e errët të krimit, amoralitetit dhe të egërsisë fashiste.

Tani është e sigurt se Bajram Gashi, sido që të venë punët (thonë se ai është edhe i qëndrueshëm e i pamposhtur në qëndrimet), është një zog që i ka dalë dore përgjithmonë UDB-së. Na mban shpresa se shembullin e tij të ndritshëm do ta ndjekin kolegët e tij të tjerë të ndershëm!" (Lajmëtari i lirisë , janar 1981-Shtojca)

Intervistë me ish të burgosurin politik, veprimtarin dhe luftëtarin e lirisë,

Bajram Gashi

Radio Kosova e lirë-Ahmet Qeriqi

28 dhjetor 2018

RKL: Z Bajram, për fillim na tregoni ku jeni lindur, ku keni kryer mësimet e para dhe shkollimin në përgjithësi?

Jam lindur më 16 qershor, 1959, në fshatin Llapushnik, komuna e Drenasit. Pesë vitet e para të shkollës fillore i kam kryer në paralelen e Shkollës Fillore "Emin Duraku" të Arllatit në Llapushnik kurse tri klasat tjera në shkollën amë në Arllat. Shkollën e mesme e kam kryer në Shkollën e Mesme për Punë të Brendshme në Vushtrri. Shkollën e lartë e kam kryer në ShLP.- në Gjakovë drejtimi Gjuhë Shqipe e Letërsi, kurse sivjet kam diplomuar në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, në Fakultetin Juridik.

RKL: Qysh në moshë të re iu keni bashkuar radhëve të Lëvizjeve atdhetare që vepronin ilegalisht në Kosovë. Cili ka qenë motivi apo frymëzimi që ta ndiqni atë rrugë me rreziqe, befasi dhe të papritura?

Që në fëmijëri jam frymëzuar nga familja, farefisi dhe shumë mësimdhënës dhe librat e lexuara jam njohur me padrejtësitë dhe vështirësitë deri në prag shfarosjeje me të cilat është ballafaquar kombi ynë por edhe me rezistencën në forma dhe përmbajtje të ndryshme dhe se ende nuk ishte arritur synimi i popullit të udhëhequr nga atdhetarët.

Dëshira për të ndjekur në mënyrë aktive udhën e rilindësve dhe atdhetarëve tjerë të të gjitha periudhave dhe lufta e drejtë për liri e bashkim ishin motivet kryesore që më nxitën të gjeja bashkëmendimtarë në mesin e studentëve të ShLP. “Bajram Curri” në Gjakovë, ku edhe unë studioja në degën Gjuhë Shqipe e Letërsi.

Ahmet Qeriqi e Bajram Gashi

RKL: A ka ushtruar ndikim në rrugën tuaj revolucionare Shqipëria Socialiste e asaj kohe?

Shqipëria Socialiste përmes emisioneve të Radio Tiranës, Radio Kukësit dhe Radiotelevizionit Shqiptar, ka pasur rol kyç në mbrujtjen time kombëtare e atdhetare që pastaj më ka përgatitur për kyçje në celula dhe organizata politike ilegale siç ishte :Fronti i Kuq Popullor” dhe “Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Viseve Shqiptare në Jugosllavi”.

RKL: Në prill të vitit 1979 iu keni bashkuar organizatës së quajtur “Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Viseve Shqiptare në Jugosllavi” e themeluar nga atdhetari i mirënjohur, Jusuf Gërvalla. Cila ka qenë platforma dhe fushë-veprimtaria e Organizatës?

Pas diplomimit në Shkollën e Mesme për Punë të Brendshme “13 Maji” në Vushtrri, fitova titullin milicioner dhe më caktuan me detyrë në Sekretariatin Komunal për Punë të Brendshme në Gjakovë. Ngase përherë isha nxënës i shkëlqyeshëm, vendosa ta vazhdoj shkollimin dhe u regjistrova me korrespodencë në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Për shkak të situatës së nderë politike, nuk më lejonin të shkoja në provime dhe duke e parë pothuajse të pamundshme vazhdimin e studimeve në Prishtinë, në vitin 1979 u regjistrova në ShLP. “Bajram Curri” në Gjakovë. Ngase që nga 1 shkurti 1979 kërkova transferim në Paralelen e Milicisë në Dushkajë mu krijuan kushte më të përshtatshme për studime. Edhe pse isha me korrespodencë, shpesh shkoja edhe në ligjërata. Profesorët si Shefqet Canhasi që ishte i kyçur në lëvizjen ilegale por edhe

profesorët tjerë ligjëratave u jepnin edhe kahe kombëtare e atdhetarëve. Gjatë studimit po ashtu arrita të fitoj besimin e studentëve tjerë që i takonin grupeve ilegale dhe ishin anëtarësuar në Frontin e Kuq Popullor e gjetiu, si Ibish Neziraj e Ramë Zeqiri por edhe shoqërohesha dhe diskutonim hapur për çështje të ndaluara ndër ta me Ismet Sopin, Agim Deskun, Ilmi Gegaj e shumë të tjerë. Kështu në prill të vitit 1979 u përfundimisht u anëtarësove në Frontin e Kuq Popullor.

Duhet cekur se gjatë shtatorit të vitit 1978 sa isha në detyrë kujdestar në Postëkomandën e Milicisë në Gjakovë, rastësisht hasa në programin e TVSh-ës. Derisa isha duke e përcjellë programin, milicioneri, Hamëz Batusha dhe një tjetër të komunikacionit krahinor me sa më kujtohet ishte një Lushtaku nga Skenderaji, hynë në kujdestari dhe ma bënë me dije se po e përcillja televizionin e ndaluar tek ne. Unë u thash se nëse nuk guxojnë ta përcjellin mua të mos më pengojnë. Ata shprehën gatishmërinë e tyre të më ndihmon në të gjitha tjerat vetëm mua ma lanë të e shtypja sustën e programit. Këtë e dëshmuan edhe në vepër. Më ndihmuan ta rregulloja antenën dhe u ballafaquan me serbë e malazez kur synonin që dhunshëm ta ndërronin kanalin televiziv. Vitin e Ri 1979 rreth dhjet milicioner e kemi pritur në kujdestarinë e Postëkomandës së Milicisë në Gjakovë duke e përcjellë nga fillimi deri në mbarim emisionet e TVSh-së

Kur u transferova në Dushkajë, vazhdova të njëjtë udhë dhe meqë kishim edhe një radio, i përcillja edhe programet e Radio Tiranës dhe Radio Kukësit sidomos emisionet për bashkatdhetarë dhe emisionet muzikore ku i këndohej edhe Enver Hoxhës. Po ashtu edhe kur patrulloja në fshatra gjatë ndejës në odë kërkoja ta përcillnim TVSh-në. Kështu e "legalizova" këtë që deri atëherë përcillej vetëm pa praninë e milicisë. Banorët e dushkajës filluan të më quanin Bajram Kukësi, në fillim nga ata që nuk ma dinin mbiemrin e pastaj edhe nga të tjerët. .

Rëndom, gjatë kohës së lirë, kur nuk lexoja, rrinim në shitoren e Avdyl Hoxhës. Avdyl Hoxha ishte i ri në moshë, humorist i madh dhe shoqëroheshim shumë me të. Pasi u bind në çiltrinë time i kishte folur për mua dhëndrit të tij Ismail Haradinajt nga Gllogjani i Deqanit. Kështu na kurdisi një ndej të përbashkët në dasmën e tij në Cërmjan ku Ismaili foli për rrethanat politike dhe rrethanat historike që ndanë Shqipërinë në Kongresin e Berlinit, Konferencën e Londrës, paqen e Shënë Stefanit, Konferencën e Bujanit e shumë të tjera. Unë isha i pranishëm në uniformë dhe disa provuan ta dredhonin rrjedhën e bisedës dhe më vidhnin me sy për të kuptuar reagimin tim. Unë e dëgjoja me vëmendje dhe kur pritej të ndërhyja, u thash: "Ne mund të themi çka të duam, por faktet historike dhe të vërtetën nuk mund ta ndryshojmë. E jona është ta ndryshojmë gjendjen dhe tu japim fund padrejtësive të deritashme. Ju vetë e shihni se sa të lirë jetoni sot dhe po u emancipuat edhe më të lirë do të jetoni nesër". Më nuk fola por kaq mjaftoi të fitoja interesimin e bacës Ismail dhe të bindej në ato që i kishte thënë Avdyli për mua.

Kështu filluam të takoheshim si rastësisht dhe të këmbenim disa fjalë derisa në qershorin e vitit 1980 e fitova besimin e plotë të bacës Ismail dhe më anëtarësoi në LKÇVShJ. Pas kësaj mora detyra konkrete të krijonim grupe të vogla në sistemin e treshit. Në një nga takimet e shumta që kisha me Ismetin, i bindur në idealet e përbashkëta e informova në mënyrë provokuese se kam vërejtur se po organizohen grupe armiqësore me synim shkëputjen nga Jugosllavia dhe bashkim me Shqipërinë. Ismeti kërkoi të hiqja nga fjalori emërtimin armiqësore dhe ta zëvendësoja me çlirimtare. Atëherë i shpjegova shumëçka dhe i propozova që së bashku të rekrutonim të tjerë kurse unë do ta rekomandoja për në celulë. Deri në shtator Ismeti arriti të rekrutonte anëtarë të rinj (Alush Thaçin, Qerkin

Sopin dhe Nuhi Sopin) dhe vendosëm të avancojmë statusin e celulës në Komitet të Vendit të LKÇVShJ për Drenicë, me seli në Llapushnik.

RKL: Kur ju kanë arrestuar dhe me cilët nga bashkëveprimtarët ju kanë dënuar për vepra penale, të cilat në ligjin penal të kohës sanksionoheshin si aktivitet armiqësor në pozita të nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar?

Më 18 nëntor 1980 është arrestuar Ibish Neziraj, më 22 nëntor Ramë Zeqiri dhe më 24 nëntor jam arrestuar unë. Më 25 shkurt 1981 Nga Gjykata Komunale në Gjakovë jam dënuar për veprimtari armiqësor bazuar në nenin 133 al. 4 të LPJ dhe nenin 217 al. 2-1 të LPK. me nga një vit e gjysmë burg për secilën vepër penale, Ibishi u dënua me dy vjet burg kurse Rama me një vit burg. Pas demonstratave, u arrestuan edhe shokët tjerë dhe edhe për mua u zgjeruan hetimet. Më 17 gusht 1981 u dënuam nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Bajram Gashi me 15 vjet burg bazuar në nenin 136 al. 1 lidhur me nenin 116 al.1 të LPJ, Ismet Sopi me 14 vjet burg, Alush Thaqi me 13 vjet burg, Naim Bujupi 12 vjet burg, Halil Kuliqi me 11 vjet burgi, Qerkin Sopi me 8 vjet burg, dhe Nuhi Sopi me 7 vjet burg.

Bajram Gashi, Ismet Sopi me shokë e shoqe të LNÇKVSHJ (pashtriku.org)

RKL: Ku e keni mbajtur burgun dhe me cilët nga veprimtarët jeni njohur gjatë vuajtjes së dënimit?

Nga 28.11.1980 deri më 29.4.1981 në Burgun e Qarkut në Pejë, nga 29.4.1981-2.6.1981 në ShNP. Në Gurakoc, nga 2.6.1981-shtator 1981 në Burgun e Qarkut në Prishtinë, nga shtatori 1981 deri më 22.11.1983 në CZ në Beograd kurse nga 22.11.1983 deri në fund më 22.12.1990 në ShNP. "Zabella" në Pozharevc. Gjatë kësaj periudhe jam njohur me shumë veprimtarë. Po i përmend këta: Abdylxhemil Alimani, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Afrim Zhitia, Ali Lajçi, Avdush Abdurrahmani, Bajram Ismaili, Bajram Kosumi, Bajrush Behrami, Bajrush Xhemajli, Bardhyl Mahmuti, Bejadin Hasani, Beqir Beqa, Enver Topalli, Fadil Vata, Fehmi Berisha, Fetah Shemsiu, Gani Koci, Hamëz Kryeziu, Habib Gajtani, Halil Alidemaj, Halil Selimi, Hydajet Hyseni, Hysen Gegaj, Januz Januzi, Ilaz Zhitia, Imer Hasani, Ismail Syla, Kadri Kryeziu, Mehmet Bislimi, Merxhan Avdyli,

Muhamet Haklaj, Muhamet Rugova, Murat Bytyqi, Murat Musliu, Mustafë Ademi, Naim Shala, Nazmi Hoxha, Nezir Myrtaj, Nuhi Muhadri, Pajazit Krasniqi, Ramadan Avdiu, Ramadan Bunjaku, Reshat Avdiu, Rifat Kafexholli, Riza Xhakli, Sabit Veseli, Sami Kurteshi, Skender Ibishi, Shaqir Ruhani, Sherf Pajaziti, Shemsi Veseli, Taip Zeka, Xhafer Osmani,Sadik Zabelajm Shaban Shemsiu, Kadri Luzha, Riza Vata e të tjerë

RKL: Ku jeni angazhuar pas lirimit nga burgu dhe cili është mendimi juaj për Lëvizjen paqësore të kohës, sidomos në vitet '90, të shekullit të kaluar?

Pas lirimit nga burgu jam angazhuar në ShBH. "Nëna Terezë" dhe nga marsi i vitit 1994 deri në kyçjen në UÇK kam qenë Kryetar i ShBH. "Nëna Terezë" Dga në Drenas. Po ashtu iu bashkova Ismet Sopit për themelimin e Degës së PShDK-ës në Drenas, por pasi kjo ndrroi në mënyrë kundërstatutore kryetarin dhe u shndërrua në filial të LDK-ës e braktisëm dhe iu bashkova Partisë Parlamentare. Në ndërkohë nga shtatori i vitit 1991 drejtori i ShF. "7 Marsi" në Kizharekë Gani Syla më mundësoi të punoj si arsimtar. Me përhapjen e luftës edhe në Llapushnik iu përkushtova vetëm luftës deri në çlirimin e Kosovës.

RKL: Kur iu keni bashkuar luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me cilët nga shokët e burgut e bashkëveprimtarë të tjerë keni vepruar?

Ushtrisë Çlirimtare iu bashkova më 12 maj 1998, në Llapushnik. Në fillim së bashku me Ferat Sopin (farmacist) Antigone Gashin (infermiere), Indira Gashin e më vonë na u bashkua edhe dr. Zeqir Gashi dhe Lume Gashi (infermiere) në shtëpinë time themeluam ambulancën ushtarake kurse në bodrumin e sajë që deri atëherë e shfrytëzonim si odë u vendosën ushtarët e pikës 3 të njësisë "Çeliku 3". Nga 1 shkurti i vitit 1999 u caktova në pozitën Administrator i Policisë Ushtarake të Brigadës 121 "Kumanova".

RKL: Pas çlirimit të Kosovës nga robëria serbe qershor të vitit 1999 ku jeni sistemuar?

Pas zhvendosjes nga Kleçka në Prizren, mu besua posti i Komandantit të Policisë Ushtarake në Prizren dhe më 29 korrik 1999 me vendimin e Ministrit të Rendit në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, gjeneral Rexhep Selimi, u emërova Shef i Kabinetit të Sektorit të Policisë në Prizren. Me konsolidimin e Prefekturës së Prizrenit nga prefekti i parë i prefekturës Kadri Kryeziu, u emërova Drejtor i Drejtorisë së Rendit. Këtë post e mbajta deri me shfuqizimin e prefekturës dhe rrënimin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës nga UNMIK-u dhe lakejt e tij. Në ndërkohë më 6 shtator 1999 u pranova në Shërbimin Policor të Kosovës me numrin rendor 00001. Më vonë ma vodhën këtë numër dhe tash e kam numrin rendor 0057.

RKL: Faleminderit për intervistën, z Bajram!

Falënderim për ju dhe Radion-Kosova e Lirë, e cila na ka përcjellë dhe na ka frymëzuar sidomos gjatë luftës por edhe tani!

Ramadan Pllana: "*Prandaj, realizimin e formimit të Komitetit të Vendit në Drenas, me udhëzimet e Jusuf Gërvallës, në vitin 1980, do ta bëjnë Ismail Haradinaj, Alush Thaçi dhe Bajram Gashi.*

...Grupi i Drenasit:

I gjykuar më 17 gusht të vitit 1981: Bajram Gashi, 15 vjet, Alush Thaçi, 13 vjet, Ismet Sopi, 14 vjet, Çerkin Sopi, 8 vjet, Nuhi Sopi, 7 vjet, Halil Kuliqi, 11 vjet dhe Naim Bujupi 12 vjet." (www.pashtriku.org, 17 mars 2009)

GASHI RRUSTEM, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Rrustem Gashi, Motorstr. 59 Zimmer 205, 8 München 40. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

GASHI SOKOL, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sokol Gashi, Mindelsheim str. 12, D-8938 Buchloc. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

GECAJ REXHEP, veprimtar në Austri. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Rexhep Gecaj, Lunzernstr. 80-7035 4020 Linz Austria. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

GEGAJ DANUSH, i biri i Qazim Gegajt dhe vëllau i Hysen Gegajt nga Sallagrazhda .

Jusuf Gërvalla: "*Hysen dhe Danush Gegaj, kohëve të fundit u arrestuan për veprimtari "armiqësore kundër popullit e shtetit", do të thotë për veprimtari patriotike, edhe këta persona: Hasan Ukëhaxhaj, magjistër i gjuhës shqipe, profesor në gjimnazin e Deçanit, Musa Berisha nga Duboviku, student i letërsisë shqipe, momentalisht në shërbimin ushtarak në Ptuj, si dhe një milic, të cilit ende s'ia dimë emrin etj.*" (Lajmëtari i lirisë, nr.1, janar-shkurt 1981, faqe 1)

GEGAJ HYSEN, veprimtar i dalluar i rrethit të Shtutgartit. Është arrestuar natën e Vitit të Ri, të vitit 1981 në fshatin e tij të lindjes.

Jusuf Gërvalla: *KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!*

Hysen Gegaj nga Sallagrazhda e Suharekës, ishte punëtor i mirë e shumë i dashur për shokët e vet, gjithnjë i gatshëm t'i ndihmojë pa kursim të tjerët. Edhe ai, me një gëzim të madh u nis për në vendlindje, ku arriti natën e Vitit të Ri. Në shtëpi e pritnin me mallë babai i rrezbitur, nëna plakë, shoqja, vëllezërit, fëmijët e mitur. I harroi vuajtjet e përjetuara gjatë qëndrimit të tij në kurbet. Jeta po i dukej sërish e bukur. Tjetër dhe ish ky, tjetër erë binte këtu athëtima e dimrit, rruga e përbaltur dhe gjerdhet e ulëta.

Si u përshëndet me prindërit e me fëmijët, sa u çmall pakëz, Hyseni doli në fshat tek shokët e moçëm dhe ndenji me ta deri pak para mesnate.

Në shtëpi e pritnin me padurim. Druanin se do ta kalonin pa të edhe këtë Vit të Ri. E dinin se ai harrohej fare kur ishte me shokët. I tillë kish qenë qysh fëmijë, kur i ruante lopët e fshatit, për t'ia shtuar një kafshatë bukë familjes. I tillë kishte qenë edhe në kohën e rinisë së hershme, kur iu desh ta regjte shtatin e njomë me peshat e rënda të betonit e të tullave, në punishtet ndërtimore të Beogradit. Për shokë jepte gjithçka edhe tash. Veçse tash vinte pak më thatim e gjithnjë më hijerëndë. Dhe sikur kishte ca brenga të thella për moshën e tij.

Megjithatë, pak para mesnate, ai u kthye në shtëpi. Shtathedhur e hijerëndë. Mbase pak edhe në qejf. Nga pija. Por ç'ishte ajo brengë e re në rrudhat e hershme, që s'po ia kuptonin dot prindërit as e shoqja? Po burrërohet si shpejt, tha me vete, jo pa njëfarë mburrjeje të druajtur, i ati, Qazim Gegaj. Ndërsa vëllau i dytë i Hysenit, Danushi, e shikonte me një admirim të fshehtë, sa herë që puqnin gotat apo ia krisnin këngës së festës." (Lajmëtari i lirisë, janar 1981, faqe 1)

Geisteswissenschaften, shkencat humanitare. Deri në fund të viteve 1950 është debatuar gjallërisht në Evropë p. sh. mbi statusin e sociologjisë në raport me shkencat humanitare (shoqërore) dhe shkencat natyrore. Një grupim i fuqishëm ka qëndruar për atë se sociologjia është shkencë humanitare sepse ekziston një hendek i pakalueshëm në mes kësaj lënde dhe shkencave natyrore. Diskutimi rreth *mikrosociologjisë* dhe *makrosociologjisë* mund të thuhet se është vazhdim i debatit si dhe çështja për të dhëna të forta (*hard data*) ose dhëna të buta (*soft data*).

Gemainschaft, *tip ideal (ideal type*) lidhur me një shoqëri të vogël lokale që karakterizohet nga relacione intime në mes njerëzve dhe ku kontrolli social bazohet në tradita dhe norma grupore. Ky term është krijuar nga Ferdinand Tönnies.

generalize *gjeneralizim* gjetja e diçkafit që është e përbashkët në dy apo më shumë ngjarje apo fenomene tjera. Nëse një ngjarje shikohet në hollësi në tërë pasurinë e detaleve, kuptohet se ajo është unike. Asnjë ngjarje nuk është krejtësisht e njejtë me ndonjë tjetër. Me rastin e gjeneralizimeve në përgjithësi lihen anash detalet unike. Me atë rast thuhet se bëhen abstrahime.

generation gjeneratë 1. Në përdorim të përditshëm me fjalën gjeneratë mendohen personat të cilët në një kohë të caktuar kanë përafërsisht moshë të njëjtë,
2. Në demografi me termin gjeneratë përcaktohen ata të cilët janë të lindur në një interval të caktuar kohor, më së shpeshti brenda një viti kalendarik. Në këtë mënyrë gjenerata është një tip special i *cohort*.
3. Në social-antropologji me gjeneratë në përgjithësi përcaktohen pasardhësit e parë të një grupi personash që vetë janë një gjeneratë. Në kuadrin e një sistemi farefisnor vëllezërit-motrat dhe kusherinjtë i takojnë të njëjtës gjeneratë.

genocide *gjenocid* politikë që ka për qëllim zhdukjen e një populli.

gerontocracy shoqëri që udhëhiqet nga pleqtë.

gerontology studimi i njerëzve të moshuar prej aspekteve të ndryshme.

gerrymandering taktik me rastin e ndarjes së zonave zgjedhore ku një apo më shumë grupe zgjedhësish mbeten të nënreprezentuar ndërsa të tjerët mbireprezentohen. Me anën e rregullave për nivelizime mandatesh mundet që gerrymandering të parandalohet.

Gesellschaft *ideal type (tip ideal)* përmes të cilit mendohet një shoqëri e madhe e urbanizuar nga kontakte jo-personale (pra personat nga njihen nga afër në mes veti), relacionet në mes individëve rregullohen në bazë të kontratave dhe kontrolli social ushtrohet përmes ligjeve të shkruara dhe sipas normave të sistemit institucional. E kundërta e kësaj është ajo që quhet *Gemeinschaft*. Termi është krijuar në vitet 1800 nga sociologu gjerman Ferdinand Tönnies.

gestalt psychology teori e cila kryesisht merret me mënyrën e perceptimit të fenomeneve të ndryshme nga njeriu në mjedisin e vet. Në bazë të pikëpamjeve të gestalt psikologjisë individi i vëren menjëherë disa kualitete tërësore tek një fenomen. Hetimi i detaleve bëhet tek më vonë. Përkrahësit e kësaj teorie kanë mendim të kundërt me ata që thonë se individi me rastin e perceptimit e krijon një pamje të plotë duke pasë si bazë e pjesë përbërëse detalet, pra duke u nisur nga detalet dhe jo nga tërësia. Si dëshmi për vlershmërinë e

gestalt-psikologjisë praktikohet bërja e eksperimenteve që tregojnë se në një fenomen mund të ndryshohen disa detale por vetitë e tërësisë së fenomenit nuk ndryshojnë. Mendimin themelor të gestalt-psikologjisë e hasim tek funksionalizmi klasik ku e ashtuquajtura *teza holistike* potencohet fuqishëm. Një prej teoricienëve më të njohur të gestalt-psikologjisë mund të përmendet M. Wertheimer.

Gestarbeiter Shprehja përdoret më së shumti për njerëzit (fuqinë punëtore të pakualifikuar) të cilët pa qëllim për t'u shpërngulur në një vend të huaj gjejnë punë jashtë vendit. Në rastin e rëndomtë familja lihet në vendlindje. Në Gjermani dhe Zvicër që nga vitet 1960 e deri më sot ka shumë shqiptarë që i kanë takuar kësaj kategorie. Me këtë kategori punëtorësh ka pasur më së shumti punë si punëtor social, Bardhosh Gërvalla.

GËRVALLA BARDHOSH; Bardhosh Gërvalla, *Habichthöhe 40, D-7101 Untergruppenbach.* Vendi i tij i punës ka qenë në *Arbeiterwohlfart, Solitudestrasse 44, Ludwigsburg, Tel. +49 7141-26091.*

GËRVALLA DINË – Dinë Gërvalla, kushëri i afërt i Jusuf Gërvallës. Dina përmendet në ditarin e Jusufit me këto fjalë: *"Atë ditë heret në mëngjes, e paskëshin burgosur Hysenin; i kishin gjetur materiale të shtypura të Lëvizjes.* ***Dina****, i cili e kishte sjellë lajmin për Hysenin, i gjen punëtorët e SPB-së duke ma bastisur banesën."*

GËRVALLA EKREM – Ekrem Gërvalla, kushëri i afërt i Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla: "*Kurrë s'i kam pasur në hatër largimet nga vendlindja, as për shëtitje të shkurtra, madje, se si po më vjen sikur jam shkëputur nga pjesa më e fuqishme e vetvetes. Pas shpine lash qindra e qindra të burgosur politikë, që po bien sakrificë për çështjen e atdheut, në mes tyre Hysenin dhe* ***Ekremin***." (Shënime nga Ditari)

GËRVALLA HYSEN, – Hysen Gërvalla, punëtor në Gjermani. Është fjala për një tjetër Hysen dhe jo për vëllaun e madh të vëllezërve Gërvalla. Aktivist i dalluar. Ka banuar në të njejtën ndërtesë me Murat Kryeziun në Bernhausen, afër aeroportit të Shtutgartit, në rrugën Nord-West-Ring 30.

GËRVALLA IDRIZ, Idriz Gërvalla, kusheri i Jusufit dhe Bardhoshit. Ka punuar si avokat në Prishtinë.

GËRVALLA ZEQIR, – Zeqir Gërvalla, lindi më 15 maj 1942 në fshatin Lupç i Poshtëm të Llapit. Përfundoi studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Është dënuar, persekutuar e burgosur për çështjen kombëtare. Poet e veprimtar i orëve të para. Në të gjitha qarqet e vetëdijshme atdhetare, ka qenë i njohur si Gërvallë, shumë e shumë më heret se sa Jusufi e Bardhoshi. Disa mendime të tij për Jusufin i kam trajtuar në librin "Filharmonia e Jusuf Gërvallës". Bardhosh Gërvalla, në letrën dërguar Nijazi Saraçoglut në Turqi, në fund të marsit 1981, e quan kusheri.

glittering generalities technique teknik propagandistike përmes të cilës bëhet përpjekja që një ide apo pikëpamje të duket sikur ka lidhje me një princip fisnik, i cili veç është i aprovuar nga ata, mbi të cilët është e drejtuar propaganda, qëllimi për t'i bindur. Kjo ndeshet p. sh. tek përkrahësit e ideologjive fashiste kur ata mundohen të fitojnë simpatizues, duke u thënë atyre se ai sistem shoqëror të cilin ata e duan është demokratik në një kuptim më të thellë se sa sistemi shoqëror aktual.

grass roots, emërtim që në rrethana politike përdoret për qytetarët e thjeshtë. Termi i përshkruar nga idetë marksiste "masat" është përafërsisht sinonim me *grass roots*.

gregarious instinct *instikti i kopeizmit*, presupozim se njeriu instinktivisht krijon grupe. Ky instinkt më parë është konsideruar si shkaku i origjinës së krijimit të shoqërive.

group 1. dy apo më shumë individ në mes të cilëve ndodh një *ndërveprim* që mund të vërehet. Koncepti i grupit është shumë i gjerë në kornizën e të cilit është e mundur një lloj-llojshmëri e madhe. Shembuj mbi vetitë-variablat e grupit janë; madhësia e grupit, qëndrueshmëria, intensiteti në ndërveprim, shkalla se sa është i hapur grupi (sa i përket rekrutimit të anëtarëve të rinj). Lista me variabla relevante mund të bëhet shumë e gjatë dhe prapëseprapë të konsiderohet e mangët. Pasuria e madhe e vetive, apo lloj-llojshmëria është shkak për tipologjizime të ndryshme. Në mesin e tipologjizimeve më të njohura janë *grup primar, grup sekundar, grup i brendshëm, grup i jashtëm.* Këtu mund të përmendet edhe grup referent, por duhet të kihet parasysh se tek grupi referent, ky koncept nuk definohet në bazë të ndërveprimit.
2. Disa sociolog parapëlqejnë që konceptit - grup t'i japin një kuptim më të ngushtë se sa që është thënë më lart. Në atë rast rëndom, përveç ndërveprimit kërkohet që një individ në një mënyrë apo tjetër të jetë i vetëdijshëm mbi ekzistencën e grupit dhe mbi anëtarësimin, pra për t'u llogaritur se ai është anëtar në atë grup. Më tutje kërkohet një interes i përbashkët apo një qëllim i përbashkët për anëtarët. Në mesin e faktorëve të tjerë që hyjnë në kuadrin e definicionit të ngushtë mbi grupin mund të përmendet kërkesa që grupi të ketë norma apo *organizatë sociale*.
3. Paralelisht me definicionet strikte sociologjike për grupin, termi grup përdoret shpesh si sinonim për *kategori*. Kështu, më së shpeshti vendosin rrethanat në të cilat lexuesit i jepet mundësia të vendos se termi grup a është përdorur në kuptimin sociologjik apo jo.

group atmosphere term përgjithësues për intensitetin e vetive emocionale tek relacionet sociale të një grupi, të marra si tërësi. P. sh. mund të flitet për atmosferë miqësore, atmosferë armiqësore, atmosferë tolerante.

group dynamics Termi përshkruan ndryshimet e bëra me qëllim të përshtatjes në *strukturën* e një grupi për shkak të ndryshimit të ndonjë pjesë të strukturës së grupit. Sa më afër që të jenë të lidhur anëtarët e grupit me njëri-tjetrin aq më e madhe është dinamika në grup. P. sh. vdekja, largimi i një anëtari të familjes shkakton ndryshime të mëdha në strukturën e grupit familjar. Ndërsa anëtarësimi i një anëtare të ri në një shoqatë të madhe ka efekt gati të parëndësishëm në strukturën e grupit.

group identification ndjenjë e anëtarit të grupit lidhur me atë se sa e ndien veten të afërt me anëtarët e tjerë të grupit, me normat, synimet dhe vlerat e grupit. Shkalla e identifikimit me grupin është treguar se ka variacione mvarësisht me pozicionin e individit në grup, numrin dhe peshën e nevojave që grupi ka për individin dhe numrin e grupeve tjera që individi u takon. Familja është një grup anëtarët e së cilës rëndom kanë shkallë të lartë të identifikimit me te si grup. Gjithashtu është e rëndomtë që lideri i një grupi ka identifikim të fortë me grupin. Një fenomen në shoqërinë e vendeve perëndimore është se shkalla e identifikimit me grupin, përgjithësisht është zvogëluar.

group moral është një koncept i përbërë dhe i gjer dhe për këtë është vështirë të definohet. Në mesin e atyre vetive që së bashku janë të lidhura me grup-moralin mund të përmendet shkalla e kohezionit, shfaqja e tensioneve të brendshme, aftësia e grupit për t'u përshtatur, atitydat e anëtarëve ndaj synimeve të grupit dhe ndaj liderëve, dëshira e anëtarëve për të qëndruar në grup dhe shkalla e *grup-identification*.

group pressure efekti në sjelljet e një individi që një grup mund të ketë. Studiues i njohur i grup-presionit në mes tjerëve është S. Asch i cili e ka kryer një seri eksperimentesh klasike ku personat e testuar do të jepnin vlerësimet e tyre për tri vija të cilat kanë pasë gjatësi të njëjtë. Vlerësimet janë bërë para një grupi i cili ka marrë instruksione për të dhënë përgjigje të gabueshme. Është vërtetuar se një numër i madh i personave të testuar (persona që nuk i kanë takuar atyre që kanë marrë instruksione me dhënë përgjigje të gabueshme, e para të cilëve është bërë eksperimenti) kanë dhënë përgjigje të gabueshme.

grup rigidity veti që ka të bëjë ndikueshmërin e faktorëve të jashtëm në strukturën e grupi. Nëse është vështirë të ndikohet prej së jashtmi ekziston shkallë e lartë e grup-rigjiditetit. Në grup-strukturë e cila është e ndjeshme për forcat e jashtme ka një shkallë të ulët të grup-rigjiditetit.

group tension relacione sociale në një grup të cilat kanë tendencë ta shpërndajnë apo ristrukturojnë grupin.

GJ

GJOCAJ MUHARREM, veprimtar në Gjermani. Vëllau i Zenun Gjocajt. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Muharrem Gjocaj, Klarastr. 9-72, 8 Munchen 19. Ka qenë një ndër pikat nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 100.

Në banesën e tij për shumë e shumë vite ka qenë një shishe konjaku "Skënderbeg" të cilën e ka çelë së bashku me Jusufin e Bardhoshin kur i kanë qenë mysafir. Pjesa tjetër e mbetur në shishe është mbyllë dhe nuk është lejuar të harxhohet kurrë.

GJOJCAJ KOLË, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Kolë Gjojcaj, 36762 Waltham, Sterling HTS. Mich. 48077, U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

H

habitat term për përcaktimin e mjedisit social dhe fizik në të cilin individi jeton.

HADRI ALI, – Ali Hadri lindi më 3 mars të vitit 1928 në Lushnjë. Shkollën fillore dhe të mesmen i mbaroi në Gjakovë. U diplomua në vitin 1956 në Fakultetin Filozofik të Beogradit dhe pastaj po aty u magjistrua në vitin 1960.

Më 26 dhjetor 1970 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës ai e mbrojti me sukses doktoraturën në temën Lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945. Kjo datë është e rëndësisë së veçantë për arsimin dhe shkencën shqiptare, sepse ishte doktorata e parë e mbrojtur në Universitetin e Prishtinës. Mjafton ky fakt për ta vënë

në pah rëndësinë e punës profesionale edukative e shkencore të Ali Hadrit, i cili në Kosovë tashmë me plot të drejtë çmohet si themeltar i shkollës sonë të historiografisë kombëtare. Ali Hadri ishte drejtori i parë i Institutit të Historisë së Kosovës, ku punoi derisa organet pushtetit të atëhershëm e shkarkuan nga detyra, për shkak të mbështetjes së kërkesave të studentëve në demonstratat e vitit 1981, të cilat i mbrojti me përkushtim, me forcën e argumentit dhe me guximin e një atdhetari të rrallë. Vdiq në Pejë, më 2 dhjetor 1987.

Jusuf Gërvalla: "*Por, egërsia dhe guximi karakteristik i socialshovinistëve jugosllavë në diskriminimin e një populli të tërë, shpërtheu haptasi vitin e kaluar në gazetën "Veçer" të Shkupit. Nga 25 shtatori deri më 21 tetor, kjo gazetë e shovinistëve maqedonas botoi në 23 vazhdime serinë e artikujve të Nijazi Limanovit me titull "Islamizimi i Maqedonisë". Duke u përpjekur gjoja për t'u dalë zot "torbeshëve" apo "maqedonasve muslimanë", siç quhet këtu me kohë një pjesë e popullsisë shqiptare pjesërisht e asimiluar, gazeta në fjalë doli me sulme të hapëta shoviniste, të padëgjuara deri më tash, kundër popullit shqiptar. Sipas të vjellave të Limanovit, një gazetar gjysmanalfabet dhe psikopat nga rrethi i Dibrës, populli shqiptar e paskësh pranuar në të kaluarën me gjithë dëshirë fenë muslimane, me qëllim që pastaj, me një "agresivitet" të paparë prej "pushtuesi" të egër, t'i islamizojë edhe popullsitë sllave përreth. Në marifetin e tij të bukur, morri Nijazi Limanov – edhe vetë një shqiptar i asimiluar - shkon aq larg sa jo vetëm i thërret të vampirizohen të gjitha forcat e errëta "shkencore" të borgjezisë sllavomadhe serbe, por atyre u siguron edhe "lëndë" të re lidhur me "agresivitetin", "dhunën" dhe përgjithësisht "egërsinë" e "pushtuesve" shqiptarë.*

Përsëri renegatët shqiptarë bënë gjumin e tyre të ëmbël të tradhtisë dhe të moskokëçarjes për çkado që nuk e rrezikon pozitën e tyre të mjerë në aparatin revizionist jugosllav. Doli dhe reagoi, vërtet pesë para dymbëdhjetëve por në mënyrë të thuktë shkencore, akademiku Dr. Ali Hadri.

Duhej që renegatët shqiptarë, siç u jepte mundësi Kushtetuta për të cilën ata kapen aq fortë kur ua do nevoja, t'ia ngjitnin për veshi Limanovit e "Veçerit" dhe ta ndërprenin që me artikullin e parë serinë e atyre shkrimeve me përmbajtje thellësisht antishqiptare. Ata, pra, janë aq energjikë e të papërtueshëm kur kanë të bëjnë, qoftë edhe me një fjalë të vetme të autorëve shqiptarë." (Liria, nr.3, maj 1981, f. 14)

HADRI ENVER – Enver Hadri (1941- 25 janar 1990) ishte veprimtar për të drejtat njerëzore dhe politike të shqiptareve të Kosovës. Në fillim të vitit 1972 ai u vendos në Bruksel, ku vazhdoi veprimtarinë politike nëpërmjet Organizatës Rezistenca Kombëtare e Shqiptarëve të Kosovës në të cilën bashkëvepronin Enver Hadri, Ramadan Gashi, Riza Kadrija, Agim Rodoniqi etj.. Organ i kësaj organizate ishte revista *Zëri i Kosovës* në gjuhën shqipe dhe frënge, përmes të cilës bëhej thirrje për bashkimin e trojeve shqiptare në përgjithësi, sidomos punohej që çështja e Kosovës të futej në agjendat e diplomacisë ndërkombëtare, si Unioni Evropian, NATO, etj., Në Bruksel, në rrugën e Shqipërisë (Rue d'Albanie) ai formoi dhe drejtoi Komitetin Shqiptar për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Më 25 shkurt, 1990, në moshën 49 vjeçare, Enver Hadri u plagos dhe më vonë vdiq në spital nga një atentat në Sent Zhil (origj. Saint Gilles), Bruksel, i porositur nga Shërbimi Sekret Serb (UDBA). Atentatorët, Veselin Vukotiç (Veshko), Andria Lakoniç, dhe Darko Asanin, e qëlluan me dy plumba në kokë deri sa kishte ndaluar ne një semafor. Hadri kishte me vete listën e 32 shqiptarëve të vrarë në Kosovë nga Serbia të cilën do t'ia dorëzonte të nesërmen Komisionit të të Drejtave të Njeriut të Parlamentin Evropian.

Më 2006, Enver Hadrin është dekoruar me Urdhrin e Artë "Hero i Kosovës", "për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës".

Pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, më 17 janar 1982, Enver Hadri në numrin vijues të revistës "*Zëri i Kosovës*" që doli më 20 janar 1982 në Bruksel, botoi shkrimin:

"JA VDEKJE JA LIRI!"

Vrasja e tre patriotëve liridashës e përparimtarë në Gjermaninë Perëndimore më 17 gjegjësisht 18. 01. 1982 në krye me Jusuf Gërvallën duhet të ngjallin mënin më të madhe kundër armikut. Këto vrasje duhet t'i bashkojnë të gjitha forcat përparimtare kosovare në luftë të vendosur drejt pavarësisë dhe socializmit të vërtetë.

Kosova jonë e dashur që nga 11 marsi 1981 u bë arenë e ngjarjeve të përgjakshme. U bë prova dhe qëndrueshmëria e shqiptarizmit. Kosovarët i vranë dhe i burgosën.

... Qeveria fashiste dhe revizioniste e Beogradit dërgon ushtri dhe polici speciale për të vrarë rininë tonë liridashëse, revolucionare dhe përparimtare (progresiste). ...Kemi parë ku çon politika jo e drejtë e një pseudosocializmi, siç është politika fashiste e qeverisë jugosllave. Shqiptarët vdiqën në Kosovë - për Kosovën, shqiptarët vdesin në botën e lirë - po për Kosovën! Vdesin djemtë më të mirë të kombit. Por edhe sikur të na vrasin të gjithëve këtu në mërgim, Lëvizja Nacional Çlirimtare për të Drejtat e Shqiptarëve nuk do të shuhet sepse çdo njeri nga ne e din se të vdesësh për atdhe është një privilegj.

Vrasja e tre atdhetarëve kosovarë, me në krye atdhetarin dhe përparimtarin e çmuar Jusuf Gërvalla, nga agjentura fashiste e Beogradit, duhet të ngjallë mëninë më të madhe kundër armikut, duhet t'i bashkoj të gjitha forcat përparimtare kosovare në luftë të vendosur drejt pavarësisë dhe socializmit të vërtetë.

Rezistenca Kombëtare e Shqiptarëve të Kosovës shpreh indinjatën e vet dhe proteston energjikisht kundër masave fashiste që merr qeveria e Beogradit për t'i likuiduar atdhetarët kosovarë, qoftë në Kosovë apo në botën e jashtme. ...

Para armikut dhe në mes të turbullirave, që ka sot në botë, asgjë nuk është e lejueshme përpos se të bashkojmë idetë tona, njerëzit tanë dhe territoret tona. Këtë detyrë të rëndë ne do ta zbatojmë për lirinë e Kosovës dhe krahinave të saja, me një ndërgjegje që t'i shërbejmë mirë dhe me vendosmëri deri në fitoren e plotë!

Kosova me ne! Ja vdekje - ja liri!

Enver Hadri, d.v.

(Enver Hadri: *Zëri i Kosovës*", Bruksel, 20 janar 1982. Marrë nga libri Halit Elshani: "Çeta e Brukselit", kapitulli 34, faqe 154, Prishtinë 2007)

HAJREDINI FADIL, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Fadil Hajredini, 1, Chemin des Ouches CH-1203 Geneve, tel. 968547. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

HAJRIZI SADRI, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sadri Hajrizi, Löhstr. 3 A, Leverkusen 1. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

HAKLAJ MUHAMET – Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Muhamet Haklaj, arsimtar nga f. Isniq, KK – Deçan, i lindur me 13 prill 1955 në Pejë, arsimtar pran QAMO "Vëllezërit Frashëri" në Deçan. ... 3 (tre) vjetësh."*

HALILI MUHAMET. Jusuf Gërvalla: *"Në Istog, polici Milan Petroviq e vrau djaloshin Muhamet Halili, pse po gjuante pa leje peshk në lumin e Istogut! (Le të na kujtohet se kjo*

vrasje ndodhi pak kohë pas pushkatimit të Selim Talit, i cili qe dënuar me vdekje pse vrau një pylltar të kombësisë tjetër dhe ia mori gjakun të vëllait, po kjo vrasje u trajtua si ata mbi "vëllazërim-bashkimin" Ne ngulim këmbë se vrasja e M. Halilit nga polici s'është gjë tjetër pos një hakmarrje e egër, e organizuar nga UDB-ja e Pejës)." (Lajmëtari ilirisë, tetor 1980, faqe 11)

HAMITI FAIK, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë numër telefoni: Faik Hamiti, në Shtutgart tel.+49.711.252784 Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

HAMITI SABRI, – Sabri Hamiti lindi më 10 maj 1950 në Dumnicë të Podujevës, ku kreu shkollën fillore. Më 1968 mbaroi gjimnazin në Podujevë dhe u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku u diplomua në vitin 1972, në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe. Në vitin 1997 ka botuar dramën *Misioni*. Në vitin 2000 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës.

Shtëpia Botuese FAIK KONICA: "Tekstin e Sabri Hamitit *Vepra letrare e Jusuf Gërvallës*, botuar si parathënie e botimit *Vepra letrare*, Ora, Prishtinë 1992, e zgjodhëm ta vejmë në ballë të këtij botimi të Shtëpisë Botese Faik Konica – Prishtinë 2010, për shkak se është teksti më gjithëpërfshirës dhe më analitik i veprës letrare të Jusuf Gërvallës. Ai i përgjigjet më së miri kërkesës së botuesit, për t'i prirë me një tekst analizues dhe vlerësues këtij botimi, i cili është mbështetur, në radhë të parë, në botimin e përmendur, duke e plotësuar edhe me shkrimet e botuara ose edhe të pabotuara të Jusuf Gërvallës." (Jusuf Gërvalla, VEPRA, vëll. 1, Prishtinë 2010, f. 30)

HARADINAJ ISMAIL – Ismail Haradinaj (1943-2009) - Kadri Rexha**:** *"Gjatë kësaj kohe, pra në muajt e parë të vitit 1980, në jetën politike të Jusuf Gërvallës hyn edhe një ngjarje tjetër shumë me rëndësi, e cila në aktivitetin e tij të palodhshëm do t'ia plotësojë një boshllëk, do ta angazhojë edhe më tepër, sidomos kur të kihet parasysh se në mes Jusuf Gërvallës dhe organizatës së tij LNÇKVSHJ ende nuk ishin vënë kontaktet e pritura.* ***Ismail Haradinaj****, arsimtar i edukatës fizike, nga fshati Glloxhan, KK i Deçanit, përndryshe burrë i ndershëm nga një derë e njohur për tradita të larta patriotike, me anë të një letre, të cilën ia dërgon përmes një studenti, e njofton Jusuf Gërvallën se në rrethin e Deçanit ekziston një grup patriotik revolucionar mjaft aktiv. Ai përmes letrës shpreh gatishmërinë e vet dhe të shokëve të tij për luftë të pakompromis për atdhe. Prandaj, në mes tjerash, e lut Jusufin që të jetë në kontakt të vazhdueshëm me ta, në mënyrë që t'u gjendet sa më pranë me këshilla dhe udhëzime. Kësaj lutje dhe kërkesave që i erdhën nga ky grup, Jusuf Gërvalla u përgjigjet pozitivisht dhe menjëherë fillon nga puna. Sa për fillim ai atyre ua ofron Statutin, materialet e LNÇKVSHJ dhe mënyrën e organizimit të saj, të cilat ata i pranojnë me entuziazëm të madh. Pas përqafimit të Statutit, ky grup, më parë gjysmë i organizuar, i riorganizon radhët e veta dhe fillon një aktivitet me hov të ri. Tash e tutje ky krah i ri i LNÇKVSHJ do të quhet 'Komiteti i Deçanit' dhe pothuajse të gjitha territoret e Rrafshit të Dukagjinit si dhe Universiteti i Prishtinës pikërisht nga kjo degë do të mbulohen me trakte, si dhe me materiale të tjera patriotike. Nga puna dhe aktiviteti i suksesshëm i këtij krahu, Jusuf Gërvalla do të marrë impulse të reja, edhe pse me vështirësi të mëdha materiale dhe pa bashkëpunëtorë, do t'i hyjë punës individualisht dhe gjatë verës së atij viti do të fillojë me nxjerrjen e revistës së përdymuajshme 'Lajmëtari i lirisë'."* (Fati i luleve, Prishtinë, 1993, f. 162)

Aktgjykim*: "Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Ismajl Haradinaj, nga f. Gllogjan, KK – Deçan, i lindur më 26 mars 1943 në të njejtin fshat, me profesion arsimtarë i edukatës fizike pranë shkollës fillore "Drita" në Gramaqel, KK – Deçan.... i shqiptohet dënimi i unifikuar me burg në kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë) vjetësh."*

HARADINAJ NAIM, Naim Haradinaj, i biri i Ismail Haradinajt. Me te jam njohur së pari, kur kam shkuar në Shtutgart, në korrik të vitit 1981. Vëllau i madh i Nasim Haradinajt. Në verën e vitit 1986, në banesën e tij në Skövde në Suedi, më ka ra të takohem për her të parë me veprimtarin Ismail Rugova.

HASANI SALI, – Sali Hasani nga fshati Dumnicë, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

HASANMETAJ AVDULLAH – Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Avdullah Hasanmetaj, profesor nga f. Strellc i Epërm, KK – Deçan, i lindur më 16 mars 1950, në të njejtin fshat, me profesion profesor i matematikës pran QAMO "Vëllezërit Frashëri" në Deçan. ... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vjetësh."*

HASHANI SAMI, veprimtar në Francë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sami Hashani, 128BD. de Stalingrad bad. lesc.1 ap.3, 94200, Ivry S/Saine Frankrei. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

HASHANI SHAIP, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Shaip Hashani, 6137 S. Kolin, Chikago Ill. 60629 USA. Ka qenë një prej pikave prej nga është shpërndarë *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

HAXHILLARI QEMAL, aktivist i rrethit të Shtutgartit, bashkëfshatar në Kosovë, dhe fqinjë i parë i Faridin Tafallarit në Gjermani. Në vitet 1980-1984 ka banuar në këtë adresë: Qemal Haxhillari, Haiterbacherstr. 75, D-7270 Nagold.

HAXHIU AJET, – Ajet Haxhiu, punëtor shoqëroro-politik i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Autor i librave "Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës" dhe "Shota dhe Azem Galica".

Jusuf Gërvalla: "*Mirëpo, duke qenë njeri i përvuajtur, i thjeshtë dhe i vetëdijshëm për dashurinë që kam ndaj nënës Shqipëri, jam i sigurtë se unë s`do të merrja në asnjë mënyrë rrugën e atyre djemve bastardë të Kosovës, që janë vënë në shërbim të armikut, por do të ndiqja shembullin e ca të tjerëve, si Ajet Haxhiu, Agim Gjakova e ndonjë tjetër të cilët kurdoherë kanë mbetur burra të ndershëm*." (Letër Enver Hoxhës; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla, www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

HAZIRAJ DEMË, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Dem Haziraj, Herweg str. 4 D-7306 Dekendorf. Ka qenë një prej pikave prej nga është shpërndarë *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

hearing marrjen në pyetje e dëshmitarëve, në të shumtën e rasteve ekspertëve të fushave të ndryshme, nga organe legjislative. Këto marrje në pyetje janë rëndom publike dhe bëhen në prag të ndonjë propozimi për ligj të ri apo propozimeve për marrjen e masave. Hearings është një dukuri e rëndomtë në ShBA.

HEBRANG ANDRIJA (babai), – Andrija Hebrang (1899-1949), lindi më 21 shtator 1899 në fshatin Baçevac pranë Viroviticës. Anëtar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (KPJ) që nga themelimi, më 1919. Në një gjykim kundër tij është deklaruar si komunist nga bindja, por jo si anëtar partie. Për veprimtari komuniste është dënuar me 12 vjet burg. Ka qenë në burgun e Lepogllavës dhe Mitrovicës së Sremit. Nga shokët burgut, anëtarët e PKJ, për shkak të mbrojtjes së të drejtave të popullit kroat, është shpallur si trockist dhe janë bërë përpjekje që ta likuidojnë qysh në burg. Është vrarë dhe zhdukur nga klika Titiste, në pamundësi që t'i kurdiset ndonjë gjykim politik. Është vrasja më e njohur në

Jugosllavi, si vrasje individuale, që është bërë në emër të "principeve komuniste" kundër një komunisti.

Atentati i 17 janarit 1982, që ka pasë në shënjestër Jusuf Gërvallën, nuk ka ngjashmëri ideologjike me atentatet kundër emigracionit të djathtë kroat në Perëndim, por ka ngjashmërinë më të madhe (nëse bëjmë analogjinë në mes dhunës serbe në drejtim të popullit kroat dhe atij shqiptar) me vrasjen e Andrija Hebrangut.

Pasardhësit e Hebrangut, qoftë gruaja apo fëmijët, nuk e kanë busullën e qartësisë ideologjike që e ka pasur burri apo baba.

hedonism pikëpamja sipas të cilës kënaqja është vlera më e lartë e jetës. Principi hedonist qëndron për atë se njeriu rëndom kërkon atë që e kënaq dhe mundohet t'i ik dhembjes dhe pakënaqësive. Ky ka qenë një prej principeve bazë të ekonomisë klasike.

HERLEVIÇ FRANJO, – Franjo Herleviç (1915-1998), ministër i punëve të brendshme në RSFJ nga 17 maji 1974 – 16 maj 1982. Në detyrën e tij si ministër i punëve të brendshme është zavendësuar nga Stane Dollanci.

Komiteti Qendror i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës: "*Për të fshehur shkakun e vërtetë të demonstratave dhe trazirave të sivjetme në Krahinën e Kosovës, skamjen e mjerimin, shtypjen nacionale, sociale e kulturore të popullsisë vendëse, qeveria shoviniste e Beogradit, me kryepolicin Herleviç në krye, u hodh në të katër anët për të kurdisur arsye të paqena, si "romantizëm nacional" dhe "nacionalizëm e shovinizëm shqiptar" si dhe për të gjetur "organizatorin" e demonstratave, duke fajësuar herë një "grup huliganësh", herë "ekstremistët" shqiptarë, (duke pasur në këtë rast parasysh Marksistë-Leninistët e Kosovës) herë organizatën Fronti i Kuq Popullor etj., në mënyrë që pastaj të kthehet e t'ia ngarkoj fajin kryesor Republikës popullore Socialiste të Shqipërisë.*

Ndër "organizatorët" e shumtë, kryepolici Herleviç, zuri ngoje edhe organizatën tonë patriotiko-revolucionare me emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës, duke e fajësuar atë për shumë "vepra" që nuk përkojnë aspak me veprimtarinë e saj.

E kemi parë të udhës që pasi, pasi në mjetet e informimit publik të Perëndimit u publikuan "informatat" e përpunuara nga agjencitë gazetare jugosllave, t'ju drejtohemi me një kërkesë demokratike edhe ne: për dezinformimet e ndryshme rreth ngjarjeve tragjike të Kosovës; ne do të kishim pasur një satisfaksion, po që se do ta transmetoni në organet tuaja edhe këtë komunikatë nga ana e Komitetit Qendror të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës.

1. Demonstratat e Kosovës të këtij viti nuk i ka organizuar LNÇK. Ato kanë shpërthyer spontanisht, së pari në Universitetin e Kosovës, e pastaj janë përhapur në të gjitha viset e Kosovës. Shkaku dhe arsyeja e shpërthimit të tyre nuk mund të kërkohen askund tjetër, pos në revoltën e grumbulluar me dhjetëra vite te popullsia shqiptare për shkak të skamjes, mjerimit dhe padrejtësive nacionale që i bëhen popullit tonë nga ana e qeverisë shoviniste të Beogradit.

2. Kërkesa për t'iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, nga të gjitha dokumentet e LNÇK të botuara në organet "Zëri i Kosovës" dhe "Lajmëtari i lirisë", si dhe në të gjitha traktet tona.

Kërkesa për republikën e Kosovës është kërkesë e një pjese të inteligjencies së Kosovës. Çështja e saj është shtruar më herët, sidomos më 1968. Pasi ajo u refuzua nga ana e Titos dhe e qeverisë jugosllave, në Kosovë patën shpërthyer në nëntor të vitit 1968 demonstrata

të fuqishme. Edhe atëherë edhe sot, kjo kërkesë u përkrah nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi. Por, LNÇK mbetet pranë kërkesës së saj të vetme – luftës për bashkimin e ligjshëm të të gjitha trojeve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkangjitjen e tyre shtetit amë." (Komunikatë e formuluar nga Jusuf Gërvalla dhe Xhafer Durmishi, korrik 1981)

heuristic Një koncept është heuristik nëse, edhe pse nuk është rigorozisht shkencor, ka ndikim stimulues për kërkimin e diturive të reja. Një metodë mësimi është heuristike, nëse ajo para së gjithash niset nga ajo që me i lejua vet nxënësit të vijnë gjer te dituritë.

hierarchy *hierarki* pjesërisht kur një grup personash apo dukurish janë të renditura sipas rangut duke u bazuar në pushtet - fuqi dhe ndikim apo ndonjë tjetër kriter për ndarje, pjesërisht ata që gjenden në krye të hierarkisë.

high-brow fjalë për fjalë do të thotë "ball lartë". Një grup apo individ quhet high-brow nëse mënyra e jetesës është më e sofistikuar dhe se e të tjerëve, nëse ka shije të veçantë (taraqillak) kur është një pyetje arti, muzika, literatura, veshja, ushqimi etj. Nga kjo shprehje fillimisht mahiçare është bërë rrjedhimi i epiteteve **middle-brow** dhe **low-brow**.

hinterland rrethet jashtë rrethit dominues-qendror. Hinterlandi ka dy funksione për rrethin qendror, pjesërisht të shërbej si furnizues i lëndëve të para dhe atyre ushqimore, pjesërisht të shërbej si treg për produktet e finalizuara të rrethit qendror.

HISTORI /*histori-filozofi*. Fjala histori paraqet si rrjedhën historike (gjermanisht: *die Geschichte*) ashtu edhe përshkrimin e kësaj rrjedhe (gjermanisht: *die Historie*). Në mënyrë gjegjëse fjala "histori-filozofi" pjesërisht paraqet një filozofi lidhur me atë se çka është një rrjedhë historike dhe pjesërisht një trajtim teorikoshkencor për atë se çka është shkenca e historisë (ose çka mund të jetë).

Në mesin e tipeve kryesore të histori-filozofisë mund të përmenden:

1. Historia është një seri komplekse e ngjarjeve të cilat kanë shumë lloje shkaqesh, por aty nuk ka ndonjë shkak të veçantë që dallohet prej të tjerëve. Në këtë mënyrë gjegjëse, nuk ka një model dominues (nuk ka një strukturë dominuese) në histori. Kjo lloj pikëpamje për historinë është e përhapur sidomos brenda traditës empiristike dhe pothuajse mbretëron në filozofinë analitike.

2. Rrjedhat historike kanë si parakusht një lloj të shkaqeve që dominon mbi të gjithë të tjerët. Ekstremet tradicionale këtu janë *materializmi* (që thotë se historia drejtohet nga forca natyrore dhe/ose ekonomike) dhe *idealizmi* (që thotë se historia drejtohet nga forca kulturore dhe/ose shpirtërore).

3. Historia përveç asaj që është e drejtuar vetëm nga një lloj i shkaqeve, ajo ka edhe një synim përfundimtar të caktuar. Ky synim përfundimtar i caktuar mund të kuptohet në disa mënyra.

a) historia përpiqet të shkoj në drejtim të një përfundimi, ku çdo gjë shkatërrohet në mënyrë që të rikrijohet prapë.

b) historia përpiqet të shkoj drejt një lirimi përfundimtar përmes ndërhyrjes së zotit, (pas ditës së kiametit, fitimi i gjenetit për ata që i kanë bërë hyzmet punës për të përfunduar në gjenet).

c) historia është diçka që gjithnjë shkon përpara (rrotën e historisë askush nuk mund ta ndalë).

d) historia është diçka që gjithnjë shkon prapa. (Këtyne herë gjithçka ka qenë më mirë - kam pasë punë me heronj të gjallë - e çfarë vakti na ka ra me pritë, - e sot më ka ra

hise me pasë punë me lahpera. Hazreti Ademi e Hazreti Hava në fillim kanë qenë në gjenet, por për shkak të mosdëgjimit janë përjashtua nga aty, dhe nga atëherë fillojnë vuajtjet e njerëzve secila më e rëndë se tjetra).

4. Përfundimisht fjala histori paraqet historicitetin e aftësisë së njeriut për të kuptuar, i cili sipas Heidegger, Jaspers, Gadamer dhe Ricceur është një parakusht i domosdoshëm për ekzistimin e historisë në kuptimet e lartpërmendura këtu nga pika 1 deri në 3.

historicism përpjekje për t'i shndërruar të gjitha shkencat shoqërore në nëndegë-nënshkenca të shkencës së historisë. Historicizmi don të bëj parashikime mbi të ardhmen duke u nisur ligje të përgjithshme historike.

holistic thesis, the *teza holistiske*. Tërësia vjen në radhë të parë, para pjesëve përbërëse dhe vendosë për përmbajtjen e tyre.

horizontal mobility 1. kur individi shkon prej një pozicioni në një pozicion tjetër brenda të të njejtit **stratum**, d. m. th. pozita e tyre sociale nuk ndryshon as lart as poshtë,

2. përhapja e vetive të ndryshme kulturore, traditave, vlerave etj. brenda një **stratumi** të caktuar.

HOXHA BUJAR, ish punonjës në Ambasadën e Shqipërisë në Ankara të Turqisë, nga qershori i vitit 1981 deri në tetor 1982. **T**itulli i tij diplomatik ka qenë: MINISTER FUQIPLOTE I SHQIPERISE në Ankara. Duke qenë djali i Kadri Prishtinës, Kryetarit të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, dhe duke treguar angazhim për çështjen e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, simbolikisht mund të thuhet se fryma e gjeneratës së babait të tij, i është përcjellur Lëvizjes së Jusuf Gërvallës. Bujar Hoxha në letrat e Jusuf Gërvallës përmendet me fjalët *Profesori* dhe *Plaku*.

HOXHA ENVER, – Enver Hoxha (16 tetor 1908 - 11 prill 1985) ishte udhëheqës i Shqipërisë nga viti 1944 deri në vdekjen e tij në vitin 1985, si Sekretar i Parë i Partisë së Punës së Shqipërisë. Ai ishte kryetar i Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura nga viti 1944 deri në vdekjen e tij.

Në dobi të revolucionit e të socializmit

Jusuf Gërvalla: "*I dashur shoku Enver!*

...Por, që nga çasti i parë i arratisjes, unë e kam pasur mendjen të strehohem në Shqipëri. Prandaj, shoku Enver, mora kurajon të Ju drejtohem Ju personalisht. Kam njoftime për marrëveshjen shqiptaro-jugosllave lidhur me ekstradimin reciprok të personave të vënë jashtë ligjit në të dy vendet. Por, sipas Nenit 65 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Shqipërisë, ku thuhet: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës", konsideroj se mua më takon kjo e drejtë. Nuk dua të them se ma mohon kush, por, procedura e rëndomë e realizimit të saj po më dëmton fizikisht e shpirtërisht, shoku Enver.

...Kur i marr parasysh çështjet në gjithë gjerësinë e tyre, kërkesa për të m`u dhënë e drejta e strehimit në atdheun tim, më duket si një luks, dhe atëherë më rrëmben një ndjenjë turpi. Por i vetëdijshëm se në Kosovë, përderisa gjendja të mos ndërrojë rrënjësisht, këmba ime s`ka si shkel më sa të jem gjallë, e në anën tjetër, me këtë botë të

huaj s`më lidh asnjë cikërrimë dhe këtu nuk shoh kurrfarë perspektive, e vetmja rrugë e drejtë dhe e njerëzishme më duket jeta në Shqipëri." (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur Jusuf Gërvalla shkruante 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Përjashtim bën Lëvizja anëtar i së cilës jam unë

Jusuf Gërvalla: ***"I dashur shoku Enver!***

... Larg ndenjës revanshiste e shoviniste, te ne është ndezur shkëndija e luftës së pashmangshme nacionalçlirimtare, konturet e së cilës po duken në horizont.

Të nxirret pjesa e robëruar e tokave dhe e popullit shqiptar nga kthetrat e përgjakshme të socialshovinistëve titistë dhe të çohet në vend vullneti i ndryshuar i popullit tonë: bashkimi me vendin amë, Shqipërinë, është një e drejtë historike, që iu mohua por nuk iu çrrënjos kurrë popullit tonë të vënë me shekuj përballë padrejtësive të mëdha historike po të papërkulur kurrë."

Ne prekemi thellë nga ata që sjellin dekurajim e pakënaqësi

"Por, gjithashtu ***ne prekemi thellë*** *në sedër sa herë që, nga mosbesimi në ne apo nga konspiracioni i thellë, ndonjë shtetas i RPS të Shqipërisë ngul këmbë sesi në Jugosllavi nuk jemi aq keq dhe se Shqipëria nuk ka fare të bëjë me të vërtetën sa i përket qëndrimit të Shqipërisë socialiste ndaj tokave të veta të pushtuara,* ***sjellin dekurajim dhe pakënaqësi në mesin e popullit tonë të shumëvuajtur****."*

Ne jemi skeptik rreth pritjes për bashkim në baza marksiste-leniniste

"Prandaj, ne jemi skeptikë se për realizimin e aspiratave tona shekullore, të drejta për bashkimin e tokave dhe të popullit tonë, mund të priten rrethana të rivendikimit në baza marksiste-leniniste."

Lufta jonë politike është fituar

"Pakënaqësia në rritje e popullit tonë, njëherazi, është edhe pasqyrë e luftës politike ndërmjet titizmit dhe popullit shqiptar. Dhe kjo pakënaqësi sot ka arritur në atë shkallë, ***sa mund të thuhet që lufta jonë politike kundër këtij pushtuesi të egër revizionist është fituar gati në mënyrë përfundimtare****."*

Përjashtim bën Lëvizja anëtar i së cilës jam unë

"Organizimi i tyre është bërë shpesh në suaza regjionesh të caktuara, të ngushta dhe vetëm në ndonjë rast të rrallë ato (si bie fjala më 1964) janë përhapur në ndonjë trevë më të madhe të tokave tona. ***Përjashtim bën Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam dhe unë.*** *Kjo lëvizje vazhdimisht ka pasur parasysh si një nga qëllimet kryesore përfshirjen në gji të vet të patriotëve dhe revolucionarëve nga të gjitha viset shqiptare."*

Luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm

"Po tash, meqë lufta jonë politike ka hyrë në fazën e vet përfundimtare, e cila po zhvillohet në favorin tonë, janë të domosdoshme edhe forma më të larta organizimi të aktivitetit revolucionar. Edhe nga kjo pikëpamje ne, me një vonesë të konsiderueshme, kemi arritur në përfundimin ***se luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm...,*** *është e domosdoshme një ndihmë konkrete nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë. Një ndihmë e tillë, konsiderojmë ne, është e drejtë e patjetërsueshme si për PPSH – në, ashtu edhe për djalërinë patriotike e revolucionare shqiptare në pjesën e robëruar të atdheut tonë të përbashkët."* (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

HOXHA FADIL – Fadil Hoxha (15 maj 1916, Gjakovë - 23 prill 2001, Prishtinë), aktivist dhe luftëtar në Luftën e Dytë Botërore, gjeneral major në LNÇ. Si i ri shkoi në

Shqipëri për t´u shkolluar. Gjatë luftës dytë botërore u inkuadrua në Lidhjen Komuniste. Në vitin 1941 kthehet në Kosovë si mësues, për t'u bërë më vonë një nga nismëtarët e Lëvizjes Nacional Çlirimtare. Pas kthimit në Kosovë i bashkohet rezistencës partizane kundër okupimit fashist italian dhe më 1943 emërohet komandant i aradhes partizane (Aradha Partizane "Emin Duraku"), që atë kohë operonte në territorin e Kosovës.

Pas luftës kishte disa funksione politike në nivel krahinor dhe federativ. Funksionet më të larta në nivelin federativ ishin anëtar i Kryesisë Republikës Socialiste Federative Jugosllavisë dhe anëtar i Kryesisë së Lidhjes Komunisteve Jugosllavisë. Më 11 qershor 1945, me formimin e Kuvendit të Kosovës emërohet kryetar i tij. Këtë funksion e mbanë deri më 20 shkurt 1953. Po në këtë funksion emërohet edhe një herë më 11 korrik 1967, dhe e mbanë përgjatë demonstratave të njohura të vitit 1968-të, ndërsa një vit më vonë 1969, i liron funksionin Ilaz Kurteshit.

Fadil Hoxha vdiq më 23 prill 2001 në Prishtinë, në moshën 85 vjeçare.

HOXHA ISMAIL, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1985 ka pasur këtë adresë: Ismail Hoxha, Heiligenstr.25, 6630 Saarlouis-Roden. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

HOXHA XHAVIT – Aktgjykim: *"Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Xhavit Hoxha, profesor nga f. Junik, KK – Deçan, i lindur më 15 tetor 1952, në të njejtin fshat, me profesion profesor i gjeografisë pran QAMO "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë, ka të kryer Fakultetin e Shkencave Natyrore – Grupi i Gjeografisë. ... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh."*

HOXHA XHEVDET, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Xhevdet Hoxha, 29559 Lamer, Livonia Mi 48152. U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

human relations, një mënyrë për t'iu afruar problemeve industriosociologjike. Përkrahësit e kësaj shkolle, reprezentuesi më i njohur i së cilës është sociologu amerikan Elton Mayo, mendojnë se pararendësja e saj *scientific management*, në mënyrë të gabueshme, pjesërisht e ka barazua socializimin funksional me efektivitetin, dhe pjesërisht ka potencuar në mënyrë të tepruar rëndësinë e funksioneve formale kontrolluese. Shkolla e vjetër e ka konsideruar të punësuarin si individ të izoluar, i cili reagon individualisht ndaj masave të udhëheqjes së ndërmarrjes dhe motivi i tij i vetëm për të punuar ka qenë i natyrës ekonomike. Duke e konsideruar të punësuarin në radhë të parë si anëtar të grupeve me karaktere të ndryshme u krijua mundësia që shkolla human relations të kthehet kundër teorive të shkollës së mëparme (scientific management). Kështu është bërë e mundur të tregohet rëndësia e madhe e punës së grupeve informale për sjelljet dhe reagimet e të punësuarit, dhe u është rekomanduar udhëheqjeve të ndërmarrjeve që të marrin masa për të rritur kënaqësinë në punë me qëllim të arritjes së gjendjes ideale "bashkëpunimit spontan". Shkolla human relations është kritikuar nga sociolog radikal për shkak se ajo bazohet në postulatin se interesat e punëtorëve dhe të udhëheqësve të ndërmarrjeve janë të pajtueshme. Kritikët mendojnë se human relations shkolla është në shërbim të udhëheqësve e pronarëve të ndërmarrjeve dhe u ndihmon atyre që metodat e vjetra të kontrollimit të zëvendësohen me moderne, dhe autoriteti formal të zëvendësohet me manipulim.

hypothesis *hipotezë*, supozim mbi lidhjen - mvarshmërinë në mes një variable të mvarur dhe një apo disa variablave të pamvarura. Rëndom mendohet se hipoteza duhet të testohet në mënyrë empirike, në mënyrë që ajo ose të pranohet ose të hidhet poshtë.

HYSENI ISMAJL, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ismajl Hyseni, 18 Rue Jean Jaqnet Ch.1201 Geneve-tel. 320975. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

HYSENI MASAR. Për rastin e Masar Hysenit ka shkruajtur Jusuf Gërvalla në Lajmëtarin e lirisë në janar 1981, në artikullin:

"*NJË AKT BARBAR, I ORGANIZUAR*

** Është bërë punë e vështirë të merret vesh me saktësi çkado që ka të bëjë me kriminelin nga Lëvosha e Pejës dhe me krimet e tij, sepse atë e mori nën mbrojtje qendra çetnike e Beogradit, duke ua hequr duarsh organeve të Pejës. Megjithatë ia kemi dalë të shtiem në dorë disa të dhëna.*

Nga të gjitha ato, që po fliten me të madhe në popull, e sigurt është sa vijon:

Më 19 tetor 1980 në Lëvoshë, fshat përmbi Pejë, një kriminel malazez shtiu mbi dy djelmosha shqiptarë, nga të cilët njëri mbeti vdekur e tjetri ia doli të ikë dhe ta informojë policinë për krimin e asaj dite. Viktimë e këtij gjahu çetnik në skalpe shqiptare qe 20 vjeçari Masar Hyseni nga fshati Sminë i Vitisë (i lindur më 1960), student i vitit të dytë në Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë.

Ditën kontestuese, Masari dhe moshatari, bashkëshkollari e bashkëvendasi i tij Osmani nga Sadovina e Vitisë, kishin dalë për një shëti të zakonshme në pyllin afër Lëvoshës. Osmani ecën pak përpara shokut dhe i teket të bëjë një vrapim në ajër të pastër, se qenka edhe sportdashës. Kur iu afrua një grupi shtëpish, dolën në rrugë ca fëmijë që e ngacmuan. Më tepër në shaka, ai i jep një shpullë njërit prej tyre, e fëmija ia merr një vaji të djallëzuar dhe duke qarë, hyn në njërën prej shtëpive. Menjëherë pas kësaj, shfaqet njeriu me dyfek. Osmani mbetet i habitur dhe nuk nxehet, se s'i merr mendja që sherri mund të dalë kaq i madh. Po krimineli i afrohet me tërbim dhe nis t'ia vërë dyfekun në gjoks. Osmani ia largon me një shkathtësi të madhe dhe ata kapen fyta fyt. Ndërkohë arrin edhe Masari që përpiqet t'i ndajë. Mirëpo në përleshje e sipër dyfeku i kriminelit vjell zjarr dhe e lë paluar Masarin. Osmani i tmerruar duke mos parë mundësi t'i rrëmbejë armën çetnikut dhe duke parë në sytë e këtij një etje të madhe për gjak, arrin të ik dhe ta informojë policinë e Pejës për ngjarjen tragjike.

Duke kërkuar, sipas udhëzimeve të Osmanit, Masarin e vrarë, organet e sigurimit hasin në afërsi të vendit të ngjarjes në një kufomë tjetër të një djaloshi, të vrarë kohë më parë, për të cilin krimineli i Lëvoshës do të pranojë më vonë në burgun e Pejës se e ka vrarë me dorë të vet, sikurse edhe Masarin." (Jusuf Gërvalla, Lajmëtari i lirisë, janar-shkurt 1981)

I

IBËRDEMAJ GANI, kryetar klubi në Munchen, Daja i vogël.

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen. Ibrahimi kritikon hapurazi si agjent dajën, por ka kontakte të vazhdueshme me djalin e dajës dhe,*

për sa mund të vërehet, edhe simpati ndaj tij. Ka provuar t'ia plotësojë këtij ***daje të vogël (Gani Ibërdemajt*** *- edhe lidhur me këtë njeri është dashur të jetë i informuar Profesori) dëshirën për t'u takuar me mua."* (Raport Komitetit të LNÇKVSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

IBISHI QERKIN, – Qerkin Ibishi gazetar i Rilindjes. Kundër mendimeve të tij, Jusuf Gërvalla e ka shkruar një artikull në Lajmëtarin e lirisë, janar 1981, me titull: Një variant leximi.

IBISHI NUHI – Nuhi Ibishi nga fshati Dërvar (Vushtrri) aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

IBM shkurtesë për **I**nternational **B**usiness **M**achines Corporation, është një ndërmarrje multinacionale në teknologjinë e informimit. Është themeluar më 1911 me bashkimin e tri ndërmarrjeve në Computing-Tabulating-Recording Company (C-T-R). Thomas J. Watson i cili u bë drejtor ekzekutiv i ndërmarrjes më 1914, ia ndryshoi emrin më 1924 në International Business Machines pra IBM.

Në shtator 1981, Jusuf Gërvalla e blen një makinë të modelit IBM Electronic Selectric Composer, me të cilin është radhitur Zëri i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, duke filluar prej numrit të parë, nëntor 1981. Nga prilli 1982 e deri në mars 1983 me këtë makinë punova unë Xhafer Durmishi-Skenderi. Prej marsit 1983 dhe më vonë (në Zvicër) nuk e di se deri në cilën kohë e numër është përdorë herën e fundit. Historinë e plotë të kësaj makine e kam trajtuar në një kapitull me titullin: *Stilografat e Jusuf Gërvallës.*

IBRAHIMI REXHEP, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Rexhep Ibrahimi Königes str. 81 Kaiserslautern. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

IBRAHIMI PAJAZIT, veprimtar në Australi. Përmes tij është vendosur kontakti në mes Lëvizjes së Jusuf Gërvallës dhe Shoqërisë Bashkimi Kombëtar "Bajram Curri" në Australi. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë postale: Pajazit Ibrahimi, P.O. Box 1119, N.T. 5797, Australia. Ka qenë një ndër pikat prej nga u shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

IBRAHIMI VEHBI, – Vehbi Ibrahimi, veprimtar i vrarë nga organet sekrete jugosllave më 10 tetor 1981 në Bruksel, Belgjikë. Gjatë kryerjes së atentatit në rrugë para banesës së tyre, përveç vrasjes së Vehbiut është plagosur rëndë gruaja e tij.

Iconoclasm me këtë fjalë fillimisht është menduar prishja, shkatërrimi i vizatimeve dhe statujave religjioze. Koncepti është zgjeruar dhe përfshin të gjitha sulmet kundër parafytyrimeve të rrejshme popullore.

Id në bazë të teorisë së psikoanalizës quhet ajo pjesë e strukturës së personalitetit që përfshin instinktet tek individi për të cilat ai është i pavetëdijshëm. Për Frojdin, fëmija me rastin e lindjes është një Id-organizëm i pastër. Me kalimin e kohës, nën ndikimin e mjedisit zhvillohet **ego** dhe **superego**, ndërgjegjja funksioni i së cilës është kontrollimi dhe frenimi i instinkteve. Kjo betejë në mes id dhe superego mendohet se bëhet në ego.

IDÉ (eidos ose idea, pamje, lloj, tufë vetish themelore) një prej fjalëve qendrore tek një radhë e gjatë filozofësh duke filluar prej antikitetit e deri në ditët tona. Nuk ekziston një vijë e përbashkët që do të mund të ndeshej në të gjitha kuptimet që i janë dhënë kësaj fjale.

1. Me fjalën ide Platoni shkurtimisht i përshkruan shkakun dhe esencën e *sendeve*. Gjithçka që paraqitet në hapësirë dhe kohë, ekziston për shkak se i përngjan ose është pjesë e një ideje. Idetë, të cilat janë të përjetshme dhe të pandryshueshme, janë të rregulluara në një hierarki, ku idetë që janë më së afërmi me sendet e veçanta janë më së poshti dhe një ide unifikuese është më së larti. Parafytyrimi i Platonit lidhur me atë se çka është një ide, nuk është i thjeshtë, i njëkuptimshëm. Në disa raste duket sikur ai një ide e kupton si koncept të përgjithshëm; e në disa raste tjera duket sikur me ide mendon në veti themelore shpirtërore, që ekzistojnë të pamvaruna nga sendet e veçanta. Mësimet e Platonit për idetë janë kritikuar nga nxënësi i tij Aristoteli, i cili këto mësime i zavendëson me teorinë për *formën* (eidos ose morfe) dhe *materien*.

2. Ne filozofinë e epokës së vonë të antikës dhe mesjetës, mendimet e Platonit mbi idetë janë zhvilluar më tej, në atë mënyrë që idetë janë kuptuar si mendime të *Zotit*. (Plotinos, Augustinus.) Nga këtu është zgjeruar kuptimi i fjalës ide për të përfshi, mbuluar procesin mendor lidhur me diçka që prodhohet. P. sh. zdrukthëtari e ka një ide lidhur me atë që ka ndërmend të prodhoj, para se prodhimi të kryhet. Gjatë epokës së skolastikës së lartë, është zhvilluar një diskutim lidhur me atë se mos lloj-llojshmëria e ideve ka ekzistua para Zotit dhe në këtë mënyrë këto paraqesin një thyerje të unitetit të Zotit, apo mos kjo lloj-llojshmëri e ka rrjedhën nga Zoti. (Bonaventura, Aquino, Duns Scotus, Ockham.)

3. Dekarti (Descartes) mendon se gjithçka që është objekt për vetëdijen paraqet ide. Kjo do të thotë se si lëndët abstrakte ashtu edhe ato për të cilat fitojmë përvojë me anë të shqisave janë ide. Ky përdorim i fjalës ide, që është një krijim i ri filozofik, e ka prejardhjen në përdorimin e rëndomtë që fjala e kishte marrë nga anglishtja dhe frengjishtja në vitet 1500. Në mesin e ideve, sipas Dekartit ka disa që posedojnë realitet objektiv. Këto janë ato ide të *lindura*, të cilat karakterizohen përmes asaj se ato kuptohen në mënyrë të qartë. Përdorimi i fjalës nga Dekarti jeton në pjesë të madhe tek filozofët pasardhës racionalistë dhe empiristë; por këto dy grupe filozofësh (racionalistët dhe empiristët) kanë teori të ndryshme se cila është lidhja *gnoseologjike* dhe *ontologjike* në mes atyre formave të ndryshme të idesë. Sipas Lajbnicit (Leibniz) është e mundur që të gjitha ideve t'u gjurmohet prejardhje prej ideve të lindura (ide të cilat individi i ka që nga lindja); ndërsa Lok (Locke) thotë se idetë tona janë të ndërtuara prej ideve të thjeshta, që e kanë prejardhjen për perceptimit të shqisave (pamjes, prekjes, dëgjimit e shijimit).

Berkeley dhe Hume e ekzekutojnë në mënyrë konsekuente propozimin e Lokut duke e kuptuar të gjithë njohurinë si konstruktime të thjeshta përshtypjes që na vijnë përmes shqisave.

Hume i jep fjalës ide një kuptim të ri dhe më të ngushtë. Pranimet direkte përmes shqisave ai i quan impresione (impressions), ndërsa fjalën "ide" (idea) ai i quan parafytyrimet (percepcionet) të cilat ne i kemi kur reflektojmë (mbajmë mend, fantazojmë) rreth përshtypjeve direkte.

4. Kanti e përdorë fjalën "ide" si përshkrim për ato principe që drejtojnë dhe rregullojnë dituritë dhe veprimet tona; por të cilave njëkohësisht nuk mund t'u vejmë etiketën (nuk mund t'i marrim si) realitet objektiv. Një princip i tillë quhet edhe si *transcendental ide*, një **ide e *arsyes*** apo **ide *regullative***. Kanti thotë p. sh. se ne kemi një ide për botën si tërësi e cila i drejton dituritë shkencore, dhe se ne kemi një ide për lirinë, që është baza për veprimet tona morale. Për këto ide nuk mund të kemi mbështetje nga përvoja e shqisave dhe për këtë arsye nuk kemi të drejtë të themi se këto ide paraqesin një realitet të pamvarur prej vetëdijes; por në të njejtën kohë ato (idetë) janë parakushte

të domosdoshme (transcendentale) si për dituritë shkencore ashtu edhe për veprimet morale.

5. Brenda *idealizmit gjerman* fjala "ide" përdoret sikurse tek Platoni për të paraqitur realitetin më të lartë. Por tek idealizmi gjerman *ideja* kuptohet si diçka që domosdoshmërisht duhet të shprehet përmes fenomeneve kohë-hapësirë. Ide – shpesh e quajtur *ideja absolute* – ekziston vetëm për atë se ajo paraqitet në hapësirë dhe kohë p. sh. në formën e fenomeneve natyrore, ngjarjeve historike, institucioneve apo veprave të artit. Në të njejtën kohë fenomenet hapësirë/kohë ekzistojnë vetëm në saje të asaj se hyjnë në një strukturë racionale.

6. Tek *pragmatizmi* merret në pranim ai përdorim që e kemi tek empiristët, por njëkohësisht potencohet lidhja e idesë (përshtypjeve nga shqisat) me jetën e veprimeve. Ky lloj përdorimi i fjalës "ide" arrin kulmin tek Dewey, i cili e kupton një ide si një rregull veprimi e cila është reaksion ndaj një perceptimi.

7. Në *fenomenologji* (sidomos tek Husserl) fjala "ide" dhe esencë përdoren si sinonime. Ideja apo esenca janë vetitë e domosdoshme tek një fenomen, të cilat nuk mund të largohen nga mendja e pa ia humbur fenomenit identitetin e vet.

Idealism 1. Drejtim filozofik që potencon se realiteti është i natyrës shpirtërore dhe jo i natyrës materiale. Përfaqësues për këtë pikëpamje në mes tjerëve kanë qenë Platoni dhe Hegeli,

2. Drejtim gnoseologjik, që potencon se një objekt nuk mund të ekzistoj pa një subjekt, se realiteti është i atillë ashtu siç kuptohet nga vetëdija njerëzore. Përfaqësuesit kryesor të kësaj pikëpamje kanë qenë filozofi anglez Berkeley dhe filozofi gjerman Immanuel Kant.

Ideal type *tip ideal* një instrument analitik që para së gjithash është zhvilluar nga Max Weber. Ideal-type është një përpjekje për t'i bartur modelet konceptuale të *nacional-ekonomisë* në fushën e modeleve konceptuale të sociologjisë. Një ideal-type nuk është ideal në pikëpamje statistikore por vetëm në kuptimin logjik. Vijat karakteristike të tipit potencohen edhe më shumë ndërsa ato që janë atipike injorohen. Ideal-type nuk është e domosdoshme të ekzistoj në realitet, por duhet patjetër të jenë të mundshme për t'u menduar, imagjinuar në mënyrë objektive. Ideal-type nga ekonomia-nacionale "konkurencë e plotë" nuk ka ekzistuar kurrë, por shërben vetëm si instrument analitik Në të njëjtën mënyrë Max Weber ka bërë me p. sh. "*burokracin*" dhe sociolog të tjerë p. sh. me "*sektin*". .

identification *identifikim* 1. mekanizëm mbrojtës, përmes të cilit individi mundohet t'i përngjaj një personi që e adhuron. Gjatë viteve të para të jetës së tij më së shpeshti personi i adhuruar është njëri nga prindërit, dhe gjatë asaj kohe identifikimi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e personalitetit, veçanërisht për zhvillimin e *superego*. Më vonë mundet p.sh. një artist filmi, i muzikës apo politikan të bëhet objekt identifikimi, dhe identifikimi në atë rast mund të shihet si kompensim për dështimet personale.

2. kur është fjala tek grupet, ndërmarrjet apo organizatat, mendohet në sjelljen e individit kur ai synimet dhe vlerat e grupit i bënë të vetat, kërcënimet ndaj grupit i konsideron kërcënime ndaj tij dhe sukseset e grupit i konsideron si suksese të veta.

IDEOLOGJI (eidos ose idea, ide, dhe logos, teoria, shkenca)

1. Fazat e para të diskutimit modern rreth ideologjisë mund të gjenden tek Bacon, në teorinë e tij mbi idolet (rreth vitit 1600) dhe tek *ideologët francez* (Destutt de Tracy dhe të tjerë, rreth vitit 1800), të cilët duke pasur si pikënisje psikologjinë dhe antropologjinë janë përpjekur ta kryejnë një hulumtim empirik rreth prejardhjes dhe zhvillimit të ideve.
2. Tek Marksi ka shumë kuptime rreth ideologjisë:
a) Në kuptim të gjerë thuhet se çdo teori apo botëkuptim është një ideologji, pasi ajo si një pjesë e "superstrukturës" kulturore është e përcaktuar nga një bazë ekonomike-sociale-materiale.
b) Në kuptim më të ngushtë një teori është shprehje e një ideologjie (apo "vetëdije të rrejshme"), nëse ajo pjesërisht thotë diçka false për realitetin dhe pjesërisht me këtë i shërben si mjet shtypës në duart e një sistemi shoqëror. Njëkohësisht Marksi mendon se përmes një kritike të ideologjisë është e mundur të demaskohet funksioni i saj shtypës, sa mund të thuhet se ideologjia tregon diçka më tepër se vetveten.
3. Në debatin modern, aty ku ka pajtim me Marksin kur me ideologji mendohet një teori false mbi botën, mund të dallohen dy tendenca kryesore:
a) Ata që thonë se një ideologji mund të mundet dhe zavendësohet me një teori shkencore apo veprim të bazuar shkencor (p. sh. racionalizmi kritik i Poperit dhe pjesërisht Althuser dhe Habermas);
b) Ata që i bashkohen kuptimit dialektik të ideologjisë, sipas të cilit ideologjia është një veti e pashmangshme tek çdo veprimtari mendore (*thinking*) (p. sh. Adorno).
4. Në një kuptim filozofik neutral fjala ideologji përdoret nganjëherë vetëm si sinonim për fjalët "teori", "botëkuptim politik" ose "botëkuptim religjioz".

Përgjithësisht me ideologji mendohet një grumbull, përbërje parafytyrimesh-besimesh, pjesërisht lidhur me atë se si **është** apo si **duket** realiteti dhe pjesërisht me atë se si do të **duhej** të ishte ai. Ideologjitë u ofrojnë individëve dhe grupeve një shpjegim të thjeshtësuar për fenomene sociale komplekse dhe u japin udhëzime në udhëkryqe të ndryshme të karakterit social apo politik. Marksi ka thënë se ideologjitë që janë në interesin e klasave sunduese e krijojnë një "vetëdije të rrejshme" tek anëtarët e shoqërisë mbi natyrën e vërtetë të saj (shoqërisë). Karl Marksi, sistemin e tij teorik nuk e ka konsideruar ideologji, por e ka përdorë emërtimin socializëm shkencor. Një definicion të ngjashëm të ideologjisë e ka gnoseologu gjerman Karl Manheim, i cili ato teori që janë në shërbim të pushteteve i quan ideologji, dhe ato teori që kërkojnë ndryshimin e gjendjes ekzistuese i quan utopi. Gjatë viteve të fundit, para së gjithash në ShBA, ideologji përdoret në kuptim të ngjashëm me atë që Manheim i ka dhënë utopisë, por me një vlerësim negativ. Me ideologji, para së gjithash janë menduar botëkuptime që qëndrojnë pas sistemeve politike totalitare, duke përfshi këtu edhe *marksizmin*.

image në kuptimin sociologjik një parafytyrim i përgjithshëm, i shpërndarë dhe i njohur rreth vetive të një personi apo të një objekti. Objekti, p. sh. mund të jetë një markë e automobilave, parti politike ose ndërmarrje. Image (imigji) i një politikani mund të jetë p. sh. se ai është zhdërvjellët, dinak, i pabesë, modern, gjakftohtë etj.

IMERI ISMAIL, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ismail Imeri, P.O.Box 511 Lisle Ilinois 60532 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

immigration *imigrim* Përveç kuptimit të rëndomtë të termit imigrim, ai e ka një kuptim më të veçantë, si një prej katër llojeve të *migrimit* të përshkruara nga Henry Pratt Fairchild në librin e tij *Immigration: A World Movment and Its American Significance* (1925). Me imigrim Fairchild mendon në shpërngulje paqësore të popullsisë prej një rrethi në një rreth tjetër me një nivel kulturor të njëjtë. (*invasion, kolonizim, pushtim)*

implicit culture botëkuptimet, vlerat, atitydat dhe *mekanizmat mbrojtës* në një shoqëri. Kultura implicite është përcaktuese për kulturën eksplicite (*explicite culture)* në një shoqëri. Botëkuptimet religjioze janë pjesë e kulturës implicite, ndërsa ceremonitë religjioze janë pjesë e kulturës eksplicite.

indirect questions lloje pyetjesh gjatë intervistave, kur ka arsye për të dyshuar se pyetjet direkte kishin me dhënë përgjigje jo të besueshme, p. sh. pyetje që kanë të bëjnë me çështje prestigji. Lloji më i rëndomtë i pyetjeve indirekte janë pyetjet projektive. Kështu p. sh. një individ në vend që ta pyetësh; Sa shpesh e lexon rubrikën e redaktorit politik të një gazete qendrore, ai mund të pyetet: Çka ta merr mendja sa shpesh e lexojnë njerëzit në përgjithësi rubrikën e redaktorit politik të një gazete qendrore. Me fjalë tjera me anën e kësaj teknike vërtetohet se në çështje të ndjeshme apo ndoshta edhe në përgjithësi, karakterin e vërtetë dhe thellësinë e shpirtit të vetë dikush e zbulon më së shumti në bazë të asaj se çka thotë për të tjerët dhe jo për vete.

induction *induksion* metodë për ardhje tek konkluzioni, sipas të cilës në bazë të disa rasteve, fjalive vihet në disa përgjithësime duke u nisur nga vrojtimet e bëra në disa raste të veçanta. P. sh. nëse individët a, b, c, d, e dhe j në një grup e kanë një veti, atëherë supozohet se të gjithë individët e atij grupi e kanë atë veti. Një konkluzion induktiv nuk ka precizitet të fuqishëm, vlershmëri të fuqishme logjike, por vetëm më shumë apo më pak probabilitet, i cili rritet me numrin e vrojtimeve të bëra.

industrial sociology studimi i grupit të punës si njësi sociale dhe i relacioneve sociale brenda grupit të punës duke përfshi këtu edhe relacionet në mes udhëheqjes së ndërmarrjes, nëpunësve dhe punëtorëve. Në një nivel më të lart (nivel makrosociologjik) mendohet në studimin e institucioneve industriale dhe raportin e tyre me institucionet tjera në shoqëri.

infinite universe një univerzum që ka aq shumë njësi, ku numri ekzakt i tyre nuk dihet ose numri i tyre është i pambarim.

informal control metoda ndërpersonale për të ndikuar tek individët që të respektojnë normat e grupeve të tyre. Metodat mund të kenë formën e kritikës së hapur, thashetheme, nofka negative, tëhuajtje (ostarcism), përqeshje etj.

informal structure vija kontaktesh dhe relacionesh brenda një organizate formale (*formal organisation*), që nuk janë zyrtarisht të njohura apo të përfshira në planin organizativ.

ingroup një grup me të cilin një individ identifikohet.

inner-directed koncept i krijuar nga sociologu amerikan David Riesman në *The Lonely Crowd* (1950). Një individ është inner-directed nëse sjellja e tij drejtohet kryesisht nga

baza e sistemit të tij të vlerave, dhe në një shkallë më të ulët nga pikëpamja e tij se çfarë mund të pret, apo çfarë shpresash ka mjedisi në te. Ky tip i njeriut, mendon Riesman, ka qenë dominues prej renesansës dhe reformacionit në shoqërinë perëndimore dhe tek gjatë decenieve të fundit është zëvendësuar në një tip njerëzor të llojit *other-directed*.

innovation 1. diçka e re, diçka që dallohet prej praktikës ekzistuese, një përshtatje ndaj një situate të ndryshuar.

2. Një kuptim më të veçantë e ka termi si një prej pesë metodave për përshtatje në një shoqëri anomike (*anomic society*). Sociologu amerikan Robert Merton e përshkruan në "*Social Theory and Social Structure*" (1949) ShBA si një shoqëri në një gjendje anomike, ku qëllimi më i lartë kulturor është arritje e suksesit sidomos në pikëpamje ekonomike, në të njejtën kohë kur mjetet e aprovuara nga shoqëria për ta arritur këtë qëllim janë krejtësisht të pamjaftueshme për shtresat (strata) e ulëta të shoqërisë. Inovacioni, sipas Merton, është një mënyrë për ta arritur qëllimin duke përdorur metoda, të cilat nuk janë të sanksionuara nga shoqëria. Se kriminaliteti është më i lartë tek shtresat e varfra në ShBA se sa tek shtresat e varfra në Evropë, Merton e shpjegon përmes nocioneve anomi dhe inovacion. Të varfrit në Evropë janë po aq të varfër sa edhe në ShBA, por kulturat evropiane nuk ia japin të njejtën peshë suksesit ekonomik.

input në kuadrin e teorisë së grupeve të vogla ai ndërveprim i një individi në një grup ndaj të tjerëve për dallim nga ***output***, ai ndërveprim që drejtohet ndaj tij.

instinct *instinkt* predispozicion i lindur për të kryer disa veprime komplekse. Koncepti instinkt në fillim të viteve 1900 ka qenë koncept qendror në psikologji, kur pothuajse çdo sjellje njerëzore është shpjeguar me instinktin përkatës, p. sh. ikja është shpjeguar me instinktin e ikjes (nga rreziku), dëshira për ta kaluar kohën në shoqëri me të tjerët si instinkt i kopeizmit e kështu me radhë. Tani ky koncept më shumë përdoret nga psikologët e shtazëve.

Instituti për Shfarosjen e Shqiptarëve

Jusuf Gërvalla: "*Ti krerëve kosovarë, sikur t´u kishe dhënë të pinë hashash, ua mbushe gushën, dhe po i tërhek për hunde e po i sjell për kërpeshi si gjënë e gjallë në mazgjah, pasi ua ke topitur mirë ndjesitë me forcën e metodave të hartuara e të studiuara në **Institutin për Shfarosjen e Shqiptarëve**, në Beograd, dhe tash s´ke si të frikësohesh se të dalin dore vasalët."*

"Metodat e tua të shfarosjes, të ka shkuar mendja, do të arrinin shpejt e shpejt efektin që s'e arritën dot me shekuj metodat romake, bizante, turke: asimilimin apo shfarosjen e shqiptarëve. (Kush kanë qenë romaku, bizanti, turku në krahasim me fuqinë tënde!)." (Letër e hapur J. B. Titos, janar 1980, Bashkimi, shkurt faqe 1)

Jusuf Gërvalla: *"Gjithë kjo është edhe një dëshmi e vrazhdë se pushteti antipopullor jugosllav jo vetëm që s'qanë kokë për mirëvajtjen e popujve të Jugosllavisë, por ai vepron me plane të caktuara për shfarosjen sa më parë sidomos të njërës nga kombësitë që jetojnë brenda kufijve të saj politikë: për shfarosjen e shqiptarëve, që janë vendësit e vërtetë të këtyre trojeve.*

Por, megjithatë, populli shqiptar është mësuar me vështirësi ndër shekuj, ndër shekuj u ka bërë ballë përpjekjeve barbare për shfarosjen e sojit të tij. Mbetet mundësia

për një pyetje të vetme: Kush mund ta quaj të njerëzishme dasmën e barbarit përmbi kufomën e njeriut të stërmunduar dhe, kur një shoqëri, më mirë një sistem si ai jugosllav, e bazon zhvillimin e vetë në dinakërinë dhe në qyqarinë më të poshtër për të cilën mund të dëgjoj njeriu, a duhet të brengosemi ne për vete që po heqim kaq keq por duke pritur ditë të lumtura, apo vetë Jugosllavia e cila ia ka mihur vetvetes themelet me pushtetin e vet të egër dhe të cilën po e pret varri i sigurt?

(Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, shkurt 1980, faqe 2)

Jusuf Gërvalla: *"I pakti prej nesh nuk është bindur ende për ekzistimin e* ***Institutit për Shfarosjen e Shqiptarëve*** *në Beograd, i cili ka themele të forta - gjithë pushtetin e revizionizmit titist. Prandaj është e natyrshme vështirësia e madhe në të konsoliduar të të gjitha forcave revolucionare të shqiptarëve në Jugosllavi.*

Për të parë këtë vështirësi, duhet domosdo t´ia bëjmë një analizë, qoftë edhe të supozuar, ***Institutit*** *në fjalë. Ja në pika të shkurtra, një analizë e tillë, duke u mbështetur në imagjinatën kreative të një shkrimtari, shkrimtar, i cili në veprat e veta ka grumbulluar artistikisht edhe vërtetësi të madhe dialektike e historike, të shkoqur nga përvoja e popullit tonë.*

1. Zhdukja fizike e rebelimit. - Sipas fjalëve të shkrimtarit tonë, ideja e rebelimit thyhet me anë të luftës. E ne e dimë: gjatë luftës së fundit, ndonëse populli shqiptar luftoi krah për krah me popujt e Jugosllavisë për dëbimin e armikut të përbashkët, fashizmit, dredhia sllave ua hëngri kokën bijve më të mirë shqiptarë, si Emin Duraku, Hajdar Dushi e sidomos Shaban Polluzha, që ia kishte ndier erën tradhtisë së madhe ndaj shqiptarëve.

2. Zhdukja e idesë së rebelimit. - Masa e dytë, të cilën e ka gjithmonë ndërmend çdo institut i pushtuesit që merret me planet e shfarosjes së popullit të pushtuar, është masa për zhdukjen e idesë së rebelimit. E ne dimë: gjithë ç'mund t´i jepte shenjë shqiptarit për rebelim, duke u nisur nga grupet dhe organizatat më të vogla politike në Kosovë, u shua, ose u bënë përpjekje të shuhet, nga ana e Sigurimit Shtetëror Jugosllav, që nga lufta e këtej.

3. Zhdukja ose gjymtimi i gjuhës, artit, zakoneve. - A e dimë ne luftën tonë të vështirë, në fillim për ta ruajtur gjallë gjuhën tonë (së pari na thoshin se gegërishtja s´paska lidhje me toskërishten), e pastaj për t´i siguruar asaj edhe jetën në shkolla, fakultete, dhe më në fund edhe në administratën e Krahinës sonë, në të cilën popullsia shqiptare përbën tetëdhjetë për qind (ndërsa të tjerët erdhën si kolonistë), kurse gjithë të tjerët së bashku njëzet për qind të popullsisë. Po arti, kultura? A s´duhet domosdo, t´i nënshtrohen edhe këto, me dhunë, një fryme dhe një vije rigoroze jugosllave, megjithëqë me artin dhe me kulturën e sllavëve të jugut nuk kanë asgjë, ama asgjë të përbashkët?

4. Zhdukja dhe dobësimi i kujtesës kombëtare. - Flamurin kombëtar, Jugosllavia na e ndaloi -në emër të internacionalizmit proletar (!) më 1946. Vjershat dhe përgjithësisht veprat e shkrimtarëve shqiptarë na i ndaloi, e në to ishte e mbledhur e gjithë e kaluara jonë kombëtare: pra duhej të harronim gjithë c´kishte të bënte me shqiptarët, se ne ishim bërë "jugosllavë" (sllav të jugut?). Na u ndalua kujtimi i fytyrave më të ndritshme të historisë sonë kombëtare. Por ngulëm këmbë dhe diçka nga këto nxorëm me dhunë. Por, doli vjet një tradhtar (e të tillë si ky ka edhe ca), me emrin Fadil Hoxha, dhe ky tradhtar e pa historikisht të nevojshme të mbante disa mitingje, nga Gjakova deri në Istog, duke predikuar pa pikë turpi: Kush është Mic Sokoli, që më janë kapur për Të, të rinjtë kosovarë; kush ishin Shota dhe Azem Galica? Ata ishin komita dhe asgjë tjetër (mos qoftë thënë me gojën tonë!). Më heret ai ka pas thënë: `Adem Dema-Demaçi është një hejn që nuk e njeh as mahalla e vetë"! Pra vetëm Fadili me kompani (Fadil&Co), që tradhtuan popullin e vet dhe po i shërbejnë qe dyzet vjet gjakpirësit më të poshtër sllav, po na delkan "hero". Trimat legjendarë shqiptarë, që luftuan për

bashkimin e tokave shqiptare, madje duke ia vënë gjoksin grykës së topit, ata nuk qenkan gjë. Kështu do të thotë renegati Fadil. Dhe shton: Kush është Eqrem Çabej, kush është Ismail Kadare? Dhe ua vë përballë Idriz Ajetin dhe Azem Shkrelin, thua se rinia, pse dashka shumë dy të parët, që janë figura të shquara në gjithë historinë e kulturës shqiptare, nuk i dashka edhe Idrizin e Azemin. Ose thotë Fadili: ç'kanë të rinjtë që dalin në koncerte të veshur me tirq, me xhamadana, me plisa të bardhë?

Të gjitha këto, sipas mendjes së Fadilit, të cilën ia kanë injektuar në kokë si hashashin atje në ***Institutin për Shfarosjen e Shqiptarëve*** *në Beograd, u dashka të harrohen!*

5. Përçaj e sundo. -Kjo është formula më e dashur e pushtuesve të të gjitha kohëve, që u kursen mund dhe u jep shumë rezultat në vendet e pushtuara. A e dimë se në çfarë shkalle të tmerrshme ka arritur në viset shqiptare të robëruara nga Jugosllavia gjaksimi i vëllaut me vëlla? E dimë. Por, kemi në këtë mes edhe një manifestim të ri të kësaj formule: sa më shumë pasiguri e mosbesim politik ndërmjet shqiptarëve përparimtarë, në mënyrë që të mos arrijnë të konsolidohen!

Dhe pikërisht kjo pjesë e kësaj formule sot është shumë aktuale për forcat revolucionare të shqiptarëve brenda kufijve politikë jugosllavë. Ekzistojnë shumë grupe e organizata, që të gjitha me një qëllim të vetëm, madje me një ide të vetme edhe për mënyrën e sendërtimit të këtij qëllimi (jo zogistë, ballistë… po vetëm komunist, marksist-leninistë që pranojnë vetëm pikëpamjet e një vendi të vërtetë socialist, siç është Shqipëria), por gjithë këto grupe e organizata e patën vështirë t'i shplohen shoqja-shoqes dhe t'i bashkojnë armët, sepse armiku pat infiltruar në radhët e tyre një armatë agjentësh." (Letër lexuesve, Bashkimi, shkurt 1980, faqe 2)

Jusuf Gërvalla: "*Dhe, në një heshtje të rëndë, populli ynë ka zënë të evokojë fuqishëm këngën e të shpëtuarit, i cili duhet ta marrë pashmangshëm gjithë çështjen e fatit të vet në duart e veta.*

Dhe Beogradi, i çuditur për paaftësinë e ***Institutit të vet për Shfarosjen e Shqiptarëve****, klithi:*

Ç'bënte (ky Institut) që linte përmbi dhe akoma legjenda të tilla?" ...

"Është e mundshme që shqiptarët të zmbrapsen vetëm me anë të kolonizimit gradual, – ankohej Dr. Çubrilloviqi, – ky është i vetmi popull që arriti jo vetëm të mbahet gjatë mijëvjeçarit të fundit në bërthamën e shtetit tonë... por edhe të na sjellë dëme, duke shtyrë kufijtë tanë etnik (kupto: Serbisë) në drejtim të veriut dhe të lindjes... E vetmja mënyrë dhe i vetmi mjet është forca brutale e një pushteti të organizuar shtetëror, e pushtetin mbi ta e kemi pasur gjithmonë." (Ç'thonë kronikat e vjetra dhe të rejat?, Bashkimi, prill 1980, faqe 5)

Jusuf Gërvalla: *"Armiku e kishte shkollën. Dhe, megjithëqë shkolla është për ndriçimin e mendjen së një populli, natyrisht në kushte normale, dhe jo për shfarosjen e popullit tjetër, armiku ynë ka hequr më shumë keq se si ta shfarosë shqiptarin se sa për ta përparuar popullin e vet.*

Edhe kralët e moçëm jugosllavë, edhe këta të sotmit; revizionistët e Beogradit, kanë hapur shumë institucione "shkencore" si Ozna, UDB-ja etj., që kanë për qëllim të mbledhin informata lidhur me shqiptarët, për të gjetur pikat më të dobëta në qëndresën e tyre ndaj asimilimit dhe gjenocidit. Në këto institute kanë shërbyer e shërbejnë edhe njerëz të shquar nga jeta politike dhe shoqërore e Jugosllavisë, si shkrimtari nobelist Ivo Andriq, historianët Vasa Qubriloviq, Atanasije Urosheviq etj. "Merita" e tyre konsiston në hartimin e elaborateve të ndryshme dhe të studimeve të errëta lidhur me mjetet, metodat dhe mundësitë për ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Serbisë e Italisë, ndërmjet

*Serbisë e Greqisë, ndërmjet dreqit e të birit, dhe për shfarosjen e shqiptarëve të Kosovës me viset e tjera shqiptare përkëndej kufirit kombëtar shqiptar." (*Langonjët në gjah pa zotërinë, Bashkimi, janar 1981, faqe 5)

Jusuf Gërvalla: *"(Trojet shqiptare në të kaluarën qenë bërë objekt preokupimi jo vetëm për Fuqitë e Mëdha. Në radhë të parë fqinjët e Shqipërisë, në Ballkan po edhe përtej Adriatikut, bënin kombinime se kush do të merrte më shumë nga tokat shqiptare. Për këtë atyre u jepte dorë atmosfera militariste e kapitalizmit dhe e imperializmit, me fashizmin gjerman e italian, i cili po bëhej gati për ta shpërthyer Luftën e Dytë Botërore. Në koniukturat e kohës kurrë nuk la pa u përzier as Jugosllavia, kur ishte fjala për grabitjen e tokave shqiptare dhe për shfarosjen e popullit shqiptar, qoftë në shtetin tonë kombëtar, qoftë jashtë kufijve të tij. Këtu po sjellim një pjesë të elaboratit të Ivan Vukotiqit lidhur me Shqipërinë dhe shqiptarët e për nevojat e qeverisë jugosllave të Stojadinoviqit, hartuar më 1939.)"* (Kreatori i robërisë, Bashkimi, janar 1981, faqe 5)

Jusuf Gërvalla: "*Dhuna, terrori, shpërnguljet në masë, djegia e fshatrave dhe e qyteteve shqiptare kishin për qëllim realizimin e planit shtetëror jugosllav për shfarosjen apo asimilimin e plotë të shqiptarëve, të cilët atëbotë qenë bërë prag i pakapërcyeshëm për daljen e Serbisë në Detin Adriatik dhe përgjithësisht për apetitet pansllave të monarkive të Serbisë dhe të Malit të Zi, më vonë Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.*

Megjithatë, që nga viti 1912 e këtej, megjithë zhdukjen e madhe fizike të shqiptarëve, nëpërmjet masakrave, vrasjeve dhe shpërnguljeve, në viset e robëruara shqiptare kurrë nuk ndërroi dukshëm fizionomia e tyre etnike: numri i shqiptarëve në këto vise mbeti gjithmonë numër dominant i popullsisë së përgjithshme në të gjitha regjistrimet e popullsisë që janë bërë deri më tash në Jugosllavi. (Në punimet historiografike dhe demografike, që po dalin kohëve të fundit ndër ne, vërehet vazhdimisht mekanizmi jugosllav për fshehjen e numrit të vërtetë të shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta, me qëllim që fizionomia etnike e tokave tona të ndërrojë rrënjësisht me kalimin e kohës.) Edhe sot, shqiptarët paraqesin shumicën dërrmuese të popullsisë, deri në 80 e 98 për qind, në pjesën më të madhe të tokave shqiptare në Jugosllavi.

As Mbretëria e SKS dhe as Jugosllavia e Titos nuk hoqën dorë asnjëherë prej aspiratave shoviniste ndaj popullit shqiptar. Si njëra si tjetra merrnin përsipër kultivimin e kombeve dhe të kombësive që jetojnë brenda kufijve të tyre politikë. Se kjo gjë lypsej, së paku formalisht, me raportet e rregulluara në shkallë ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Jugosllavia, qe 68 vjet, u shtrëngua që, në trajtë kompensimi për shkeljen brutale të të drejtave legjitime të shqiptarëve, të zhvillojë në mënyrë permanente dhe me mundim të konsiderueshëm një mekanizëm të gjallë të propagandës së konsumit të brendshëm, jugosllav dhe të konsumit ndërkombëtar. Siç është fare e natyrshme, Jugosllavia e sotme, duke ruajtur dhe dukje çuar një hap më tej aspiratat shoviniste ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe duke qenë në anën tjetër e shtrënguar t'i thellojë e t'i arsyetojë më shumë se e djeshmja këto aspirata, mjetet për shfarosjen dhe për asimilimin e shqiptarëve i ka përsosur dukshëm, në përputhmëni me situatën në vend dhe në botë." (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, artikulli i parë në faqet 1 e 2)

Jusuf Gërvalla: "*Deri sa ne na kanë zhdukur masivisht si "ballistë" dhe deri sa kemi duruar urie, deri sa ne kemi shikuar me sedër të vrarë kombëtare si zbret dhe si na ndalohet flamuri shqiptar me të cilin i kishim çliruar tokat tona, deri sa nga vatrat tona të dashura na kanë dëbuar me tortura e shantazhe, me një fjalë, gjithë kohën që ne kemi shijuar mjetet më të egra të gjenocidit nga ana e social-shovinistëve titistë, i vetmi satisfaksion për ne ka qenë forcimi dhe zhvillimi i mbarë Shqipërisë nënë dhe denoncimi nga ana e saj i të zezave të zbrazura me rrebesh mbi kokën tonë. Dhe në vend të ndjenjës*

së braktisjes nga Shqipëria nënë (këtë ndjenjë provoi një kohë të gjatë ta injektonte në ne gënjeshtra e ligë titiste), qenien tonë e mbushi ndjenja e fuqishme se nuk jemi vetëm dhe ka kush na del zot, ka kush e davarit mjegullën, me të cilën titistët menduan ta mbështillnin historinë tonë të vërtetë dhe planet e tyre shtetërore për shfarosjen e shqiptarëve." (Me sy e zemër nga Nëna Shqipëri, Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 3)

Jusuf Gërvalla: "*Në kohën që Atdheu ynë, Shqipëria iu rrek konsolidimit të shtetit shqiptar, të rifituar me gjak pas afro pesë shekujsh, në viset shqiptare që mbetën jashtë shtetit filloi shfrytëzimi më i egër i pasurive dhe popullsisë nga pushtetet e huaja serbe, malazeze e greke. Dokumente të kohëve të shkuara e të sotme provojnë në mënyrë të pakundërshtueshme një shtypje barbare të shqiptarëve, e cila pasqyrohet në shfrytëzimin e pasurive tona natyrore, në shtypjen e traditës së popullit tonë deri në zhdukjen e saj,* ***me qëllim të fundit, shfarosjen e plotë të shqiptarëve*** *që mbetën në robëri nën pushtetet përkatëse*." (Më të fortë se kurdoherë, Lajmëtari i lirisë, janar 1981, faqe 2-3)

Jusuf Gërvalla: *"Mësimi i parë që duhet të nxjerrim ne nga situata e krijuar është se qeveria e Beogradit s'para heq dorë nga aspiratat pushtuese e kolonializuese, nga mjetet për* ***asimilimin dhe shfarosjen e popullit shqiptar në Jugosllavi****. Dhe jo vetëm kaq, por ajo nuk ka reshtur së menduari edhe për shkatërrimin e Shqipërisë së pavarur."* (T'i japim shtytje të re luftës, *Zëri i Kosovës*, faqe 1)

Jusuf Gërvalla: "*Deri sa ne kemi duruar urinë, deri sa ne kemi shikuar me sedër të vrarë kombëtare si zbret dhe si ndalohet flamuri shqiptar, deri sa nga vatrat tona na kanë dëbuar me dajak, me presion e shantazhe dhe deri sa na kanë vënë në tortura të pashembullta, gjithë kohën që ne kemi shijuar mjetet të gjenocidit nga ana e socialshovinistëve serbo-malazezo-maqedonas, i vetmi satisfaksion për ne ka qenë forcimi dhe zhvillimi i mbarë i Shqipërisë mëmë dhe denoncimi i hapët nga ana e PPSH i të zezave të zbrazura me rrebesh mbi kokën tonë. Dhe, në vend të ndonjë ndjenjeje të braktisjes nga Shqipëria mëmë (këtë ndjenjë provoi një kohë të gjatë të injektonte në qenien tonë kombëtare gënjeshtra e ligë titiste), qenien tonë e mbushi ndjenja e fuqishme se ka kush na del zot dhe kush e davarit mjegullën historike, me të cilën titistët donin të mbështillnin historinë tonë të vërtetë dhe planet e tyre shtetërore për shfarosjen e shqiptarëve. Të shtypur në pikëpamje ekonomike, sociale, nacionale e kulturore me breza të tërë intelektualësh e revolucionarësh të asgjësuar fizikisht nga pushtuesit serbo-malazezo-maqedonas, pa institucione dhe literaturë të përshtatshme, nga do të rridhnin informata e njohuri, në bazë të të cilave do të mund të hetohej aktualiteti politik ndërkombëtar dhe çështja jonë jetike, aktivitetin e djalërisë patriotike shqiptare në këtë pjesë të robëruar të atdheut tonë e karakterizonte një kohë të gjatë vetëm instinkti kombëtar dhe entuziazmi i pashuar*." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980)

Jusuf Gërvalla: "*Mendoj se në revistën tonë duhet të bëjë vend sa më shpejt një artikull mbi marrëdhëniet shqiptaro-serbe në periudha të ndryshme. Qëllimi është që të shihet kontinuiteti i aspiratave pushtuese, kolonizuese serbe dhe shovinizmi i tyre, që shkon deri në dëshirën për shfarosjen e plotë të popullit shqiptar. Si literaturë bazë mund të shërbejnë disa punime të Sadulla Brestovcit në "Gjurmime Albanologjike", librat e Shukri Rahimit "Vilajeti i Kosovës" dhe "Lufta e shqiptarëve për autonomi 1897 – 1912", libri i Z. Canës "Lëvizja kombëtare shqiptare 1908 – 1912", ai i D. Tucoviçit "Serbia dhe Shqipëria", i Kosta Novakoviçit " Politika e Serbisë në pushtimin dhe serbizimin e Kosovës"(për titullin e këtij të fundit nuk jam krejtësisht i sigurt në është i saktë), libri i Shaban Brahës "Idriz Seferi " etj. Tema duhet të shtjellohet nga një historian i rryer, së pari për nevojat e revistës e pastaj, nëse zgjerohet, mund ta nxjerrim*

edhe si broshurë a libër. Unë do të përpiqem nga ana ime të gjej njeri të tillë, por edhe më shumë të përpiqeni ju andej. Ideale do të kish qenë sikur përmes Plakut, materiale të tilla me peshë të mund të siguroheshin në rrugën nëpër të cilën më kanë arritur këtu paratë e mbledhura për makinë." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 275)

institution *institucion* një sistem permanent, stabil dhe i organizuar i sjelljeve, që mirëmbahet dhe ka mbështetjen e shoqërisë, që ka për qëllim t'iu shërbej disa funksioneve sociale që konsiderohen të rëndësishme për mbijetesën e shoqërisë. Institucionet si familja, sistemi politik dhe religjioni gjenden në shumicën e shoqërive.

institution of contract term i cili përdoret për të përshkruar rregullat, normat dhe sanksionet që i përcjellin marrëveshjet përmes kontratës në një shoqëri. Ky tip i institucionit është trajtuar në hollësi nga pos të tjerëve Durkheim dhe Parsons.

institutionalization *institucionalizim* proces që ka domethënien e formalizimit dhe standardizimit të sjelljeve sociale, të cilat konsiderohen të domosdoshme për arritjen e synimeve sociale të rëndësishme dhe për të krijuar procedura kontrolli të rregullta në një shoqëri. Si shembull i kësaj janë negociatat e përcaktimit të pagave në vendet skandinave.

institutional adjustment ndryshime në funksionet e institucionit me qëllim për ta përshtatur institucionin ndaj situatave të reja. Një shembull për përshtatje institucionale është zgjerimi i aktivitetit të disa kishave p.sh. përmes sindikatave katolike dhe kufizim në disa drejtime tjera, p. sh. ndikimi gjithnjë e më i vogël i shumë kishave në fushën e arsimit.

institutional fiction një parafytyrim i përgjithshëm tek anëtarët e një grupi apo organizate se grupi i tyre është diçka më shumë se anëtarët dhe pasuria, të cilat për momentin e përbëjnë atë. Grupi apo organizata konsiderohen si njësi mbi-individuale. *Fiktioni institucional* shfaqet pjesërisht për shkakun se individët në percepcionin e tyre duan të organizojnë *gestalter* apo tërësi nga vrojtime të veçanta, dhe pjesërisht për atë se individët kanë nevojë të identifikohen me objekte që u japin kënaqësi. Grupet dhe organizatat të cilat shpesh japin shkak për *institutional fiktion* janë pos tjerash universitetet e vjetra dhe klube të llojeve të ndryshme.

institutional role një sjellje e individit të cilin shoqëria apo të tjerët e presin prej atij që e ka rolin e caktuar, p. sh. roli si nënë, mjek apo politikan. Sjellja në rolin e caktuar nganjëherë është e përshkruar në formë ligjore, dhe devijimet nga sjellja e pritur dënohen me mjete ligjore, e nganjëherë vetëm nga sistemi i normave të shoqërisë, dhe në atë rast dënimi është informal. Një burrë apo grua e martuar, p. sh. pritet që të jen monogam por devijimet më së shpeshti nuk dënohen në mënyrë formale.

institutional system një grupim i disa institucioneve që afër njëri tjetrit përbëjnë një sistem më të madh. Ekonomia p. sh. mund të konsiderohet si sistem institucional, me njësit si bankat, tregun e aksioneve etj.

instrumental act sjellje që ka për qëllim që ta drejtoj grupin apo individin më afër një synimi të deklaruar. Në bazë të *Bales-shemës së ndërveprimit* akte të tilla janë; të

propozosh, të kërkosh propozime, të japësh pikëpamje, të kërkosh pikëpamje, të jepësh informata dhe të pyesësh për informata.

instrumentalism 1. drejtim filozofik që e ka prejardhjen nga filozofi amerikan **John Dewey**. Me instrumentalizëm mendohet, se sasia e vërtetësisë së një ideje qëndron në aftësinë e saj për të dhënë udhëzime për veprime praktike, të cilat mund të sjellin tek plotësimi i nevojave në mënyrë të kënaqshme.
Sa i përket historisë se lëvizjes punëtore ndërkombëtare John Dewey, me angazhimin e tij (në kohën kur i kishte 80 vjet) në rastin e Leo Trockit kundër akuzave të Stalinit, është një ndër figurat më të nderuara intelektuale që ndonjëherë kanë jetuar në Perëndim.
2. E njejtë me *operationalism*.

instrumental leader ai lider i grupit funksioni i të cilit është për ta udhëhequr punën e grupit drejt qëllimit të shpallur.

instrumental orientation Orientimi i një grupi është instrumental, kur grupi kryesisht është i angazhuar për arritjen e disa qëllimeve të caktuara, dhe aktiviteti i tij sillet kryesisht në bashkangjitje të arritjes këtyre qëllimeve. Qëllimi, p. sh. për një grup pune mund të jetë produktiviteti i lart, dhe aktivitetet e tij sillen rreth këtij problemi, që duhet të zgjidhet për t'u arritur qëllimi.

integration *integrim* proces social me domethënien, se njësi të ndryshme dhe të ndara të cilat qëndrojnë përball njëra-tjetrës sillen në harmoni me njëra-tjetrën, e gjithashtu vet rezultati i gjendjes së krijuar. Sociologu amerikan Werner S. Landecker ka bërë një ndarje të katër llojeve të integrimit.

A) Integrim kulturor, që do të thotë se vlerat dhe rregullat e shoqërisë për sjellje nuk qëndrojnë në kundërthënie ndaj njëra-tjetrës. Një masë për integrimin kulturor është përqindja e vlerave dhe rregullave alternative në një shoqëri. Një përqindje e madhe e **alternativave kulturore** është një simptomë për integrim të ulët.

B) Integrimi normativ që do të thotë se sjelljet e anëtarëve të shoqërisë qëndrojnë në përputhmëni me sistemin e normave të shoqërisë. Kriminaliteti i lartë është simptomë për integrim normativ të ulët.

C) Integrim komunikativ që do të thotë shkallë e lartë e ndërveprimit në një shoqëri dhe me pak individ të izoluar.

D) Integrim funksional që ka domethënien se anëtarët në një shoqëri janë reciprokisht të mvarun nga njëri-tjetri. Një shkallë e lartë e ndarjes së punës dhe e specializimit në një shoqëri është një simptomë për integrim të lartë funksional, i cili pastaj ka si rrjedhim atë që sociologu francez Emile Durkheim e ka quajtur *solidaritet organik*.

Këto forma të ndryshme të integrimit mund të përdoren edhe për të përshkruar sisteme më të vogla sociale se sa shoqëritë, p. sh. grupet.

integrative subsystem Në bazë të sociologut amerikan Talcott Parsons duhet patjetër që në të gjitha *sistemet sociale* prej grupeve primare deri tek shoqëritë, të kenë role ose institucione për t'i plotësuar ato funksione, që janë të domosdoshme për vazhdimësinë e sistemit social. Këto janë *subsistemi adaptiv*, -subsistemi për arritjen e synimeve, *subsistemi për zgjidhjen e tensioneve* dhe *subsistemi integrativ*. Funksioni i përmendur në fund është për ta mbajtur ose rritë frymën e unitetit në sistem. Në një shoqëri ky funksion kryhet pos të tjerëve nga institucionet religjioze.

intellectuals *intelektualët* nocion me shumë kuptime i cili në literaturën amerikane rëndom përkufizon ato grupe që në një shoqëri prodhojnë dhe shpërndajnë kulturë e me këtë mendohet në artin, shkencën dhe religjionin. Grupe të tilla janë shkrimtarët, artistët e skenës, artistët e arteve figurative, shkencëtarët, bibliotekistët, mësimdhënësit në nivele të larta etj. Në rrethana evropiane nocioni zgjerohet më tepër duke përfshi edhe grupe tjera, të cilat aplikojnë njohuri shkencore, siç janë p. sh. avokatët dhe mjekët.

interaction *ndërveprim* proces përmes të cilit veprimet e një individi apo grupi sjellin veprime tek një individ apo grup tjetër. Ndërveprimi mund të klasifikohet në bazë të kritereve të ndryshme dalluese. Një prej propozimeve më të njohura janë ato të sociologëve amerikan Robert E. Park dhe E. W. Burges, të cilët bëjnë dallimin në mes garimit (në kuptim shumë të gjerë), konflikt, përshtatje dhe asimilim. Më vonë format e ndërveprimit *bashkëpunim* dhe *parazitizëm* janë plasuar në të njejtën bazë të kritereve dalluese.

Një lloj tjetër bazë për kritere dalluese përdorë bazën e elementeve atraksion, *repulsion* dhe *indiferentizëm*. Këto elemente mund të kombinohen në gjashtë mënyra të ndryshme (atraksion reciprok, atraksion - repulsion, atraksion - indiferentizëm, repulsion reciprok e kështu me radhë). Këto kombinacione janë të aplikueshme në të gjitha situatat e ndërveprimit me dy aktor, pra dy pjesëmarrës.

internalization *internalizim* ai proces përmes të cilës individi e shndërron një *normë sociale* në private, në atë mënyrë që ai shtron po ata kërkesa para vetvetes në të njejtën mënyrë siç i shtron edhe shoqëria ndaj tij. Ajo çka e dallon *internalizimin* nga *mësimi* (*learning)* është, se *internalizimi* kryhet në mënyrë të pavetëdijshme. Pjesa kryesore e tij kryhet gjatë fëmijërisë, kur fëmiu e identifikon veten me prindërit dhe i aprovon normat e tyre, të cilat në përgjithësi janë edhe të shoqërisë.

internal system norma dhe pritje sjelljesh sociale të krijuara në grupin e vet, për dallim nga *external system*, norma dhe pritje sjelljesh në sistemin e gjerë social, në kuadrin e të cilin hyn grupi i vogël. Sipas George Homans i cili e ka bërë introduktimin e këtij koncepti në *The Human Group* (1950), ato aktivitete të grupit që janë të orientuara kah arritja e synimeve përcaktohen kryesisht nga *sistemi eksternal* (sistemi i jashtëm), ndërsa aktivitetet integrative, ato që kanë për qëllim ruajtjen e unitetit në grup, përcaktohen nga sistemi internal.

intolerance of ambiguity (intolerancë ndaj dy-kuptimshmërisë) një veti karakteristike para së gjithash e personave të tipit *autoritativ*. Individët me këtë veti kanë vështirësi me i vështrua objektet dhe ngjarjet si të dykuptimshme apo të pastrukturuara. Ata kanë një tendencë ta *dikotomizojnë* botën, njerëzit dhe dukuritë. Ato trajtohen ose si krejtësisht të mira apo krejtësisht të këqija. *(Ai që nuk është me mua është kundër meje.)* Ata kanë një tendencë të shohin bardh e zi, dhe të krijojnë struktura njohëse (kognitive) të thjeshta dhe qartë të organizuara. Ata janë në një shkallë shumë të ulët të hapur për informacione, të cilat *strukturat* e tyre kognitive do t'i bënin më komplekse. Janë fituar gjithashtu të dhëna që flasin për atë se ekziston një mvarëshmëri negative në mes *intolerance of ambiguity* dhe kapacitetit intelektual.

introspection metodë shkencore klasike, në bazë të së cilës hulumtuesi e studion jetën e tij shpirtërore dhe duke e nisur prej saj bënë gjeneralizime.

introvert personality vëmendja dhe interesimet e individit janë të drejtuara kah ai vet. E kundërta e kësaj është *extrovert personality*, që kryesisht interesohet për fenomene sociale të jashtme e të dukshme.

invasion *invazion* 1. një nga format e *imigrimit* të përshkruara nga Henry Pratt Fairchild në librin e tij *Immigration: A World Movment and its American Significance* (1925). Me invazion Fairchild mendon një imigrim jopaqësor i një popullsie me nivel kulturor më të ulët në një territor me nivel kulturor më të lartë. E kundërta e kësaj është *pushtim*. Shembull i një invazioni në këtë kuptim, është invazioni i gotëve në Perandorinë Romake.
2. Në kuptimin ekologjik mendohet në rastet kur një klasë apo tip i organizmave të gjallë vjen tek një territor dhe i zhdukë të gjitha klasat apo tipet tjera.

iron law of oligarchy *ligji i hekurt i oligarkisë* teori e formuluar nga sociologu gjermanoitalian Robert Michels në *Zur Soziologie des Parteiwessens in den modernen Demokratien* (1912). Michels mendon se edhe organizata që formalisht janë demokratike (p. sh. partia socialdemokrate gjermane të cilën Michels e ka studiuar) krijojnë, qesin nga vetja, një grup të ngushtë shumë të organizuar, të cilët shpejt fitojnë pothuajse kontroll absolut mbi organizatën. Liderëve të organizatës, u krijohet mundësia të fitojnë njohuri specifike të cilat masa nuk i ka. Duke iu falenderuar këtyre njohurive liderët i dominojnë mbledhjet me anëtarë dhe ata shpesh kanë ndikim vendimtarë në marrjen e vendimeve. Ata ia vështirësojnë masës e cila ka më pak njohuri mundësinë për t'i larguar apo zëvendësuar liderët, të cilët mund të qëndrojnë në postet e tyre në periudha të gjata. Liderët kanë interes të qëndrojnë në postet e tyre, jo gjithmonë për shkakun se janë të etshëm për pushtet, por shpesh edhe për atë se kanë dobi ekonomike nga mbajtja e pozicioneve të tyre. Ata e kontrollojnë procesin e ngritjen në nivelet e larta të organizatës, dhe ata do të lejojnë ngritjen në shkallët e organizatës vetëm për ata anëtarë që i kanë mendimet e njejta me ta. Michels potencon se liderët nuk do të thotë se gjithmonë janë të korruptuar, apo të kenë defekte morale. Ata (liderët) janë rezultat i një ligji që vepron në të gjitha organizatat, pa marrë parasysh karakterin e liderëve.

irrational rationality koncept i krijuar nga Max Weber. Max-i ka menduar se një përsosje e mjeteve shpesh mund të sjell tek zvogëlimi i mundësive për t'ia arritur qëllimit. Weber ka treguar se pos tjerash organizatat burokratike nganjëherë kurthohen në aspektet procedurale të tyre sa synimet e tyre (për arritjen e të cilave janë formuar) janë lënë në harresë. Për një organ shtetëror që merret me çështje sociale mund të ndodhë që procedura (komentet e paragrafeve, rregulloreve, ligjeve neneve të shkoj deri në atë masë) të vjen në radhë të parë dhe situata e klientit në radhë të dytë.

Më vonë ky koncept është përdorë edhe nga hulumtuesit e çështjeve të paqes dhe konflikteve në kritikën e tyre mbi bazat ideore të superfuqive rreth asaj që quhet terror-balance.

ISUFI IMER, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Imer Isufi 1611 Mary An Lan Lockport, Ill., 60441 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

J

JAHIR JAHIRI, – Jahir Jahiri veprimtar i dalluar i rrethit të Shtutgartit, dhe Vëllezërve Gërvalla. Ka vepruar më së shumti me Faridin dhe Sefedin Tafallarin.

JASHARI SHEFQET, – Shefqet Jashari lindi në fshatin Strofc, komuna e Vushtrrisë, më 15 maj 1944. Pas shkollës së Mesme Bujqësore në Prishtinë më 1964, ka kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike, Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë më 1970.

Në vitin 1964 është dënuar me 5 vjet burg të rëndë, si anëtar i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. Së bashku me të në gjyq kanë dalë Enver Mehmeti, Hilmi Rakovica, Vezir Uka dhe Selman Berisha.

Së bashku me Metush Krasniqin dhe Sabri Novosellën, është bashkëthemelues i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës. Më 15 nëntor 1979 arrestohet nga policia jugosllave. Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, më 4 qershor 1980 është dënuar me 8 vjet burg.

Xhafer Durmishi: "*Shkollën fillore e kam mbaruar në fshatin Prilluzhë. Në dy vitet e para mësim më ka dhënë* ***Qerkin Peci****. Në këto dy vite, përveç Qerkinit praktikën si mësues e ka bërë Sheremet Saraçi, i cili e ka zëvendësua Qerkinin për dy muaj. Në klasën e tretë dhe të katërt mësuese e kemi pas Hanëmshahe Pasomën. Pas mbarimit të shkollës fillore në fshatin Prilluzhë, me sukses shembullor, d.m.th. pa asnjë katërshe gjatë tetë viteve, regjistrohem pa provim pranues në Qendrën Shkollore Teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq. Kjo shkollë nuk ka qenë shkollë komunale por pronë e Kombinatit të Obiliqit, dhe ka pas për detyrë të shkolloj punëtorët e kuadrot e profileve të ndryshme për Kombinatin.*

Në shkollën e mesme në Obiliq, shok të ngushtë e kam pas Hakif Krasniqin nga fshati Zhilivodë. Në Obiliq jam njohur edhe me Bahtir Haradinajn. Me Hakifin nuk më ka lidhë shumë interesi i lëndëve shkencore në shkollë si kimia, fizika e matematika (për diskutimin e këtyre lëndëve kam pas një rreth krejt tjetër) por interesi ynë i përbashkët ka qenë për gjuhën e letërsinë shqipe dhe leximi i veprave të letërsisë shqipe deri tek ato të realizmit socialist, të botuara në Shqipëri e të cilat na kanë ra në dorë, apo i kemi huazuar në biblioteka.

Hakifi me vëllaun e vetë më të vogël Hasanin dhe nanën kanë jetuar në Zhilivodë. Sa motra më të rritura i ka pas nuk më kujtohet. Por e di se një motër e tij më e madhe, Bedrija ka qenë e martuar me Ismet Saraçin, nga fshati Bivolak. Ismeti ka qenë shok i ngushtë me Sheremetin dhe këta të dy së bashku shokë me ***Shefqet Jasharin nga Strofci.*** *Përmes shokut tim të shkollës së mesme Hakifit jam njohur me Ismetin dhe rinjohur me Sheremetin (pasi Sheremeti më kishte dhënë dy muaj mësim në dy vitet e para të shkollës fillore). Në fillim të vitit 1978, Ismet Saraçi, pasi më kishte takuar shumë e shumë herë më ka folë për Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi, më ka propozuar të anëtarësohem dhe unë jam pajtuar. Ismeti më ka anëtarësuar në Lëvizje në shtëpinë e tij në Bivolak. Viti 1978 është viti i 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit dhe në këtë vit puna ime si anëtar i Lëvizjes është një pikë ujë në deti në krahasim me punën pothuajse krejtësisht zyrtare për të kujtuar 100 vjetorin e Lidhjes." Përmes Hakifit jam njohur edhe me Behxhet Krasniqin."*

JASHARI SKËNDER – Skender Jashari, i lindur më 11 korrik 1954 në Prishtinë. Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, më 4 qershor 1980 është dënuar me 3 vjet burg.

JETA NË PESHOJË, Jusuf Gërvalla: *"Përkundrazi, asnjë propagandë për të ashtuquajturin "terrorizëm shqiptar", të inskenuar e të "sulmuar" nga qeveria shoviniste e Beogradit, nuk do të na frikësojë e të na ndalë në kërkesat tona të drejta për bukë, të drejta e liri demokratike. Ato do t'i kërkojmë në mënyrën që do ta shohim të arsyeshme, pa e vënë në peshojë as jetën, derisa t'i realizojmë që të gjitha!*" (*Zëri i Kosovës*, nëntor 1981, faqe 14)

JOKLI NORBERT, Norbert Jokl (25 shkurt 1887 - maj 1942) ishte albanolog austriak me prejardhje hebreje. Njihet si një ndër themeluesit e albanologjisë. Por, para se me u njohtë si albanolog i madh ai ishte i çmuem si studiues i filologjisë balto-sllave dhe si bibliotekar (Oberstadtsbibliothekar) i Universitetit të Vjenës.

Ernest Koliqi, duke përshkruar një vizitë të bërë së bashku me Aleks Budën në shtëpinë e Joklit në dhjetor të 1937, shkruante një vit më vonë te «Demokratia» e Vangjel Koçës: "*E më çoi fill ke nji raft librash [...] Botime të vjetra e të reja: Toskësh e Gegësh e Shqiptarësh t'Italís; të gjithë auktorët, të mëdhej e të mesëm e të vegjël fare; kolekcjone së përkohëshmesh shti për bukurí në kartuç, radhiteshin të dendun n'at bibljotekë të smirueshme. Shum prej atyne botimeve sot nuk gjinden mâ, sado me i pague. Sejcili vëllim mâ së miri i lidhun mbante të shkruem me gërma ari në shpinë titullin e vet. Sýt e mij shetitshin plot lakmi mbi ato tituj e zemra më ndrydhej. Paska qenë dashtë të shkojshëm larg Shqipnije, në nji vend të huej, për të gjetun bibliotekën ideale shqipe".*

K

KABASHI NUHI, – Nuhi Kabashi nga fshati Polac, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

KABASHI XHAVIT, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Xhavit Kabashi, 316-6-92street, ap.26. New York, city. 10028 USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

KADARE ISMAIL, -Ismail Kadare, lindi më 28 janar 1936 në Gjirokastër. Ka shkruar parathënien e romanit *Rrotull* dhe punimin "Baladë për vdekjen e Jusuf Gërvallës". Shkrimtari më i cituar nga Jusuf Gërvalla.

KALAJ, Familje veprimtare në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Familja KALAJ, 40 East Ave. 81 St. New York, N.Y.10027 USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej saj ka qenë 10.

KALAJ GJERGJ, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Gjergj Kalaj, 125 Goldner Av. Pontiak, Mich., 48054 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

KAMBERI ILJAZ, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Iljaz Kamberi, Schödlerstr.30 Wandsbek 20 2 Hamburg. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 150.

KASTRAT SAÇIR, shtetas i Turqisë me prejardhje shqiptare apo nga viset shqiptare. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Saçir Kastrat, Feridiye cad. No. 93, Taksim Istanbul. *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës i është dërguar për ta informuar me gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi.

KASTRATI SALIH, Jusuf Gërvalla: "*Kah ora dy pas mesnate, tashmë ditë e shtunë, i trokita në derë Skënder Blakajt. Me veturën e tij shkuam në Pejë, e morëm* ***Salih Kastratin****, dhe u nisëm për Jesenice, në kufirin jugosllavo-austriak. Rrugës kaluam mirë. Ata më lanë në oborr të Bacit Haxhi, kështu ishim marrë vesh dhe shkuan."*

SULM ME BOMBË NDAJ BIZNESMENIT NGA PEJA SALIH KASTRATI

Nga Express 15 Mars 2012 13:10

Një sulm me bombë ka ndodhur sot në Pejë, konkretisht në shtëpinë e biznesmenit të arit, Salih Kastrati. Sipas RTK-së, sulmi ka ndodhur rreth orës 10:30, përderisa shpërthimi i bombës është dëgjuar në tërë qytetin e Pejës. Bomba ka qenë e montuar para shtëpisë së biznesmenit Salih Kastrati, i cili është lënduar rëndë dhe po trajtohet në gjendje kritike në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Ndërkaq, zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Pejës, Xhevat Ibraj e ka konfirmuar shpërthimin e bombës por ka thënë se ende nuk ka ndonjë të arrestuar apo të dyshuar në lidhje me këtë rast. (www.gazetaexpress.com)

Nga sulmi me bombë vdes Salih Kastrati. Lajmi për varrimin e tij u dha më 12 prill 2012.

KELMENDI ADEM, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Adem Kelmendi, T.O. Box.95, Focskray, Virginia, 22150, USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërndа *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

KELMENDI AVDI – Avdi Kelmendi, i lindur më 21 dhjetor 1951 në fshatin Ribari i Vogël KK Lipjan. Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, më 4 qershor 1980 është dënuar me 5 vjet burg.

KELMENDI IBRAHIM, – Ibrahim Kelmendi**,** përfaqësues i Frontit të Kuq.

Jusuf Gërvalla: "*Po ashtu, „përkundrazi“, i nderuar shok Ibrahim!*

...E marr me mend (e kjo spikat edhe në letrën tënde) ç‘mundime ke pasur të më shkruash në “nivelin” tim, sikur. thua se vetëm në “nivelin” tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë “niveli” im, sikur t‘u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?! Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit! (Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.)" (Letër Ibrahim Kelmendit, nëntor 1980; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

Ibrahim Kelmendi: "*Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant."* (Bedri Islami, LËVIZJA, Tetovë 2012, faqe 114-117)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në*

duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin.

.... Madje në atë kohë, Ibrahimi kërkonte një njeri "të ndershëm e trim", që për një kundërshpërblim prej nja 50 mijë markash gjermane, do të kryente në Kosovë një aksion sipas porosisë së reaksionit shqiptar antikomunist. (Lidhur me këto çështje kemi pasur një dialog të përbashkët dhe bukur të rreptë në praninë e tij unë dhe dy shokë nga Vjena, lidhur me këtë është dashur të jetë i informuar patjetër Profesori, në qoftë se është i informuar për çkado lidhur me I. Kelmendin.)

...Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen. Ibrahimi kritikon hapurazi si agjent dajën, por ka kontakte të vazhdueshme me djalin e dajës dhe, për sa mund të vërehet, edhe simpati ndaj tij. Ka provuar t'ia plotësojë këtij daje të vogël (Gani Ibërdemajt - edhe lidhur me këtë njeri është dashur të jetë i informuar Profesori) dëshirën për t'u takuar me mua.

... Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjegj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" RAPORT mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "*Zëri i Kosovës*" dhe Fronti i Kuq Popullor; U botua për herë të parë në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011 nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin; Kur Jusuf Gërvalla shkruante)

Ibrahim Kelmendi: *"Tani ka shkruar një reagim të gjatë Xhafer Durmishi, ish-bashkëveprimtar, njëkohësisht ish-kundërshtar i imi. Sa për shembullin që sollët ju për sqarim, unë nuk do t'i isha hidhëruar fare Xhaferit, sikur të kishin qenë shpifje të tij autentike, ngaqë ndaj tyre kam krijuar imunitet. Tani më shqetëson fakti se ato shpifje i vishen Jusufit, të cituar në bazë të një "raporti" që gjoja ai i paskësh dërguar Sabri Novosellës. Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "raport" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant.*

... Mjafton të them se Jusufi e ka ditur shumë mirë kush ishte Ramë (Idriz) Ibërdemaj, prandaj nuk ka pasur nevojë të hamendesohej nëse ishte Ramë Ibërdemaj apo Ramë Nikqi." (Bedri Islami, LËVIZJA, Tetovë 2012, faqe 114-117)

KLAIQI ISMET, – Ismet Klaiqi, veprimtar i dalluar i rrethit të Shtutgartit që nga fillimi i vitit 1980. Ka punuar në fabrikën e Mercedesit në Sindelfingen.

KLAIQI SHABAN DHE ISLAM RAFUNA, në dhjetor të vitit 1981, u arrestuan në kufirin austriako-slloven duke e futur numrin e parë të Zërit të Kosovës, dhe u dënuan me nga tri vjet burg.

AKTGJYKIM: "*NE EMER TE POPULLIT*

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga kryetari i gjykatës Riza Fazlija dhe gjyqtarët: Tadej Rodiqi, Aqif Tuhina, Durmish Koqinaj dhe Halil Halilaj, anëtarë, me

*bashkëpunëtoren profesionale Milica Smajli, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarve **Shaban Klaiqi** dhe **Islam Rafuna**, për veprën penale të pjesëmarrjes në veprimtari armiqësore, të parashikuar nga neni 131 të LP të RSFJ, të kryer si bashkekzekutorë, duke vendosur përkitazi me ankesën e prokurorit publik të qarkut dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarve Zhivana Bersavleviq, paraqitur kundër aktgjykimit P-nr. 34/82 datë 3 korrik 1982 të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, në seancën jopublike të mbajtur më **17 janar 1983**, zëvendësprokurori publik krahinor Ndue Selmani, mori këtë*

AKTGJYKIM

*Në rastin e ankesës së prokurorit publik dhe ankesës së mbrojtëses së të akuzuarve, e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi P-nr. 34/82 datë 3 korrik 1982 i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit ndryshohet sa i përket zbatimit të ligjit penal, kështu që Gjykata Supreme konstaton se në veprimet e të akuzuarve **Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna** qëndrojnë elementet e veprës penale të propagandës armiqësore, të parashikuar nga neni 133 par. 3 të LP të RSFJ.*

ARSYETIMI

*Me aktgjykimin P-nr. 34/82 datë 3 korrik 1982, Gjykata e Qarkut të Gjilanit i ka shpallur fajtorë të akuzuarit **Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna** për veprën penale të propagandës armiqësore, të parashikuar nga neni 133 par. 1 të LP të RSFJ dhe i ka dënuar me nga **tri vjet burgim**, duke i detyruar edhe t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor prej 1000 dinarësh."*

KLUBE SHQIPTARE; Bashkësia BKSHM, Postfach 2, D-7271 Rohrdorf
(Kryetar i Bashkësisë së Klubeve Shqiptare në Mërgim-Faridin Tafallari)
Klubi Asim Vokshi, Rue de Geneve 46, Lausanne, Llozanë
Shoqëria Drita, Brunnen str. 20, 7400 Tybingen
Klubi "Emin Duraku", Graf-Adolf-Str. 63-65, Düsseldorf
Klubi "Gjergj Kastrioti – Skënderbeu" Kreuzlingen
Klubi "Hasan Prishtina", Zug- Demë Mustafaj
Klubi "Ibe Palikuqi" Hamburg
Klubi „Idriz Seferi", Rue Rubens 41, 1030 Bruksels-Beg.
Klubi "Igballe Prishtina" Gjenevë
Klubi "Isa Boletini", më 20 gusht 1983, ka filluar aktivitetin e tij.
Klubi "Jusuf Gërvalla" Nju Jork
Klubi "Kosova" Bilefeld - Xhavit Ramabaja
Klubi „Përparimi" Weststr.150 Zürich, tel.01-352411
Klubi "Xheladin Zeqiri" në St. Gallen

KLUBET NË DYSELDORF E BILEFELD, Jusuf Gërvalla: "*Një hap tjetër revolucionar që u bë këto ditë në Gjermani, qe pushtimi nga punëtorët tanë i dy klubeve kosovare, të cilat deri më tash ishin bërë çerdhe spiunazhi e propagande e njerëzve të konsullatave jugosllave. Punëtorët revolucionarë i morën në dorë ato klube, hoqën flamurin jugosllav dhe fotografinë e xhelatit Tito, ndoqën së andejmi njerëzit e konsullatave, përderisa ngjarjet në Kosovë të vazhdojnë të trajtohen kështu nga ana e qeverisë jugosllave.*

*Klubet e pushtuara ndodhen në Dyseldorf dhe në Bilefeld. Policia gjermane jo vetëm nuk ka ndërmarrë asgjë lidhur me këtë aksion, por e konsideron edhe shumë të drejtë, meqë sipas statusit të tyre, klubet duhej edhe më parë të ishin të pavarura nga ndikimi i konsullatave. Tani kemi shpresë se ky shembull do të ndiqet në të gjitha ato qendra ku kanë ekzistuar deri më tash klube që veç emrin e kanë pasur kosovar. Dhe kjo gjë ka rëndësi mjaft të madhe." (*Letër Sabri Novosellës 13 maj 1981*;* Faridin Tafallari,

ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 262)

KËRÇOVA Q., veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Q. Kërqova, Co "Red Apple INN" 8. Street, Monroe Wis, 53566 USA. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

KOCA SELIM, – Selim Koca, i biri i Kajtaz Kocës nga Polaci. Veprimtar në Gjermani, në rrethin e Shtutgartit, Sindelfingen. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

KOLANECI ENXHËLL, diplomat në ambasadën e Shqipërisë në Vjenë. Me sa më kujtohet, adresa e mëposhtme, e viteve 1982-1983 është e ambasadës dhe jo e tija private: Enxhëll Kolaneci, Botschaftsrat S. V. AL. Jacquingasse 41, 1030 Wien Austri

KOMITETET PËR KOSOVËN, Jusuf Gërvalla: "*Tani, në bashkëpunim me komunistët gjermanë e zvicëranë, unë dhe një shok i "Lirisë" jemi duke punuar në formimin e disa komiteteve për Kosovën. Këto komitete do të përbëhen prej autoritetesh të njohura gjermane e zvicërane, si politikanë, shkrimtarë e artistë të njohur demokratë. Konkretisht, në komitetin që do të formohet në Gjermaninë Federale, kemi rënë dakord që nga pala shqiptare të hy unë, kurse në atë në Zvicër, një shoku (Kadri Zeka-shën. i Xh. D.) i "Lirisë". Komitetet kanë për qëllim ta sheshojnë të vërtetën për Kosovën dhe të organizojnë ndihma të ndryshme për popullin tonë të shumëvuajtur. Komitetet do të bëjnë demarshe pranë qeverive, dhe ndoshta edhe pranë Kombeve të Bashkuara, si dhe do të përpiqen të ndikojnë sa më shumë në shtypin evropian e botëror, duke e ushqyer këtë shtyp me të dhëna faktografike mbi Kosovën, në mënyrë që demagogjia jugosllave të demaskohet në përmasa të gjera. Po kështu, komitetet do të hapin edhe xhiro-llogarinë për ndihma materiale dhe do të caktojnë qendra me adresa ku të arrijnë të dhëna konkrete lidhur me numrin e të vrarëve, të plagosurve dhe të të burgosurve në ngjarjet e fundit në Kosovë. (Prandaj është mirë që qysh tani, shokët të mbledhin sa më shumë informata dhe, kur të formohen komitetet, t'i ushqejmë ato me të vërteta në shkallë sa më të gjerë.)"* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981*;* Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 263)

KOMITETI "MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS" (1918-1924). Organizatë politike kombëtare që luftoi për mbrojtjen e shtetit të pavarur shqiptar, për demokratizimin e tij, për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, të shkëputura padrejtësisht më 1913 dhe për bashkimin e tyre me Shqipërinë. U themelua në ilegalitet më 1 maj 1918 dhe nga nëntori u vendos në Shkodër, ku e zgjeroi më tepër veprimtarinë e tij. Midis drejtuesve të organizatës u dalluan Kadri Prishtina (kryetar), Hasan Prishtina, Bajram Curri, Sali Nivica Hysni Curri etj. ...



Kadri Prishtina, Jusuf Gërvalla dhe Bujar Hoxha

Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" iu kushtua veçanërisht organizimit dhe drejtimit të Luftës Nacionalçlirimtare të popullsisë shqiptare të Kosovës e të viseve të tjera kundër zgjedhës së pushtuesve serbomëdhenj. Themeloi degët e tij në Kosovë dhe mbante lidhje të vazhdueshme me prijësit e lëvizjes së armatosur nacionalçlirimtare në ato treva. Komiteti demaskoi me forcë para opinionit publik brenda dhe jashtë vendit, politikën e terrorit dhe të gjenocidit serbomadh ndaj popullsisë shqiptare, përpjekjet e tyre për shkombëtarizimin e shfarosjen e saj. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, faqe 499-500)

KOMITETI QENDROR I PPSH, Jusuf Gërvalla: "*Letrën për KQ të PPSH-së e vonuam shumë. Unë e shkrova në disa variante, por me asnjërin prej tyre nuk mbeta i kënaqur. Nuk jam mësuar të komunikoj me një nivel të tillë. Më së fundi e lash variantin që e mora prej teje.*

Hapi si hap më pëlqeu shumë dhe më duket shumë i dobishëm. Por, nuk di a duhet të jemi të kënaqur si e kemi realizuar." (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982*;* Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 278)

KONCERTI "KOSOVARJA KËNDON" MË 11 NËNTOR 1983 NË SHTUTGART

I ORGANIZUAR NGA KONZULLATA E SHTUTGARTIT

Njoftim për shokët e _____

Të gjithë ju të dashur bashkatdhetarë jeni në dijeni për rastin që ndodhi më 11 nëntor 1983 në Shtutgart me rastin e shfaqjes së Ansamblit "Kosovarja këndon".

Atë mbrëmje u arrestuan 17 bashkatdhetarë të rrethit të Shtutgartit dhe një nga një qytet tjetër. Tetë veta u liruan natën e dytë, njëherazi duke u liruar edhe nga aktakuza. Nëntë të tjerë u mbajtën në burg. Pas dy javësh, nga burgu u liruan edhe tre shokë të tjerë me kusht që në çdo javë të lajmërohen njëherë në stacionet e policive të qytetit ku banojnë. Pesë shokë të tjerë që mbetën në burg u liruan pas pesë javësh, më 15 dhjetor 1983, me kusht që vetëm për lirimin e tyre deri në gjyq të paguhet një shumë të hollash prej 35 000

DEM. Tre avokatët për punën e tyre të deritanishme kërkuan 9000 DEM. Bashkatdhetarët e rretheve më të aktivizuara, këtë shumë të hollash e përballuan për rreth 45 ditë, duke arritur të paguajnë pjesën dërmuese të kësaj shume.

Por që në fillim që të mos humbim në kohë, disa shokë të rrethit të Shtutgartit hynë në kredi me besim në solidaritetin vëllazëror, i cili edhe kësaj radhe u manifestua në shkallë të lartë.

Për solidaritet vëllazëror ju shprehin mirënjohje punëtorët e rrethit të Shtutgartit.

30 janar 1984

PS. Këto të holla u dhanë nga Faridin Tafallari, i cili muar Kredit nga Deutsche Bank Nagold, 14 Dezember (Dhjetor) 1983. Unsere Zeichen Sz/Bin Barkredit 30 000 DEM, me afat deri më 30 mars 1984, me kamatë 10%, z. Zt. und bis auf weiteres.

NDIHMA:

Që u erdhën nga rrethe dhe qendra të ndryshme të Evropës Perëndimore vëllezërve që punojnë e jetojnë përkohësisht në rrethin e Shtutgartit, për rastin që ndodhi më 11 nëntor 1983, ku ranë në burg 17 shokë. Për t'i liruar nga burgu këta shokë kërkuan një shumë të hollash prej 35 000 DEM, kaucion dhe avokatët për punën e tyre kërkuan deri më sot 9000 DEM. Këto të holla u paguan brenda një kohe të shkurtër nga vëllezërit dhe motrat mërgimtarë që punojnë nëpër vende të ndryshme të Evropës. Ju falenderojmë ju të gjithë vëllezër e motra për ndihmat solidare që na ofruat.

Këtu po shënojë rrethet dhe shumën e të hollave:

1. Rrethi i Shtutgartit-Sindelfingen (Selim Koca, më 17-11-1983)	*DM*	*2050*
2. Rrethi i Shtutgartit-Sindelfingen (Mejdi Rexha, më 19-11-1983)	*DM*	*1400*
3. Rrethi i Esslingenit (Nami Ramadani, më 15-12-1983)	*DM*	*820*
4. Rrethi i Dusseldorfit (Qamil Rexhepi 14-05-1984)	*DM*	*1500*
5. Rrethi i Dusseldorf-Duisburg (Imerja Qamili, 29-12-1983)	*DM*	*2000*
6. Rrethi i Bilefeldit (Xhavit Ramabaja, më 16-01-1984)	*DM*	*2470*
7. Rrethi Bremenit (M.Z., H.D. dhe L.I. më 14-12-1983)	*DM*	*1200*
8. Rrethi i Saarlouis-it (Ismail Hoxha, më 17-11-1983)	*DM*	*500*
9. Rrethi i Hamburgut (Ali Ademi, më 14-01-1984)	*DM*	*6100*
10. Rrethi i Shtutg-Waiblingen (Kolë Paloka, 10-12-1983)	*DM*	*1170*
11. Rrethi i Ingolstatit (Nezir Neziri, më 27-02-1984)	*DM*	*760*
12. Rrethi i Dortmundit (Q. Kryeziu, më 19-03-1984)	*DM*	*800*
13. Shoqëria e Kölnit (Imerja Qamili, 15-05-1984	*DM*	*510*
14. Demë Demaj (Nagold, 15-12-1983)	*DM*	*300*
15. Shaip Zeqiri (Tybingen, 17-12-1983)	*DM*	*100*

Nga Zvicra, nëpër rrethe të Zvicrës janë këto ndihma:

1. Rrethi i Gjenevës K Igballe Prishtina, 19-12-1983	*DM 2867+500F*	
2. Klubi "Asim Vokshi" Llozanë CH më 19-12-1983	*DM*	*3740*
3. Klubi Përparimi, më 10-12-1983	*Fr.*	*660*
4. Klubi Xheladin Zeqiri St. Gallen, 10-12-1983	*DM*	*1495*
5. Shoqëria e Gjenevës (Shaqir Shabani, 16-12-1983)	*DM*	*6234*
6. Shoqëria e Gjenevës (Shaqir Shabani, 16-12-1983)	*Fr*	*1100*

Të dhanat për lirimin e shokëve nga burgu, më 15-12-1983 në Shtutgart.

1. Avokatit Micheil Wolf, për punën e bërë më 14-11-1983 ia dhash 2600 DM
2. Avokatit M. Wolf, kaucion i dhash më 18-11-1983 DM 1x500+1x500=1000
3. Avokatit M. Wolf, për lirimin e shokëve më 15-12-1983 i dhash DM 15 000
4. Avokatit M. Wolf, për lirimin e shokëve i dhash më 28-11-1983 DM 10 000
Remzi Ademit ia dhash për avokatin DM 3000

Hafiz Gagicës ia dhash posa dual nga burgu *DM 1500*
Xhafer Durmishit, ia dhash për nevoja të aktivitetit *DM 1500*
Murat Kryeziut ia dhash për avokatin *DM 1000*
Familjes Gërvalla i dërgova 2xnga 1100 pas (Zeqirit) *DM 2200*
Familjes së Hysen Gegajt ia dërgova ndihma pas (Beqirit) *DM 1500*
Sqarim: Avokati mbrojtës i Mejdi Bytyçit u pagua nga shokët në Heilbron.
(Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 247-248)

KONFLIKT (lat. confli'ctus ndeshje) kundërshtim, mospajtim që kërkon zgjidhje. Konfliktet mund të shfaqen në shumë nivele të ndryshme *brenda* një shoqërie dhe në *mes* shoqërive të ndryshme (shteteve). Mund të flitet, duke filluar prej konflikteve destruktive në mes shteteve (luftë), të kundërshtimeve në mes partive politike apo palëve në tregun e punës (ndërmarrësve, kapitalistëve dhe bashkimeve profesionale) deri tek konfliktet në mes njerëzve (si individ) apo në mes nënshtetasve dhe shtetit. Një konflikt shpesh përjetohet si i ngarkuar, i mundimshëm për ata që janë të përzier në te dhe për mjedisin. Por konflikti nganjëherë mund të jetë konstruktiv dhe krijues, p. sh. në formën e konkurencës, garimeve dhe lojërave. Përgjithësisht deri tek konflikti vjen kur dy apo më shumë palë në të njejtën kohë synojnë vlera dhe resurse të cilat nuk mund të ndahen në mes tyre në mënyrë të thjeshtë. Kjo do të thotë se tek konflikti vjen kur resurset janë të pamjaftueshme në raport me synimet e palëve (p. sh. në situatat e krizave ekonomike). Konflikti mund të ketë bazën edhe në ato raste kur formulimi i synimit të palëve është bërë në atë mënyrë sa nuk është e mundur në mënyrë të thjeshtë të plotësohet kërkesat e tyre njëkohësisht (p. sh. të dyja palët kërkojnë më shumë se gjysmën e resurseve).

Konfliktet bëhen të dukshme kur palët veprojnë në mënyrë aktive për arritjen e qëllimeve të tyre (p. sh. përmes sjelljeve konfliktuale siç janë grevat, lokautet, aksionet e dhunës). Konfliktet e armatosura (luftërat) zhvillohen rreth çështjeve territoriale (p. sh. përcaktimit të kufijve), pushtetit dhe rritjes së ndikimit, brenda dhe në mes shtetesh, kur forcat e armatosura përdoren qëllimisht për ta detyruar palën tjetër për lëshime apo për ta eliminuar ate krejtësisht. Konfliktet janë latente kur palët nuk veprojnë për t'i arritur synimet e tyre. Në ato raste kur është e mundur të bëhet parashikimi se resurset dhe vlerat do të pakësohen, por palët ende nuk kanë paraqitur synime të formuluara, kemi të bëjmë me ekzistimin e konflikteve potenciale.

KOPUKU I DHËNË PAS DOKKRAVE, Jusuf Gërvalla: *"Në këto çaste na kujtohet edhe gulçimi i rinisë hitleriane për ta shtruar e për ta dërrmuar Shqipërinë. Por, këtij kujtimi i del përballë me gjallëri një pamje e këndshme: sot, komunistët marksistë-leninistë gjermanë, Atdheun tonë, Shqipërinë socialiste, e konsiderojnë pishtar të komunizmit dhe atdhe të të gjithë proletarëve në botë.*

Ç'ndërrim fatlum i kohëve!

Vetëm i padituri dhe kopuku i dhënë pas dokrrave dhe pas ashtit, që mund t'ia hedhin në këmbim të lirisë së rrëmbyer social-shovinistët e Beogradit, nuk mund të kuptojë ende se ku kanë vajtur punët. Dhe vetëm ky i paditur dhe ky kopuk mund të mos mendojë ashtu si mendon bota." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 6)

KORABI ARBËR, pseudonim, me sa kam mundur ta kuptoj nga Jusufi, edhe pse nuk ma ka thënë në mënyrë direkte, *pseudonim rasti* i Enver Hoxhës, që më 12 shtator 1981, në gazetën Zëri i popullit publikoi artikullin **"**KËRKESA "KOSOVA – REPUBLIKË" NUK MUND TË SHUHET AS ME DHUNË, AS ME TEORIZIME BOSHE"

Jusuf Gërvalla: "Natyrisht se do të varet shumë edhe nga vëllezërit tanë në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi, se sa do të ju afrohemi realizimit të kërkesave tona objektive plotësisht të ligjshme. Po të jetë puna te kosovarët, për ata që i kanë pjekur hesapet, ata që e kanë shtrydhur mendjen për luftën e kaluar në mars e në prill e për këtë që po vazhdon e sidomos për atë që do të vijë, këtu është shumë fjalë e rëndë, që flitet për ndonjë tradhti të tillë, që të flitet për ndonjë harresë kur është fjala për vëllezërit në Maqedoni edhe në Mal të Zi. Por natyrisht në drejtimin e asaj, që të realizohen të drejtat e ligjshme të të gjithë popullit Shqiptar në Jugosllavi, për përfshirjen e të gjithëve brenda kufijve të ardhshëm të Kosovës, kjo varet shumë siç thashë edhe më parë, nga vetë aktiviteti që do të zhvillojnë vëllezërit tanë në regjionet përkatëse. Por duhet ta kemi guximin e të flasim objektivisht e të themi, se vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, siç e tha kohë më parë Zëri i Popullit, pikërisht ***Arbër Korabi****, që kjo kërkesë para se të jetë një aspiratë, një qëllim të fundit të popullit shqiptar në Jugosllavi, paraqet më parë një protestë."* (E botoi për herë të parë Faridin Tafallari në shkrimin: ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981; www.albaniapress.com, 22 nëntor 2008)

KOSOVA REPUBLIKË, Jusuf Gërvalla*: "Se ç'ka do t'i sjell, çfarë të mira do t'i sjellë Kosovës statusi i Republikës, ne ose duhet të realizojmë (analizojmë) ta shtrydhim mendjen , të mendojmë ditë e natë. Kemi edhe disa pika të tjera si të mbështetemi edhe të logjikojmë pse një njeri i mençur thotë, se mendimi është e vetmja parajsë, prej së cilës nuk mund të na ndjekin. Ta zëmë se një pikë mbështetje prej të cilës mund të nisemi ne kur të analizojmë, se çfarë të mirash do të na sjellë statusi i Republikës për Kosovën, mund të drejtohemi konkretisht te armiku. Po të ishte kërkesa Kosova Republikë, një kërkesë boshe, një kërkesë në ajër, një kërkesë mendje lehtë, një kërkesë, të cilën e kanë bërë aventurierët, një kërkesë të cilën e kanë bërë, ata që ëndërrojnë pa baza, pa farë dyshimi se Beogradi, qysh më 11 mars të këtij viti, do të dilte me dokumentin për statusin e Republikës së Kosovës dhe do të na thoshte urdhëroni shqiptarë ja ku e keni Republikën! Por a është kështu, po e shohim që prej afër nëntë muajsh. Të gjitha forcat, gjithë plehun, gjithë vrerin shovinist të 74 vjetëve, qindra vjetëve më të përparshëm, Beogradi, tashmë e ka akumuluar, e ka grumbulluar, për ta shtypur kërkesën e Kosovës Republikë. Prandaj ne po duam ta vlerësojmë punën. Mund të nisemi edhe nga ky moment, po të ishte kjo kërkesë, një kërkesë me rëndësi të vogël, ose pa rëndësi, padyshim se Beogradi, do të shfrytëzonte rastin edhe do të na e bënte qejfin. Por është një kërkesë shumë vitale për popullin shqiptar dhe prandaj Beogradi, qeveria e Beogradit, si një qeveri shoviniste e tërbuar në kulm, na e mohon me aq këmbëngulje për arsye se , a do të mund të na mohojë apo jo do ta tregojë e nesërmja e shenjtë, se si do të mbarojë puna!"* (E botoi për herë të parë Faridin Tafallari në shkrimin: ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981; www.albaniapress.com, 22 nëntor 2008)

KOVAÇEVIQ MILIJA kryetar i komisionit ekonomik që e ka përfaqësuar Kosovën në Federatën Jugosllave.

Jusuf Gërvalla: *"Fraza më e dashur e Jugosllavisë, e cila trumbetohet sa herë të shfaqet rasti i përshtatshëm në mjetet e informimit publik, është një frazë tipike e kolonizatorit: Jugosllavia do bëjë çmos që ta nxjerrë Kosovën nga prapambeturia ekonomike e sociale, Federata do të ndaj ndihma të jashtëzakonshme për zhvillimin e shpejtuar të Kosovës. Përshtypja e pjesës së painformuar të opinionit është se Jugosllavia është dërmuar duke ndihmuar Kosovën, por kjo, Kosova, si një pus i pafund, kurrsesi të*

ngopet! Ndërkaq, Milija Kovaçeviqi, në cilësinë e kryetarit të Komisionit ekonomik që e përfaqëson Kosovën në Federatë, shkruante para disa vjetësh në gazetën e përditshme "Rilindja": "Që nga viti 1947 e deri më 1977, për çdo dinarë të investuar në Kosovë, ka marrë nga Kosova dy dinarë e gjysmë".

Si merren nga Kosova dy dinarë e gjysmë etj.?" (Bashkimi, prill 1980, faqe 5)

KRASNIQI BESNIK, veprimtar në Kosovë dhe Australi. Djali i Metush Krasniqit. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Besnik Krasniqi, Po Box 1314 Bunbury 6230 W.A. Australia. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

KRASNIQI HAMIT, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Hamit Krasniqi, Rübinhomle 30 D-7074 Albsdadt 2. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

KRASNIQI HAXHI, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Haxhi Krasniqi, Köhlerstr. 30, 4250 Botorp 2. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

KRASNIQI METUSH – Metush Krasniqi lindi më 19. 8. 1927 në fshatin Dajkoc, Komuna e Dardanës (ish-Kamenicës).

Për herë të parë e kanë burgosur në Lubjanë në pranverë të vitit 1947, sa ishte në shërbimin ushtarak!

Për herë të dytë e kanë burgosur më 1948 në Gjakovë. Arrestimi është bërë para nxënësve të Shkollës Normale, kur po i ndiqte mësimet përfundimtare në këtë shkollë.

Për herë të tretë e kanë burgosur në vitin 1956, gjatë aksionit të armëve. E kanë dënuar me 60 ditë burg! Ky dënim iu shqiptua se nuk dorëzoi armë dhe e akuzuan se po bënte propagandë kundër rendit kushtetues të Jugosllavisë, për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Iu kishin zënë disa shkrime me planprograme shkollore në gjuhën shqipe, sepse ishin të ndaluara! Në këtë kohë ishte drejtor i Shkollës Fillore në fshatin Roganë!

Zhvillimet politike dhe luftarake gjatë Luftës së Dytë Botërore i lanë trojet shqiptare të copëzuara dhe nën pushtimin jugosllav, gjegjësisht pushtimit serb. Vrasjet dhe burgosjet e shqiptarve, pas vitit 1945 dhe dalja në skenën politike e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, si dhe burgosjet e pushkatimet e krerëve të NDSH-së, nuk e lanë kurrë të qetë Metush Krasniqin.

Për herë të katërt Metushin e burgosën më 3 nëntor 1958, kur i ngritën aktakuzë dhe e nxorën para Trupit Gjykues të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit më 1- 7 mars 1959.

Në Gjykatën e Qarkut në Gjilan ka filluar gjykimi kundër Metushit Krasniqit, Sejdi Kryeziut, Mark Gashit, Mehmet Nuredinit, Qemajl Kallabës e Mehmet Ajetit. Gjykimiështë pritur në opinion me interesim të madh. Propaganda e UDB-së i dha publicitet të madh këtij gjykimi.



Metush Krasniqi

Veprimtaria kombëtare e Metush Krasniqit dhe e shokëve të tij trajtohej nga propaganda e Beogradit si vepër penale kundër shtetit. Grupi i tij akuzohej si nacionalistë, irredentistë, terroristë…Nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë të grupit ilegal të Metush Krasniqit, shkruante shtypi iasaj kohe, "përmes luftës së armatosur e dhunës kanë planifikuar shkëputjen e Kosovës nga Serbia- Jugosllavia dhe bashkimin e saj me Shqipërinë". Kjo pra ishte propaganda thelbësore me akuza sa më të rënda në mënyrë që "armiqtë" të dënohen sa më parë me dënime të rënda!

Fjala përfundimtare e Metush Krasniqit para trupit gjykues

…Gjendemi para një trupi gjykues pa dëshirën tonë. Këtu na ka sjellë UDB-a dhe gardianët na mbajnë të mbyllur në burg. Para këtij trupi gjykues duhet të flasim pa droje se do të na përsëritet dhuna e inspektorëve të sigurimit shtetëror jugosllavë dhe e gardianëve të burgut, si hyzmeqarë të tyre, të cilët për këto katër muaj janë sjellë ndaj të burgosurve sikur ndaj shtazëve. Të themë se asgjë nuk ka të vërtetë në aktakuzë, nuk është e drejtë, por para se me folë, dua të parafrazoj një realitet tjetër që ka të bëjë me shqiptarët;

– E para, nga pushteti jugosllav Kosova shfrytëzohet mizorisht, populli shqiptar trajtohet sikur në Jugosllavinë e kralit, nuk i gëzon të drejtat më elementare në asnjë segment të jetës, si në punësim, në administratë, në shëndetësi, në arsim, në kulturë etj.

– E dyta, nga pushteti "popullor"i Jugosllavisë së Titos nuk iu ka hequr dhuna popullit shqiptar. Unë e shtroj pyetjen, sa shqiptarë janë ekzekutuar pa gjyq prej nëntorit të vitit 1944 e deri sot? Sa vrasje ndodhën në emër të "armiqëve" të shtetit? Me dhjetëra mijëra shqiptarë… Mund të jenë edhe më shumë se 20 mijë në gjitha trojet shqiptare në Jugosllavi.

– E treta, aksioni i armëve u zhvillua vetëm në Kosovë për t'i çarmatosur shqiptarët. Pse i njëjti aksion nuk u zhvillua edhe në republikat tjera? Pse kjo dhunë dhe këto vdekje të dhunshme të shqiptarëve? Pse një pushkë është shitur me dhjetëra herë? Pse shqiptarët i nënshtroheshin atij terrori në emër të Partisë Komuniste Jugosllave? Në rrethin tonë, në Kamenicë, si pasojë i patëm tri vdekje dhe mbi 3000 të keqtrajtuar fizikisht me metodat më sadiste, që munden t'i bëjnë vetëm regjimet antipopullore ndaj shtetasve, duke i trajtuar si skllevër!

Këtu i ndërhyni në fjalë kryetari i gjyqit, duke e kërcënuar se do t'ia merr fjalën, dhe i thotë; – I pandehur, ti po e paraqet mbrojtjen tuaj apo shqiptarët po i mbron? Metushi vazhdoi: – Tash dua me dalë te mbrojtja.Po ju pyes juve, si është e mundur që prej duarve të UDB-së të ikë Sahit Zubaku e të shkojë të varet në nallbanhanen e Ismajl Zubakut? Ju, si gjykatës, mund të ma merrni fjalën, megjithatë jeni të thirrur të gjykoni drejt, e jo sikur këta zotërinjtë, të cilët i tregojnë muskujt para të burgosurve dhe të vetmin mjet të komunikimit e kanë shkopin në dorëne tyre dhe dhunën fizike!

– E katërta, a po i sheh këta shokët e mi, hiq Metën, të tjerët janë të pestit mësues me profesion, shqiptarë më të shkolluar në trevën tonë nuk kemi. Ky është shkaku pse na keni burgosur, por duhet ta dijë shteti juaj se nxënësit, të cilët kanë dalë prej tyre, nuk do ta ndjekin rrugën e shtetit i cili e përdor dhunën ndaj shtetasve të vet dhe do t'i respektojë edhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kurse UDB-a dhe policia juaj prodhojnë vetëm dhunë e asgjë tjetër…

Këtu kryetari i trupit gjykues ia mori fjalën Metushit dhe e ftoi një dëshmitar serb, Jovo Milenkoviq,i cili mes tjerash, deklaroi: – Metush Krasniqi, gjatë fushatës zgjedhore të Këshillit Popullor në Muçiverc, në vitin 1957, agjitonte kundër kandidatëve, të cilët i kishte propozuar partia komuniste dhe pushteti popullor. Në vend të tyre kishte dëshirë t'i zgjidhte nacionalistët dhe armiqtë, siç ishin: Sejdi Kryeziu dhe Qemajl Kallaba. Metushi gjithnjë ka dëgjuar radiostacione reaksionare, si: Radio BBC-në, "Zërin e

Amerikës" etj.Rregullisht ka bërë propagandë kundër shtetit tonë nëpër oda dhe ndeja me katundarë, si në Hogosh, Rogaçicë, Muçiverc, Hodonoc, Strezoc, Dajkoc etj. Po ashtu, iu ka shpjeguar se çka ka lexuar nëpër gazeta të huaja kundër Serbisë, sidomos nga gazetat e Shqipërisë, Turqisë etj.

Ja se çka mund të nxjerrë njeriu nga ky dëshmitarë shovinist serb, të cilin UDB-a e ka përpunuar se si me folë dhe me shprehë urrejtjen ndaj fqinjve të tij shqiptarë. Vlenë të theksohet se, pos Metushit e Sejdi Kryeziut, edhe Mark Gashi i ka mohuar deklaratat e dhëna në hetuesi, sepse ato deklarata janë konstruktuar sipas diktatit të inspektorëve të UDB-së, si dhe është përdorë dhuna fizike ndaj të akuzuarve.

Anëtari i trupit gjykues, Mustafë Hoxha, iu drejtua Metushit:

– I pandehurMetush Krasniqi, tregoni gjyqit se a është ky nënshkrimi juaj?

– Po, gjykatës, para se të përgjigjem në pyetjen tuaj, po e shtroj një kundërpyetje, pse vallë nuk më pyetët se si kemi kaluar në hetuesi? Shikoni këta shokë, të gjithë kanë qenë mësues, kanë punuar me zell nëpër shkolla me nxënës, por dhunën e xhelatëve tuaj nuk e kanë imagjinuar.Megjithatë, e kanë provuar në lëkurën e në trupin e tyre, në qelitë ku qëndrojnë, trajtohemi më keq se kafshët. Në emër të drejtësisë dhe propagandës ju servoni lagështi. Promaja na mbyti, nga plagët e dhunës na kullojnë këmbët. Nuk kemi trajtim mjekësor e ju ende pyesni se a është ky nënshkrimi im apo jo!?Të gjitha këto na i shkaktojnë gardianët e burgut dhe inspektorët tuaj, që janë të gjithëpushtetshëm. Duke u bazuar në këtë që theksova, deklaratat nuk i pranoj si të mijat, sepse kanë mund të falsifikohen, por qëndroj pranë kësaj deklarate të cilën e japë para gjyqit.

Metushi vazhdoi para këtij gjyqi: – Deklaroj me përgjegjësi morale dhe politike se e kam themeluar organizatën politike "Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin amë". Referatin e kam shkruar unë, e kam bërë skicën për formacionin ushtarak, brigadën e luftëtarëve shqiptarë të Moravës lindore (ORGANOGRAMIN), e kam vizatuar shqiponjën dykrenare për t'u betuar para saj, i kam shkruar poezitë, traktet e proklamatat, i kam bërë thirrje popullit tim për luftë për çlirim nacional dhe bashkimin me Atdheun tonë – Shqipërinë. Plotësisht jam i vetëdijshëm, ia kam pasur borgj popullit tim, prandaj e kam dhënë një kontribut të vogël, pasi nuk kemi arritur ta çlirojmë. Këtë detyrim, që e kam pasur ndaj popullit tim deri në arritjen e lirisë, nuk do të pushoj së punuari në këtë drejtim, për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet, me një emër të natyrshëm, Shqipëri!

Trupi gjykues mbeti i shtangur, duke e dëgjuar Metush Krasniqin,i cili vazhdoi:

Vërtet kam shkruar për masakrat e gjenocidin ndaj popullit shqiptar, të cilin e ka shkaktuar shteti jugosllavë.Pra, kam shkruar dhe do të shkruaj deri sa t'i realizojmë kërkesat tona. Nuk mund të quhet krim nëse lufton për çlirimin e popullit tuaj e të atdheut. Nuk është krim nëse e pengon shpërnguljen e popullit tuaj dhe e pengon kolonizimin me serb e të tjerë! Mund të më quani nacionalist dhe irredentist, por unë ndihem krenar. Ju nuk mund të më dënoni për krimet që i ka bërë shteti jugosllav ndaj shqiptarëve prej nëntorit të vitit 1944 e deri në aksionin e armëve më 1955/56 dhe për torturat që ia kanë shkaktuar popullit shqiptar. Ju mund të më dënoni, mirëpo drejtësia është në anën time dhe të shokëve të mi. Nëse, sadopak, kam thënë të pavërteta, atëherë unë bartë përgjegjësi.

Nëse mund të më bindni se Sahit Zubakun nuk e kanë varur milicët dhe UDB-a, atëherë do të isha i lumtur sikur të dilte e kundërta, se Sahiti është i gjallë.

Krejt në fund, me përgjegjësi deklaroj; – Edhe nga kjo gjykatë e thërras popullin shqiptar të organizohemi dhe ta luftojmë këtë pushtet, i cili i vret qytetarët e vet. Derisa të jam i gjallë do të punoj për çlirimin e trojeve shqiptare dhe bashkimin me Shqipërinë.

Pastaj, janë marrë në pyetje të gjithë të akuzuarit, por nuk kishin se çka të shtonin pas fjalimit të të madhit Metush Krasniqi. Edhe prokurorit i humbi llogaria, sepse shumë pak informacione kishte nga ato që i paraqiti Metushi në fjalën përfundimtare para trupit gjykues, ndërkaq mbrojtësit kukulla, që i kishte caktuar gjyqi, nuk patën se çka të flasin.

Shqiptimi i dënimit për Metushin me shokë:

Në fund, më 7 mars 1959, në bazë të nenit 117, alineja 1, në lidhje me nenin 100 dhe 101, alineja 1 e kodit penal të RFPJ, Gjyqi i Qarkut në Gjilan ua shqiptoi dënimin të akuzuarve, sa vijon:

Metush Krasniqidënohet më 18 vjet burg të rëndë dhe me tri vjet përkufizim të të drejtave qytetare,
Mark Gashi dënohet me 10 vjet burg të rëndë dhe dy vjet përkufizim të të drejtave qytetare,
Sejdi Kryeziu dënohet me 10 vjet burg të rëndëdhe dy vjet përkufizim të të drejtave qytetare,
Mehmet Nuredin Dërmaku dënohet me dy vjet burg të rëndë,
Qemajl Kallaba dënohet me një vit e gjysmë burg të rëndë,
Mehmet Ajeti, dënohet me një vit e gjysmë burg të rëngë.

Për herë të pestë Metushin e burgosin në nëntor të vitit 1969, pas demonstratave të vitit 1968! Akuzohej për organizimin e demonstratave dhe bashkëpunimin me organizatorët e demonstratave. E liruan gjoja në mungesë të fakteve, sepse asnjëri nga organizatorët nuk e zuri në gojë emrin e tij!

Në realitet Metushi ishte ideolog i demonstratave të vitit 1968. Ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë e kishte Ismajl Dumoshin, përmes të cilit takoheshin me Osman Dumoshin. Megjithatë, Metushi bashkëpunonte me të gjithë organizatorët e demonstratave, por shumica prej tyre kanë menduar se vetëm ai kishte kontakte me Metushin(!) si, Hasan Dërmaku, Skënder Kastrati, Osman Dumoshi, Selatin Novosella, Isa Kastrati, Rexhep Mala, Ilmi Ramadani etj. Pas lirimit nga burgu Metushi ka pasë kontakte pothuaj me të gjithë ish-të burgosurit politikë të trojeve shqiptare.Nga të gjithë ka qenë i pranueshëm. Kjo flet shumë për një personalitet, i cili nuk e përjashton askend por i bashkon të gjithë!

Metush Krasniqi ishte përpjekur, me tërë qenien e tij, që energjitë atdhedashëse të të gjithë veprimtarëve, pa dallim ideje, t'i shkrijë në dobi të çështjes kombëtare, për Shqipërinë.

Se puna e tij ishte në frymën e bashkimit kombëtar, e paraqes një fakt konkret: Metushi organizoi një pritje të ngrohtë në shtëpinë e vet, në Dajkoc të Dardanës, më 2, 3 dhe 4 shtator të vitit 1974, bashkë me Adem Demaçin, Mulla Ramë Govorin, Hyrije Hanën, Ahmet Haxhiun, Selman Ramadanin, Fehmi Bajramin, Sylë Krasniqin (pleqnar), Hazir

Krasniqin (kushëri). Në këtë takim ishin edhe Ilmi Ramadani, student, si dhe Emin e Besnik Krasniqi, nxënës.

Nga këto biseda me ndjenja të larta atdhedashurie u arrit marrëveshja e pajtimit në ide e veprime dhe u vendos që të vazhdohet lufta nacionalçlirimtare e Kosovës e viseve tjera në ish-Jugosllavi vetëm me një "Platformë Politike Kombëtare", as në të majtë e as të djathtë, nga i cili takim, në vitin 1974, do të lind "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës" dhe, më vonë, LNÇKVSHJ-ja e viteve 1976/77.

Mjerisht,në vitin 1975 pushteti antishqiptar e burgosi Adem Demaçin me dhjetra shokë, por Metush Krasniqin nuk e burgosën. Megjithatë, veprimtarinë politike nuk e ndërpreu për asnjë çast!

Për herë të gjashtë Metushin e burgosën në prill të vitit1981, pas demonstratave gjithëpopullore. E mbajnë katër muaj të izoluar në Burgun e Gjilanit! Prej Metush Krasniqit UDB-a kërkonte që ta nënshkruajë një kërkesë për ta liruar nga burgu. Mirëpo, Metushi iu përgjigjet: – kur më keni burgosur, nuk kam bërë kërkesë, prandaj ju më keni burgosur, poashtu duhet edhe të më lironi.Pas daljes nga burgu Metush Krasniqin e shohim duke bashkëpunuar me organizatat ilegale të kohës dhe bashkëpunimi me ta për ta arritur qëllimin themelor, për themelimin e Republikës së Kosovës, por kurrsesi të mos ndalet ideja e bashkimit të trojeve shqiptare me Shqipërinë!

– Pas demonstratave të vitit 1981 Metush Krasniqi ka pas kontakt me shumë individë dhe grupe, të cilat punonin për çlirimin e Kosovës, si me OMLK-në – Hydajet Hysenin, Albanikos-in – me Emin Krasniqin, Besnikun, Ramizin etj.

Për herë të shtatë Metushin e burgosin më 4 nëntor 1985 dhe në burg e mbajnë deri më 17 qershor 1986. Metushin e bashkangjitën me një grup nga Ferizaj, ku ishte i akuzuar edhe Ramadan Haziri, Sylejman Bytyçi etj. Atë e liruan nga burgu por familja e dërgoi në spital. Pasojë nga torturat çnjerëzore të UDB-së, vdiq më 15 tetor 1986 dhe është varrosur me nderime të larta në fshatin e lindjes, në Dajkoc.

Shefik Sadiku

Janë mbajtur shumë përkujtime për Metushin, duke filluar nga 14 prilli 1990. Shkollën fillore në fshatin Rogaçicë e emëruan me emrin e tij.Me rastin e 5-vjetorit të vdekjes, në një tubim të gjerë në shkollën fillore "Metush Krasniqi" në Rogaçicë, marrin pjesë shumë shokë të Metushit, në mesin e të cilëve ishin: Mark Gashi, Sejdi Kryeziu, Vesel Shala, Rexhep Avdullahu, Murteza Nura, Selatin Novosella, Skender Kastrati, Hasan e Xhavit Dërmaku e shumë të tjerë. Vlenë të veçohet shënimi i 10-vjetorit të vdekjes, i mbajtur në Rogaçicë, në mes të cilëve mori pjesë edhe Hyrije Hana dhe Adem Demaçi e shumë ish-të burgosur politikë.

Adem Demaçi e ka vlerësuar lart veprimtarinë politike të Metush Krasniqit: Bac Metushi nuk u ndal kurrë së vepruari për çlirimin e kombit dhe Atdheut dhe bashkimin e tij.Ky ishte motivi, edhe pse e vrau armiku ynëshekullor. Kishin frikë nga Metushi, kurse prej neve nuk kanë frikë.Për këtë arsye na lejojnë të sorollatemi poshtë e lartë dhe të bëhemi në copa, si subjekte politike dhe shpërndahemi si zogjtë e qyqeve nëpër këto "parti" dhe asgjë nuk realizohet prej tyre. Ju thërras, nga ky përvjetor, që ta përkujtojmë këtë kolos të pashoq, të cilin e kishim në mesin tonë por nuk ditëm ta ruajmë, të bashkohemi rreth idealit të tij dhe t'i bashkojmë të gjitha forcat mendore e politike dhe ta kapitalizojmë idealin e tij e ta çlirojmë këtë pjesë të territorit të robëruar nga Serbia.

Emrin e Heroit, Metush Krasniqi e mban Shkolla Fillore në Roganë të cilët ia kanë ngritur Bustin!

Heroit, Metush Krasniqit, iu ka ngritur një shtatore në Parkun e Ulpianës në Prishtinë dhe një shtatore tëngjashme edhe në Qytetin e Dardanës. Punëtorët e Hekurudhës së Kosovës ia kanë ngritë njëbust pranë Stacionit të Trenit në Fushë-Kosovë. Në Drejtorinë e Hekurudhës së Kosovës Metushi ka punuar deri në burgosjen e tij të fundit, pasi e kishin diferencuar nga Shkolla e Mesme Teknike e Prishtinës, ku punonte si referent.
Metush Krasniqi është shpallur HERO I KOSOVËS, prandaj,vepra e tij është e përjetshme.
Lavdi e përjetshme për Heroin, Metush Krasniqi!

Me rastin e shënimit të 35 vjetorit të Heroit, Metush Krasniqi, kjo kumtesa u lexua ne Tryezën e mbajtur më 15.10.2021 në Prishtinë. E organizuar nga Këshilli Organizativ "Pranvera Shqiptare '81"!

Shefik Sadiku
Më 15.10.2021, Prishtinë

KRASNIQI ZEQIR, Jusuf Gërvalla: *"Ta shfletojmë gazetën e 27 prillit 1980, artikullin me titull "Urdhëroni parmenda!"*

"U shitën parmendat? – e pyetëm Zeqir Krasniqin nga Llodroviqi.

Posi! Ende kam myshterinj të mirë... në disa fshatra ende punohet me parmendë", gazeta jonë të ther mu në zemër. Por, në shekullin e satelitëve dhe të kompjuterëve, shqiptari i Kosovës lavron ende me parmendë!" (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, f. 2-3)

KREÇMER PAUL (PAUL KRETSCHMER), lindi më 2 maj 1866 në Berlin, vdiq më 9 mars 1956 në Vjenë. Ka qenë profesor në Universitetin e Marburgut, i gjuhësisë krahasimtare, më pas në Universitetin e Vjenës. Më 1896 botoi veprën "Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache" ("Hyrje në historinë e gjuhës greke"). Në këtë vepër pioniere ky dijetar u kushton mbi 40 faqe ilirëve dhe rolit të tyre në hershmëri. Gjatë studimeve në Vjenë, Eqrem Çabej ka ndjekur ligjëratat e Paul Kreçmerit dhe të Norbert Joklit.

KRIZMAN BOGDAN, lindi më 28 qershor 1913 në Varazhdin, vdiq më 5 korrik 1994 në Zagreb. Ka qenë një historian kroat. U ka bërë analizë elaborateve të Ivo Andriqit dhe Ivan Vukotiqit kundër popullit shqiptar.

KRYEZIU MAHMUT, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Mahmut Kryeziu, Frolihstr. 12, 89 Augsburg. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

KRYEZIU MURAT, veprimtar i dalluar i rrethit të Shtutgartit. Në vitet 1981-1983 ka banuar në adresën: Murat Kryeziu, Nord-West-Ring 30, D-70794 Filderstadt. Në mbrëmjen e 16 janar 1982, banesa e tij ka qenë e mbushur me aktivist, duke shikuar filma të Rilindjes Kombëtare, të tubuar aty me iniciativën e Vëllezërve Gërvalla.

KRYEZIU SHEMSEDIN, veprimtar në Austri. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Shemsedin Kryeziu, Hotel Z. Hircshen Sant Julistr 21 Salzburg. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

KRYEZIU ZYMER, një prej veprimtarve kryesor të rrethit të Dusseldorfit. Shokë dhe këshilltar i ngushtë i Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës. Në vitet 1981-1983 ka banuar në këtë adresë: Zymer Kryeziu, Dorotenstr, 85, D-4000 Düsseldorf

KUÇI SHKURTE-DRITA – Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarës Shkurte-Drita Kuqi, profesoreshë nga f. Junik KK – Deçan, e lindur më 20 shtator 1956, në të njejtin fshat, në të njejtin fshat, me profesion profesoreshë e gjuhës shqipe pran QAMO "Xhevdet Doda" në Prishtinë. ... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjetësh."*

KUÇI VEBI, familje patriotike në Francë, që në vitet 1981-1985 e ndoshta edhe më vonë, ka banuar në Merý, rreth 60 km në veri të Parisit.

kulak fjalë ruse për bujk, pronarë toke. Gjatë revolucionit rus dhe gjatë viteve 1920 dhe 1930 fjala kulak ka marrë kuptimin e një bujku që ka bërë rezistencë kundër përpjekjeve, masave të komunistëve për kolektivizimin e bujqësisë.

KUNDËR SHQIPËRISË Disa emra për të cilët Jusuf Gërvalla, në dhjetor të vitit 1981, mendon se nuk ia vlen me ua dërgua gazetën.

Jusuf Gërvalla: "*Vehbi Ibrahimi, i vrarë në Belgjikë, ishte sekretari personal i (E. Kastriotit). Ky far Emili i së ashtuquajturës "Besëlidhja shqiptare", është një nga reaksionarët më të mykyr të shqiptarëve në Perëndim. Enver Hadri, për sa jam i informuar, i takon gjoja një partie komuniste, por me orientim prorus. Edhe Martin Camaj, për sa dimë, është* ***kundër Shqipërisë****. Për emrat e tjerë, adresat e të cilëve na janë dërguar me nga një pikëpyetje pranë, nuk dimë gjë. Ne s'po u dërgojmë tash për tash asgjë, derisa të mos vërtetohet puna e tyre. Në qofshin si këta që përmendëm më lartë, s'kemi pse ua dërgojmë as "helmin", lëre më shtypin tonë. (Fjala është për Hasan Beun në Amerikë, Hysen Çamin në Suedi, Vincenzo Gollettin në Frankfurt).* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.452-454)

KUNUSHEFCI FERIZ. Pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës (më 17 janar 1982) në adresë të Familjes Gërvalla dhe të Kadri Zekës kanë ardhur shumë letra ngushëlluese, nga anë të ndryshme të botës, si nga Sydnei i Australisë,

nga Nju Jorku i Amerikës etj. Në mesin e këtyre letrave është edhe një letër e Feriz Kunushefcit, i cili ato ditë ishte në burgun e Heilbronit.

Ferizi në letrën e tij shkruan:

E DASHURA NANË SHQIPTARE

Ket leter poe shkruej edhe deshiroj ngushllime te thella per djemt e juej si e dhan jeten per vendlindje edhe per popullin Shqiptar. Mos u merzit hiq se djemt e juej jeten e kan dhan edhe nuk jan ma ne mesin e familjes se vet. Trupi i tyre ka vdek, por vepra e tyne edhe puna e tyne per popullin shqiptar kurr nuk ka me vdek. Banu e fort edhe thuej: Djemt e mij nuk jan dek por kan lind, se jan dek per Atdhe per popullin shqiptar. Anmiku popullin shqiptar nuk mund mei tut me pushk. Djemt e juej jan Heroja ata nuk jan dek ne krevet por tue punue edhe tue u mundue dit e nat per neve te gjithve shqiptarve. Djemt e tu i ka njoft bota edhe i njef. Djemt e juej nuk vdesin kurr sikur Skender Beu edhe Bajram Curri ata nuk vdesin por jan met neper zemrat e qdo njenit shqiptar. Mos qaj e mos u merzit se qdo Nané nuk munet me marue asi djemsh! Une Adresin e juej nuk e di por familjen e juej e njef bota tash se e kan dhan jeten vllaznit per popull shqiptar. Une kit leter pi shkruej se me ardh meu pa per kit vdekje nuk muj se une jam ne burg ne Heilbronn. Vetem zemra po me qan per ata dy trima tu edhe per at shokun apo mikun e djemve tu. Banu e fort edhe zemer guri se djemt tu nuk jan vdek po jan lind se e kan dhan jeten per popull te vet e jo per veti. Vllaznit: Isufin dhe Bardhin i kemi humb por ata na e kan lan ni veper edhe ni pun edhe jan vdek me ftyr edhe per popull edhe kan mbet ne zemrat tona gjithmon oj nané. Tash po i dha fund edhe mos u mërzit ti as familja e juej hiq se per kto pun nuk mun des gjithkush oj nané shqiptare.

Feriz Kunushefci

Nga burgu i Heilbronnit" (Nga arkivi i Faridin Tafallarit)

KURTULUS RAMIZ, shtetas i Turqisë me prejardhje shqiptare apo nga viset shqiptare. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ramiz Kurtulus, Gazi Osman Pasa cad. No. 16 Aliböjköy, Istanbul. *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës i është dërguar për ta informuar me gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi.

L

labor-force survey përdoret për hulumtimin e madhësisë dhe llojit të punës me pagesë. Të dhënat mblidhen përmes intervistave hulumtuese. Përdoren katër lloje kategorish gjatë analizës së fuqisë punëtore:

1. Të inkuadruar, që janë në punë,
2. Të inkuadruar, të cilët nuk janë në punë (pushim vjetor, sëmundje etj.),
3. Të painkuadruar, apo të papunë, të cilët kërkojnë punë,
4. Të painkuadruar, që nuk janë në kërkim të punës (student, persona që nuk mund të punojnë etj.).

Ata që ju takojnë ndonjërës prej tri kategorive të para llogariten, definohen si fuqi punëtore. Nëse gjatë dy apo më shumë matjeve analizohen ndryshimet në madhësinë a kategorive të ndryshme, deri në njëfarë mase mund të vlerësohen ndryshimet në situatat konjukturale. Gjithashtu vëmendje i kushtohet ndryshimeve tek fuqia punëtore sa i përket aspektit të moshës, gjinisë, gjendjes civile, llojit të veprimtarisë ekonomike etj.

LAÇI HAMZA, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Hamza Laçi, Westfalenweg 103, 4837 Verl; Tel. +49-52462308. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

LAHU ABDYL – Avdyl Lahu, i lindur më 1 tetor 1944 në Gllamnik. Ka kryer fakultetin filozofik grupi i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, më 4 qershor 1980 është dënuar me 4 vjet burg.

LAJMËTARI I LIRISË, revistë e botuar, në pjesën më të madhe, me forcat e Vëllezërve Gërvalla, të inspiruar nga lufta e Komitetit të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës në rrethin e Deçanit. Përfundimisht revistë e cila i dedikohet Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, pasi revista aprovohet me entuziazëm nga të gjitha rrethet. Ky dedikim më së miri shihet në fjalët e Jusufit:

Jusuf Gërvalla: "*Kërkesa për t'iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, nga të gjitha dokumentet e LNÇK të botuara në organet "Zëri i Kosovës" dhe* ***"Lajmëtari i lirisë",*** *si dhe në të gjitha traktet tona*." (Komunikatë e KQ të LNÇK, gusht 1981)

Kanë dalë tre numra: Gusht 1980, tetor 1980 dhe janar 1981.
Koka e Lajmëtarit e ka pasur këtë formë:

Me penë dhe pushkë...

lajmëtari i lirisë

...për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë socialiste!

Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendëse, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e popullsisë së vendit dënohej të ndërronte zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi. ARBEN PUTO

viti I nr. 1 gusht 1980

LAJMI I 10 QERSHORIT 1980 Jusuf Gërvalla: *"Më 10 qershor të këtij viti, "Rilindja" mori lejë të nxirrte emrat e një grupi prej 8 vetash: Shefqet Jashari, Ramadan Pllana, Avdi Kelmendi, Abdyl Lahu, Isa Demaj, Sylejman Qyqalla, Skënder Jashari dhe Hysen Gërvalla – që Gjykata e Qarkut të Prishtinës u dha dënime 3-8 vjet burg të rëndë për "vepër penale të propagandës dhe bashkimit me qëllim të veprimtarisë armiqësore*"." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 2)

LATA BAJRAM veprimtar, në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Bajram Lata, Kastellstr.11, 7972 lsny Allgäu. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

learning (*mësim*) proces përmes të cilit vihet tek një lloj i reaksioneve apo modifikim reaksionesh nëpërmes përsëritjes së tyre (reaksioneve) apo përsëritjes së situatës stimuluese që bëhet shkak për atë lloj reaksionesh.

legitimacy *legjitimitet* Një sistem autoritativ ka legjitimitet nëse sistemi njihet (pranohet) nga ata që i nënshtrohen sistemit, kur anëtarët e një shoqërie, një organizate ose një grupi pranojnë të udhëhiqen, për shkak se ata e ndiejnë një obligim moral për t'a ndjekur atë rrugë që udhëheqësit e tregojnë. Sipas Max Weber, legjitimiteti është baza e vetme dhe e mjaftueshme për një sistem efektiv autoritativ.

Max Weber bënë dallimin në mes tri llojeve të autoritetit legjitim.

A) Autoriteti legal, që është shenjë karakteristike për burokracinë. Udhëheqësit ose janë të zgjedhur apo të emëruar (të caktuar nga organe tjera në atë detyrë) dhe udhëheqja burokratike është, si në pjesët ashtu edhe në tërësinë e vetë, racionalisht e organizuar. Individët e ndiejnë veten në radhë të parë të obliguar t'i ndjekin ligjet dhe rregullat dhe jo personat që e ushtrojnë autoritetin. Ata që ushtrojnë autoritet janë të obliguar t'i ndjekin rregulloret e caktuara gjatë ushtrimit të detyrave të tyre udhëheqëse. Nëse ata i tejkalojnë këto rregullore atëherë autoriteti i tyre nuk është më legjitim.

B) Autoriteti tradicional, që është shenjë karakteristike e mënyrës patriarkale të udhëheqjes. Baza e këtij autoriteti qëndron mbi besimin se rendi social ekzistues është i shenjtë, stabil dhe i pandryshueshëm. Individi është i ndëgjueshëm personalisht ndaj udhëheqësit për shkak se pozita e tij është e shenjtëruar nga tradita. Udhëheqësi nuk caktohet në bazë të kompetencës së tij, siç është rasti tek mënyra burokratike e udhëheqjes, por para së gjithash në bazë të shoqërisë, miqasisë apo farefisnisë me udhëheqësin. Të drejtat e udhëheqësit janë të padefinuara në formë të qartë, ato ndryshojnë prej rasti në rast dhe përcaktohen nga udhëheqësi. Nëqoftëse udhëheqësi gjatë ushtrimit të detyrës devijon shumë nga tradita atëherë pushon edhe legjitimiteti i tij.

C) Autoriteti karizmatik, që është shenjë karakteristike për profetë, udhëheqës ushtarak ose demagogë të mëdhenj. Kryesisht është "lideri" është ai tek i cili janë të drejtuar sytë e "nxënësve". Nxënësit, (dishepujt) e ndëgjojnë udhëheqësin vetëm në bazë të kualiteteve të tija të jashtëzakonshme personale, d.m.th. jo për atë se autoriteti i tij është legal, i përkufizuar me ndonjë ligj, dhe as për atë se ai mbështet në ndonjë traditë që konsiderohet e shenjtë. Nga kjo rrjedh se mënyra e udhëheqjes së tij është krejtësisht e pamvarur nga rregulla të shkruara apo nga tradita. Legjitimiteti i tij si udhëheqës pushon së ekzistuari kur përkrahësit e tij nuk shohin më tek ai ato veti të jashtëzakonshme, të cilat e kanë bërë atë udhëheqës.

LENIN (1870-1924) ”*Pika qendrore e edukimit internacionalist të punëtorëve në vendet shtypëse duhet patjetër të jetë propaganda dhe mbrojtja nga ana e tyre e lirisë së shkëputjes së kombeve të shtypura. Pa këtë nuk ka internacionalizëm. Ne kemi të drejtë dhe duhet ta trajtojmë çdo socialdemokrat (kupto komunist) të një kombi shtypës, i cili nuk e bënë këtë propagandë si imperialist dhe maskara*.”

Jusuf Gërvalla: "*Një i burgosur politik kosovar paska deklaruar para do kohësh se është marksist-leninist i bindur; kur e pyesin më gjatë në hetuesi, ai gjoja qenka përgjigjur se nuk e ka lexua asnjë vepër të Leninit.*

Kështu thotë Tanjugu dhe kjo mund të jetë e vërtetë, dhe, edhe po të jetë e vërtetë, s'ka krisur kiameti. Të burgosur politikë shqiptarë - vetëm pas ngjarjeve të përgjakshme të marsit dhe prillit - ka me mijëra, e të paktën janë 232 sish, të shpallur zyrtarisht, që kanë marrë dënime drakoniane. Dhe në mos të gjithë, në pjesën dërmuese po se po, në mos marksistë-leninistë të ngritur, këta të burgosur janë së paku ithtarë e dashamirës të

marksizëm-leninizmit. Dhe kjo mjafton për fillimin e çdo lufte çlirimtare dhe të çdo revolucioni.

Nga ana tjetër, ky është një grusht i rëndë për sistemin e arbitrarizmit policor jugosllav, sado që qeveria e Beogradit, me maskën e "marksizëm-leninizmit" mbi surrat, ushtron një pushtet thellësisht antimarksist, antipopullor e antikombëtar. Prandaj i pëlqen aq shumë Tanjugut ta ngrejë në dukuri çështjen e atij luftëtarit tonë të lirisë, i cili s'e paska lexuar Leninin. Por kjo nuk na brengosë fare, ne jemi të vetëdijshëm që Tanjugu, sikur të kish pasur në dorë shënime qoftë vetëm edhe për një tjetër të burgosur politik shqiptar, "që të mos e ketë lexuar Leninin", nuk do të lente kurrë pa e propaganduar gjerë e gjatë në shtyp me një vetëkënaqësi edhe më të madhe kreteneske. Por, tukse s'e përdori, do të thotë se nuk e gjeti.

Konkluzioni është i qartë. Policia e fshehtë jugosllave, ose në mënyrë më të popullarizuar UDB-ja, përpiqet ta kompromet ojë me cinizëm figurën e luftëtarëve tanë të lirisë. Prandaj, me gojën e Tanjugut, ajo bien në 'rezignacion' pse këta nuk e paskan lexuar Leninin! E ç'të mirë mund të pres arbitrarizmi policor jugosllav nëse kundërshtari i tij i lexon veprat e viganit të revolucionit socialist. Ato, a ishin në anën e arbitrarizmit policor, apo pikërisht në anën e kundërshtarëve të tij? Mos, duke lexuar Leninin, luftëtarit tonë do t'i bjerë hovi revolucionarë? Apo do të ngjasë e kundërta.

Megjithatë, pasi i 'pëlqeka' UDB-së, ne që s'e kemi lexuar dhe që e kemi lexuar pak Leninin, tash e tutje do ta lexojmë edhe më me zell." (Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 10-11)

Jusuf Gërvalla: "*Sepse siç na porosit udhëheqësi i madh i revolucionit të parë socialist në botë, Lenini: sa më shumë e më seriozisht ta zbatojmë teorinë marksiste të revolucionit dhe të luftës çlirimtare, aq më seriozisht dhe në mënyrë më të thelluar do ta kryejmë detyrën tonë revolucionare në të demaskuar të armikut në baza të shëndosha teorike e praktike të revolucionit, aq më me sukses do t'ia dalim t'i këpusim hallkat e hekurta të censurës që ushtrohet mbi shtypin legal (shtetëror), kurse përfaqësuesit e regjimit do t'i detyrojmë kështu të dalin para popullit me përgjigjet e tyre pikërisht lidhur me ato pyetje vitale, të cilat ne do t'i kemi shtruar paraprakisht në shtypin tonë ilegal dhe në gjithë veprimtarinë tonë të organizuar revolucionare.*" (*Zëri i Kosovës*, janar 1982, faqe 4-5)

liberalism *liberalizmi* përgjithësisht, një rrymim politik dhe ekonomik i cili don që individit t'i epet një e drejtë maksimale e vetëvendosjes. Ky definim fillestar nuk është gjithmonë i zbatueshëm. Me liberal në SHBA mendohet përafërsisht një radikal jo-socialist që kërkon rritjen e ndikimit të shtetit, dhe që gjendet në krahun e majtë të qendrës së politikës amerikane. Në Evropë partitë liberale qëndrojnë në mes atyre konzervative dhe socialiste. Qëndrim i përbashkët për të gjitha drejtimet që e quajnë veten liberale, është toleranca ndaj minoriteteve dhe atyre që mendojnë ndryshe, p.sh. në pikëpamje religjioze.

life-chances, term i përdorur nga Max Weber me qëllim të formulimit ekzakt të definicionit të klasës. Për Max Weberin, faktori vendimtar, kur është në pyetje diferencimi i klasave është shpërndarja e të mirave, përparësive, p.sh. pasurisë dhe mundësive për shkollim. Në një situatë, të pastër, në ekonomi tregu, kjo shpërndarje është shkaktare e ndryshimeve në mes klasave të ndryshme, e cila ka si rrjedhim krijimin e dallimeve në life-chances, do me thënë mundësinë me e mbajtë ose me e ngritë një status social të caktuar.

life style 1. Psikoanalisti Alfred Adler me këtë fjalë mendon në metodat të cilat individi i përdorë për t'i arritur qëllimet e tij në jetë dhe për t'i zgjedhur problemet që i paraqiten në lidhje me ushtrimin e profesionit të tij, jetën seksuale dhe rolin e tij si anëtarë i shoqërisë. Stili i jetës së individit, mendon Adleri, përcaktohet kryesisht gjatë fëmijërisë së hershme nën ndikimin e prindërve.

2. Të gjitha klasat sociale kanë tendenca për ta pasur një stil të jetës të vetin, më pak apo më shumë të dalluar prej klasave tjera. Stili i jetës së klasave të ndryshme praktikohet të dallohet pos tjerash: veshje, edukimin e fëmijëve, aktivitete të lira, moralin seksual dhe në mënyrën e përdorimit të gjuhës.

LIPOVICA RASIM – Rasim Lipovica, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit dhe shok i Jusuf e Bardhosh Gërvallës.

LIRIA, Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës (OMLK). Kanë dalë gjashtë numra: 1. Tetor 1980, 2. Dhjetor 1980, 3. Maj 1981, 4-5 gusht 1981 dhe 6. Dhjetor 1981. Numrat 3 dhe 4-5 janë përgatitur, shtypur në Shtutgart dhe organizimi i dërgimit të tyre për Kosovë është bërë nga shtëpia e Jusuf Gërvallës.

LIRI (anglisht *freedom, liberty*; frengjisht *liberte*; latinisht *libertas*; gjermanisht *Freiheit*). Në kuptimin tonë të përditshëm, në njërën anë, mendojmë se mund të diskutojmë dhe të marrim vendime, dhe në këtë kuptim kemi liri për të zgjedhur (në mes alternativave të ndryshme). Në anën tjetër mendojmë se në natyrë çdo gjë e ka shkakun e vet, është e vendosur nga një shkak dhe mu për këtë pyesim se mos edhe veprimet tona janë të lidhura në zingjirin shkak-pasojë. Në bazë të këtyre dy interpretimeve, në dukje, kundërthënëse mbi realitetin, lind **problemi metafizik** rreth *vullnetit të lirë* dhe atyre përpjekjeve tradicionale për zgjidhjen e tij.

1. Në bazë të **fatalizmit** (nga latinishtja fatalis, "e vendosur që nga krijimi i botës") përjetimi i lirisë për të zgjedhur është një iluzion. Pamvarësisht se çka bëjmë, e ardhmja do të formohet "ashtu siç është shkruar", siç është vendosur nga fati apo siç ka vendosur krijuesi. I ngjashëm me fatalizmin është i ashtuquajturi determinizmi logjik, ku potencohet se; pasi deklarimet tona për të ardhmen qysh tani janë të vërteta apo false, qysh tani, në baza logjike duhet të jetë e vendosur se si do të jetë, si do të duket e ardhmja.

2. Forma tjera të **determinizmit** (latinisht determinare, me e kufizue, përcaktue) pranojnë se zgjedhjet tona apo veprimet tona kanë ndikim në ngjarjet e ardhshme, pasi këto janë të pranishme dhe janë shkaktare të tyre (ngjarjeve të ardhshme). Por njëkohësisht potencohet mendimi se vetë zgjidhjet dhe veprimet tona janë të përcaktuara nga shkaqet e mëparshme (të natyrave fiziologjike, mentale ose sociologjike). Në kundërshtim ndaj fatalizmit pranohet se (a) e ardhmja mundet me qenë ndryshe dhe (b) se e tashmja dhe e ardhmja kishin mund me qenë ndryshe sikur e kaluara të kishte qenë ndryshe, por duke u bazuar në të dhënat faktike të së kaluarës e tashmja dhe e ardhmja janë definitivisht të vendosura, të përcaktuara.

Në bazë të së ashtuquajturit **determinizimit të fortë,** kjo do të thotë, se edhe nëse veprimet tona nuk janë të vendosura nga ndonjë krijues, prapë se prapë është një iluzion të flitet për "*zgjedhje të lira*" në bazë të "*vullnetit të lirë*", kur në rrethanat e dhëna nuk ka kuptim të flitet "se unë kisha mund me veprua ndryshe". Për këtë arsye njeriu nuk është përgjegjës për veprimet e tij, dhe të gjitha gjykimet morale, lavdatat apo kritikat janë të pavend.

Në kundërshtim me këtë **determinizmi i butë** (i quajtur edhe si **kompatibilizëm**, "pikëpamje përbashkuese", nga anglishtja compatible, bashkues, jokundërthënës), potencon se është i mundur bashkimi i përvojës së veprimeve të lira me determinizmin. Liria është një çështje e mungesës së detyrimit të brendshëm apo *të jashtëm.* Një njeri vepron lirisht kur e bën atë që dëshiron, do me thënë vepron në bazë të dëshirave, qëndrimeve, pikëpamjeve, karakterit të tij, etj. Liria dhe shkak-pasoja mund të bashkohen, dhe për këtë nuk ekziston ndonjë problem teorik lidhur me përdorimin e koncepteve morale. Lira e njeriut nuk është një çështje rreth gjithçkafit apo asgjësë, por është çështje shkallësh. Krejt sipas rrethanave, një njeri është më pak apo më tepër i lirë dhe liria duhet gjithmonë të vlerësohet konkretisht. Përkrahës të këtij determinizmi të butë janë pos tjerësh Hobbes, Locke, Hume, J. S. Mill, Ayer dhe përgjithësisht filozof të traditës empiriste dhe liberaliste. Gjatë viteve 1900 filozofia analitike ka përpjekur ta thelloj determinizmin e butë duke e analizuar edhe konceptin *veprim* dhe janë bërë diskutime se a është fare e mundur që veprimet të shpjegohen si pasoja të një shkaku.

3. Përkrahësit e **indeterminizmit** e mohojnë si fatalizmin ashtu edhe të gjitha format e determinizmit. Ata e pranojnë se veprimet vërtetë kryhen në rrethana të caktuara të llojit fiziologjik, mental apo sociologjik ("trashëgimi dhe mjedis"), por ata e përjashtojnë mendimin se veprimi apo pasojat e tij janë *pasojë* e domosdoshme e *shkaqeve* të mëparshme. Njeriu e ka një vullnet të lirë me ndihmën e të cilit ai mund të bëjë zgjedhje të cilat paraprakisht nuk janë të përcaktuara.

Indeterministët i kanë dy probleme themelore:

a) problemin për ta shpjeguar raportin në mes njeriut si pjesë të asaj natyre të përcaktuar nga shkaku-pasoja. Zgjidhja *moniste* niset nga ajo se njeriu i lirë është një pjesë e botës, por në gjendje ta shkëpusë zingjirin e shkaqeve dhe të ndërhyjë në te. Tek filozofë të tjerë bëhet një zgjidhje *dualiste*, sipas të cilës njeriu është pjesëtar në botëra të ndryshme, në botën e lirisë dhe në atë të domosdoshmërisë, dhe këto dy botë janë dy sfera të pamvarura. Kantit (sigurisht gabimisht) i është mveshur një dualizëm i tillë. Pos të tjerëve D. Davidson ka paraqitur pikëpamje të ngjashme.

b) Pa marrë parasysh bashkimin në njërën apo tjetrën, prej këtyre dy zgjidhjeve (moniste apo dualiste), prapë se prapë do të ndeshet problemi për dallimin në mes zgjidhjes së lirë, të *indeterminuar*, dhe vetëm asaj mungese të shkaqeve dhe *ligjshmërive* (rastësisë). P. sh. si mund të bëhet dallimi në mes një veprimi të lirë të indeterminuar dhe një ngjarje indeterminuese atomike tek Epikuri apo në kuantfizikën moderne?

4. Në bazë të Karl Jaspers (1883-1969) si fatalistët, deterministët dhe indeterministët tradicional e kanë gabim, pasi ata gabimisht e kuptojnë njeriun si një send (objekt) në mesin e sendeve tjera dhe tek pastaj pyesin nëse ky send a është i lidhur në zingjirin shkaqeve apo jo. Por njeriu karakterizohet pikërisht nga ajo se ai nuk është send (objekt), por një subjekt që ekziston, subjekt i lirë i cili tejkalon (transcendon) sendin (send-shmërinë). Pikëpamje të ngjashme gjenden tek Kierkegard, Heidegger dhe Sartre.

Problemi metafizik mbi *vullnetin e lirë* dhe këto katër përpjekje për zgjidhje që janë përmendur më lartë sillen rreth kuptimit të pastër metafizik mbi lirinë. Anash këtij kuptimi rreth lirisë, ekziston gjithashtu një **kuptim normativ rreth lirisë**, sipas të cilit njeriu është i lirë nëse ai vetë-realizohet (self-realization=zhvillim i balancuar i personalitetit njerëzor, ku asnjë pjesë nuk dominon mbi një tjetër.), (liria si vetë-realizim). Diskutimi mbi **kuptimin normativ rreth lirisë** ia prenë shpeshherë udhën diskutimit metafizik mbi vullnetin e lirë.

Në mesin e problemeve kryesore janë:

a) A është qëllimi më i rëndësishëm i njeriut të bëhet pjesë e një tërësie?

b) A janë mjetet më të rëndësishme diçka mbi të cilat ai (njeriu) vetë mund të vendosë – apo ato janë objektivisht të dhëna në një mënyrë apo tjetër?
c) Cilin rol luan vetëdija e njeriut mbi vetveten për zhvillimin e balancuar të personalitetit të tij, ku asnjë pjesë nuk dominon mbi një tjetër (vetë-realizimit)?

1. Për **fatalistin** para së gjithash çështja e vetë-realizimit është përmes;
a) pajtimit me fatin e tij, apo fisit të tij dhe të mos luftoj kundër asaj që është e pashmangshme.
b) Tradicionalisht fatalistët i konsiderojnë qëllimet finale të jetës (fisit apo botës) objektivisht të dhëna qysh atëherë kur është krijuar bota. Mësimet e Niçes "mbi rikthimin e përjetshëm" mund të interpretohen si shembull i mendimit fatalist.
c) Kuptimi i ekzistencës si domosdoshmëri e palakueshme konsiderohet si qendror për jetën e lirë.

2. a) Përgjithësisht **deterministët e fortë** kanë një tendencë ta konsiderojnë individin vetëm si një moment në një tërësi botërore, në atë mënyrë që individi bëhet i lirë përmes nënshtrimit ndaj kërkesave të tërësisë. Në mënyrë të kundërt **deterministët e butë** kanë një tendencë ta konsiderojnë individin si qëllimin më të rëndësishëm, që shihet më së lehti në traditën e liberalizmit (p. sh. Locke), ku liria normative shihet si mungesë e detyrimit të jashtëm dhe të brendshëm. Hegeli mund të interpretohet si determinist i butë, që thotë se individi është i lirë tek atëherë kur dëshirat e tij përputhen me qëllimin e tërësisë.
b) Nuk ekziston unitet në mes deterministëve se lidhur me atë se a ka vlerëshmëri objektive kuptimi i jetës apo jo. P. sh. një utilitarist si J. S. Mill kishte me thënë se po, ndërsa Ayer do ta mohonte këtë, megjithëse që të dy janë determinist dhe liberalistë.
c) Ekziston unitet lidhur me atë se njohja e situatës personale është një kusht i domosdoshëm për të arritur lirinë në kuptimin normativ.

3-4. a) Intederministët e llojeve të ndryshme i konsiderojnë zhvillimet origjinale individuale si synimin më të lartë të lirisë. Kanti dhe filozofët ekzistencialistë (p. sh. Jaspers apo Sartre) janë këtu shembuj të pamohueshëm.
b) Por në anën tjetër ekziston jo-uniteti lidhur me atë se a janë synimet përfundimtare të jetës objektive apo jo. Jaspers dhe Sartre e mohojnë statusin objektiv të synimeve jetësore. Ndërsa Kierkegaard në një pjesë të shkrimeve të tij, si dhe më vonë Scheler, thonë se çdo njeri e ka një detyrë individuale (një ide të personalitetit), të cilën ai duhet ta vetë-realizoj përmes zgjidhjeve të interdeterminuara për të arritur liri të plotë. Sipas Sartrit zgjidhjet themelore të ndonjërit lidhur me synimet jetësore janë indeterminante dhe pa ndonjë njësi matëse objektive. Në disa pjesë tek Kierkegaard dhe tek Scheler, në anën tjetër, thuhet se ne, vërtetë jemi indeterminent kur është çështja të bëjmë zgjidhjet, nëse ne duam ta realizojmë synimin e vërtetë me jetën, por ne nuk mund të vendosim (të zotërojmë situatën) se çka do të duhej të bëjmë këtu në jetë. Kant thotë diçka të ngjashme. Sipas Kantit për ne është e mundur që ta përdorim lirinë tonë zgjedhëse indeterminante në mënyrë të kushtëzuar, por nuk është liri e vërtetë. Liria e vërtetë kërkon që t'u nënshtrohemi ligjeve të pandryshueshme morale, autor i të cilave, në bazë të fuqisë së arsyes, jemi vetë.

c) Ekziston unitet lidhur me atë se liria ka si parakusht ekzistencën e një vetëdije mbi situatën vetjake, pasi zgjidhjet indeterminante të (drejtë) një synimi kanë si parakusht ekzistencën e vetëdijes mbi situatën personale.

LISTA E NJË PJESE SHQIPTARËSH TË BURGOSUR

Jusuf Gërvalla**: "*Kush thumbit e kush potkoit***

Revista jonë ishte në përfundim e sipër kur ne siguruam të dhënat për ngjarjet e mëposhtme. Ç'është e vërteta pjesën më të madhe e dinim edhe më parë. Por prisnim ndonjë listë konkrete, që do të paraqitte, në mënyrë më të afërme, sidomos gjendjen tonë sa u përket burgosjeve të egra, që UDB-ja po zbaton masivisht në viset shqiptare, gjithnjë më intensivisht prej më se dy vjetësh e këtej, duke u përpjekur të na trembë e të na qes pengesë pas pengese në rrugën e lëvizjes sonë patriotike e revolucionare. Kështu na shënimet relativisht të bollshme që mblodhëm tani, u detyruam ta zgjerojmë gjithë numrin e revistës sonë me këtë shtojcë, dy faqesh, që i kapërcen shpenzimet tona edhe ashtu të mëdha për shtypjen e revistës. ***Qëllimi kryesor ishte që të mos presim t'i botojmë ato në numrin e ardhshëm, nga i cili do të na ndaj shumë kohë, kurse nga materialet e përgatitura më parë për këtë numër nuk gjenim asnjë të tepërt, që të hiqnim dorë prej tij kësaj radhe.*** *Prandaj, në qoftë se materialet e shtojcës nuk do të jenë të përpunuara në nivelin e shkrimeve tjera, nga lexuesi ynë i ndershëm kërkojmë ndjesë.*

Ja që u krye lista e një pjese shqiptarësh të ndershëm, që UDB-ja jugosllave i burgosi - me dorën e veglave të fëlliqura kosovare - vetëm në periudhën prej 21 nëntorit 1980 deri në të aguar të 1 janarit 1981:

1. Hasan Ukëhaxhaj, nga Carrabregu, magjistër i gjuhës shqipe, arsimtar në QAMO "Vëllezërit Frashëri" të Deçanit,

2. Ibish Neziri, nga Bardhaniqi, student i gjuhës shqipe, i burgosur më 21 nëntor 1980,

3. Bajram Gashi, nga Llapushniku, milic me shërbim në fshatin Cërmjan, student i gjuhës shqipe në SHL të Gjakovës,

4. Ali Mehmeti, nga Botusha, mësues në Mushtisht të Suharekës,

5. Sokol Mehmeti, gjithashtu nga Botusha, student,

6. Ramiz Zeqiri, nga Brovina, student i gjuhës shqipe,

7. Xhafer Sylejmani, nga Nivokazi, student

8. Musa Berisha, nga Duboviku, student i letërsisë shqipe, i arrestuar gjatë kohës që po bënte shërbimin ushtarak diku në Slloveni,

9. Ismet Ibërdemaj, nga Peja, student në Prishtinë,

10. Hysen Gegaj, nga Sallagrazhda, bujk, në kohën e arrestimit punëtor i inkuadruar në botën e jashtme, e

11. Danush Gegaj, nga Sallagrazhada, student në Prishtinë, që, bashkë me të vëllain, Hysenin, u arrestuan në mëngjesin e 1 janarit 1981, në shtëpinë e lindjes, në Sallagrazhdë." (Lajmëtari i lirisë, janar 1981 - Shtojca)

LOSHI ASLLAN, SHALA IBRAHIM DHE SARAMATI RUZHDI;

Jusuf Gërvalla: "*Nëse gjyqi, shtypi, radioja dhe televizioni jugosllav e shohin të arsyeshme t'i dënojnë "Për vepër penale të propagandës dhe të bashkimit me qëllim të veprimtarisë armiqësore kundër popullit dhe shtetit" patriotët dhe revolucionarët Shefqet Jashari, Ramadan Pllana, Avdi Kelmendi, Abdyl Lahu, Isa Demaj, Sylejman Qyqalla, Skënder Jashari, Hysen Gërvalla,* ***Ibrahim Shala, Asllan Loshi, Ruzhdi Saramati*** *dhe gjithë kusurin që tepron nga dy mijë e më shumë të burgosur politikë shqiptarë brenda disa muajsh (që mund të supozojmë pse nuk shpallen botërisht emrat e tyre), ç'na mbetet*

neve tjetër pos t'i nderojmë këta revolucionarë dhe të mburremi siç mburret çdo popull me bijtë e vet më të mirë." (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 1-2)

LUFTA E SPANJËS, Jusuf Gërvalla: *"Nëqoftëse populli shqiptar ishte në gjendje që në vitin 1936/37 të dërgonte njësitë të tëra me në krye heronjtë e popullit tonë, që ne sot i njohim, si Asim Vokshi, Xhemal Kada, Mehmet Shehu, Justina Shkupi e të tjerë në Front, në luftë për republikën e Spanjës, atëherë si mund të dyshojmë dhe nëqoftëse ne dyshojmë në forcat progresive të botës do të gabojmë për arsye se është një mori njerëzish progresivë njerëzish liridashës në botë, që lirinë e të tjerëve e respektojnë si lirinë e vet. Kurrsesi nuk duhet të dyshojmë në ndihmën që do të kemi nga forcat internacionaliste të gjithë botën, aq më tepër kur sot ekziston një pishtar, i cili është burim për energjitë e këtyre forcave përparimtare. E ky burim nuk është as më shumë e as më pak po pikërisht vendi amë i shqiptarëve pra i kosovarëve, ai që sot të gjitha forcave në botë, po jua tregon rrugën e drejtë të lirisë, të drejtësisë, njerëzisë, humanitetit, të demokracisë e socializmit."* (E botoi për herë të parë Faridin Tafallari në shkrimin: ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981; www.albaniapress.com, 22 nëntor 2008)

LL

LLESHI GAZMEND, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasë këtë adresë: Gazmend Lleshi, 1330, S.Central Chikago 60650 U.S.A. Ka qenë një prej pikave prej nga u shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

M

machine *makineri* term i cili në kuptimin sociologjik në radhë të parë përdoret për të përshkruar disa dukuri në jetën politike në SHBA. Më së shpeshti me *machine* mendohet rrethi më i ngushtë në një parti. Ky grup pak a shumë homogjen e ruan unitetin duke u bazuar në ambiciet për ta marrë pushtetin. Machine në këtë kuptim është një term neutral (nuk zgjon asociacione as pozitive e as negative). Në kuptime tjera koncepti machine (makineri) ka ngarkesë negative. Një *machine*, në këtë kuptim karakterizohet nga korrupsioni dhe pandershmëria. Qëllimi i makinerisë është për ta rritur pushtetin e bosave në radhë të parë, dhe të partisë në radhë të dytë.

MALA HASAN; *"Apostol Duka: -U arritë ky bashkim, ose shkrirja e* ***dy organizatave*** *në një të vetme, nëse mund të shprehemi kështu?*

Hasan Mala: *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të dyja organizatat të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej* ***'Liria'****. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e* ***Frontit****, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 256-257)

Xhafer Shatri: *"Ta thjeshtësosh në një individ pa asnjë peshë, vrasjen e tyre, mua më duket absolutisht e pafalshme, dhe realisht kjo punë bëhet edhe nga njerëz të cilët në vitet 1980-të kanë arritur që lëvizjen kombëtare ta përçajnë keqas dhe ta zëmë citatin e Jusuf Gërvallës të cilin ne e venim në ballë të Zërit të Kosovës e i cili ishte një*

*citat kushtrimtar i cili thoshte: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme." Do me thënë dhe në vend të tij ta nxjerrësh pastaj "**Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!"** Njeriu nëqoftëse i shikon këto gjëra do me thënë e sheh që **përpiqen ta mbrojnë Jusuf Gërvallën njerëzit që janë përpjekur ta vrasin për së gjalli, t'i vrasin idetë e tij, idetë e tij nacionaliste**."* (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 25-28)

MALAJ QAZIM, veprimtar në Gjermani, nga rrethi i Deçanit. Jemi njohur me te përmes Naim Haradinajt. Në banesën e tij ka vazhdue aktiviteti me shfaqje filmash, kur janë mbledhur me dhjetëra e dhjetëra punëtor të rrethit të Bonit, menjëherë në ditët pas 17 janarit 1982. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Qazim Malaj F. Grem Stationsweg 14 D-5210 Troisdorf, tel 0224-173832. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

MALIQI XHELAL "*Njëri nga ata që nuk e braktisi për asnjë çast kreun e turmës së kryengritësve, qe edhe Xhelal Maliqi, punëtor nga Prishtina.*

Xhelal Maliqi u lind më 11 janar 1957 në Prishtinë. Ai ishte djali i pestë i Abdylit dhe i nënë Myhybes. Duke qenë fëmija më i vogël, ai ishte më i përkëdheluri në familje, si nga prindërit, ashtu edhe nga të katër vëllezërit e mëdhenj.

Familja Maliqi mbahej me rrogën e vogël të babë Abdylit, shërbëtor në Spitalin e Prishtinës. Prandaj Xhelali nuk arriti të shkollohej si shokët e tij. Qysh fëmijë i vogël, ai u detyrua të punonte çirak në dyqanin e një qebaptori. I zoti i dyqanit dhe punëtorët tjerë e donin dhe ia kishin hatrin, se Xhelali ishte i shkathët, i vyer e i ndershëm. Ato pak para që merrte me djersën e tij djaloshare, të derdhur që nga orët e hershme të mëngjesit e deri në mbrëmje vonë, rregullisht ia dorëzonte nënë Myhybes.

Xhelali u lind në një kohë kur populli shqiptar po përjetonte një nga çastet më të vështira në historinë e tij, aksionin famëkeq të armëve, të ushtruar nga këlyshët çetnikë të Rankoviqit. Më vonë, duke u rritur, ai mësoi për shumë fatkeqësi që i kishin rënë mbi kokë familjes dhe popullit të tij. Ai sa vinte e mbushej urrejtje ndaj shkaktarëve të këtyre fatkeqësive dhe dashuri të pamatë ndaj atyre që luftonin kundër padrejtësive e terrorit shtetëror jugosllav që ushtrohej mbi shqiptarët.

Gjatë punës, ai nuk dinte për hile. Duke qenë vetë i varfër, i donte të varfrit, kurse ata që luftonin për të varfrit i adhuronte dhe përpiqej t'i ndihmonte me çka kishte mundësi. Shpesh kishte ngjarë që, rastësisht, në dyqanin ku punonte ai të hynte edhe ndonjë patriot, për të cilin Xhelali kishte kuptuar se është i papunë dhe i ndjekur nga UDB-ja. Prandaj, sa herë që njerëz të tillë vinin në dyqan, ai nuk u merrte para për bukën varfanjake që hanin aty, kurse të zotit të dyqanit ia kompensonte nga xhepi i vet.

Erdhi një ditë që disa punonjës të Radiotelevizionit të Prishtinës, në afërsi të të cilit ndodhej edhe qebaptorja ku punonte Xhelali, duke parë sjelljen e tij shembullore dhe karakterin e një njeriu të vyer, i gjetën një vend pune në RTP.

Një prilli e gjeti në këmbë mbarë Kosovën. Kërkesa "Kosova–Republikë" i theu të gjitha rrethimet e hekurit dhe zjarrit.

Për herë të fundit e mbushi me gurë xhaketën e tij Xhelal Maliqi ditën e tre prillit. Dhe nuk arriti t'i hedhë të gjithë gurët, që qenë arma e vetme e tij dhe e popullit gjatë kësaj lufte çnjerëzore të pabarabartë. Forcat policore vinin duke u shtuar si thneglat. Kur i binin nga plumbat e milicisë xhakatare shokët e shoqet, Xhelali nuk trembej, por i shtohej urrejtja, e me të edhe forca për të qëndruar sa më burrërisht. Mirëpo, një plumb

automatiku, që e godit mu në zemër, ia ndërpreu luftën Xhelal Maliqit. Në çastet e fundit të jetës ai u bërtiti shokëve përreth: "Mua më goditën, ju vazhdoni… Rroftë populli shqiptar…" Dhe pasi eci ashtu edhe disa metra, ia dha në dorëzim shpirtin e ri përjetësisë.

Shokët dhe vëllezërit e tij nuk lejuan që policia t'ia merrte e t'ia zhdukte kufomën Xhelalit, si bëri me shumë kufoma të dëshmorëve tanë të orëve të para, që ranë gjatë kryengritjes.

Të nesërmen, ndonëse i tërë qyteti ishte bllokuar e të gjitha rrugët e tij ishin mbushur me tanke e autoblinda, prapëseprapë, një numër shumë i madh qytetarësh u mblodhën për ta përcjellë Xhelalin në rrugën e tij të fundit.

Xhelal Maliqi vdiq njëherë për të jetuar gjithmonë në zemrën e popullit të vet, si të gjithë ata bij të tij të shtrenjtë, të cilët dhanë jetën e tyre që të tjerëve t'u sigurohet një jetë më e mirë e më e lumtur. (*Zëri i Kosovës*, janar 1982, faqe 18)

MARINC ANDREJ, – Andrej Marinci lindur më 1930 në Celje, punëtor shoqëroro-politik i RSFJ dhe RS të Sllovenisë. Anëtar i Partisë "Komuniste" të Jugosllavisë nga viti 1947.

Jusuf Gërvalla: *"Pas ngjarjeve të Kosovës, përçarja e mospajtimet janë ashpërsuar edhe në mes klaneve nacionaliste në udhëheqjen më të lartë të Federatës. Kjo u duk qartë edhe nga fjala e Andrej Marincit, të cilin klani kroato-sllloven e kishte dërguar si përfaqësues të vet në mbledhjen e 6 gushtit të Komitetit Krahinor. Ai u dërgua për të nuhatur situatën politike në Kosovë, për ta parë nga afër se deri ku kanë arritur fërkimet mes shqiptarëve e borgjezisë serbe, por edhe për të paralajmëruar klanin serbo-malazez se nuk është ai i vetmi që bën ligjin në Jugosllavi e për t'u vënë fre ambicieve të tij për një pushtet despotik.*

Ai përgëzoi kolegët e tij serbë për masat e rrepta që kanë ndërmarrë kundër shqiptarëve, por nga ana tjetër nuk harroi t'i qortonte ata për masat e nxituara e të pamatura, që dëmtojnë Jugosllavinë në planin ndërkombëtar e mund të rrezikojnë edhe sigurinë e saj.

Ai, duke bërë fjalë për rolin e ushtrisë në ngjarjet e Kosovës, rikujtoi se udhëheqja më e lartë e Federatës ka dërguar armatën në Kosovë "para së gjithash për të zënë pozitat", e jo me fjalë tjera, të gjuhet me gurë rrugëve me pionierë e nxënës të shkollave të mesme. Tërthorazi ai bëri edhe vërejtje të tjera rreth politikës së terrorit, që zbaton udhëheqja serbe në Kosovë (këtë jo se ai është më dashamirës i shqiptarëve sesa kolegët e tij serbë, por për hir të interesave konjukturale të borgjezisë së vet, të cilën e përfaqëson). Dhe më vonë ai filloi të profetizojë për mënyrën se si mund të dilet nga kjo gjendje e nderë në Kosovë, se si duhet të dalë regjimi titist nga qorrsokaku ku është futur. "Shokë, – thërret Marinci, – ne jemi në situatën kur para së gjithash është thelbore lufta politike, pra, me mjetet e punës e të aktivitetit me qytetarë përmes punës politike. Në praktikën tonë politike ne kemi ikur gjithmonë nga aktivitetet që kanë si mjet detyrimin, mjetet e shtetit etj." Kjo të bie te konkluzioni se, si pasojë e interesave egoiste, nacionaliste në rivalitetin e grupeve të ndryshme borgjeze në udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit jugosllav, ka mospajtime e kundërshtime edhe ndaj dënimeve të ashpra që po shqiptojnë gjyqet serbe në Kosovë.

Qeveritarët e lartë jugosllavë edhe "ideologët" e "vetadministrimit" janë të shqetësuar seriozisht, pasi veprimet e tyre antinjerëzore e antishqiptare e demaskuan keq para botës dhe e zbuluan hapur regjimin e tyre fashistë e gjakatar. Ata gjithashtu po e shohin se megjithë mizoritë që kryen, nuk arritën ta mposhtin e ta gjunjëzojnë popullin tonë. Ata e mbytën në gjak Kosovën tonë martire, por edhe planet e tyre të mbrapshta nuk arritën t'i realizojnë. Populli ynë po e vazhdon pa u trembur rezistencën dhe nuk ka forcë

në botë ta frikësojë e ta largojë nga rruga e tij e drejtë, nga rruga për t'u çliruar prej tutelës e shtypjes së shovinistëve serbë." (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 4-5)

MARKS, - KARL HEINRICH MARKS lindi më 5 maj të vitit 1818 në **Brückenstraße 10, D-54290 Trier**, Gjermani; vdiq më 14 mars të vitit 1883 Londër, Britania e Madhe. Ishte një filozof, ekonomist politik dhe organizues revolucionar i Shoqatës Ndërkombëtare të Punëtorëve. Ndërsa Marks merrej me një gamë të gjerë problemesh, puna e tij më e famshme analizon historinë e luftës së klasave. Qysh në fjalinë e parë të Manifestit Komunist, ai deklaron: *"Një fantazmë sillet nëpër Evropë.*"

Xhafer Shatri: *"Kemi insistuar për një takim, sepse e pamë se veç ia kanë nisur t'i përçajnë radhët tona, të organizojnë edhe njerëzit e organizuar, duke u shërbyer me shpifje dhe dinakëri krijuan konfuzion të madh sidomos në rrethin e Shtutgardit. Kjo reflektohej keq te punëtorët. U përpoqëm të bisedojmë bashkarisht për këto probleme, por u iknin takimeve. Njëherë udhtuam me* ***mija kilometra*** *për t'u takuar, por ai burri i botës i iku takimit, vetë shoku i tij më i ngushtë ikjen e tij e çmoj si tradhti... Ky rast pati pasoja të mëdha. Herën e dytë i shkruam letër urgjente që të propozojnë se ku po shihemi dhe kur, bile morëm përsipër që të* ***udhëtojmë 5000 kilometra****, me rreziqe të shumta, por përgjegje morëm vetëm pas dy muajsh, kuptohet përgjegje negative."* (Qarkore, qershor 1983)

marksizmi Kontributi më i madh i Karl Marksit në teorinë e sociologjisë është koncepti i tij i klasave, i bazuar në kontrollin e mjeteve të prodhimit, dhe nënvizimi i tij në luftën e klasave si shkaku kryesor i ndryshimeve sociale. Raportet në prodhim (në ekonomi) përcaktojnë karakterin e fenomeneve tjera sociale në një shoqëri. Superstruktura ideologjike, do me thënë arti, literatura, sistemi i normave etj. janë një funksion i ekonomisë. Koncepti *alienation*, ndjenja një personi si të huaj në jetë si pasojë e pozitës së tij në procesin e prodhimit, vjen nga Marksi, ndërsa koncepti *reifikation*, tendenca kur ndjenjat, vlerat etj. shndërrohen në mallra që mund të blihen dhe të shiten në treg, është zhvilluar nga marksisti hungarez Gyorgy Lukacs.

MARKSIZËM-LENINIZMI. Botëkuptimi i proletariatit dhe i partisë së tij revolucionare, shkenca udhëheqëse e tyre. Marksizëm-leninizmi përfaqëson një sistem të argumentuar shkencor pikëpamjesh filozofike, ekonomike dhe socialpolitike, që përbëjnë përmbajtjen e tri pjesëve themelore të tij: materializmi dialektik e historik, ekonomia politike dhe socializmi shkencor.

Doktrina marksiste lindi në mesin e shekullit XIX. Themeluesit e saj janë Marksi dhe Engelsi. Ajo lindi si përgjigje e problemeve që kishte shtrua zhvillimi ekonomik, politik, socialklasor e shkencor natyror në mesin e shekullit XIX. Doktrina marksiste u bë shprehëse teorike e interesave të proletariatit revolucionar, program shkencor i luftës së tij për socializëm e komunizëm. Doktrina marksiste lindi si trashëgimtarja më e mirë e çdo gjëje pozitive e me vlerë që kishte përpunuar mendimi mijëvjeçar njerëzor. Por në të njejtën kohë ajo shënon një kthesë revolucionare në historinë e mendimit shoqëror, një heroizëm të vërtetë shkencor. Marksi dhe Engelsi bënë përgjithësimin gjenial të historisë e të mendimit njerëzor, zbuluan ligjet e përgjithshme të zhvillimit shoqëror dhe mbi këtë bazë ligjet, normat, metodat, format e mundshme të shndërrimit të shoqërisë, të zhdukjes së kapitalizmit e të ndërtimit të socializmit e të komunizmit.

V. I. Lenini e zhvilloi më tej doktrinën marksiste dhe e ngriti atë në një etapë më të lartë. Leninizmi është marksizmi i epokës së imperializmit dhe revolucioneve proletare. Marksizëm-leninizmi është një teori koherente, e plotë dhe shkencore, një busullë e pagabueshme në duart e proletariatit dhe të popujve të shtypur, që u tregon rrugën e drejtë

në luftën e tyre, që u ndriçon të ardhmen e tyre të ndritur socialiste e komuniste. ((Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, faqe 673)

MARRËDHËNIET SHQIPTARO-SERBE. Jusuf Gërvalla: "*Mendoj se në revistën tonë duhet të bëjë vend sa më shpejt një artikull mbi marrëdhëniet shqiptaro-serbe në periudha të ndryshme. Qëllimi është që të shihet kontinuiteti i aspiratave pushtuese, kolonizuese serbe dhe shovinizmi i tyre, që shkon deri në dëshirën për shfarosjen e plotë të popullit shqiptar. Si literaturë bazë mund të shërbejnë disa punime të Sadulla Brestovcit në "Gjurmime Albanologjike", librat e Shukri Rahimit "Vilajeti i Kosovës" dhe "Lufta e shqiptarëve për autonomi 1897–1912", libri i Z. Canës "Lëvizja kombëtare shqiptare 1908–1912", ai i D. Tucoviçit "Serbia dhe Shqipëria", i Kosta Novakoviçit "Politika e Serbisë në pushtimin dhe serbizimin e Kosovës"(për titullin e këtij të fundit nuk jam krejtësisht i sigurt në është i saktë), libri i Shaban Brahës "Idriz Seferi " etj. Tema duhet të shtjellohet nga një historian i rryer, së pari për nevojat e revistës e pastaj, nëse zgjerohet, mund ta nxjerrim edhe si broshurë a libër. Unë do të përpiqem nga ana ime të gjej njeri të tillë, por edhe më shumë të përpiqeni ju andej. Ideale do të kish qenë sikur përmes Plakut, materiale të tilla me peshë të mund të siguroheshin në rrugën nëpër të cilën më kanë arritur këtu paratë e mbledhura për makinë.*" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 275)

mass *masa* një grup njerëzish që marrin pjesë në një sjellje-mase. Anëtarët e masës vijnë prej të gjitha grupeve të shoqërisë, anëtarët janë anonim, nuk ekziston fare apo mund të ekzistoj një ndërveprim shumë i vogël në mes anëtarëve, të cilët fizikisht janë të ndarë nga njëri tjetri dhe ata janë skajshmërisht pak të organizuar. Kur anëtarët veprojnë ata e bëjnë këtë në mënyrë individuale. Koncepti masë përdoret më së shpeshti në lidhje me komunikimet në masë (masë-komunikim), p. sh. të gjithë ata që e shikojnë një TV-program të caktuar përbëjnë një masë.

meaning *kuptim* (*domethënie)* i një dukurie nuk është absolut, ai duhet të ketë relacion (të lidhet) me atë individ që e pranon (percepton) dukurinë në fjalë. Kuptim do të thotë ai interpretim që individi ua bërë të dhënave që i pranon përmes shqisave të tij. Kuptimi i një simboli apo objekti për individin përcaktohet nga përvoja e tij e mëparshme. Ai (individi) don t'i interpretoj të dhënat e pranuara në atë mënyrë që interpretimi të mos shkaktoj ndryshimin e atitydave dhe ai don t'i grupoj të dhënat në modele të tëra të cilat janë në lidhshmëri me njëri-tjetrin. Metodat për ta hulumtuar kuptimin janë krijuar pos tjerësh nga sociologu amerikan Charles E. Osgood.

MEHA TAHIR – TAHIR MEHA (10 tetor 1943 në Prekaz - 13 maj 1981) dhe
NEBIH MEHA; Jusuf Gërvalla: *"Turpi i mizorit dhe lavdia e heronjve*

Fundi i luftës së 13 majit solli turp e panik të paparë për fashistët e tërbuar serbë përballë armës shqiptare dhe lavdi të pashoqe për Mehajt, Prekazin e Kosovën. Me dhjetëra milicë kishin mbetur të vrarë, me plumbin në lule të ballit ose në dritë të syrit. Qindra të plagosur barti ndihma e shpejtë dhe i shtriu spitaleve. Nga pala tjetër ranë heroikisht të gjithë luftëtarët, gjithsej dy trima të papërkulur shqiptar, Nebihu e Tahiri, që u shpaguan shumëfish. Lajmi i përfundimit të kësaj lufte popullin tonë e la me një ndjenjë të topitur keqardhjeje për jetën e shuar të luftëtarëve dhe me një admirim të pafund për lavdinë e zemrës dhe të armës së tyre. Me shpresën dhe këmbënguljen për vazhdimin, në shembullin e Prekazit, të luftës së ashpër e të pabarabart, por të lavdishme e ngadhënjimtare.

Shpërblim më të mirë për heroizmin e Prekazit nuk mund të ketë. Ndërkaq, armiku mbeti duke fajësuar të tjerët për turpin e vet. Për gjoja mosvigjilencë e mashtrim, u burgosën komandiri, zëvendëskomandiri dhe një milic i postkomandës së Skenderajt, që të tre shqiptarë. Pastaj serbomëdhenjtë u dhanë të vajtonin si qyqe trupin dhe turpin e milicëve të rënë dhe të hanin si gjarpri dhjamin e vet egërsinë dhe helmin që i kaploi përballë trimërisë tradicionale të shqiptarëve.

Sepse, në qoftë se në luftën e tyre çnjerëzore antishqiptare, të egër e të pabarabartë, kanë mundur të sigurojnë epërsi në numër dhe në teknikën ushtarake (një shtet përballë dy individëve, ose përballë një popullsie të vogël duarthatë), serbomëdhenjtë e tërbuar nuk mund ta sigurojnë edhe shpirtin luftarak, frymën e sakrificës së lartë dhe këmbënguljen, të cilat janë virtyte vetëm të atij që bën luftë të drejtë, mbrojtëse.

Nebih dhe Tahir Mehaj mbesin për popullin tonë kujtimi e shkuar kujtimit të Ahmet Delisë e Mursel Ahmetit, të cilët kohë më parë patën luftuar heroikisht po për Prekazin, Kosovën dhe për gjithë Shqipërinë." (*Zëri i Kosovës*, nëntori 1981, faqe 8)

MEHEMTI REXHEP; Aktgjykim: "*Rexhep Mehmeti, i biri i Hajdarit dhe Azemnines e gjinisë Haziri, i lindur më 10.04.1954 në fshatin Dumnicë e Ultë komuna e Vuçitërnës, ku e ka edhe vendbanimin, shqiptar, shtetas i RSFJ, i martuar, baba i 3 fëmijve, ka të kryer SHNE - dega për agjystator, momentalisht i papunë, shërbimin ushtarak e ka rregulluar në Zagreb më 1981, gjindet në EU pranë KK Vuçitërnë, me gjendje të mesme ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në parapurgim prej 15.08.1982,....*

GJYKON

Të akuzuarin Regjep Mehmetin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 8 (tetë) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit....

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË E TITOS

P-nr. 9/83, - më 27.05.1983"

meritocracy *meritokraci* koncept i krijuar nga sociologu anglez Michael Young në *The Rise of the Meritocracy* (1961). Young mendon se një formë e re e elitës shoqërore është në krijim e sipër, një elitë hyrja në të cilën është e bazuar në merita, në radhë të parë arsimim. Konfliktet në mes klasave do të zbuten apo do të zhduken krejtësisht, pasi stratifikimi (shtresimi) në bazë të meritave është një princip i pranueshëm prej të gjitha klasave shoqërore, deri në atë masë sa stratifikimi është fare i pranueshëm. Klasat e ulëta do të varfërohen nga talentet, të cilët do të përfaqësonin e mbronin interesat e tyre.

Young është kritikuar para së gjithash për atë se ai nuk ka mund të ofroj fakte empirike se zhvillimi është duke shkuar në atë drejtim, në ndonjë vend, ashtu siç e ka skicuar ai.

messianic movment *lëvizje mesianike* lëvizje fetare e krijuar rreth një udhëheqësi karizmatik i cili anëtarëve u ofron shpëtim në ndonjë kuptim. Lëvizjet mesianike janë më të rëndomta tek shtresat e ulëta apo tek shtresat e shkreta.

methodology *metodologji* 1. shuma e të gjitha metodave që përdoren brenda një shkence,

2. studimi i metodave të një shkence, se si metodat janë të përshtatura për qëllimin e tyre shkencor për arritjen e diturive të reja. Metodologjia nuk krijon metoda të reja por bënë vlerësimin e atyre metodave që janë në përdorim.

MËRTURI KOLË, – Kolë Mërturi, aktivist i rrethit të Shtutgartit. Shok i Vëllezërve Gërvalla. Përmes Kolës, Jusufi u ka dërguar personave të caktuar porosi.

MËRTURI MARK, – Mark Mërturi, aktivist i Lëvizjes. Është njohur me Sabri Novosellën gjatë kohës në burg.

middleclass shtresë (stratum) në një shoqëri që gjendet në klasës së lartë dhe klasës punëtore. Kufijtë si në drejtim të epërm si në atë të poshtëm janë vështirë të përcaktuar, dhe koncepti klasë-e-mesme është zavendësuar në kuptime shkencore me koncepte tjera klasore më precize.

migration, typologies of *tipologjitë e migrimit*

A) Migrim primar dhe sekundar. Baza për këtë ndarje në këto tipe është se a bëhet shpërngulja në territor të pabanueshëm apo të banueshëm.

B) *Invazion*, *pushtim*, *kolonizim* dhe imigrim. Baza për këtë tipologjizim është se a është bërë migrimi në mënyrë paqësore apo jo dhe a është bërë tek një kulturë më e lartë, më e ulët apo e barabartë.

Kjo tipologji është konstruktuar nga sociologu amerikan Henry Pratt Fairchild në *Immigration: A World Movment and its American Significance* (1925).

C) Tipologjia më e përpunuar është bërë nga sociologu amerikan William Petersen në *A General Typology of Migration (American Sociological Review* 1958). Ndarja e tij kryesore është në atë se a është migrimi konzervativ apo inovativ. Migracioni është konzervativ nëse rezultati i tij për migrantët është rrethana të ngjashme, të cilat migrantët i kanë pasë para shpërnguljes. Migracioni është inovativ, nëse rezultati është rrethana të reja dhe të ndryshme nga ato të cilat migrantët i kanë pasë para shpërnguljes. Migracioni mund të jetë primitiv ose jo-primitiv. Migracion primitiv Petersen e quan atë lloj që shkaktohet nga forcat ekologjike. Migracioni i karakterit nomad është konzervativ, ndërsa migracioni i shkaktuar nga dendësia e popullsisë apo dëmtimit të bujqësisë për shkak të kushteve atmosferike më së shpeshti është inovativ.

Migracioni jo-primitiv mund të jetë vullnetar dhe jo-vullnetar. Nëse organet shtetërore të vet vendit të migrantëve e bëjnë migrimin të detyrueshëm ai bëhet konzervativ, nëse vendi i pranimit të migrantëve është forca nxitëse ai bëhet inovativ (p. sh. tregtia me skllevër).

Migracioni vullnetar, nëse ai bëhet individualisht, më se shpeshti është inovativ (p. sh. shpërnguljet e hershme në Evropë apo Amerikë), dhe konzervativ nëqoftëse bëhet me grupe (p. sh. kur grupe të tëra besimtarësh nën udhëheqjen e një prifti janë shpërngulë në SHBA). Migracioni masiv është konzervativ nëse shpërngulja bëhet prej viseve rurale në vise rurale, dhe inovativ nëse bëhet prej viseve rurale në qytete.

mini-max principle, the koncept brenda teorisë së vendim-marrjes (decision theory) me përmbajtjen se një individ në udhëkryqe zgjedhëse preferon ta zvogëloj rrezikun prej humbjes maksimale. Në këtë mënyrë individi e sakrifikon mundësinë për të arritur fitimin maksimal, nëse qëllimi për ta arritur këtë fitim maksimal është i lidhur me rrezikun për humbje maksimale. Lidhja e kontratave të sigurimeve është një shembull i veprimit sipas mini-max principit.

HIL KABASHI DHE MOTRA E TIJ MARTA

MISIONI I PARË KATOLIK SHQIPTAR NË EVROPË; *"Për ta zbutur sado pak dhimbjen për atdhe dhe për ti ndihmuar atij me kohë u formuan shumë shoqata të cilat vazhduan të përkujdesen për mërgatën shqiptare. Një nevoje të këtillë në ruajtje të kulturës, traditës dhe asaj shpirtërore në njeriun ndjeu edhe ipeshkvnia e jonë e cila përmes françeskanit pater Hil Kabashi (tashmë ipeshkvë për veriun e Shqipërisë) të cilin e dërgoi me mision në Gjermani bëri thuajse të pamundshmen, dhe pas shumë mundimeve dhe sakrificave, por edhe me ndihmën e besimtarëve tanë atje e në veçanti me aktivitetet paraprake për themelim të z. Pjetër Mjedës, hapi Misionin Katolik Shqiptar i cili tani numëron 26 vjetorin e themelimit. Në Gjermani, atëherë shqiptarët katolik të asaj kohe për ta themeluar misionin zgjodhën qytetin e* ***Shtutgartit*** *që ishte një çerdhe për shqiptarët e asaj kohe që numerikisht nuk mund të krahasohet me numrin e sotëm. Kjo qendër e kulturës shqiptare ishte edhe Misioni i parë shqiptar që vepron në shtetet e Evropës.* ***Misioni zyrtarisht u themelua më 12 shkurt të vitit 1984."*** (Kabash-Binçë-Viti, 2012)

Hil Kabashi i lindur më 19 shkurt 1941 në Caparc afër Prizrenit, peshkop katolik, gjatë kohës së tij në **Shtuttgart, pas vitit 1984**, në krye të Misionit katolik shqiptar ishte përgjegjës për kujdesin baritor të rrethit të Jusuf Gërvallës në Shtutgart.

Kur Hil Kabashi erdhi në Shtutgart, me rastin e mbajtjes së meshës së tij të parë, Kolë Paloka e Kolë Mërturi, aktivist të palodhur e të pandashëm të Jusuf e Bardhosh Gërvallës, na njoftuen dhe kërkuen prej shokëve të tyre, që ta presim pater Hilin, si burrë të madh shqiptar, ashtu që të mos mbetet asnjë karrikë e zbrazët. Dhe shokët e Jusuf Gërvallës, në bazë të kulturës e edukatës që e kishin mësuar, iu përgjegjën Kolë Palokës e Kolë Mërturit, dhe ma merr mendja se pater Hili ishte i kënaqur me ne.

MJAKU HASIM, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Hasim Mjaku, Markgrafenstr. 54, 7750 Konstanz. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

monism përgjithësisht pikëpamja se gjithçka mund të reduktohet në një princip të vetëm apo në një substancë të vetme. Në kuptimet sociologjiko-shkencore mendohet në pikëpamje se të gjitha dukuritë sociale mund të shpjegohen duke u nisur nga një princip i vetëm themelor apo nga një shkaktar i vetëm.

MORINA HATIXHE, veprimtare në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Hatixhe Morina, Schubertstr.18, 6000 Frankfurt-Main. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej saj ka qenë 10.

motive *motiv* gjendje tek individi e cila ka si pasojë një sjellje për të arritur një qëllim të caktuar. Motivi mund të jetë i vetëdijshëm apo i pavetëdijshëm, dhe pushon së ekzistuari apo reduktohet kur qëllimi arrihet.

muckraker *krijues sensacionesh* gazetar apo shkrimtar që gjen dhe publikon dëshmi për korrupsion në organet shtetërore dhe në ndërmarrje ekonomike.

MUHARREMAJ AHMET, veprimtar në Francë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ahmet Muharremaj, 8 Rue du Prebotin Nr. 77160 France. Ka qenë një ndër pikat

prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

MUHARREMI ASLLAN, – Asllan Muharremi, ka vepruar pranë LNÇKVSHJ-së që nga viti 1978. Në vitin 1983, Shërbimi i Sigurimit të Shtetit të Jugosllavisë, ka tentuar ta arrestoj dhe është larguar nga Kosova. Në vitin 1984 ka qëndruar në Zvicër. Që nga qershori i vitit 1985 jeton në Suedi.

MUHARREMI SHABAN, – Shaban Muharremi, veprimtar i hershëm i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës. Shokë i fëminisë me Xhafer Durmishin. Vëllau i Asllan Muharremit.

MULOLLI MUSTAFË; Aktgjykim: "*MUSTAFË MULOLLI, i biri i Rrustemit dhe i Mihanes e gjinisë Fejzullahu, i lindur me 03.10.1955 në fshatin Shajkovcë komuna e Podujevës ku e ka edhe vendbanimin, shqiptar, shtetas i RSFJ, ka të kryer dy klasë të shkollës së mesme ekonomike, punëtor administrativ - shaptillografist, i martuar, babë e 1 fëmiu të mitur, (...), i pa dekoruar, me gjendje të varfur ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej datës 05.08.1982,...*

Gjykon

Të akuzuarin Mustafë Mulollin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 4 (katër) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit....

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË E TITOS

P-nr. 9/83, - më 27.05.1983"

MUSLIU SHEFKET, - Shefket Musliu lindi më 10 prill 1946, në Artanë nga prindërit Zylfiu dhe Mihrije. Që në moshën 16 vjeçare, me familje u shpërngul në fshatin Sopot të Kumanovës. Nga viti 1981, familja Musliu u kthye sërish për të jetuar në Gjilan. Për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, Shefketi u detyrua të merrte rrugën e kurbetit. Që nga viti 1971, u vendos në Regensdorf, afër Cyrihut, ku jeton edhe sot. (Ismet Rashiti, Rrëfanë lirie, Prishtinë 2010)

Së bashku me Faridin Tafallarin është organizatori i aspekteve praktike të takimit të 14-15 majit 1982 në Biel-Bienne, takim prej të cilit është përpiluar një komunikatë, bashkëformulues, daktilografues dhe shpërndarës i së cilës është Xhafer Shatri.

"KOMUNIKATE

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave ***NË NJË TË VETME****. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982.

Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit, përfaqësuesit e tri organizatave në mes tjerash morën këto vendime e qëndrime:

1. Që organizata e re të pagëzohet "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ)."

MUSLIU XHEMAIL, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Xhemail Musliu, Poststr. 58, 7250 Leonberg. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

MUSTAFAJ NIMON – Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Nimon Mustafaj, arsimtar nga f. Gllogjan, KK – Deçan, i lindur më 5 gusht 1938 në të njejtin fshat me profesion arsimtar pran shkollës fillore në f. Gramaqel, ka të kryer Fakultetin e Shkencave Natyrore – Degën e Gjeografisë. ... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh."*

MUSTAFI VEBI, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Vebi Mustafi, Oberbilker Allee. 6, 4000 Düseldorf 1. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

myth *mit* në kuptimin antropologjik një tregim me prejardhje të panjohur rreth forcave mbinatyrore, prejardhjen e universit, mbi kuptimin e jetës apo historinë e një populli, i cili mund të jetë i vërtetë ose i pavërtetë, por që nuk mund të verifikohet. Mite të këtij lloji ndeshen tek të gjitha kulturat. Funksioni i mitit është të prezantoj një sistem moral që është në fuqi në shoqërinë aktuale dhe të jep rregulla praktike për sjellje njerëzore. Në shumicën e religjioneve elemente mitike janë pjesë përbërëse të rëndësishme. Bibla mund të thuhet se është një përmbledhje mitesh.

mythology *mitologji* 1. Struktura e miteve që ekzistojnë në një shoqëri. 2. Studimi i miteve si fenomen social.

N

nativism lëvizje të ndryshme në një shoqëri që kanë për qëllim kthimin e shoqërisë tek një nivel kulturor i mëparshëm. Lëvizje nativiste ndeshen para së gjithash në shoqëritë primitive, të cilat përmes kontaktit me teknologjinë dhe kulturën perëndimore iu nënshtrohen ndryshimeve të shpejta. Lëvizjet janë një reaksion kundër këtyre ndryshimeve.

negative reference group do të thotë për një individ një grup normat dhe vlerat e të cilit ai (individi) i hedh poshtë pikërisht për shkak se vijnë nga referens-grupi negativ. Individi mund të jetë vetë anëtar i grupit dhe prapë se prapë ta konsideroj atë si referens-grup negativ, p. sh. djali apo vajza që revoltohen kundër prindërve, dhe normave e vlerave të tyre. Në përgjithësi referens-grupi negativ paraqet (*outgroup) grup të jashtëm*. Në masë të madhe vlerat dhe atitydat e grupit të vet (grupit të brendshëm) mvaren nga atitydat dhe vlerat e grupit të jashtëm, të cilat merren si shembull për të keq. Grupi i jashtëm thuhet se ka *prestigj negativ*.

NEZIRI NEZIR, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Nezir Neziri, Martin Hemmstr. 81, 8070 Ingolstadt. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 50.

NEZIRI SHABAN, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Shaban Neziri (K. L.) Klingenstr. 23, 7101 Massenbachhauesn. Ka qenë një ndër pikat

prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

NEZIRI SYLË, veprimtar në Austri. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sylë Neziri, Mommssengasse 21-14, 1040 Wien Austria. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 10.

NGUCATI SMAJL, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Smajl Ngucati, Kelenstr. 19, 7000 Shtutgart 1. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

NIKÇI RAMË, prezantimin e hollësishëm të Ramë Nikçit e ka bërë Ibrahim Kelmendi, (përfaqësuesi i Frontit të Kuq) në maj 1982, një pjesë të vogël të të cilit po e japim më poshtë:

KUSH ËSHTË VOJVODA RAMË NIKÇI
Ç'do të thotë fjala v o j v o d ë ?

Vojvodë është gradë ushtarake në mbretërit serbe e malazeze. Këtë fjalë do ta gjejmë të sqaruar në "ilustrovana politika" të Beogradit. Por për çudi, kur klika serbomadhe ka ndërmarrë fushatë histerike kundra "nacionalizmit romantik" shqiptar, si nuk u bie fjala vojvodë në sy, që nuk ka të bëj vetëm me nacionalizmin serb. Për këtë nuk kanë frikë as gazetari shovenist Zec as vojvoda Ramë, që e përdorin me krenari.

"... Vojvoda rugovas, shkruan "ilustrovana politika" (më 26.05.81), është përfaqësuesi i tanishëm "lozës" (serbisht: loza), e cila që nga kohërat turke ruan qetësinë dhe paprekshmërinë e Patriarkanës...)

Siç na del, vojvodët kanë qenë rojë e rendit, ndërsa vojvodët e familjes Nikçi (nga Shtupeçi i Madh, fshat i Rugovës) kanë qenë rojë besnike e Patriarkanës, të ndërtuar nga Dushani, për ta përjetësuar robërinë e "stara Serbisë" (siç e quajnë shovenistët Kosovën.).

Kush është vojvoda Ramë Nikçi?

Të shkruajmë se kush është vojvoda Ramë Nikçi nuk e kemi vështirë, pasi ai vetë na e ka lehtësuar këtë, duke përmbledhur historinë e vetë e të familjes në bisedën dhënë "ilustrovana politikës" së Beogradit, Nr. 1177, të 26.05.81. Pos kësaj bisede, ai në rrethin e Pejës është ndër më të kompromet uarit. Sa ai është edhe vetëm udbashi rankoviçevës Bajram Dreshi. Të dy së bashku, me ca të tjerë, Rugovës ia njollosin emrin e pa njollosur, pse bijtë e bijat i dalin asaj zot.

Në artikullin e revistës në fjalë, "Besa nije vracena" lexojmë:

"Ramë Nikçi është shef i shërbimit juridik ndërkomunal pranë Entit për Inkuadrim në Pejë..." Siç e pamë më lartë, është përfaqësuesi i tanishëm i "lozës" për ta mbrojtur Patriarkanën.

Në pyetje të gazetarit, se a ka marrë pjesë ndonjë rugovas në demonstrata "nacionaliste", vojvoda përgjigjet: "Po. Të tillëve ju takon sipas ligjit nga qeveria, kurse nga rugovasit – bojkotimi (izolimi). Në shtëpitë s'do hynë askush, dërisa Pleqësia jotë të mos vendos ndryshe. Nga vllazëria ime Nikçi nuk ka asnjë demonstrues. E kam vërtetuar dhe për këtë jap fjalën. Askush nga anëtarët e SHKA "Rugova" s'ka marrë pjesë në demonstrata. Më është bërë qefi..." Pastaj vazhdon vojvoda: "Ishim dy herë si shoqëri mysafirë në RPS të Shqipërisë. Këtë vit shqiptarët është dashur të na e kthejnë vizitën, por le të mos vinë..." Më poshtë vijon vojvoda: "... Çka u duhet këtyre demonstruesve që

kërkojnë t'i bashkangjiten Shqipërisë (...). Këtë liri, siç e kanë shqiptarët në Jugosllavi, nuk e kanë patur asnjëherë askund dhe secili që mendon ndryshe – është njeri i keq..."

Gazetari pyet: "Babën tëndë, gjithashtu vojvodë rugovas, e kanë vrarë në pritë në vitin 1939. Kush dhe përse?"

Ramë vojvoda përgjigjet: "Kanë vrarë babën tim me dy mixhallarë, para syve të mij, brenda gjysmë ore. Ka qenë larje llogarish me fiseve, nuk ka qenë hakmarrje gjaku. U ka penguar (mendohen "vrasësit") pse baba ka qenë vojvodë rugovas, që ka ***ruajtur*** *(nënvizimi ynë) Patriarkanën e Pejës..." Pastaj vojvoda vijon me nostalgji çetnike:*

"... Me konakun e vjetër të kishës m'është djegur edhe dhoma në të cilën kam banuar prej 1941-tës e dëri në mbarim të Luftës. Në të ka qenë kërveti, në të cilin kam fjetur, aty ka qenë edhe luga me të cilën kam ngrënë dhe fotografitë e t'parëve të mij. Të gjitha janë djegur..."

Artikulli mbaron me fjalët e vojvodës Ramë: "Unë i ***dua*** *(nënvizimi ynë) shumë fjalët e Mark Milanit..." (Ato s'po i citojmë – Shtojmë se Mark Milani ka qenë komandant i forcave pushtuese malazeze, në luftë për t'i pushtuar Plavë, Gusi, Hot, Grudë e Rugovë...).*

E cituam si shumë artikullin në fjalë pse u pa e arsyeshme përmes të kësaj reviste çetnike, gjegjësisht përmes fjalëve të vojvodës, ta njohim udhëheqësin e SHKA "Rugova", i cili, sipas "Pravosllavjes" (Gazetë kishtare serbe", "kur ka parë konakun në flakë ka qa." Vojvoda kësaj radhe "demanton" atë çka ka shkruar "Pravosllavja", duke thën se rugovasit nuk qajnë kur t'u ndodhin fatkeqësi të rënda...

"Patriotizmi" serb i Ramë vojvodës, siç na bind ky artikull dhe profesioni i tij si vojvodë, ia kalon "patriotizmit" serb të shumë çetnikëve, të cilët nuk kanë bërë dhe s'do bëjnë aq sakrifica për ta mbrojtur kishën, sa bëri familja Nikçi (nga Shtupeqi i Madh). Krenaria e Ramë Nikçit si vojvod... për ta mbrojtur Patriarkanën...!!

Duket së nana e Ramës kur ka dashur të kryen nevojë (me nder me then) në vend të m... ka pjellur rastësisht vojvodën...

Punëtorët shqiptarë në mërgim. (Shkrim në 6 faqe A5, i shpërndarë nga Ibrahim Kelmendi, në maj 1982. Nënvizimet e këtij punimi ishin të autorit të saj, ashtu siç janë në origjinal në shkrimin e shpërndarë)

NIMANI XHAVIT (1919 - 2000), aktivist dhe luftëtar në Luftën e Dytë Botërore. Xhavit Nimani në mars të vitit 1974 u emërua në postin e sapo krijuar, e Kryetarit të Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Në këtë post qëndrojë për 7 vite, deri më shpërthimin e demonstratave të ashtuquajtura në atë kohë nga regjimi "kundër-revolucionare". Disa muaj më vonë, në gusht, në këtë postë u emërua Ali Shukriu.

nominal group member individ i cili prej të tjerëve definohet si anëtarë grupi, por i cili në të vërtetë nuk merr pjesë në asnjë ndërveprim brenda grupit. Sjelljet e tij nuk ndikohen fare apo ndikohen në masë shumë të vogël nga shkaku i anëtarësisë së tij në grup.

norm rregull për sjellje. Normat munden me qenë private, nëse janë krijuar nga vet individi dhe vlejnë vetëm për sjelljet e tij, p. sh. premtimet që dikush mund të bëjë natën e vitit të ri dhe çështja e mbajtjes së tyre. Por ajo që u intereson sociologëve janë normat sociale, d. m. th. norma që janë të zhvilluara dhe të pranuara prej një grupi. Normat sociale janë dy llojesh; jo-operative dhe operative. Normat jo operative përbëhen prej udhëzimeve mbi sjelljet ideale, p. sh. “mos ia bërë askujt ate që nuk dëshiron të ta bëjnë ty”. Norma operative janë ato të cilat faktikisht i drejtojnë sjelljet e individit. Devijimi nga normat e këtij lloji dënohet në mënyra të ndryshme, në raste të lehta me humbjen e prestigjit dhe përqeshje, në raste të rënda me izolim, tëhuajtje dhe sanksione ligjore. Në

anën tjetër respektimi i normave shpërblehet me shprehjen e pëlqimit nga grupi. Brenda një grupi, normat munden me qenë të ndryshme për anëtar të ndryshëm. Për këtë arsye një përshkrim i plotë i një norme sociale operative duhet të përmbaj;

(a) prej kujt apo prej cilëve pritet një sjellje,
(b) kush apo cilët janë ata që e presin një sjellje të caktuar,
(c) çka guxon të bëhet dhe çka nuk guxon të bëhet,
(d) në çfarë rrethanash apo kushtesh
(e) cili është dënimi për devijim nga norma dhe cili është shpërblimi për respektim të përpiktë dhe
(f) cilët janë ata që e japin dënimin apo e ndajnë shpërblimin.

NOVAKOVIÇ KOSTA, lindi më 3 qershor 1886. Së bashku me Dimitrije Tucoviçin ka qenë një ndër udhëheqësit e Partisë Socialdemokrate serbe. Në kongresin themelues të Partisë Komuniste të Jugosllavisë më 1919 është zgjedhur në Këshillin Ekzekutiv të udhëheqjes qendrore. Në mesin e dy luftërave botërore ka redaktuar shumë gazeta partiake, ka qenë i zgjedhur në Komitetin Qendror dhe ka qenë delegat i PKJ në Kongresin e Katërt dhe të Gjashtë të Kominternit. Për shkak të veprimtarisë revolucionare më 1924, nga Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene është dënuar me gjashtë muaj, ndërsa më 1926 me pesë vjetë burgim. Në vitin 1927 ik nga burgu dhe emigron në Bashkimin Sovjetik. Atje burgoset më 1937 në spastrimet staliniste dhe supozohet se është likuiduar më 1938.

NOVOSELLA SABRI, Sabri Maxhuni-Novosella i lindur më 1943 në Vushtrri. Eprori organizativ i Jusufit në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 274-275)

NUHAJ AVDYL, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Avdyl Nuhaj, Drahenfelstr.1/A, D-6700 Ludwigschafen tel.573194. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

O

office në tekstet amerikane të sociologjisë, një rol i definuar mirë dhe i sanksionuar nga lart, i cili qartë mund të dallohet nga personi, që për momentin e ka atë rol. Koncepti ka rëndësi themelore për teoritë e Max Weberit rreth burokracisë.

OLIVETTI, ndërmarrje me renome botërore për prodhimin e makinave të shkrimit. U themelua në Ivrea, në periferinë e Turin-it më 1908 nga Camillo Olivetti. Numrat 2 dhe 3 të Lajmëtarit të lirisë, si dhe numrat 3 e 4-5 të revistës Liria, të gjitha këto të përgatitura nga Jusuf Gërvalla, janë bërë me të njejtën makinë, e cila ka qenë e markës Olivetti. Këtë temë e kam shtjelluar gjerësisht në shkrimin "Stilografat e Jusuf Gërvallës."

open-class society formë shoqërore që mundëson lëvizshmëri të plotë sociale vertikale, d. m. th. të gjithë anëtarët e shoqërisë që nga lindja kanë mundësi të barabarta për të arritur në pozitat e larta të shoqërisë. Kjo formë shoqërore nënkupton edhe relacione sociale të barabarta në mes klasave të ndryshme në shoqëri. E kundërta e kësaj është shoqëria-me-kasta.

open shop, ndërmarrje në të cilën mundësia për t'u punësuar është e barabartë si për punëtorët e organizuar në sindikata ashtu edhe për ata të paorganizuar.

opinion, pikëpamje që konsiderohet e vërtetë, deri në njëfarë mase e bazuar nga gjykimet intelektuale, por jo edhe e vërtetuar, domosdoshmërisht, me fakte të mjaftueshme. Një opinion, në natyrën e tij është i përkohshëm për ndryshim nga atityda dhe vlera.

opposition rezistencë kundër apo përpjekje për t'i penguar idetë apo tentimet e një personi apo grupi tjetër. Opozicioni nuk është e domosdoshme të jetë i lidhur me qëllimin e keq, urrejtjen apo dëshirën për ta dëmtuar apo zhdukur kundërshtarin, karakteristika këto që i ndeshim tek *konflikti*.

OPTIMIST, Jusuf Gërvalla: *"Sa për situatën në Kosovë, megjithë krimet e pashembullta fashiste që po ushtron armiku ynë mizor e që prekin thellë në zemër çdo shqiptar dhe jo vetëm shqiptarët, unë jam shumë optimist, Arsyet i mendoj kësisoji : 1) Doli sheshazi mospajtimi i shqiptarëve me armikun e egër, qeverinë shoviniste të Beogradit; bota, që sot po e bën të veshin shurdh e syrin qorr për çështjen shqiptare, në mos sot, nesër do të detyrohet patjetër të ballafaqohet në mënyrën më serioze me këtë çështje, deri në fitoren tonë përfundimtare. 2) Populllsia e Kosovës, e ballafaquar me tanket, aeroplanët, helikopterët e me gjithë pancirin tjetër të ushtrisë dhe policisë serbe, nuk u frikësua dot, po qëndroi pa iu trembur syri; kjo populllsi tregoi se është e zoja të çohet në kryengritje dhe ta bëjë edhe luftën përfundimtare për çlirimin nga armiku mizor dhe bashkimin me vendin amë. 3) Vetë armiku, që kohë më parë e dinim edhe për politikan të regjur, me këtë intervenim ushtarak e policor mbi shqiptarët bëri pa dyshim gabimin më të madh në historinë e vet shtetërore-politike; ky gabim do t'i kushtojë shtrenjtë, sepse gjithë situata, edhe në mos vazhdoftë menjëherë lufta definitive për bashkim me Shqipërinë tonë, pra gjithë situata do të ndjekë në të ardhmen e afërme atë drejtim, i cili do ta sjellë shqiptarin në potez për të zgjedhur se ç'dëshiron brenda kuadrit të Jugosllavisë, madje duke na lejuar të bëhemi edhe mjaft nazeqarë..."* (Letër Sabri Novosellës 14 prill 1981, Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 260-261)

optimum group size, the *madhësia optimale e grupit* Kjo madhësi optimale e grupit në bazë të disa teorive dhe hulumtimeve është prej pesë anëtarësh. Një grup prej pesë anëtarësh i ka këto veti: situatë e bllokuar në rastin e marrjes së vendimeve në mund të ekzistoj për shkak se numri i anëtarëve është tek. Kur grupi nuk është unik ai ka tendencë të ndahet në shumicën prej tre anëtarëve dhe pakicën prej dy anëtarëve. Kjo do të thotë

se një individ që i takon pakicës nuk izolohet. Nëse grupi është më i madh se pesë, atëherë secili anëtarë ka kohë më të vogël për t'u ndëgjuar mendimi i tij.

organic solidarity *solidaritet organik*, ajo formë e solidaritetit që ekziston në shoqëritë moderne industriale, në të cilat një pjesë e madhe e ndërveprimit bëhet në bazë të kontratave dhe marrëveshjeve, si pasojë e shkallës së lartë të ndarjes së punës dhe specializimit. Në shoqëri me solidaritet organik numri i devijimeve është më i madh se në shoqëritë primitive me *solidaritet mekanik*, e gjithashtu edhe toleranca ndaj devijimeve është më e madhe tek solidariteti organik. Konceptet *solidaritet organik* dhe *solidaritet mekanik* janë formuluar nga sociologu francez Emile Durkheim në *De la division du travail social* (1893).

organization man koncept i krijuar nga William H. Whyte në *The Organization Man.* Ky lloj njeriu, sipas Whyte nuk është as punëtor as nëpunës në kuptimin e rëndomtë të fjalës. Ai punon vetëm për Organizatën. Ai i takon organizatës. Ai e ka lënë shtëpinë e tij në pikëpamje shpirtërore dhe trupore, dhe ai së bashku me ata si ai tani janë shpirti i institucioneve të mëdha të vetpërjetësueshme. Ai më së shpeshti gjendet në mesin e hierarkisë së organizatës por iu takon atyre që do ta drejtojnë Amerikën dhe vlerat e tij do të jenë dominuese në vend.

OSMANI AGIM, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Agim Osmani, Schmidenstr. 156 7000 Shtutgart. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

OSMANI BILALL; Jusuf Gërvalla: "*Shkroi edhe "Rilindja" e 21 nëntorit për një vëlla tonin, i cili, në çastin që doli gazeta (e mallkuar) ishte i burgosur dhe nuk arriti të lexojë gjë për aktin e madh njerëzor që kish bërë vetë, duke e ndihmuar me të madhe edhe Ndihmën e Shpejtë për t'u dalë përballë kërkesave të popullsisë, që po përjetonte çaste nga më të vështirat. Këtë e bëri ai, Shoku* ***Bilall Osmani****, punëtor në "INA". Ai duke luftuar me armë të thjeshtë, kofë, ia arriti që ujin e tërbuar mos ta lenë të futet në fuqinë nën tokë, ku do të përzihej me benzinë. Kështu, ishte e vetmja pompë në rrethin e Prizrenit që funksiononte. Kur në mëngjes shkuam të mësojmë diç më shumë për sakrificat që i kishte bërë gjatë tërë natës, Shokun Bilall e kishin arrestuar kusarët e UDB-së! Edhe një pjesë e madhe e shqiptarëve të vetëmohueshëm, që s'ua trembë syrin stihia, e që mikrofoni dhe kamera e gazetarëve ua lavdoi guximin e gatishmërinë, s'pati rast t'i dëgjojë t'i shikojë emisionet në radio e televizion, të cilat flisnin për heroizmat e tyre. S'patën rast, se UDB-së, që kish dalë në gjahun e madh mbi shqiptarët pikërisht ato ditë, duke përfituar ligësht nga një fatkeqësi elementare, i duhej preja sa më e majmur*. (Bashkimi, shkurt 1980, faqe 2)

OSMANI HALIT, – Halit Osmani nga fshati Dumnicë- aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

OSMANI SEJDULLAH, – Sejdullah Osmani nga fshati Qirez- aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

ostarcism *ostracizëm* një formë e dënimit brenda grupit. Ai që dënohet, injorohet dhe përbuzet haptaz. Por ai nuk përjashtohet nga grupi.

other-directed koncept i krijuar nga David Riesman në *The Lonely Crowd* (1950). Një individ është other-directed nëse sjellja e tij është e drejtuar nga mendimi se çfarë sjellje presin të tjerët prej tij. Ky lloj konformizmi, mendon Riesman, është bërë shumë i dukshëm gjatë viteve 1900, veçanërisht në mesin e "klasës së re të mesme" në ShBA, tek burokratët, biznesmenët e paguar me rrogë etj.

out-group Si grup i jashtëm llogaritet një grup i tillë prej anëtarëve të një grupi tjetër. Koncepti është krijuar nga W. G. Sumner në veprën e tij *Folk-Ways* (1906). Vrojtimet e tij janë të bazuara në shoqëritë primitive. Më vonë Merton dhe Kitt kanë treguar se në një shoqëri moderne kufijtë në mes in-group (grupin e vetë) dhe out-group (grupin e të tjerëve) janë të lëvizshëm. Në një rrethanë mundet që një pjesë-grupi e një grupit të madh ta konsideroj një pjesë tjetër si out-grup. Në një rrethanë tjetër është e mundur që dy pjesë-grupet së bashku ta përbëjnë një in-group.

output në sociologji më së shpeshti një term që përshkruan atë që individi e jep nga vetja në formë të aprovimeve, propozimeve etj. brenda një grupi të vogël, për ndryshim nga *input*, se çka pranon ai.

P

PALOKA KOLË, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Kolë Paloka, Seestr. 42, D-7033 Kernen. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

Panairi Ndërkombëtar i Artizanatit i Munchen-it (IHM)

Bashkimi i Artizanateve për Ekspozita dhe Panaire është themeluar në Munchen më 15 tetor 1948. Në bazë të statutit Bashkimi ka: Qëllim që, në kuadër të asaj që është e lejueshme dhe e ligjshme, të organizoj ekspozita dhe panaire apo pjesëmarrje në organizime të tilla në Gjermani dhe jashtë Gjermanisë, për ta zhvilluar tregtinë.

Në vitin 1949 është organizuar Panairi i parë në Munchen nga Bashkimi i Artizanateve për Ekspozita dhe Panaire. Në atë vit kanë marrë pjesë 820 ekspozues me ekspozitat e tyre në një sipërfaqe prej 14 000 metra katror.

Në vitin 1950 Panairi i Artizanateve i Munchenit ka marrë emrin e ri: Panairi i Artizanateve i Gjermanisë.

Në vitin 1962 është ndryshuar prapë emri në Panairi Ndërkombëtar i Artizanateve (Internationale Handwerksmesse – IHM). Fakti se gjithnjë e më shumë vende nga blloku komunist lindor i kanë ekspozuar produktet e tyre në Munchen, tregon për rritjen e rëndësisë historike dhe politike të këtij panairi.

Në vitin 1981 Panairi Ndërkombëtar i Artizanateve është mbajtur në mesin e marsit. Të shtunën më 14 mars në këtë panair si vizitor kanë marrë pjesë Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla.

Panairi librit në Frankfurt

Panairi librit në Frankfurt ka filluar në vitin 1949 në kishën Paulskirche me rreth 200 shtëpi botuese, dhe është zhvilluar duke u bërë platforma më e rëndësishme e shtëpive botuese për përmbajtje dhe ide. Panairi ka shërbyer si shumëzues i shtëpive botuese, vend i përhapjes së tregimeve fantastike, vend që ka mundësuar takime me

vlerë. Sot, historia e Panairit të librit të Frankfurtit është pjesë e historisë së qytetit të Frankfurtit, pjesë e historisë së demokracisë së Gjermanisë dhe pjesë e historisë ndërkombëtare të shtëpive mediatike e botuese.
Panairi i librit i librit i vitit 1981, ka qenë panairi i 33-të me radhë. Është mbajtur nga 14-19 tetor. Janë prezantuar 280 mijë tituj nga 5100 shtëpi botuese prej 86 shteteve. Numri i vizitorëve ka qenë 175000. Në mesin e vizitorëve, më 17 tetor 1981 kanë qenë Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla.

paper local bashkim profesional që ka pak apo nuk ka asnjë anëtar. Në ShBA ka ndodhë që funksionarë të bashkimeve profesionale kanë krijuar bashkime të tilla për ta rritur numrin e delegatëve, tek të cilët ata do të mbështeteshin në kongreset e bashkimeve profesionale.

PAQE Paqja është një gjendje e harmonisë së brendshme dhe e liruar prej konflikteve. Termi përdoret për ta përshkruar ndërprerjen ose përfundimin e një konflikti ndërkombëtar; në këtë kuptim paqja është e kundërta e luftës. Kjo fjalë përdoret edhe për konflikte të brendshme, dhe me atë rast paraqet arritjen e qetësisë apo ekuilibrit në mendje.

Koncepti paqe është i kontestueshëm dhe brenda hulumtimeve për paqen ekzistojnë dy shkolla – ajo që studion paqen pozitive – gjegjësisht paqen negative, por edhe në mesin e institucioneve kulturore dhe fetare ekzistojnë shumë shkolla dhe pikëpamje të ndryshme lidhur me atë se çka është paqja.

Paqja negative

Paqe negative është përfundimi i një lufte ose gjendja në mes dy luftërave.

Gjendja tradicionalisht është përqendruar kryesisht tek shteti pikënisja e të cilit është se të gjitha njësitë sociale në fund të fundit janë të bazuara në dhunë, ku pala më e fortë gjithmonë e përdorë dhunën për ta sunduar palën e dobët dhe në këtë mënyrë e ruan raportin dhe qetësinë apo për të fituar përparësi. Paqja merr kuptim negativ pasi ajo nuk shihet si diçka e natyrshme por para së gjithash si gjendje e kundërt me luftën. Qëllimi, kuptohet vetvetiu, është evitimi i luftës. Për ta shtyrë luftën sa më larg, shtetet mund të krijojnë aleanca përmes traktateve dhe pakteve. Krejt kjo bëhet për ta ruajtur ekuilibrin dhe për t'i frikësuar shtetet tjera, që ato të mos bëjnë agresione.

Paqja pozitive

Paqja pozitive është përpjekja për relacione paqësore në mes grupeve të ndryshme sociale dhe kombeve. Koncepti nuk është i koncentruar tek shteti ashtu siç ishte tek paqja negative por potencohet se edhe në rastin e mungesës së dhunës direkte, njerëzit, për shkak të mungesave të të drejtave dhe vlerave njerëzore, vdesin apo plagosen (psikikisht ose fizikisht). Kjo bënë që ata nuk mund të vazhdojnë të jetojnë një jetë kuptimplote. Kjo ndodhë edhe për shkak të pabarazisë në strukturat e shoqërisë. Dhuna institucionale, eksploatimi, racizmi apo mungesa e mundësive të barabarta (p. sh. në mes burrave dhe grave) janë disa shembuj që e prishin paqen. Paqja pozitive pra arrihet vetëm atëherë kur dhuna strukturale zhduket dhe liria, barazia, integrimi etj., bëhen të realizueshme. Ai i cili e ushtron dhunën (aktori) shpeshherë është vështirë të definohet (për dallim tek dhuna direkte) dhe dhuna shpeshherë është më e ngadalshme, apo efektet e saj nuk vërehen menjëherë. Hulumtimet shkencore në drejtim të paqes pozitive janë rritur vazhdimisht viteve të fundit ndërsa hulumtimet për paqen negative janë zvogëluar. Kjo do të thotë se përpjekjet në drejtim të paqes pozitive janë një proces që nuk përfundon kurrë.

Paqja mund të paraqet edhe një marrëdhënie në mes disa partish që karakterizohet nga respekti, drejtësia dhe mirëkuptimi.

parlor pink person i cili shpreh dhe përkrah ide radikale dhe socialiste por vetë nuk bëhet anëtar i lëvizjeve dhe partive, të cilat luftojnë për realizimin e atyre qëllimeve. Një term i ngjashëm është *bolshevik sallonesh.*

PARTI (frengjisht, nga *partir* këtu në një kuptim të vjetër "me nda", "përça"), *parti politike*, bashkim apo grup zgjedhësish që paraqitet në zgjedhje me një emër e përcaktim të veçantë. Partia mund të definohet edhe si opinion i organizuar. Detyrat e një partie janë pos tjerash të krijojnë dhe të absorbojnë opinione, prej opinioneve dhe ideve të krijojnë programe, të rekrutojnë anëtar, të bëjnë emërime për vende, atyre që u falet besimi, si dhe pas zgjedhjeve të legjitimuara të krijojnë qeveri dhe ta realizojnë programin.

parties of integration emërtim për parti politike të cilat nuk e ofrojnë vetëm një alternativë politike gjatë zgjedhjeve, por gjithashtu ofrojnë, në përputhje me partinë dhe ideologjinë e saj një mjedis të integruar për anëtarët e tyre, p. sh. duke organizuar aktivitete të lira si dhe kurse, rëndom të mbrëmjeve etj., duke ndërtuar ose duke ndikuar në krijimin e organizatave ekonomike të cilat i mbrojnë interesat e anëtarëve, duke i politizuar organizatat sindikale etj. Shpesh partitë integruese janë totalitare, por përjashtime ka, p. sh. disa parti socialdemokrate dhe parti katolike. Të kundërta me partitë integruese janë *partitë reprezentative*, veprimtaria e të cilave është e fokusuar vetëm në fitimin e votave gjatë zgjedhjeve. Shumica e partive të Evropës Perëndimore konsiderohen si reprezentative.

part-time farming Ai apo ata që merren me punë bujqësore, dhe e sigurojnë vetëm një pjesë nga bujqësia kurse pjesën tjetër nga një punë që nuk ka karakter bujqësor. Shumë ekonomi të vogla bujqësore në viset shqiptare janë të këtij lloji.

PARULLAT E DEMONSTRATAVE; Jusuf Gërvalla: "*Parullat e demonstratave kanë një përmbajtje thellësisht marksiste-leniniste dhe përkrahin deri në fund kërkesat e rinisë heroike të Kosovës për republikë(që nënkupton edhe përfshirjen e tokave dhe të popullsisë shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi). Përveç kësaj, demonstratave u prin automobili me megafon, i cili i koordinon veprimet, kontrollon disiplinën dhe shprehjen unike. Me megafon lexohet në shqipe dhe në gjuhë të huaja trakti përkatës, me elemente informative e sqaruese lidhur me gjendjen e krijuar në Kosovë nga kryengritja e këtej.*" (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 260)

pastoral society *shoqëria pastorale* e siguron ushqimin kryesisht prej shtazëve shtëpiake. Atë pjesë të vogël që rrjedh nga bota bimore kjo shoqëri e siguron përmes tregtisë ose duke përdorur bimë të egra. Populsia pastorale si rregull është e nomadizuar, çka do të thotë se shtazët shtëpiake duhet të kenë mundësi të shpërngulen bukur shpejt. Për këtë arsye, kuajt, lopët, dhentë e dhitë janë të përshtatshme, por jo edhe derrat. Kultura dhe forma organizative e shoqërisë pastorale përcaktohen nga *migracioni*.

paternalism relacion në mes prindërve dhe fëmijëve në lidhje me të drejtat dhe detyrat, që në familje ekzistojnë në mes rolit si baba dhe rolit si fëmijë. Ky lloj relacioni i roleve mund të ekzistoj p. sh. në mes shtetit dhe qytetarëve, ndërmarrjes dhe të punësuarve.

PECI QERKIN; Aktgjykim: "*QERKIN PECI, i biri i Hajdarit dhe i Halimes, e gjinisë Haziri, i lindur më 20.04.1944 në fshatin Zhazhë komuna e Mitrovicës së Titos, vendbanimin e ka në Mitrovicën e Titos në lagjën "Tamnik" rruga 8 nr. 30, shqiptar, shtetas i RSFJ, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, ka të kryer Fakultetin filozofik - grupi i albanologjis, i martuar, babë i 3 fëmijve të mitur, shërbimin ushtarak e ka rregulluar në Nish më 1971, gjindet në EU pranë KK Mitrovicë e Titos, i pa dekoruar, me gjendje të mesme ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05.08.1982,...*

Qerkin Peci

Gjykon – Të akuzuarin Qerkin Pecin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 3 (tri) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit....

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË E TITOS
P-nr. 9/83, - më 27.05.1983"

Çerkin Peci: ”I respektuari dëshmor i Kosovës, Jusuf Gërvalla, ndihem krenar që Të kisha prijës në LNÇKVSHJ! Përkujtim atdhetar deri në përjetësi!” (17 janar 2016 www.facebook.com/jgervalla)

pedantocracy *pedantokraci* Pushteti politik në një shoqëri apo në një grup është në duart e personave që janë teoricien pa ndonjë përvojë praktike.

penology *penologji* pjesë e kriminologjisë e cila trajton aspekte të ndryshme të dënimit. P. sh. bënë studimin e trajtimit të të dënuarve, strukturën sociale në burgje, procedurat në polici dhe gjykata si dhe metodat për të kontrolluar dhe parandaluar krimet.

perception *percepcion* ai proces mental përmes të cilit individi e kupton një *stimul* apo një tufë stimujsh dhe u jep atyre kuptim ose përmbajtje. Percepcioni nuk do të thotë vetëm kuptim i stimulit, por këto (stimulime) duhet integruar me përvojat e mëhershme. Për t'u mundësuar bartja e përvojave fizike dhe organike në një mënyrë kuptimplote, duhet që njeriu ta ketë të zhvilluar një aparat konceptesh, i cili e bënë të mundshme lidhjen e relacioneve të kuptimeve të ndryshme, të stimujve.

perfect mobility situatë në të cilën të gjithë individët, pamvarësisht nga situata e tyre sociale fillimore apo rangu, p. sh. të matur (në krahasim) me rangun e babait, kanë mundësi probabiliteti për të arritur çfarëdo pozite. Ky nocion *hipotetik* (do me thënë që bazohet vetëm në supozime) kishte me pasë në praktikë të njejtin efekt sikur me anë të shortit me i vendosë të gjithë individët në të gjitha pozicionet që gjenden në dispozicion. Duke e bërë një krahasim në mes të mobilitetit faktik më të plotë është e mundur p. sh. të bëhen krahasime në mes hapjes së shteteve të ndryshme sa i përket mobilitetit social. Mobiliteti i plotë mund të ndeshet vetëm në shoqëritë e hapura.

peripheral groupmember *anëtar periferik i grupit* person i cili merr pjesë në aktivitetet e grupit në shkallë aq të vogël sa sjelljet e tij shumë pak kontrollohen nga grupi. Në këtë mënyrë ai mundet që në një shkallë më të madhe se sa *anëtarët nominal* me i thye normat e grupit pa pasur frikë me iu nënshtrua *sanksioneve negative.*

personality tendenca të qëndrueshme tek individi të cilat janë lidhura përmes relacionesh në një sistem. Këto tendenca tek individi janë zhvilluar përmes përvojave të tij sociale, do me thënë përmes proceseve të ndryshme të ndërveprimit.

PETER D'ALBANO, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Peter d`Albano, 765 Agate st. apt San Diego. Cal 92109 U.S.A. Ka qenë abonues i Zërit të Kosovës, me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

petit bourgeoisie *borgjezia e vogël*, kategori sociale ky llogariten ndërmarrësit e vegjël, dyqangjinjtë, nëpunësit e ulët etj. Me fjalë tjera quhet edhe shtresa e ulët e klasës së mesme.

PIRECI RAMADAN - Ramadan Pireci ka lindur në vitin 1951 në fshatin Struzhë të Prizrenit. Ramadani, apo siç e quanim shkurt Rama, ishte një aktivist i dalluar, për veprimtarinë e tij në aktivitetet e Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare nën ish- Jugosllavi.

Ramadan Pireci me shallin e kuq në qafë, në demonstratën e Frankfurtit, 7 qershor 1981

Me Ramadanin kemi vepruar në një celulë treshe. Ai ka qenë përherë i gatshëm që t'i shërbejë atdheut, duke qenë pjesëmarrës, nëpër të gjitha demonstratat e organizuara në Gjermani, Zvicër, Belgjikë etj. Me Ramën, disa herë kemi shkruar edhe parulla si "Kosova Republikë" nëpër muret e ish konsullatave dhe të klubeve sllave dhe të atyre

shqiptaro-prosllave, si dhe kemi vepruar së bashku për shpërndarjen e shtypit ilegal dhe trakteve për informim.

Rama ra në sy të udbashëve dhe në veçanti të Vesel Krasniqi si dhe të torbeshit Asllan Skenderi, të cilët sa herë shkonte në pushime e merrnin në pyetje dhe e maltretonin, duke i bërë shumë pyetje për veprimtarinë e tij dhe të bashkëveprimtarëve të tij. Por duke e parë se, Rama nuk donte të zbulonte asgjë, atëherë ata udbashë e provokonin me lëmosha, duke i ofruar gjëra të ndryshme por edhe para sa të donte, vetëm e vetëm që ai të bëhej bashkëspiun i tyre, por edhe duke e kërcënuar që ai dhe shokët e tij, mund të pësonin edhe me vdekje, sepse merrej me aktivitete ilegale në shtetet perëndimore kundër Jugosllavisë.

Këta udbashë i nxirrnin fotografitë, të cilat ish spiunët i kishin bërë gjatë demonstratave ku edhe ai vetë, Rama, ishte nëpër ato foto, edhe me shokë, si pjesëmarrës i rregullt. Udbashët këtë metodë e kanë përsëritur disa here, gjatë mbajtjes së tij në burg, duke e munduar e torturuar, duke e maltretuar aq shumë, lidhur me duar për radiatorët e nxemjes qendrore. Radiatorët ishin me temperatura të larta. E munduan së tepërmi Ramën, deri sa ia morën edhe pasaportën dhe ia humbën edhe punën në Gjermani.

Rama të gjitha këto i pranoi edhe pse ishte i vetëdijshëm se, do të vuante pa punë dhe pa të ardhura, por ai, kurrsesi nuk pranoi të bëhej spiun dhe tradhtar ndaj shokëve dhe atdheut. Ai i qëndroi besnik idealit të shenjtë dhe betimit të bërë se, do të luftonte armikun pushtues me të gjitha mënyrat dhe mundësitë, vetëm e vetëm për çlirimin e Kosovës dhe Bashkimit të Kosovës me shtetin amë Shqipërinë.

Faridin Tafallari-Gjermani

platform, program i karakterit gjeneral që një parti para zgjedhjeve thotë se do të dëshironte me zbatua, po që se pas zgjedhje vjen në pushtet dhe kjo më këtë të bëhet e mundur.

PLATZMANN PETER; Jusuf Gërvalla: "*Kam pasur nderin të njihem edhe me sekretarin e parë të Partisë Komuniste Gjermane, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri* ***(Peter Platzmann****-shën i Xh. D.) dhe i kam dërguar një letër me lutjen që edhe ai me partinë e tij të shikojë ndonjë formë të përshtatshme ndihme për përkrahjen morale të popullit shqiptar të Kosovës. Ende s'kam marrë përgjigje prej tij, por shpresoj se megjithatë do të na ndihmojë patjetër, sepse për këtë i obligon drejtpërdrejt edhe artikulli i "Zërit të popullit" i datës 8 prill, se siç dihet, kjo parti e komunistëve gjermanë ka për busollë të vetme PPSH-në."* (Letër Sabri Novosellës 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 260)

Platzman Peter, sekretari i parë i Partisë Komuniste të Gjermanisë dhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri ka pasur këtë adresë: Peter Platzmann, Erlbüggerstr. 15a. 4370 Marl.

Partia Komuniste e Gjermanisë në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë:
KPD. Welinghofer Straße 103, 4600 Dortmund 30

plebiscite, votim i popullit, shpesh brenda një rrethi gjeografik të caktuar për të vërtetuar se cilit shtet, banorët e rrethit që voton, duan t'i takojnë në të ardhmen. Si rregull ky lloj votimi ndeshet me rastin e përfundimit të luftërave dhe nënshkrimit të paqes. Kështu ka ndodhur p. sh. në rrethin Saar (Gjermani) pas Luftës së Parë Botërore.

pluralistic ignorance, situatë në të cilën anëtarët e një grupi apo të një shoqërie besojnë se anëtarët e tjerë e respektojnë një *normë* të caktuar dhe ata janë të vetmit që e thyejnë atë normë. Në të vërtetë atë normë e thyejnë një numër i madh i anëtarëve.

plutocracy *plutokraci* shoqëri në të cilën individët apo klasat më të pasura ekonomikisht e kanë pushtetin politik në dorë dhe e kanë këtë pushtet nga arsyeja se janë të pasur.

PLLANA RAMADAN - Ramadan Pllana, i lindur më 6 korrik 1947 në fshatin Shtitaricë, KK Vushtrri. Ka kryer vitin e tretë të Fakultetit filozofik – dega e gjuhës Frenge. Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, më 4 qershor 1980 është dënuar me 7 vjet burg.

pogrom *pogrom* shtypje e dhunshme kundër një grupi në shoqëri. Pushteti, qeveria si rregull e përkrah këtë shtypje, këto shpërthime dhune, apo pajtohet me to dhe i përkrah në heshtje. Prapaskena e pogromeve mund të jetë plani për ta zvogëluar numrin e individëve në atë grup, kundër të cilëve është e drejtuar dhuna, kërcënimi i tyre deri në nënshtrim, thyerja e fuqisë politike që mund ta kenë, apo për t'i maskuar dështimet politike. Origjina e këtij koncepti është përdorur për vrasjet masive të hebrenjve të cilat në mënyrë periodike kanë ndodhë në Rusinë Cariste.

political philosophy *filozofia politike*, përshkrim tradicional për një radhë problemesh normative dhe të njohjes mbi shoqërinë dhe shtetin. Probleme qendrore për filozofinë politike janë; kundër të cilave veprime dhe kundër cilave sjellje është e mundur që në mënyrë legjitime të drejtë të përdoret dhuna, dhe çfarë karakteri kanë ato institucione të cilat e ushtrojnë apo e mbështesin të drejtën e detyrimit.

Një karakteristikë esenciale e një shteti është se ai ka monopol në ushtrimin e *dhunës fizike*. Të vetmit që ja mohojnë të drejtën shtetit në këtë kuptim janë anarkistët, përderisa liberalët dhe socialistët, përkundër mospajtimeve të mëdha në mes veti lidhur me synimet e shtetit dhe fushës së veprimtarisë së tij, e aprovojnë shtetin si organizatë të dhunës legjitime.

Nëse shteti ka të drejtë të ushtrojë dhunë, shtrohet pyetja se sa e gjerë është kjo e drejtë dhe si mund të legjitimohet ajo?

Në bazë të liberalistëve shteti ka të drejtë të marrë masa detyruese vetëm ndaj atyre personave që i kanë shkelë të drejtat e personave të tjerë. Funksionet vitale të pushtetit shtetëror janë që të ruajnë ligjin dhe rregullin, d. m. th. të garantojnë të drejtat e individëve. Autoriteti i shtetit legjitimohet me mbështetjen dhe pajtimin e bashkështetasve (nënshtetasve). Për të tjerë, p. sh. konzervativët dhe socialistët, shteti ka synime më të mëdha, tradicionalisht të realizueshme nga ide të caktuara mbi jetën e mirë. Këto ide pushteti shtetëror mundohet t'i realizojë përmes ndërhyrjeve të ndryshme pozitive, p. sh. përmes aprovimit të ligjeve që u jep privilegj pikëpamjeve të caktuara apo grupeve të caktuara shoqërore, p. sh. përmes një rindarje të benificioneve ekonomike apo përmes marrjes së mjeteve të prodhimit nga ana e shtetit. Bazat rreth të drejtës së shtetit për t'ua detyruar nënshtetasve atë jetën e vërtetë, janë të shumëfishta. Për këtë janë bërë thirrje në natyrën, Zotin ose arsyen, apo tek dobia, pasi shteti do të ishte ai organ që ka më së shumti mundësi ta bëjë të lumtur numrin më të madh të mundshëm të individëve, ose tek vullneti i përbashkët, njohuria e popullit se cila është më e mira e përbashkët.

Që shteti të ketë mundësi të ketë pushtet dhe autoritet apo legjitimitet duhet patjetër që bashkështetasit (nënshtetasit) të kenë një *obligueshmëri politike* për t'i respektuar rregulloret dhe ligjet e shtetit. Idetë mbi jetën e mirë janë gjithashtu një përpjekje për legjitimimin e obligueshmërisë politike. Ngjashëm me këtë është edhe

problemi rreth *drejtësisë*, d. m. th. kërkesa që ligjet e shtetit dhe ushtrimi i pushtetit prej tij të bëhet në një mënyrë të veçantë dhe të rregulluar. Problemet e *demokracisë* janë çështje të lidhura me atë se deri në çfarë mase bashkështetasit apo populli kanë ndikim në shtet – në organet legjislative dhe ekzekutive.

political sociology ajo pjesë e sociologjisë që trajton apo merret me sistemin politik dhe relacionin e tij ndaj shoqërisë në përgjithësi. Vëmendje u kushtohet tri lloj çështjeve:

1. rendit politiko-shoqëror, do me thënë në çfarë mënyre është i rregulluar pushteti politik dhe atë para së gjithash si në cilën mënyrë institucionet politike mbështeten në popull dhe nga populli,
2. sjelljes politike, do me thënë çka i nxit njerëzit dhe deri në cilën shkallë janë politikisht aktiv, pse dalin në zgjedhje etj.,
3. proceseve politike, p. sh. pjesëmarrjes së grupeve të ndryshme në politikë dhe bashkëpunimit apo konkurencës në mes grupeve.

positivism *pozitivizëm* teori në bazë të së cilës dituria rreth fenomeneve sociale mund të arrihet me ndihmën e përvojës dhe kjo dituri duhet të trajtohet logjikisht dhe matematikisht në të njejtën mënyrë ashtu siç bëhet në shkencat natyrore. *Introskpektion* dhe *intuition* bëhen metoda të papranueshme për arritjen e diturisë. Në sociologji ky koncept vjen nga A. Comte.

power elite koncept i krijuar nga sociologu amerikan C. Wright Mills në *The Power Elite* (1956). Mills mendon në se në shoqëritë demokratike ekziston një minoritet individësh të cilët nuk janë të zgjedhur në mënyrë demokratike, por që e kanë pushtetin vendimtarë me rastin e marrjes së vendimeve më të rëndësishme. Elita pushtetare është e përbërë nga individ që reprezentojnë burokracinë, ushtrinë dhe financierët e mëdhenj dhe që ka vlera dhe interesa të përbashkëta. Koncepti i Mills-it rreth elitave pushtetare është kritikuar, pasi - sipas kritikëve - ai e ka bërë teprime kur thotë se elita-pushtetare është unike.

prejudice *paragjykim* atityd negative ndaj një grupi apo personi që bazohet në stereotipe. Në shkencat shoqërore nocioni përdoret më së shumti kur grupi ose individi u ekspozohet paragjykimeve për shkak të prejardhjes etnike.

prestige *prestigj* plasim të cilin një individi apo një grupi i epet nga të tjerët, në ndonjë formë të sistemit të vlerave. Që të jetë kuptimplotë mendimi për prestigjin, duhet të ekzistojë një unitet rreth sistemit të vlerave. Prestigji mund të bazohet në një veti të vetme apo në shumë prej sosh. Këto veti mund të jenë të atribuara, p. sh. gjinia, ose të fituara, p. sh. kryerja e studimeve.

primary deviation *devijim primar*, sjellje e paligjshme apo ndonjë sjellje tjetër devijuese, ushtruesi i së cilës (sjelljes) përmes *racionalizimit* nuk e konsideron atë të paligjshme por si një pjesë të një *roli* të pranuar social, p. sh. një njeri i rëndomtë e i respektuar i cili i fshehë disa paketa me cigare nga tatimi, me rastin e kthimit pas një udhëtimi në botën e jashtme.

primary group *grup primar* grup me relativisht pak anëtar por që është i qëndrueshëm. Komunikimi në mes anëtarëve është intim. Funksionet e grupit janë relativisht të padefinuara dhe ai u shërben nevojave të anëtarëve të grupit për aq kohë sa këto nevoja të jenë në harmoni me integritetin e grupit. Familja, grupi i shokëve, grupi i shokëve në vendin e punës janë shembuj të grupeve primare. Ky lloj grupi është një prej faktorëve

më të rëndësishëm për *socializimin* e individit. Përvojat e mangëta prej grupeve të tilla mund ta vonojnë zhvillimin social të individit. Termi është krijuar dhe përshkruar nga C. H. Cooley në *Human Nature and Social Order* (1902). E kundërta e kësaj është (*secondary group-grupi sekundar*). Ky çift opozitar i koncepteve është përafërsisht me përmbajtje të njejtë sikurse *Gemeinschaft-Gesellschaft* dhe *solidaritet mekanik-solidaritet organik*.

PRISHTINA HASAN; Jusuf Gërvalla: *"Në fillim Stambolli, pastaj agjentët e Beogradit e të Zogut, e kishin dënuar disa herë Hasan Prishtinën, dhe pasi nuk e kishin shtruar dot me kolltuk e me armë. Ata e kërkonin me këmbëngulje "kryet e gjarprit", siç e quante Pashiqi atë, sepse ishte tribun i popullit shqiptar e bir besnik i Kosovës trime. Me pesë plumba e vranë tradhtisht pas krahëve, më 14 gusht të vitit 1933 në Selanik, ashtu sikurse kishin bërë me Bajram Currin e Luigj Gurakuqin.*

Por kujtimi dhe vepra e tij nuk u zhdukën kurrë. Populli ynë i kujton dhe nuk i harron ata që sakrifikuan gjithçka për mëmëdhenë. Emri i Hasan Prishtinës është një shembull frymëzues për të bërë çdo therrori për çështjen e atdheut e të popullit." (*Zëri i Kosovës*, nëntor 1981, faqe 6-7)

PROFESORI-PLAKU, me pseudonimet *Profesori* dhe *Plaku* mendohet **Bujar Hoxha,** djali i Kadri Prishtinës. Në Raportin e Jusuf Gërvallës, për Degën "Hasan Prishtina" të LNÇKVSHJ, në fund të korrikut 1981, *Profesori* përmendet tri herë. Pseudonimi *Plaku* përdoret poashtu tri herë; një herë në letrën e 5 nëntorit 1981 dhe dy herë në letrën e 14 janarit 1982.

Jusuf Gërvalla: "*Lidhur me këto çështje kemi pasur një dialog të përbashkët dhe bukur të rreptë në praninë e tij unë dhe dy shokë nga Vjena, lidhur me këtë është dashur të jetë i informuar patjetër* ***Profesori****, në qoftë se është i informuar për çkado lidhur me I. Kelmendin.) ... Ka provuar t'ia plotësojë këtij daje të vogël (Gani Ibërdemajt - edhe lidhur me këtë njeri është dashur të jetë i informuar* ***Profesori****) dëshirën për t'u takuar me mua. ... Menjëherë pas kësaj, bashkë me shokët, kanë vazhduar rrugën për në Çekosllovaki, në gjurmim të armëve (ndoshta* ***Profesori*** *mund të ketë ndonjë informim nga ana e shokëve të Pragës lidhur me sjelljet e tyre në atë vend, sepse e di që shokët e Pragës kanë pasur kontakte dhe bile disa mosmarrëveshja me ta, sipas fjalëve të I. dhe H.)*." (Raport për Degën "Hasan Prishtina" të LNÇKVSHJ, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "*Tema duhet të shtjellohet nga një historian i rryer, së pari për nevojat e revistës e pastaj, nëse zgjerohet, mund ta nxjerrim edhe si broshurë a libër. Unë do të përpiqem nga ana ime të gjej njeri të tillë, por edhe më shumë të përpiqeni ju andej. Ideale do të kish qenë sikur përmes* ***Plakut****, materiale të tilla me peshë të mund të siguroheshin* ***në rrugën nëpër të cilën më kanë arritur këtu paratë e mbledhura për makinë.***" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Jusuf Gërvalla: "*Tani po kthehem edhe njëherë në fillim të letrës. Mendimi im është se disa çështje parimore, siç është themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë, pastaj mënyra e organizimit të Lëvizjes në kushtet e reja të luftës, duhet të* ***diskutohen e të pleqërohen më dendur me shokët, sidomos me Plakun.*** *Jo vetëm gabimet e mëdha parimore, por edhe të voglat ka mundësi të evitohen shumë më mirë në këtë mënyrë.* ***Ju atje jeni të lumtur që e keni Plakun****. Në këtë pikëpamje ne jua kemi lakmi, se këndej punët me relacione të tilla nuk janë aq të thelluara, jo për fajin tonë."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Në letrat e Qendrës Ekzekutive (organit udhëheqës të Lëvizjes për Republikë, 15 janar 1983 – 3 mars 1984 përmendet shpesh herë *Plaku*. Në letrat e kësaj periudhe me pseudonimin *Plaku* mendohet Hasan Mala.

privilege *privilegj* e drejtë apo përparësi të cilën e ka një individ ose një grup dhe e cila nuk është në dispozicion për ndonjë tjetër. Si rregull privilegji është i llojit social apo ekonomik dhe është i përcaktuar me ligj ose në bazë të traditës. Me rastin e analizave të shtresimeve sociale privilegji shihet si një komponent i rëndësishëm.

production norm *normë produktiviteti*, normë e cila e vendosë një kufi të epërm dhe një kufi të poshtëm për atë se sa grupi apo individi si anëtar grupi duhet të prodhojnë. Këto norma janë të karakterit jo-formal. Ata të cilët nuk u përmbahen këtyre u ekspozohen sanksioneve negative të karakterit fizik dhe psikik. Ata të cilët nuk i pranojnë këto rregulla, shpesh, nuk e kanë grupin e vendit të punës si grup kryesor (referimit) të identifikimit.

production-oriented leader ai lider apo kryepunëtor i cili para së gjithash është i fokusuar për rritjen e produktivitetit nga grupi të cilin e udhëheq. Mbikëqyrje (kontrollimi) karakterizohet nga urdhëresat, fshehtësia dhe rezistenca ndaj metodave të reja të punës. Është treguar se grupet me këtë lloj lideri, arrijnë rezultate po aq të mira sa edhe ato me *employee-oriented leader*, por këto grupe e kanë të vështirë të funksionojnë një kohë të gjatë.

profession zanat që kërkon dituri dhe shkathtësi shumë të specializuara. Këto kryesisht duhet të fitohen përmes arsimimit teorik, dhe kërkohet studimi në universitet apo institucion të ngjashëm arsimimi. Zanatet janë kryesisht në orientim ndaj klientëve dhe jo të prodhimit e distributimit. Si rregull, ushtruesit e zanatit janë të bashkuar në organizata të cilat e kontrollojnë shkollimin, përgatitjen e kuadrove të reja, përcaktojnë rregulla për sjelljet e anëtarëve ndaj klientëve dhe kontrollojnë që këto rregulla të respektohen. Avokat dhe mjek janë shembuj për këtë lloj të zanateve.

projection *projektim* Individi u mvesh, i etiketon personat tjerë me ato veti negative të cilat vet i ka. Ai i akuzon të tjerët për dështimet e veta. P. sh. ai i cili ka gënjyer mendon se të gjithë janë gënjeshtar apo një biznesmen i dështuar i akuzon të tjerët për mungesën e suksesit, se si të gjithë kanë punuar kundër tij. Projektimi është një prej reaksioneve të mundshme ndaj *frustracionit* dhe llogaritet si një *mekanizëm mbrojtës.*

proletariate *proletariati* klasa më e ulët në shoqëri. Shpesh me proletariat mendohet ajo pjesë e klasës punëtore, që është krejtësisht e mvarur nga shitje e fuqisë punëtore për të mundur të mbijetoj.

protocracy *protokraci* Shoqëria drejtohet prej atyre që janë më kompetent, pa marrë parasysh statusin social të tyre. E kundërta e kësaj janë monarkia, aristokracia, demokracia etj.

pressure group, persona të cilët bashkohen me qëllim realizimit të një qëllimi të përbashkët. Para së gjithash arritja e këtij qëllimi përpiqet të bëhet duke ushtruar forma të ndryshme presioni në ato institucione apo grupe, të cilat mbi baza kushtetuese kanë pushtet në shoqëri, p. sh. partitë politike që janë të reprezentuara në parlament.

PUNA 1. Aktivitet apo veprimtari me qëllim të caktuar, përmes të cilit njeriu gjallnon dhe formon jetën e tij.

2. Rezultati apo produkti i këtij aktiviteti.

3. Ajo detyrë apo ai qëllim që duhet të realizohet përmes këtij aktiviteti (ajo punë që duhet të bëhet).

Puna është një koncept themelor për filozofinë antropologjike. Me anën e këtij koncepti bëhet përpjekja që të qartësohet dallimi në mes aktivitetit njerëzor nga ai jo-njerëzor (aktivitetit mekanik apo instiktiv). Puna reprezenton një veprimtari specifike njerëzore. Por me këtë edhe lindë pyetja, cili është relacioni që ekziston në mes punës dhe *veprimit*, kur edhe veprimi konsiderohet aktivitet karakteristik për njeriun.

Filozofia "praktike", e kuptuar si filozofi mbi veprimet njerëzore e ka themelin tek Aristoteli. Ai bën dallimin në mes dy formave të veprimit, "praxis" dhe "poiesis". *Praxis* është një formë aktiviteti i cili ka një qëllim në vetvete. Është diçka që bëhet për hir të vet atij veprimi (p. sh. i bien flautës, apo e shpëton një fëmijë nga rreziku i mbytjes në ujë).

Poiesis është krijim apo punë përmes së cilës bëhet përpunimi i një materiali të caktuar (p. sh. ndërtimi i një shtëpie nuk është mjet por është qëllim, ne e përdorim atë për të banuar në te dhe jo vetëm sa për ta ndërtuar). Praxis ka një kuptim më të gjerë se poiesis, sepse para së gjithash praxis ka të bëjë me veprime në shoqëri, bashkësi, me veprime etike-politike.

Në kohët e fundit koncepti punë ka marrë gjithnjë e më shumë një rol qendror. Tek John Locke dhe Adam Smith bëhet potencimi i punës si krijuese vlerash dhe kulturash. Këtë e thotë edhe Hegeli, i cili njëkohësisht përpiqet që punën ta plasojë në një përcaktim gjerësisht të diferencuar të veprimtarisë njerëzore. Si përpunuese e natyrës, puna na liron prej detyrimeve (domosdoshmërive) natyrore. Përmes punës njeriu i formon sendet sipas "pamjes së tij", por me këtë e formon edhe vetveten. Në të njejtën kohë puna është e futur në një rreth veprimesh në mes njerëzve. Pra ekziston në një rrethanë shoqërore. Në këtë mënyrë Hegeli bën dallimin në mes punës dhe veprimit (si veprim ndaj të tjerëve) dhe në të njejtën kohë bën bashkangjitjen e tyre (punës dhe veprimit).

Marksi niset nga mendimi i Hegelit. Puna është esenca e njeriut, në atë mënyrë që, është puna ajo që e bën njeriun atë që është. Por ai menjëherë e kthen konceptin punë kundër idealizmit të Hegelit. Ai e potencon karakterin material, trupor tek puna.: "Puna është në radhë të parë një proces në mes njeriut dhe natyrës, një proces në të cilin njeriu, me iniciativën e tij ndërmjetëson, rregullon dhe kontrollon bashkëveprimin e vetë me natyrën." Me ato "forca natyrore" të karakterit trupor; duar, këmbë dhe kokë, njeriu ndërhyn në procesin natyral për t'i plotësuar nevojat e tij. Por në të njejtën kohë puna është diçka që e karakterizon njeriun. Ajo (puna) e distancon ate prej natyrës. Puna ka lidhje me një qëllim në atë kuptim se vetë njeriu e përcakton këtë qëllim. Përmes punës, njeriu u jep formë sendeve që janë rreth tij. Por relacioni në mes njeriut dhe produkteve mund të shtrembërohet, në atë mënyrë që njeriu nuk mund ta sheh veten në ato sende të cilat i ka krijuar – *alienation*.

Meqenëse njeriu e ndryshon natyrën rreth tij, sipas Marksit ndryshohet edhe vetë natyra e njeriut. Ai i zhvillon nevojat dhe mundësitë e tij përmes punës. Njeriu mbërrin tek vetvetja përmes punës. Në këtë mënyrë puna është krijuese e historisë. Përmes punës njeriu i jep formë botës sociale dhe kulturore. Në traditën marksiste puna ka një domethënie të gjerë dhe themelore. Ajo nuk paraqet vetëm një formë të caktuar të aktivitetit njerëzor por vetë procesin në të cilin njeriu i jep formë jetës së tij. Tendenca në këtë traditë është që të bëhet identifikimi i praxis apo veprimit me punën.

Një identifikim i tillë bëhet shkaktar i krijimit të problemit lidhur me atë se në çfarë mënyre duhet kuptuar veprimet në raport me njerëzit tjerë, pra në kuptimin etik e politik. A është e mundur që një veprim i tillë të reduktohet në përpunim të një materiali të caktuar? Në një kritikë brenda traditës marksiste, Habermas bën dallimin në mes

veprimit teknik, "instrumental" (d. m. th. punës) dhe veprimit "komunikativ" (ndërveprimit d. m. th. veprimit në raport me të tjerët, veprimit ndaj të tjerëve).

Q

QAMILI IMERJAH, veprimtar në Gjermani. Një nga udhëheqësit e Klubit "Emin Duraku" të Dusseldorfit. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Imerjah Qamili, Kölnerstr. 313, D-4000 Düseldorf. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

QELAJ LATIF, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Latif Qelaj, Alte Landstr. 101, 2072 Bargteheide. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

QYQALLA SYLEJMAN – Sylejman Qyqalla, i lindur më 29 qershor 1954 në fshatin Bellaqefci i Madh KK Prishtinë. Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, më 4 qershor 1980 është dënuar me 4 vjet burg.

R

racketeer *reketash* person i cili merret me veprimtari të ndryshme kriminale. Më së shpeshti reketashi është pjesë përbërëse e një organizate kriminale. Dhuna fizike dhe shkatërrimi i pasurisë janë disa prej mjeteve me të cilat ai shërbehet për t'i detyruar të tjerët t'i japin para. Kockarnicat ilegale, shtëpitë publike-burdelet me prostituta dhe tregu i zi janë disa prej aktiviteteve të tij fitimprurëse.

radicalism *radikalizëm* Veprim politik apo social ose një ide që qon apo kërkon ndryshime të menjëhershme dhe rrënjësore në shoqërinë ekzistuese. Si rregull koncepti është i lidhur me politikën majtiste, si atë marksiste poashtu edhe atë jo-marksiste. Radikalizmi shpesh shihet si poli i skajshëm i një vazhdimësie, që në skajin tjetër ka lëvizjet reaksionare. Nganjëherë flitet për radikalizmin e djathë, i cili qëndron në raport të kundërt me *konzervatizmin* tradicional.

RAMA REXHEP, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Rexhep Rama, Dorfstr. 54, 4656 Starkihre. CH. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 2.

RAMABAJA XHAVIT, veprimtar në Gjermani. Aktivisti kryesor në rrethin e Bilefeldit. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Xhavit Ramabaja, Auf Dem Felde 23, Gütersloh 12. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

RAMADANI NAMI, veprimtar i dalluar në Esslingen-rrethit të Shtutgartit nga fshati Tenovë i Tetovës. Postjeri kryesor i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës. Shofer profesionist i kamionave të mëdhenj. Si shofer i ka ra shpesh herë kryq e tërthor Evropës. Në të gjitha rrugët e tij, me vete ka pas gazetat, Zërin dhe fjalët e Jusuf Gërvallës, të cilat ua ka shpërnda bashkatdhetarëve, nëpër anët e ndryshme të Evropës, të cilët në marrëveshje

paraprake me te kanë dalë dhe e kanë pritë në ato vendpushime e pauza që i kanë konvenuar Namiut. Në vitet 1980-1985 ka banuar në këtë adresë: Nami Ramadani, Karlsbaderstr. 12, D-7300 Esslingen.

RAMADANI QAZIM – Qazim Ramadani nga fshati Smirë- aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

RAMAJ MUHARREM, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Muharrem Ramaj, Pasenstr. 13, 2800 Bremen 44. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

RAMIQI EMRUSH, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Emrush Ramiqi, Schutzenstr. 27, 6700 Ludwigschafen. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

RAMIQI MUHAMET, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Muhamet Ramiqi, Cite Ouest« G »Ch.1196 Gland (VD)tel. 642957. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

rank *rang* pozitë të cilën një individ e ka në një grup, anëtarët e të cilët i kanë në dispozicion në masa të ndryshme ato resurse të pakta (të kufizuara) që vlerësohen nga grupi. Resurset munden me qenë; pushtet, të ardhura, kapital, shkollim etj., apo ndonjë kombinim i këtyre që u përmendën. Sa më e madhe që të jetë qasja (masa e disponimit) që individi ka në ndonjë resurs aq më i lartë është rangu i tij në atë dimension të resursit. I njejti individ mund të ketë rang të lartë në një dimension dhe më të ulët në ndonjë tjetër, p. sh. drejtori i një ndërmarrje i cili e ka të kryer vetëm gjysmën e shkollës fillore.

RASHANI FADIL, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Fadil Rashani 10, Rue John-Grasset CH-1205 Geneve, tel. 299374. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

rate buster person e cili përpiqet gjithnjë t'ua kaloj të tjerëve me punë, apo duke e bërë atë më shpejt dyshohet se e prish akordin për tërë grupin punues.

rationalization *racionalizim* racionalizimi ndodh kur një veprimi i epet një sqarim i pranueshëm social, kur motivi i vërtetë që qëndron pas atij veprimi është i papranueshëm. P. sh. dikush mund të thotë se merr pjesë e angazhohet në politikë me qëllim që t'i shërbej shoqërisë, ndërsa motivi i vërtetë është pushteti, hegjemonia dhe hajnia. Me ndihmën e racionalizimeve, të cilat mund të jenë të pavetëdijshme ose të vetëdijshme përpiqet të ruhet respekti për vetveten. Racionalizimet ndodhin në gjendje të *frustracionit* dhe ato mund të përshkruhen si *mekanizëm mbrojtës*.

reaction formation Individi sillet në një mënyrë që është e kundërt me atë që kishte dashtë. P. sh. një person i cili është shumë i idhnuar në dikend, në vend që ta shprehë idhnimin, e fshehë atë, dhe ndaj tij tregohet në mënyrë të tepruar i shoqërueshëm e miqësor. Ky është një nga shumë reaksionet, të cilat hyjnë në funksion gjatë *frustrimit* dhe është një *mekanizëm mbrojtës*.

reactionary *reaksionar* person apo grup që kërkon kthimin një gjendje të mëparshme që ka ekzistue në shoqëri apo në ndonjë pjesë të saj. Pra nuk është në pyetje ruajtja e gjendjes aktuale. P. sh. kërkesa për kthimin e dënimit me vdekje për krime të caktuara, në disa vende perëndimore, është reaksionare.

realism *realizëm* Në shkencat shoqërore, ajo pikëpamje sipas të cilës shoqëria, institucionet, grupet etj. janë më shumë se sa pjesët përbërëse pra më shumë se sa thjeshtë numri i individëve që hyjnë në përbërjen e tyre. Realizmi quhet edhe universalizëm. E kundërta është *atomizëm*.

rebellion *rebelizëm* një prej shumë modeleve të veprimit që sipas R. Merton, ndeshet gjatë tensioneve strukturale në shoqëri, tek të cilat vjen si pasojë e ndarjes së pabarabartë të atyre mjeteve që konsiderohen të pranueshme për arritjen e qëllimeve-caqeve që definohen nga një kulturë. Gjendjen e tillë ai e quan anomike, e cila në atë situatë reagon përmes rebelizmit, duke i hedhur poshtë si caqet e aprovuara nga kultura ashtu edhe mjetet për t'i arritur këto caqe. Në këtë mënyrë bëhet përpjekja për rikonstruktimin e shoqërisë duke vendosur qëllime-caqe të reja dhe duke përcaktuar mjete të reja për arritjen e këtyre caqeve. Në *Social Theory and Social Structure* (1957) Merton përshkruan edhe katër modele tjera të reagimit në një situatë anomike. Ai i quan ato *inovacion, konformizëm, retretizëm dhe ritualizëm*.

recidivism përsëritja apo rikthimi, pos tjerash në veprimtari kriminale.

redintegration përdorimi i pavetëdijshëm i mënyrës së sjelljeve të të tjerëve nga dikush. Quhet shpesh gabimisht imitim.

reductionism *reduksionizëm* 1. supozimi se metodat dhe teoritë të cilat vlejnë për disa fenomene sociale të caktuara vlejnë edhe për të tjera, përkundër ndryshimeve esenciale që ekzistojnë në mes fenomeneve gjegjëse,
2. supozimi se ligjet mbi sjelljet e fenomenet sociale janë vetëm një rast i veçantë i atyre ligjeve që vlejnë për objektet biologjike dhe fizike.

reference group Veprimet sociale të individit drejtohen pjesërisht nga ato *norma* që vlejnë për atë apo ato grupe të cilave ai u takon dhe pjesërisht nga *normat* që vlejnë për grupet tjera, pamvarësisht se a janë ato të vërteta apo të imagjinuara. Të gjitha grupet që në këtë mënyrë ndikojnë në individin dhe veprimet e tij sociale quhen *referensgrupe*.

Që një grup në të cilin individi nuk është anëtar të konsiderohet nga ai si *referens-grup* duhet që ai (grupi) të plotësoj diçka prej këtyre kritereve:

1. individi përpiqet që të bëhet anëtarë në te,
2. individi përpiqet që t'u përngjaj anëtarëve të atij grup në ndonjë aspekt,
3. individi është i kënaqur që dallohet prej anëtarëve të atij grupi dhe përpiqet t'i ruaj këto dallime dhe
4. individi e merr si pikënisje atë grup (të cilit nuk i takon) si objekt krahasues kur don të bëjë vlerësime për grupin e vetë (pra grupit të cilit i takon).

Teoria e *reference group* është trajtuar hollësisht nga R. Merton dhe A. Kitt në librin e R. Merton *Social Theory and Social Structure* (1957).

reference individual Nëse një individ në të gjitha rolet të cilat ai i luan, përpiqet t'i ngjaj një tjetër individi ky i fundit është *reference individual* i të parit. Kështu ky koncept është më i gjerë se sa (*rol-model*).

referendum *referendum* votim ku zgjedhësit kanë mundësi ta pranojnë ose hedhin poshtë politikën e ndjekur. Referendumet mund të jenë obliguese dhe këshilluese. Në rastin e parë (referendumet obliguese) duhet të zbatohet ajo vijë që ka fituar shumicën, gjë që nuk është e domosdoshme tek referendumet e llojit të dytë (këshilluese).

REKA HYZRI, figurë qendrore e rrethit të Dusseldorfit. Një nga aktivistët më të dalluar. Shok i Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës. Në vitet 1980-1984 ka banuar në këtë adresë: Hyzri Rekaj, Mintorpstr. 27, D- 4000 Dusseldorf.

RENEGATI, një nga artikujt më të mirë të Jusuf Gërvallës. Është botuar në numrin e parë të Lajmëtarit të lirisë, në faqe 8-9:

RENEGATI

Prolegomenë për historiatin, zhvillimin dhe perspektivën e dështakut më të madh të fisit njerëzor

Prejardhja dhe shtrirja fizike e renegatit.

-Ndër fjalorë, renegatin e gjejmë te shkronja r me këtë shpjegim përkatës: renegati vjen nga lat. Renegate (re…+ negare – me mohue) dhe shenjon njeriun që ka ndërruar mendje, bindjen e përparshme dhe ka dalë në taborin kundërshtar, në taborin e armikut; ai është edhe i arratisur, dezertor, përçarës, tradhtar, pjellë e keqe, kopil….
Ndër vende e popuj, renegatin e gjejmë kryesisht në të gjitha paralelet dhe meridianet e planetit Tokë. Sidomos në gji vendesh dhe popujsh të pushtuar e të kolonizuar.

***Ekologjia e renegatit**.- Truall i përshtatshëm për lulëzimin e renegatëve quhet trualli ku ekziston konflikti i përhershëm mes gjakësorit dhe viktimës. Karakteristikë kryesore e truallit të tillë janë ato rrethanat e njohura, që e mbajnë gjallë ligjin ekologjik, sipas të cilit, për të gjalluar ujku, duhet të zhduket dhia, dhe për të gjalluar dhia , duhet të zhduket lakra. Këtu renegati futet si një pykë, që gjithmonë shërben për të çarë trupin e palës së dobët, të viktimës.*

Edhe klima, që kushtëzon mugullim të dendur dhe rritje të suksesshme të renegatit, është klimë ters: qielli i ulët, i rëndë, i zymtë, me një minimum ditësh me diell gjatë vitit (apo gjatë dekadave, shekujve) dhe me maksimumin e të reshurave kalbëzuese. Kusht i domosdoshëm janë erërat e përhershme me kundërmim qelbanik, që duhet të fryjë gjithmonë nga një drejtim, nga qendra (kupto: nga institutet e pushtuesit për shtypjen dhe ç'kombëtarizimin e të pushtuarit) në drejtim të provincave të pushtuara e të kolonizuara. Këto erëra duhet të sjellin pështjellim, anarki, pacifizëm, altruizëm të inskenuar, terr injorance e analfabetizmi, tradhti, vëllavrasje, përçarje dhe sherre që mbillen, piqen e korren përngut, pa e pritur njëri-tjetrin.

***Format e ekzistencës së renegatit**.- Në përputhje me kushtet e tilla ekologjike, te familja e madhe e përbindëshave-renegatë është zhvilluar një mori formash të ekzistencës, nga më të ulëtat e deri te ato më të lartat; që nga renegati-morr, i cili nuk shikon si e si të sigurojë për të vegjlit e vet një lugë kos, po që ta bëjë të ngordhur lopën*

e të vëllait, për t'ia lënë atij pa kos carrokët, e deri te renegati-katalla, i cili ushqimin e vet e siguron duke ushqyer sa më majmë armikun me gjakun e vëllezërve të dikurshëm.

***Përkufizimi i qenies së renegatit**.- Më poshtë do të shohim sa e vështirë na del puna e përkufizimit të qenies së renegatit. Ja se pse. Thamë se ai është ndërmjetësues në shtypjen sa më të suksesshme të të pushtuarit nga ana e pushtuesit. Pra, renegati na del jo krijesë e mëvetësishme po gjymtyrë e këputur nga një praorganizëm (praatdhe, prapopull), që i ndajshtohet një organizmi të ri (të armikut), i cili për nga konstitucioni elementar dhe për nga bindjet s'ka asgjë të përbashkët me paraardhësin e renegatit.*

Një dukuri e tillë nuk është hetuar në asnjë plan të ekzistencës së gjallesave të planetit tonë. Madje as te sendet dhe fenomenet natyrore. Në mungesë të mundësive për ndonjë përkufizim plotësisht të saktë të qenies së renegatit, do të mjaftohemi me evidentimin e ekzistencës së tij në disa plane fiziko-metafizike dhe në disa shkallë të ndryshme të qenies.

a)Plani metafiziko-mistik

Të gjitha doktrinat fetare e kanë evidentuar ekzistencës e shpirtit të lig, i cili bën çerdhe nën sjetullat e njerëzve të vdekshëm, për t'i larguar këta nga rruga e mbarë dhe për t'i joshur në udhën e djallit. Prandaj, në mësimet fetare renegati jo rastësisht krahasohet pikërisht me këtë qenie mitike, emërtohet "hafije" dhe i caktohet vendi më i keq në rrathët e ferrit. Po ndryshe nga fryma e ligë mistike, renegati e ha bukën dhe, si të tillë, edhe renegatin e ha plumbi. (Po të ketë kush ia jep)

b)Plani antropologjik

Sikundër në gjithë botën shtazore, forma më e lartë ekzistenciale e së cilës është njeriu, edhe te njeriu dominon instinkti i dashurisë ndaj më të afërmit të llojit dhe rezoni e kujdesi për zhvillim sa më të mbarë të llojit të cilit i përket (kjo e dyta vetëm te njeriu)

Përjashtim bën pasardhësi i Kainit, vëllavrasësi..

Po edhe në këtë pikë, qenia e renegatit sikur ikën nga mundësia e përkufizimit të saj të saktë. Vërtet, Kaini e vrau Abelin, që e kishte vëlla, por vrasja i bë për shkak të xhelozisë, do të thotë për të jetuar vetë në liri (patologjike) , e jo për t'ia dhënë armikut barbar lëkurën e të vëllait.

c)Plani zoologjik

Të themi: renegati është dosë, që e ha pjellën e vet! Por, deri më sot nuk kemi njoftime për ndonjë dosë që t'ia ketë shpënë për ëmbëlsirë ujkut derrkucët. Ose, mund të themi mace. Macja e ha pjellën e vet, këtë e dimë. Por, ajo vazhdimisht kujdeset që, duke eliminuar të vegjlit e vet, ta lërë gjallë më të shkathëtin, pasardhësin më të aftë për të gjuajtur minj dhe për t'u përleshur me qen. Renegati jo! Ai, bijtë e shkathët të popullit të vet i rjep dhe lëkurën e tyre ia jep falas armikut; ai i lë gjallë këlyshët që i përngjajnë atij, më të dobëtit.

ç)Plani botanik

A bën lulja pa lulen? "Me një lule nuk çel pranvera!" Por, edhe në këtë mes na paraqiten patologji madërgona, bie fjala. Mbin ku s'e ke pritur, rritet duke ua marrë ushqimin bimëve që japin fryte. Edhe kërpnaja, që u lidhet për trupi pemëve dhe ua ndan rriten. Por, t'i pyesësh, për hir të kujt bëjnë kështu, edhe madërgona edhe kërpnaja të tregojnë se e bëjnë vetëm për të jetuar vetë, dhe jo për hir të hithit agresiv, ta zëmë. Kurrsesi!

d)Plani i sendeve dhe objekteve

Në e parë duket se përfundimisht kemi dalë në fushën e kërkuar. Përfytyrimi i parë që lidhet me shembëlltyrën e renegatit, është një vegël e thjeshtë e praktikës më të thjeshtë: masha. Me mashë nxirren gështenjat nga zjarri, me mashë e ruajmë dorën nga prushi. Ose biza. Me të i hapim rrugë gjilpërës për në lëkurë dhe kështu ruajmë gishtat. Por, edhe masha edhe biza janë aq indiferente, aq të marra e të ftohta, sa s'kanë lidhje

ç'janë duke bërë. Më në fund, edhe sikur të mos kishin qenë indiferente e të marra, masha dhe biza mund ta ngrenë kokën me mburrje para renegatit, sepse as njëra as tjetra nuk përdoren kurrë për asgjësimin e llojit të vet.

***Shumimi i renegatit**. – Shkencërisht është vërtetuar se vetmia është gjendje vrastare edhe për krijesat më asociale, madje edhe për monstrumet, që pothuaj se i kanë mjaftuar gjithmonë vetvetes. Ndoshta edhe dështaku më i madh i fisit njerëzor, renegati, do të mund të bënte pa shoqëri dhe pa pasardhës. Por, meqenëse në lashtësinë e errët hyjnore mistike, kur janë ndarë shpirtrat dhe fatet jetësore, ai ka zgjedhur shpirtin, rrugën dhe fatin e Kainit, fatin e këpujës, bullungës, macallungës, bajllagës; fatin e ushujzës që thith gjak jo për vete po për të tjerë, pra të një ushujze patologjike, ai ka pranuar njëherazi fatin e veprimit sipas diktatit të të huajit. Kështu , edhe për shumimin e tij vendos tjetri. Ka çaste që renegati, ngjashëm me revolveristët me pagë të Perëndimit të egër, lodhet me punën e vet dhe dëshiron fuqishëm të kthehet në jetën e qetë: po ai që i rri mbi kokë dhe i dikton nuk e lejon kurrsesi një gjë të tillë. Atëherë renegati rrëmbehet nga ndjenja e vetëshkatërrimit dhe e iritimit ndaj shumimit. Por, edhe atëherë ai është i detyruar të shumohet sipas urdhrit të armikut, të cilin e ka bërë "vëlla".*

Zakonisht, renegati shumohet duke mbjellë mjegull, me të cilën lypset të mbulohet e drejta, e vërteta historike dhe trashëgimia e mbarë kombëtare e vëllezërve të tij të përparshëm në atdheun e robëruar. Rekuizitat praktike: gënjeshtra e imtë, edhe atëherë kur të gjithë e dinë se je duke gënjyer; gënjeshtra e madhe historike, demagogjia. Pra, siç shohim, shumimi i renegatit bëhet të shumtën në mënyrë metafizike, pa kontakt fizik. (Ose me një kontakt oral!) Por, edhe kjo mënyrë e shumimit kërkon shpenzime sasish të mëdha energjie, e cila kompenzohet po me mjete patologjike: pas çdo komunikimi me qëllim të fundëm shumimin, renegati duhet të hajë pak palcë kurrizore të ish vëllezërve të vet dhe të lëpijë ndonjë asht të ish vëllezërve. Zakonisht, ashtin ia hedh pushtuesi dhe kolonizatori, pasi ta ketë konsumuar vetë intenzivisht.

***Përfaqësuesi**.- Qielli, toka dhe uji shqiptar, me një nga klimat më optimale për rritjen dhe shumimin e renegatit, e bëjnë me të madhe këtë kopil, këtë ushujzë. Kësaj radhe do të marrim shembull vetëm disa nga përfaqësuesit e renegatëve, ekzistenca e të cilëve manifestohet në planin dhe në shkallën më të lartë: Fadil Hoxha, Xhevdet Hamza, Xhavit Nimani, Mahmut Bakalli…*

***Perspektiva e renegatit për ekzistencë**.- Regenati, përfaqësuesi më i denjë i llojit të vampirit, që është i thirrur për ta zhdukur lugatin, zhduket posa të bien mbi dhe shenjat e para të agimit, pra të luftës çlirimtare-çkolonizuese dhe të revolucionit. Duke iu referuar kapitullit me titull "Ekologjia e renegatit", po përfundojmë se perspektiva ekzistenciale e renegatit është si ajo e disa insekteve të caktuara, që jetojnë vetëm tre çerek ore: "ata lindin aty nga ora pesë dhe ngordhin aty nga ora gjashtë e mbrëmjes. Për këto insekte nuk ekzistojnë mëngjesi, mesdita, mbrëmja, për to nuk ekziston kohë tjetër veç muzgut, ku ato lindin dhe vdesin."* (Jusuf Gërvalla, Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, f. 8-9)

residue Një komponent i rëndësishëm në sociologjinë e W. Paretos janë residue-t. Ato janë gjashtë dhe ai mendon se ato janë themeli i motiveve për të gjitha veprimet. Ato kanë këtë përmbajtje vijuese:

1. tendenca për kombinime të reja (inovacion),
2. ruajtja e *agregateve* ekzistuese (konsolidim),
3. ndjenjave me iu dhënë simbole (ekspresivitet),
4. me iu bashkangjitë të tjerëve (ekspresivitet),
5. ruajtja e dinjitetit (integritet), dhe
6. vështrimi i botës përmes termave erotik (seksualitet).

Në teorinë e Paretos për cirkulacionin e elitave ai e ka përdorë më së shumti konceptin e inovacionit dhe konsolidimit. Ai mendon se ato veprime që janë vetvetiu jo logjike duhet me u arsyetue. Kjo bëhet duke përdorur *derivate* të ndryshme, që përbëjnë mveshjen gjuhësore. Ai i ka trajtuar residue-t dhe derivatet në *Trattato di sociologia general* (1916).

resocialization *risocializim* ndryshim i shpejt dhe i madh në atitydat dhe sjelljet e një individi. Atitydat dhe sjelljet e reja jo vetëm që janë të ndryshme nga të mëparshmet, por janë edhe të papajtueshme me to. *"Brain wasching*", rehabilitimi i kriminelëve dhe konvertimet-kthesat religjioze janë shembuj për këtë.

response përgjigje që individi e jep ndaj një *stimuli*. Përdoret shpesh për sjellje që mund të vështrohen por nganjëherë edhe kur janë në pyetje procese fiziologjike të brendshme. Term alternativ është reaksion.

retreatism është një model i mundshëm i veprimit në një situatë në të cilën shoqëria është në gjendje *anomike*. Kjo do të thotë sipas R. Merton, se ato mjete, që janë të aprovueshme (legjitime) për arritjen e një qëllimi të definuar në pikëpamje kulturore, janë të shpërndara në shoqëri në mënyrë të pabarabartë. Ata individ që në një situatë të tillë përgjigjen me retreatism i hedhin poshtë si qëllimet-caqet ashtu edhe mjetet dhe i individualizojnë reaksionet e tyre. Endacakët që flejnë stacioneve të trenave e autobusëve dhe në tabuta të xhamijave, vagabondët, alkoolistët dhe narkomanët, në bazë të Mertonit janë persona, që në këtë mënyrë e individualizojnë sjelljen e tyre. Në *Social Theory and Social Structure* (1957) përveç përshkrimit të këtij modeli të veprimit, përshkruhen edhe katër modele tjera të veprimit në një situatë anomike, të cilat Merton i quan *inovacion, konformizëm, rebelizëm dhe ritualizëm*.

revitalization movement lëvizje që vepron për ripërtrirjen e kulturës së shoqërisë të cilët anëtarët i takojnë. Këto lëvizje kanë pasë rëndësi të madhe në histori. Krishterimi, muhamedanizmi dhe budizmi mund të konsiderohen lëvizje të këtij lloji.

REVIZIONIZMI. Formë e maskuar e oportunizmi dhe pasqyrim i ideologjisë borgjeze në lëvizjen punëtore e komuniste, që u shfaq kur marksizmi triumfoi mbi kundërshtarët e tij ideologjikë dhe u afirmua si botëkuptim i klasës punëtore. Revizionistët e pranojnë marksizmin me fjalë, por kërkojnë rishikimin e tij, e falsifikojnë atë, flakin mësimet themelore dhe shpirtin revolucionarë të tij, duke pasur si qëllim strategjik përjetësimin e sundimit të kapitalizmit atje ku ai është në fuqi dhe rivendosjen e tij atje ku ai është përmbysur.

Revizionizmi modern, duke qenë vazhdues i drejtpërdrejtë i revizionizmit të vjetër, të Bernshtajnit, Kautskit etj. ka edhe tiparet e veta dalluese të veçanta. Dallimi kryesor qëndron në faktin që revizionizmi i sotëm nuk është vetëm një rrymë ideologjike antimarksiste, por edhe revizionizëm në pushtet në një numër vendesh. Përvoja tregon se në këto vende baza shoqërore kryesore e tij u bë një shtresë e gjerë kuadrosh drejtuese të partisë, të aparatit shtetëror, të ekonomisë e të kulturës, që gradualisht u burokratizuan, e vunë veten mbi masat dhe u borgjezuan, deri sa u shndërruan në një klasë të re borgjeze, ndërsa në BRSS e në Kinë edhe në përfaqësues të socialimperializmit. Revizionizmi modern përfaqëson armikun kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, është "kali i Trojës" i imperializmit dhe kapitalizmit botëror.

Ekzistojnë rryma të shumta të revizionizmit modern, ndër të cilat më kryesoret janë; revizionizmi sovjetik, revizionizmi jugosllav, revizionizmi kinez, dhe revizionizmi eurokomunist. Luftën konsekuente kundër revizionizmit modern të të gjitha ngjyrave, PPSH e ka parë dhe e sheh si një çështje të madhe parimore, kusht të domosdoshëm e detyrë të dorës së parë për të çuar përpara çështjen e revolucionit, të çlirimit të popujve e të socializmit. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, faqe 917)

REVIZIONIZMI EUROKUMINIST. Variant i revizionizmit modern, një grumbullim teorish pseudokomuniste, që i kundërvihet marksizëm-leninizmit. Eurokomunizmi është produkt i degjenerimit të partive komuniste të Evropës Perëndimore që u futën në rrugën e revizionizmit. Ai është ideologji e aristokracisë punëtore dhe e reformizmit borgjez të kulluar, që ka për qëllim sabotimin e revolucionit, mbrojtjen e përjetësimin e rendit kapitalist. Përfaqësueset të eurokomunizmit janë partitë revizioniste të Italisë, Francës dhe Spanjës.

Veçori dalluese e revizionizmit eurokomunist është se ai paraqitet si "revizionizëm pa dorashka", që del hapur kundër leninizmit dhe mësimeve marksiste-leniniste për revolucionin e shoqërinë socialiste. Eurokomunistët mohojnë ligjet e përgjithshme të kalimit nga kapitalizmi në socializëm, janë vënë në kërkim të një "rruge të re", të ndryshme nga ajo e Revolucionit të Tetorit, predikojnë rrugë specifike "me ngjyra kombëtare". Thelbi i predikimeve të tyre është kalimi gjoja në socializëm pa udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë së saj, pa revolucion, pa përmbysur borgjezinë, pa shkatërruar makinën shtetërore borgjeze, dhe pa vendosur diktaturën e proletariatit, por me "paqe sociale", në "rrugë demokratike e parlamentare" përmes "reformave të strukturës", në kuadrin e kushtetutës borgjeze, në "kompromis historik" e aleancë me partitë socialdemokrate e borgjeze, me pjesëmarrjen e të gjithëve të proletarëve e të borgjezëve, të priftërinjve e të policëve etj.

Tabloja e shoqërisë "së re", që japin eurokomunistët, s'është tjetër veçse shoqëria e sotme kapitaliste, e retushuar me bojë "socialiste". "Socializmi i përfytyruar nga eurokomunistët është një shoqëri, në të cilën pleksen e bashkëjetojnë elemente socialiste e kapitaliste në ekonomi e në politikë, në bazë e në superstrukturë. Eurokomunizmi është një shembull i qartë i degjenerimit socialdemokrat dhe i tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, faqe 917-918)

REVIZIONIZMI JUGOSLLAV. Rryma e parë e revizionizmit në pushtet, armë e posaçme e imperializmit për përçarjen dhe minimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare e të kampit socialist, për degjenerimin dhe shkatërrimin e socializmit, për sabotimin e revolucionit e të lëvizjes antiimperialiste çlirimtare të popujve, për falsifikimin e marksizëm-leninizmit.

"Socializmi vetadministrues" jugosllav, i propaganduar nga titistët dhe nga borgjezia ndërkombëtare si model i një "socializmi specifik demokratik e human", është mohim i hapur i mësimeve të marksizëm-leninizmit dhe i ligjeve të përgjithshme të ndërtimit socialist. Sistemi ekonomik e politik "vetadministrues" jugosllav është një shoqëri hibride kapitalisto-revizioniste, një formë anarkosindikaliste e diktaturës së borgjezisë, e frymëzuar nga idetë e Prudonit, të Bakuninit, të "Opozitës punëtore" etj., që sundon në Jugosllavinë e varur nga kapitali ndërkombëtar.

Në lëmin e marrëdhënieve kombëtare, revizionizmi jugosllav është mishërim i shtypjes shoviniste dhe i përçarjes midis kombeve. "Socializmi vetadministrues" ka ngjallur antagonizmat e vjetër midis klaneve të ndryshme shoviniste, ka çuar në thellimin e pabarazisë, të grindjeve e të rivalitetit të republikave e të krahinave të Jugosllavisë, në rritjen e tendencave hegjemoniste e seperatiste.

Revizionistët jugosllav janë armiq e minues të revolucionit e të luftërave antiimperialiste çlirimtare të popujve. Ata predikojnë pikëpamjet antimarksiste të ecjes spontane drejt socializmit, pa përmbysjen revolucionare të borgjezisë, pa udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë komuniste. Një vend të veçantë në misionin e revizionizmit jugosllav në shërbim të strategjisë së imperializmit zë teoria dhe praktika titiste e "mosangazhimit", e cila ka për qëllim të largojë popujt liridashës nga lufta aktive kundër skllavërisë imperialiste e neokolonialiste.

Një rol i madh në demaskimin e titizmit i takon J. V. Stalinit. PPSH e para u ndesh me ballë për ballë me revizionizmin jugosllav në teori e në praktikë, ajo nuk e ndërpreu për asnjë çast luftën kundër tij dhe i ka bërë atij analizën, më të plotë e të thellë. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, faqe 918)

REVIZIONIZMI KINEZ. Rrymë oportuniste në lëvizjen komuniste botërore dhe një ndër variantet kryesore të revizionizmit modern, që ka luajtur e luan një rol të posaçëm që ka luajtur e luan një rol të posaçëm në strategjinë e imperializmit për falsifikimin e marksizëm-leninizmit, për sabotimin e revolucionare e veçanërisht të luftërave çlirimtare në vendet ish-koloniale e të varura, si dhe për degjenerimin e socializmit, për përçarjen e minimin e lëvizjes komuniste e marksiste-leniniste ndërkombëtare.

Baza "teorike" e revizionizmit kinez, "maocedunideja", e shpallur prej tij si "etapa e tretë e më e lartë e marksizëm-leninizmit", përfaqëson në të vërtetë një teori eklektike, një amalgamë pikëpamjesh, ku janë përzier ide e teza të shkëputura marksiste me parime filozofike idealiste, pragmatiste e revizioniste, të huajtura nga filozofia e lashtë kineze dhe nga shkollëzat e filozofisë e të sociologjisë së sotme borgjeze e pseudomarksiste.

Thelbin e pikëpamjeve e të praktikave antimarksiste të revizionizmit kinez e të "maocedunidesë" e përbëjnë: mohimi i rolit të klasës punëtore në revolucion dhe përhapja e teorisë së "rrethimit e të çlirimit të qytetit nga fshati"; përligjja e bashkëjetesës së shumë vijave në partinë komuniste; vënia e ushtrisë mbi partinë; predikimi i pluralizmit politik në socializëm; integrimi paqësor i borgjezisë; ruajtja e pozitave të saj dhe shuarja e luftës së klasave në shoqërinë socialiste; mohimi i rolit të botëkuptimit marksist-leninist dhe predikimi i pluralizmit ideologjik në socializëm.

"Teoria e tri botëve" e revizionistëve kinez mohon rolin historik të proletariatit, duke paraqitur si forcën lëvizëse kryesore të historisë të ashtuquajturën "botë e tretë", nën hegjemoninë e Kinës; predikon shuarjen e çdo lëvizjeje revolucionare e çlirimtare, aleancën e punonjësve e të popujve me borgjezinë, me regjimet reaksionare, me shtetet imperialiste të "botës së dytë" dhe me imperializmin amerikan kundër socialimperializmit sovjetik; është ideologji e politikë e afrimit me imperializmin botëror dhe e nxitjes së luftës imperialiste, si rrugë për shndërrimin e Kinës në një superfuqi.

Lufta e PPSH kundër revizionizmit kinez është me rëndësi të madhe për lëvizjen revolucionare në botë, sepse ajo, siç ka theksuar shoku Enver Hoxha, rrëzoj dy mite: atë të Kinës, si vend ku ndërtohej socializmi dhe atë "maocedunidesë", si marksizëm-leninizmi i kohës sonë. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, faqe 918)

REVIZIONIZMI SOVJETIK. Një ndër rrymat kryesore të revizionizmit modern dhe forma e tij më e rrezikshme që karakterizohet nga një demagogji e stërholluar. Ai u shfaq pas vdekjes së J. Stalinit, u kristalizua në Kongreset XX e XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe u zhvillua e u thellua më tej pas rrëzimit të N. Hrushovit, si "hrushovizëm pa Hrushovin". Pikërisht dalja në skenë e revizionizmit hrushovian në BRSS e shndërroi revizionizmin modern në një dukuri ndërkombëtare. Revizionizmi sovjetik përfaqëson teorinë e praktikën më të gjerë e më të përpunuar të

kundërrevolucionit revizionist, revizionimin e teorisë marksiste-leniniste në të gjitha fushat e për të gjitha çështjet.

Ai është, para së gjithash, ideologji e politikë e likuidimit të diktaturës së proletariatit, e shkatërrimit të rendit socialist dhe e rivendosjes së marrëdhënieve kapitaliste në formën e kapitalizmit shtetëror të një tipi të veçantë, që sundon në tërë jetën e vendit. "Partia dhe shteti i gjithë popullit", "socializmi i zhvilluar" etj., që propagandojnë revizionistët sovjetik, s'janë tjetër gjë veçse maska për të fshehur diktaturën borgjeze socialfashiste dhe rendin shfrytëzues kapitalist.

Në të njejtën kohë, revizionizmi sovjetik është teori e praktikë e sabotimit dhe e shuarjes së revolucionit e të luftërave çlirimtare. Teoritë e tij të "bashkekzistencës paqësore", të "kalimit paqësor", e të "rrugës parlamentare" për në socializëm, të "demokracisë antimonopoliste" etj. janë falsifikim i plotë dhe flakja e mësimeve themelore të marksizëm-leninizmit për revolucionin proletar dhe luftërat nacionalçlirimtare.

Lufta për demaskimin e plotë të revizionizmit sovjetik ka qenë dhe mbetet një detyrë e madhe për të gjithë marksistë-leninistët në kohën tonë. PPSH dhe shoku Enver Hoxha kanë mbajtur që në fillim një qëndrim të drejtë dhe parimor kundër revizionizmit sovjetik dhe kanë dhënë një ndihmesë të veçantë për demaskimin e tij. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, faqe 918-919)

REXHA BESIM, veprimtar në Velbert, Gjermani. Për Besim Rexhën me ka folë Jusufi gjatë gjysmës së dytë të vitit 1981. Besimi i dërgonte nganjëherë letra Jusufit, dhe për korrespondencën e tyre nuk di asgjë. Ajo çka di është se Jusufi disponohej nga mahitë dhe ekspresiviteti i Besim Rexhës. Duke e parë disponimin dhe të qeshurat që i vinin nga shpirti, Jusuf Gërvallës, Besim Rexha ka qenë një figurë e mirë dhe e ndershme për mua, dhe atë mendim nuk kam pasur arsye ta ndryshojë, edhe kur më ka ra rasti me e takue Besimin. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Besim Rexha, Heidelstr.4 D-5520 Velbert 1. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

REXHA HALIL, – Halil Rexha, nga fshati Korishë, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

REXHA KADRI, – Kadri Rexha lindi më 7 shkurt 1949 në fshatin Cerrcë të komunës së Burimit (Istogut). Shkollën fillore dhe gjimnazin i mbaroi në Burim në vitin 1968. Studimet, Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Fakulteti Filozofik, i mbaroi në Universitetin e Prishtinës.
Është magjistër i shkencave filologjike. Gjatë vitit shkollor 1972/73 punoi si profesor i Gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe i Gjuhës latine në Gjimnazin e Burimit. Nga viti 1973 e deri në vitin 1978 punoi si profesor i Gjuhës dhe letërsisë shqipe në Sh. F. "Naim Frashëri" (ish "V. Nazor") të Prishtinës. Nga viti 1978 e deri në shkurt të vitit 1982, kur edhe burgoset për veprimtari atdhetare, punoi në sektorin e klasifikimit të librit si dhe në atë të zhvillimit të bibliotekarisë së Kosovës, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Pas vuajtjes së dënimit dhe daljes nga burgu, në vitin 1986 arratiset në Zvicër, ku ka zhvilluar veprimtari të dukshme në fushën e politikës dhe të kulturës. Nga Maji i vitit 2006 është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Jeton dhe vepron në Zvicër. Poezinë e parë e ka botuar si nxënës i klasës së pestë të shkollës fillore. Në fushën e publicistikës është paraqitur qysh si student, në fillim të viteve të shtatëdhjeta. Ka shkruar poezi, recensione për libra të botuar, ese, vështrime letrare, portrete figurash të shquara të kulturës dhe të historisë kombëtare, kolumne politike, etj. Ka bashkëpunuar me gazetat

dhe revistat e kohës: “Rilindja”, “Bota e re”, “Fjala”, “Flaka e vëllazërimit”, “Zëri i rinisë”, “*Zëri i Kosovës*”, “Demokracia”, “Alternativa”, “Republika”, “Qëndresa”, “Fjala e lirisë”, “Epoka e re”, “Zëri ditor”, “Kosovasot”, “Lajm”, www.radiokosovaelirë.com, www.pashtriku.org. Deri më tashti ka botuar librat: Kosovë, gurrë e bardhë, poemë, “*Zëri i Kosovës*”, Biel-Biene,1989, me pseudonimin D. Bardhi; Fati i luleve – rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla (monografi), Buzuku, Prishtinë, 1993; Pushkë lajmëtare, (monografi për Gjeneralmajorin Edmond Hoxha), “Epoka e re”, Prishtinë, 2002. Ka redaktuar dhjetëra libra letrarë dhe publicistikë. (Shënimet për Kadri Rexhën u morën nga libri i këtij autori për Dervish Shaqën)



Kadri Rexha

Jusuf Gërvalla: *"Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën. Aty nga ora 16, erdhën në "Rilindje" Suzana me* ***Kadri Rexhën*** *dhe më prunë lajme të hidhura. Atë ditë heret në mëngjes, e paskëshin burgosur Hysenin; i kishin gjetur*

materiale të shtypura të Lëvizjes. Dina, i cili e kishte sjellë lajmin për Hysenin, i gjen punëtorët e SPB-së duke ma bastisur banesën." (Shënime nga Ditari, 30 dhjetor 1979, Ludwigsburg)

"Shefqet ***Dibrani: Pas ngjarjeve të Pranverës Kosovare 1981 jeni ndër intelektualët që u dënuat me burg. A mund të na thoni më konkretisht kur u burgosët, për çka, me cilin grup dhe sa u dënuat***?

Kadri Rexha: *Në burg kam rënë më 22 shkurt 1982, në valën e burgosjes së intelektualëve shqiptarë. Duke lënë përshtypjen e përgjithshme se me çdo kusht po kërkonte të zbulonte folenë e shtabit të "kundërrevolucionit dhe irredentizmit shqiptar", UDB-a, respektivisht Serbia asokohe po fillonte fushatën e egër inkuizicionale kundër intelegjencës shqiptare, fushatë kjo që do të rezultojë deri edhe në mbylljen edhe të shkollës së fundit në gjuhën shqipe në Kosovë. Në aktakuzën që na e ngriti UDB-a figuronim tre persona. Unë akuzohesha për shpërndarje dhe ruajtje të materialit propagandistik antijugosllav, për lidhje me emigracionin politik dhe për takimin tim me Jusuf Gërvallën në Gjermani në gusht të vitit 1980. Ndonëse nuk kemi qenë grup i mirëfilltë i formuar me betime e me grushta të ngritur, veprimtarinë e kemi zhvilluar në kuadër të grupit. Si tresh edhe na dënuan me burg: mua me 3 vjet, Dr. Muhamet Tërnavën me 2 vjet, ndërsa Dr. Shaqir Shaqirin me 1 vit e gjysmë. Vlen të theksohet këtu se vetëm në saje të qëndresës së Nazmi Selmanaj dhe të Islam Mustafaj kemi shpëtuar të mos lidhemi me Komitetin e Deçanit, njërën ndër degët më aktive të LNÇKVSHJ-së, ku do të merrnim dënime shumë më të larta. Por edhe kësi soji, kjo ishte një hakmarrje ndaj miqve të Jusuf Gërvallës dhe një kërcënim paralajmërues kundër intelegjencës së pambrojtur shqiptare."* (Intervistë dhënë Shefqet Dibranit, Qëndresa, 8/9, janar-shkurt 1994)

REXHA MEJDI, – Mejdi Rexha**,** aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit, nga fshati Korishë-Prizren. Për te do të kisha dashtë me u zgjerua edhe më shumë, por më kanë munguar të dhënat konkrete biografike dhe fotografitë. Një prej 7-8 shokëve të parë të Jusuf Gërvallës gjatë vitit 1980. Në vitin 1981 e në fillim të 1982 e ka pasur këtë adresë: Mejdi Rexha, Hidere Wasse 30/682, 7032 Sindelfingen.

REXHA MUHARREM – Muharrem Rexha nga fshati Korishë- aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

REXHA MUSTAFË, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Mustaf Rexha, Rue de Indenerie 5 Geneve-Suisse tel.564011. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

REXHEPI RAGIP lindi në fshatin Baincë të Kaçanikut. Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike ishte detyruar ta merrte rrugën e kurbetit. Në vitet e shtatëdhjeta u vendos në Cyrih të Zvicrës. ... Ragip Rexhepi sot jeton me bashkëshorten dhe fëmijët në fshatin Baincë. (Ismet Rashiti, Rrëfanë lirie, Prishtinë 2010, faqe 179-181). Në bazë të hulumtimeve të mia, ma merr mendja se Ragip Rexhepi, i prezentuar si Ragipi nga Cyrihu, pas 17 janarit 1982 ka qenë në Untergruppenbach dhe është nga ata që ka ndihmuar më së shumti. Se Ragipi nga Cyrihu është Ragip Rexhepi, bazohem në të dhënat e Ismet Rashitit.

RISTIÇ DUSHAN. Politikan serb në Kosovë. Ka qenë përfaqësuesi i shovinizmit serbomadh të Beogradit në Prishtinë.

Jusuf Gërvalla: "*Se kjo është një manovër mashtruese, u detyrua ta pranojë para disa kohësh edhe vetë udbashi e kryeshovinisti serb në Kosovë, Dushan Ristiqi. Ai, duke vlerësuar punën e LKJ e të UDB-së në Kosovë, shprehi shqetësimin e tij dhe tha: "Ne ende nuk kemi mundur t'i zbulojmë organizuesit e vërtetë të këtyre demonstratave, ende nuk po mund të arrijmë te organizuesit e vërtetë kur është fjala për këtë aksion armiqësor… Shtrohet pyetja se për ç'arsye nuk po mund t'i zbulojmë disa organizues, pse nuk po mund t'i zbulojmë ata që po shkruajnë parulla, pse nuk po mund t'i zbulojmë ata që po veprojnë, pse nuk po mund të zbulojmë atë që sulmoi njeriun në rrugë dhe nuk po mund ta dimë se kush është…"*

Vendosmëria e popullit tonë në kërkesat e tij të drejta dhe masat e represionet që po ndërmarrin shovinistët serb në Kosovë, jo vetëm që e kanë diskredituar Jugosllavinë në sytë e botës, por kanë futur përçarje e mosbesim edhe në mes vetë titistëve. Pasojë e kësaj janë edhe gjithë ato spastrime e shkarkime në udhëheqësinë më të lartë të Krahinës. Kanë filluar të hidhen si limon i shtrydhur e të sikterisen dhjetëra tradhtarë shqiptarë, që u kanë shërbyer me besnikëri vite e dekada të tëra titistëve e shovinistëve serbë. Mosbesimi e grindja ka hyrë edhe në radhët e LKJ, të UDB-së e të organeve të tjera shtypëse. Këtë e kanë shprehur tërthorazi shumë funksionarë të lartë, por më troç e pohoi Ristiqi. Ai, duke bërë fjalë për rezistencën e popullit e për masat që duhet ndërmarrë, me plot nervozitet shtroi pyetjen para Komitetit Krahinor: "A është e mundshme që në ato mjedise, ata njerëz të mos e dinë, a është e mundshme që anëtarët e LK disa mos t'i dinë, a është e mundshme që organet e pushtetit atë nuk mund ta gjejnë. Unë jam i bindur se akoma nuk kemi krijuar atmosferë të tillë në organet e pushtetit, unë jam i bindur se akoma nuk kemi krijuar atmosferë të tillë në Parti – te masa, që të gjithë të veprojmë kundër veprimeve të tilla dhe që të gjejmë atë që vepron kështu. Gjërat po ndodhin publikisht dhe gjysmëpublikisht". (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 4-5)

ritual *ritual* sjellje e ripërsëritur e cila është e rregulluar kulturalisht. Rituali mund të ketë variacione duke u nisur nga rregulla shumë rigoroze sa i përket përmbajtjes në secilën prej sekuencave (të ritualit) deri tek ato ku kryerësit i ritualit i lejohet mundësia të zgjedhë në mes formave të ndryshme të sjelljes. Para së gjithash koncepti përdoret për të paraqitur veprime të cilat janë të karakterit magjiko-fetar, por mund të ndeshet edhe gjatë përshkrimit të sjelljeve të llojeve tjera. Veprimi ritual shihet si simbol i rëndësishëm për vlera religjioze dhe sociale. Rituali ka domethënien e komunikimit në mes individëve dhe në mes gjeneratave, pasi forma dhe përmbajtja e tij ndryshojnë shumë ngadalë.

ritualism *ritualizëm* është sipas R. Merton një prej modeleve të mundshme të veprimit në një situatë në shoqëri që karakterizohet nga *anomia*. Kjo do të thotë se caqet e definuara kulturalisht mund të arrihet vetëm me mjete të institucionalizuara, dhe të cilat mjete janë të shpërndara në shoqëri në mënyrë të pabarabartë. Ata individ të cilët në një situatë të tillë përgjigjen me ritualizëm, tregojnë konformizëm të tepruar me mjetet e institucionalizuara dhe nënkonformizëm me caqet. Një shembull për këtë është burokrati, i cili si skllav i ndjek rregullat e caktuara, pamvarësisht se a çonë ky zbatim skllavëror i rregullave në arritjen e caqeve-qëllimeve apo jo. Në *Social Theory and Social Structure* (1957) përshkruan Merton gjithashtu modele tjera të reagimit në një situatë anomike. Ai i quan ato *inovacion, konformizëm, rebelizëm dhe retretizëm.*

RÖHM JOACHIM, personalitet kulturor në Shtutgart. Aktivist i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri. Njohës i shkëlqyeshëm i gjuhës shqipe. Përkthyes i shumë fjalimeve

dhe trakteve të Jusuf Gërvallës në gjuhën gjermane. Në vitet 1980-1983 ka banuar në këtë adresë: Joachim Röhm Kristofstr. 41 Shtutgart-Fellbach.

rol *role* sjellje që pritet nga një person i cili e kanë një pozitë të caktuar në një grup apo në një shoqëri. Disa pozicione sociale mund të mbahen prej shumë personave, p. sh. si muratorë, ndërsa role të tjera mund të mbahen vetëm nga një person, p. sh. ai si kryeministër. Kjo do të thotë se shumë individ mund ta kenë rolin e njejtë dhe e kundërta kur vetëm një person e ka një rol. Pastaj, bëhet dallimi në mes rolit dhe kryerjes së detyrës në rolin e caktuar. I pari (roli) ka të bëjë me atë që e pret rrethi prej personit që e ka një pozitë sociale, ndërsa e dyta i kushton vëmendje mënyrës se si individ e kryen detyrën e tij në rolin e caktuar, prej fillimi e në mbarim. Nëse nuk ka përputhmëni në mes kryerjes së detyrës në një rol dhe vet rolit, atëherë individi u nënshtrohet *sanksioneve* apo i humb shpërblimet. Çdo individ luan në të njejtën kohë një numër të madh rolesh. Ai mund të jetë baba, udhëheqës ndërmarrje dhe nëpunës në zyrë. Nëse përmbajtja në rolet e ndryshme është kundërthënëse kjo sjell tek rol-*konflikti*. Pritjet nga një rol i caktuar, në një pozitë të caktuar mund të jenë të ndryshme prej grupeve të ndryshme në një mjedis. Kështu p. sh. ndoshta pritjet prej një kryepunëtori mekanik mund të jenë tjera prej udhëheqjes së ndërmarrjes dhe tjera prej skuadrës së punëtorëve që udhëhiqen nga ai. Në këtë rast thuhet se pozicioni ka një *role-set* (rol-përmbajtje). Nëse pritjet e ndryshme janë në kundërthënie vjen deri tek rol-konflikti. Roli mund të jetë *atribues*, p. sh. roli si fëmijë ose i fituar p. sh. drejtor gjeneral. Nëse përmbajtja në një rol është e pakufizuar, d. m. th. mbulon shumë fusha, atëherë ai është difuz, (p. sh. roli si nënë) dhe nëse nuk është difuz, atëherë është specifik, p. sh. roli si avokat. Nëse një person trajtohet në bazë të pozicionit social që e ka, p. sh. relacioni nënë-bijë, thuhet se roli është *partikularistik*, e nëse trajtimi bëhet në bazë të rregullave të përgjithshme jo-personale, p. sh. relacioni gjykatës-i akuzuar, atëherë thuhet se roli është *univerzalistik*. Të drejtat që priten, që sjell një pozitë sociale quhet shpesh status social. Me këtë rast *rol*-dhe-*status* bëhen dy anët e të njejtës çështje, pra pozicionit social.

role model *rol-model* kryerja e detyrës në një rol apo disa role prej një personi përdoren si shembull (për të mirë) nga një person tjetër gjatë kryerjes së detyrave në një rol identik. Rol-modeli duhet të dallohet nga *referens-personi*, ku koncepti i fundit do të thotë se ai që imiton mundohet me i luajtë të gjitha rolet e tij në një mënyrë që i përngjajnë *referens-personit*.

role-set shprehje për shumën e roleve të ndryshme të cilat janë të lidhura me një pozitë të vetme sociale (*social position*). Pozicioni mësues do të thotë një rol në raport me nxënësit, një rol tjetër me prindërit e nxënësve, një rol të tretë në raport me kolegët e kështu me radhë. ***Role-set*** nuk është e njejta gjë sikur me atë që një individ mund të ketë role të shumëfishta. Tek rasti i dytë (tek rolet e shumëfishta), mendohet në atë se një individ ka shumë pozita sociale. Secila prej këtyre pozitave janë të lidhura me një role-set të veçantë.

role-playing mënyra se si një person e luan rolin e tij. Se në çfarë mënyre do ta bëjë këtë mvaret prej përmbajtjes së rolit, pastaj mvaret pos tjerash prej *socializimit* (*socialisation*) dhe se si ai e ka *internalizue* rolin.

ROTER MORGEN; Jusuf Gërvalla: "*Vëlla, Mërgim! Kohë më parë unë i kisha nisur një letër njërit nga anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Gjermane, të cilin*

*e kam njohur personalisht. Iu drejtova me kërkesën që ta përdorë autoritetin e Partisë së tij dhe të na dalë në ndihmë në një mënyrë apo në një tjetër. Ato ditë Radio Tirana transmetoi edhe artikullin e parë të "Zërit të popullit" lidhur me ngjarjet në Kosovë, kështu që komunistët e këtushëm morën qëndrim zyrtar, që të solidarizohen me Kosovën dhe ta ndihmojnë luftën e popullin tonë me të gjitha mjetet që kanë në dorë. Në fillim të fillimit, ata botuan gjermanisht në organin e tyre "**Roter Morgen**" artikullin e "Zërit të popullit" dhe neve na nxorrën lejet zyrtare te policia gjermane për mbajtjen e demonstratave. Po kështu, me luftën tonë janë solidarizuar edhe komunistët zvicëranë dhe ata turq në botën e jashtme."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 262-263

routinization Në analizën e autoriteteve, Max Weberi ka ardhë në përfundimin se nëse deri tek *legjitimimi* është arritur përmes *karizmës*, atëherë legjitimimi do të jetë i përkohshëm. Autoriteti në një mënyrë apo tjetër duhet patjetër të rutinizohet, nëse ai do të mbijetojë. Kjo bëhet ose përmes *legjitimimit tradicional* ose *legjitimimit racional-legal*. Me atë rast elementet karizmatike integrohen-shkrihen në strukturën sociale ekzistuese, strukturë e cila do të shërbej si bazë për ambiciet e mëparshme të autoritetit karizamtik për t'i konsideruar (ato ambicie) si legjitime.

ruralization *ruralizim* proces apo rezultat i tij, kur atitydat dhe sjelljet e popullsisë rurale barten në ambientet qytetare. Me fjalë më të shkurta, kjo mund të shprehet edhe si: katunarizim i qytetit apo qytetarëve. E kundërta është *rurbanization*, *rurbanizim*; qytetërim i katunarëve.

RR

RRAHMANI HASAN, – Hasan Rrahmani, aktivist në rrethin e Shtugartit, nga fshati Dumnicë e Llapit. Në Shtutgart, në gjysmën e dytë të vitit 1981, erdhi nga Turqia, përmes Sabri Novosellës. Jeton në Suedi.

S

SADIKU ABDURRAHMAN – Abdurrahman Sadiku nga fshati Dumnicë e Llapit - aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

SADIKU AHMET, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ahmet Sadiku, Gineheimer Landstr. 42 1653, 6. Frankfurt, 90. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

SADIKU FEHMI, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Fehmi Sadiku, Av Du 00Mars 24 CH200 Neuchtal tel.38/246570. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

SAHITAJ RESHAT, veprimtar politik e kulturor në Belgjikë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Reshat Sahitaj, Rue Masui 116 1100 Bruxeles Begique. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf

Gërvallës. Rethi i tij dhe i Enver Hadrit janë ata që e kanë realizuar premierën e dramës Procesi të Jusuf Gërvallës.

salient attitude *atityd* që zen vend të madh në fushën kognitive të një personi, apo e shprehur me fjalë tjera një atityd për të cilën personi është i vetëdijshëm, e verbalizon atë, e shpreh shpesh etj. Shkalla e saliens tek një atityd merret si indikator me rëndësi për sjelljen e individit. Lidhshmëria në mes rëndësisë së një atityde në fushën kognitive dhe rëndësisë së sjelljes së individit nuk është perfekte. Shpesh një atityd për të cilin individi nuk është i vetëdijshëm mund të luaj rol më të madh në sjelljen e tij, se sa një atityd për të cilën ai është i vetëdijshëm.

SALIHU JASHAR – Aktgjykim:: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Jashar Salihu, profesor nga f. Batushë KK – Gjakovë, i lindur më datën 10 shkurt 1953, në të njejtin fshat, me profesion profesor i gjuhës angleze pran QAMO "Vëllezërit Frashëri" në Deçan, ka të kryer Fakultetin Filozofik. .... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë vjetësh)."*

"*Jashar Salihu u lind në fshatin Batushë më 10 shkurt të vitit 1953. Shkollimin fillor e kreu në fshatin Molliq, ndërsa shkollën e mesme e mbaroi në Gjakovë. Ka kryer Fakultetin Filozofik-dega e gjuhës angleze, në Prishtinë.*

Prej viteve 70, në kohën kur studionte në Prishtinë Jashar Salihu ishte anëtar i ***Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve Shqiptare në Jugosllavi****. Ishte ndër anëtarët më aktiv të grupeve ilegale të asaj kohe që vepronte brenda organizatës ilegale të quajtur Komiteti për Deçan, në kuadër të lëvizjes së udhëhequr nga ideologu, veprimtari më i shquar i çështjes kombëtare,* ***Jusuf Gërvalla***." (Radio Kosova e Lirë, 16 dhjetor 2023)

SALIHU RIZA, – Riza Salihu**,** person që ka vepruar në Shtutgart. Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Lëvizjen e Jusuf Gërvallës, Jusufi hollësisht është deklaruar në dy raste kur i shkruan Sabri Novosellës dhe Degës "Hasan Prishtina" të Lëvizjes në Turqi. Në rastin e parë i shkruan më 13 maj 1981 dhe në rastin e dytë në fund të korrikut 1981.

Jusuf Gërvalla: "*Unë, që në fillim të Lëvizjes e kam pasë ditur se organ i Lëvizjes është "Zëri i Kosovës", se kjo shihet nga vetë Statuti. Dhe, me kënaqësinë më të madhe, në vend që të dilte "Lajmëtari i lirisë", kam mundur të bëja që të dilte "Zëri i Kosovës". Nuk e bëra për dy arsye. Së pari nuk isha i autorizuar nga Lëvizja. Së dyti, këtu kishte vepruar qysh më herët një i ashtuquajturi Grupi Komunist "Zëri i Kosovës", për punën e errët të të cilit me ndonjë rast tjetër mund të bëj para Lëvizjes ndonjë raport të gjerë. Tash për tash po theksoj se udhëheqësi i këtij grupi (****Rizah Saliu****, nga Mushtishti, një provokator ose njeri shumë naiv dhe i rrezikshëm), provoi të organizonte me shokë likuidimin tim dhe të vëllaut tim, duke na quajtur "të dërguar specialë të UDB-së", pikërisht për arsyen se i pata thënë që "Zëri i Kosovës" është organ i LNÇKVSH, kurse ai e kishte marrë për emër të grupit të vet. Po për këtë arsye, para se t'i hymë botimit të këtij organi, duhet të marr nga Ti dhe Lëvizja edhe fjalën e fundit, sepse ka mundësi që titulli "Zëri i Kosovës" si organ i LNÇ, të përzihet në mendjen e naivëve me Grupin Komunist " Zëri i Kosovës"*." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Jusuf Gërvalla: "*Nga dita e arratisjes sime në RF të Gjermanisë, më 14 dhjetor 1979, këtu kam pasur kontakte me përfaqësues të Grupit komunist "Zëri i Kosovës" dhe pastaj me ata të organizatës Fronti i Kuq Popullor. Le të më lejohet të shënoj këtu disa përshtypje dhe disa vrojtime lidhur me punën e tyre, aq më parë lidhur me punën e Frontit*

të Kuq, pasi Dega "Hasan Prishtina" mendon se është e arsyeshme të thërriten edhe përfaqësuesit e tij për bashkimin e organizatave dhe të veprimtarisë sonë.

Me përfaqësuesin kryesor të Grupit komunist "Zëri i Kosovës" jam njohur, pra, në fund të dhjetorit 1979. Quhet Riza Salihu, nga fshati Mushtisht. Ra fjala për organin e LNÇK "Zëri i Kosovës" dhe ai, me një ton të ashpër, shprehu dyshimin jo vetëm në ekzistencën e këtij organi dhe të LNÇKVSH, por edhe në besnikërinë time. Arsyeja ishte se ai qëndronte vetë në krye të Grupit me të njejtin emër dhe, meqë, siç del logjikisht, nuk dinte për ekzistimin e LNÇKVSH dhe kishte edhe vetë një logjikë të kufizuar, kurrsesi nuk ia kapte rradakja të bënte dallimin në mes një organizate me emrin "Zëri i Kosovës" dhe një organi me titull "Zëri i Kosovës" që i takonte koinçidentalisht një organizate krejt tjetër. Po atë natë, ai më njohu mua dhe vëllaun tim me dy shokët e tij, Hysen Gega (tani i burgosur në burgun e Prishtinës) dhe Maksut Saramati, me punë të përkohshme në RFGJ. Që në fillim ra në sy kapadaillëku në rigorozitetin prej një shefi bande i Riza Salihut dhe natyrshmëria e zgjuarsia e dy shokëve të tij (anëtarë të KQ të "Z.K.").

Me Hysenin e Maksutin u pamë dhe ndjenjëm disa herë me radhë dhe e pritëm bashkë Vitin e Ri 1980. Hyseni lente të kuptohej se kishte diku në Gjermani një shok më të mirë se Rizanë, një student. Ai fliste dendur për të dhe vëllaut tim, Bardhit, që kishte njohur kohë më parë një person të tillë, i shkoi mendja mos ishte fjala për njëfarë Ibrahim Kelmendin. Por Hyseni e fshehte, prandaj nuk ngulëm këmbë për t'u njohur. Pak ditë më vonë vijnë te Hyseni e Maksuti dhe na tregojnë se si Rizai kishte ardhur, që në takimin e parë me mua, në përfundim se unë jam "i dërguar special i UDB-së" dhe se u kishte propozuar haptazi Hysenit e Maksutit të më likuidonin bashkë me vëllaun, Bardhin. Ata u hapën në "muhabet" për dy arsye, sipas pohimit të tyre: e para, lidhur me Rizanë kishin pasur disa dyshime më përpara, dhe e dyta, tashmë ishin takuar me Ibrahimin dhe ai i kishte këshilluar të më afroheshin se gjoja ai e ditka kush jam dhe se jam "i mirë".

Këto ishin dyshimet e shokëve më të ngushtë të Rizasë lidhur me veprimtarinë dhe me personalitetin e tij:

- Rizai jetonte me vite në Gjermani, por as punonte as kishte zënë banesë të përhershme. Me se mbahej, pos me paratë e punëtorëve tanë?

- Rizai e kishte theksuar vazhdimisht domosdoshmërinë e moralitetit, te çdo patriot e revolucionar. Vetë jetonte me një serbe dhe kishte me te një djalë me emër sllav. Këtë e kishin zbuluar shokët, e nuk ua kishte thënë ai vetë.

- Ç'është më me rëndësi, mënyra e organizimit të Grupit "Z.K." ishte bërë e dyshimtë edhe për bashkëpunëtorët më të ngushtë të Rizasë. Sipas kësaj mënyre, në organizatë mund të hynte çdo shqiptar që "do të luftoj për atdhe". Çdonjëri që hyn në organizatë duhej të jepte shënimet e sakta biografike (emri, mbiemri, vendlindja, datëlindja, vendi i punës) dhe, mbi të gjitha, këto shënime si dhe betimin ta bënte me shkrim, me dorë të vet. Nga listat me të dhëna të tilla të hollësishme, një mbahej nga shokët e tyre në atdhe dhe një tjetër nga Rizai në RFGJ. Para se të arrija unë këtu, pothuaj të gjithë njerëzit e organizuar prej Rizait (kryesisht në Ferizaj e në Prizren) ishin burgosur pa mundimin më të vogël nga policia, sepse arrestimet ishin bërë në bazë të listave të përmendura. (Mërgimi mund ta dij për çfarë të burgosurish është fjala: kur ishim në atdhe, ne gjatë takimeve kemi pas biseduar me të disa herë lidhur me një grup të rinjsh ferizajas, që vepronin demonstrativisht nëpër qytet nën hundët e policisë. Unë këtu kur kuptova hollësitë lidhur me organizimin e "Z.K.", supozova se ishin pikërisht ata të arrestuar.) Edhe Rizai, më vonë, e H. dhe M. që në fillim, i thoshin edhe me emra shokët e tyre të burgosur, kryesisht në dy qytetet e përmendura. Tre apo katër prej tyre përmenden në artikullin e parë të "Lajmëtarit" Nr. 1.

Nga bisedat që kam pasur me H. e M. kam kuptuar se puna e Grupit komunist të tyre konsistonte në radhë të parë në botimin e disa trakteve (nëse më bie në dorë ndonjë

prej tyre do t'jua dërgoj) dhe në shfaqjen e disa filmave të huajtur nga shokët gjerman, miq të RPSSH. (Kur unë vetë mora kontakt me këta shokë gjermanë, më thanë se pas një kohe janë detyruar ta largojnë Rizanë nga lokalet e partisë së tyre, për shkak të arrogancës së tij.)

Përafërsisht katër muaj pas takimit të parë me Rizanë, u takuam edhe njëherë, në banesën e H. Ishim prezentë unë e vëllau, pastaj Ibrahim Kelmendi (ishim njohur me të ndërkohë), Hyseni e Maksuti dhe Rizai. Ne u fjalosëm keq me të, sepse patëm rastin të hetojmë që të gjithë se ai kishte prirje të gënjejë dhe t'i shmanget bisedës parimore. Këto ishin pikat që rrahëm: Pse ai, pa verifikuar dyshimet e veta, që në takimin e parë kish kërkuar nga shokët e vet të më likuidonin mua dhe vëllaun; pse, me muaj të tërë, në stacionin hekurudhor të Shtutgartit, ku dalin e rrinë punëtorët tanë, kishte agjituar kundër meje (pa i vërtetuar akoma dyshimet) me fjalët: "Ruajuni se këndejpari vepron filan fisteku, i dërguar special i UDB-së; Pse ai vetë (edhe pse ia kisha tërhequr vërejtjen që në takimin e parë), vazhdonte kontaktet me njëfarë Adem Povataj nga Strellci, i cili, pasi kishte marrë më qafë disa punëtorë stinorë në Titograd, më 1978, duke i ngashënjyer së pari për punë patriotike e pastaj duke ua dorëzuar komplet UDB-së (që Rizai kishte kontaktuar dhe vazhdonte të kontaktonte me këtë njeri, ia thoshin ndërsy shokët H. e M.); pse ai, si komunist që i thoshte vetes, edhe pasi kishte parë rezultatet e hidhura të mënyrës së organizimit me lista të anëtarëve të organizatës, vazhdonte punën me të vjetrën dhe merrte njerëzit më qafë.

Gjatë gjithë bisedës ai mbajti një qëndrim qyqar, që s'kishte aspak të bënte me qëndrimin e një komunisti shqiptar. Në fund ai pranoi se kishte gabuar sa u përket shpifjeve të pabazuara rreth meje e vëllaut dhe premtoi se nuk do ta përsëriste. Por, që të nesërmen ai e përsëriti, në Stacionin e Shtutgartit.

Nga gjysma e gushtit të vjemë te unë erdhi në banesë policia kriminalistike gjermane (po atë orë Bardhi ndodhej në qendrën e kësaj policie në Shtutgart, ku e kishin marrë nga puna). Ata na morën në pyetje veç e veç. Çështja kishte të bënte me Riza Salihun. Ai kishte hapur në postën e Shtutgartit 14 fah-postale në emër të 14 njerëzve të ndryshëm, ku ndalte letrat e këtyre dhe i lexonte për nevojat e veta. Mes të 14, kishim qenë unë e vëllau, Hysen Gega, Ibrahim Kelmendi etj. Policia e kishte zënë, e kish hedhur në burg dhe dyshonte se është agjent i UDB-së. Ndërkohë që Rizai kishte shpallur ndër punëtorë sesi ka kërkuar azil politik në Gjermani, ai kishte qenë pesë herë, në prag të burgimit, në konsullatën jugosllave në Shtutgart. Këto i kishte të shënuara në bllokun e shënimeve. Për mua, vëllaun dhe Ibrahim Kelmendin kishte dhënë te policia deklarata shumë të liga me shkrim, me plot gënjeshtra edhe për dy takimet që kishim pasur e ku kishim shumë dëshmitarë. Policia në fjalë kërkonte prej nesh: të thoshim edhe ne se Rizai është spiun jugosllav. Natyrisht, ne s'bënim dot një gjë të tillë pa qenë të sigurt, dhe insistimet e policisë, të bazuara nga ana e saj në disa fakte që ne s'na e mbushnin mendjen, i kthenim mbrapshtë me arsyetimin se UDB-ja ka mundësi të mëdha të kurdisë gracka, e kështu ka mundur të veproj edhe me R. S.

Pastaj tërë vjeshtën dhe tërë dimrin s'dëgjuam gjë për të. Të tretën herë u takuam me të në demonstratat e punëtorëve tanë në Shtutgart. Ishte vënë në bisht të kolonës, me duar në xhepa dhe pas asnjë shok me vete. Pas demonstratës m'u afrua. Përshëndeste punët e mia, lavdëronte (ishim më këmbë dhe s'pata si ta pyesja për çfarë punësh e kishte fjalën) dhe thoshte se do të kish qenë mirë të bisedonim. Aty për aty ishin zënë me Ibrahim Kelmendin dhe Ibrahimi ia kishte ndaluar pjesëmarrjen në demonstratat e ardhshme. Unë e qortova Ibrahimin, se s'bënte ashtu, dhe Rizait, ndërsy Ibrahimit, i thashë që e kish derën hapur për ta thënë mendimin e vet. Ai tha se më ka diçka borxh dhe se do të bënte një autokritikë. Unë i shpreha gatishmërinë se do ta dëgjoja kur të ketë qejf, por atë ditë

e sot as më kërkoi më dhe as e kërkova unë. Tani po dëgjoj se paska ndërruar mendje lidhur me mua dhe nëpër njerëz nuk flitka më keq.

Lidhur me këtë person ka edhe një të dhënë me rëndësi. Diku nga viti 1976, Rizain e ka plagosur me thikë një kroat. Kroati i ofron një hartë dhe Rizai e refuzon me fjalët "Nuk e pranoj një Jugosllavi të tillë, e cila s'e ka edhe Kroacinë brenda." Në spitalin e Shtutgartit pastaj e kanë vizituar njerëzit e konsullatës jugosllave dhe e kanë mburrur për patriotizëm jugosllav. Disi pas këtij rasti fillon edhe veprimtaria partiotike (?) e Rizait." (Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" RAPORT mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "*Zëri i Kosovës*" dhe Fronti i Kuq Popullor; U botua për herë të parë në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011 nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin; Kur Jusuf Gërvalla shkruante)

Hysen Gega: *"Kjo është e vërtetë, Riza Salihu thoshte dhe propagandonte se Jusufi është agjent i UDB-së. Pohimet e tij më shtynë që unë të bëja pyetje në ambasadën shqiptare në Vjenë se mos kishin ndonjë fakt për Jusufin. Aty atëherë ishte njëri që më duket se quhej Simon Qirici, sekretar i parë, ndërsa vetë ambasadori ishte farefis me Avni Rrustemin. Prej tyre mora garancinë se Jusufi është i pastër dhe se mund të bashkëpunonim lirisht e pa asnjë rezervë me të. Ata madje edhe na rekomandonin bashkëpunimin. .....*

.... Me t'u kthyer nga Vjena takova Riza Salihun dhe i thashë që të mos merrej me thashetheme, me akuza të rreme e me shpifje ndaj bacës Jusuf. I propozova që të shkonim së bashku në ambasadën shqiptare e të dëgjonte vetë se ç'thuhej aty për Jusuf Gërvallën. ... Në këtë rast ai nuk pranoi që të shkonim bashkë në Vjenë, me arsyetimin se po i dhembte syri, me gjithë ngulmimin tim se unë do të vozisja dhe ai vetëm do të rrinte i qetë. Megjithatë, edhe pas këtij episodi ai vazhdonte shpifjet e tij kundër Jusuf Gërvallës, duke shkuar aq larg sa në një rast më tha: "I vjen keq se s'ka kush e bën sepse ai madje e meriton edhe plumbin", duke nxjerrë me këtë rast edhe revolen e duke më thënë: "Ja merre këtë dhe vrite, sepse ai e meriton plumbin", propozim të cilin ia refuzova me fjalët: "Më mirë mbaje për vete, sepse mund të të duhet ndonjë ditë për të vrarë veten". (Kam refuzuar ta vras Jusuf Gërvallën, kosova-sot.info, 28 Mars 2012)

SALIHU SHAQIR, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Shaqir Salihu, 7408 Laybton Drive Sprinfield Virginia 22150. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

Shaqir Salihu: "Të dashtuna motra e Vëllezër Gërvalla,

Na kanë tronditur lajmet mbi vrasjet e Jusufit dhe Bardhoshit. Ju lutem pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta, bëhuni të forta e qëndroni edhe pse nuk është lehtë. Këtu në Amerikë kemi dëgjuar mbi ato ngjarje e gjindemi ashtu si ju të mërzitur për ato humbje aq të mëdha.

Emnin e kam Shaqir Salihu e jam prej Prishtine. As Jusufin as Bardhoshin e as shokun e tyre nga Zvicra që u vra me ta nuk i kam njoft. Unë e kam njoft dhe e kam dashtë shumë nji Idriz Gërvallën që është avokat diku në Kosovë. Tani 12 vjet që kam hik se dojshin me më burgos në Prishtinë më 1969.

Në Gazetën "Dielli" që del këtu n'Amerikë iu kam ba thirrje që të gjithë shqiptarët e Amerikës të japin kontributin e tyre me u ndihmue juve që tani keni mbetur vet. Atë fushatë po e bëjë Unë vet e nuk e di se sa pare kam me tubue por e dijë që kanë me dhanë. Ata do t'i nisin ke unë e Unë kur i tuboj të gjitha iu bëjë një çek në dollarë e iu nisi menjëherë. Por adresën e saktë të juajën nuk e kam. Këtë adresë e mora prej disa gazetave. Ju lutem nëse kjo letër iu bie në dorë ma shkruani adresën e Juaj menjëherë si

dhe mbi shëndetin e fëmijëve e të Juajin dhe cila prej jush është me barrë dhe ndonjë fotografi të atyre që vdiqën për kombin tonë të varfur.

Ju lutem më shkruani se si Jeni dhe Ju lutem qëndroni! Vuajtjet janë për ne shqiptarët. Durim. Mbetshi me shëndet, Shaqir Salihu, nusja Ana dhe fëmijët Iliri e Donika. Shkruani se nuk iu di adresën e sakët. Qëndroni! Shaqir Salihu

SALIU SADRIJE DHE VEDAT, veprimtarë të dalluar në rrethin e Shtutgartit, nga fshati Veleshtë e Strugës. Një nga kontributet më të mëdha të këtij çifti është se së bashku me disa shokë të tjerë, janë ndër ata që më së shumti e më së shpeshti u kujdesën për mirëmbajtjen e Varrezave në Shtutgart, për ujitjen e ndërrimin e luleve të çdo stine, prej shkurtit 1982 deri në shkurt 2002. Vedat & Sadrije Saliu, tel. 0711-886727

sanction *sanksion* 1. Në përdorimin gjuhësor sociologjik, sanksion do të thotë dënim ose shpërblim të ndonjë lloji. Nganjëherë fjala sanksion negativ përdoret për dënim dhe sanksion pozitiv për shpërblim. Kur një sjellje është e sanksionuar nga një grup mendohet se ushtrimi i asaj sjellje është e lidhur me shpërblim dhe devijimi nga ajo sjellje është e lidhur me dënim.

2. Në kuptimin juridik ndërshtetëror fjala sanksion më së shumti paraqet dënim, p. sh. sanksione kundër një vendi që ka shkelur ndonjë marrëveshje ndërkombëtare. Por fjala ndeshet edhe në kuptimin e lejimit, apo aprovimit të diçkafit.

SARAÇOGLU GÜRKAN, shtetas i Turqisë me prejardhje shqiptare apo nga viset shqiptare. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Gürkan Saraçoglu, Mahmut Pasa cad. No.82, Istanbul. *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës i është dërguar për ta informuar me gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi.

SARAÇOGLU NIJAZI, shtetas i Turqisë me prejardhje nga Kosova, i cili është angazhuar për çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha serbomadhe. Në vitet 1981-1983, ka pasur këtë adresë: *Nijazi Saracoglu, Mahmut Pasa Çadesi 82, TR-ISTAMBUL, Türkei.*

Sabile Keçmezi-Basha: "*Ndërsa gazeta tjetër turke "Sabah" (Mëngjesi), në numrin e 19 korrikut, 1964, po ashtu i kushton vëmendje arrestimeve të shqiptarëve të Kosovës duke njoftuar opinionin turk se : Në Prishtinë (radio), Komiteti "Lidhja Kosovare" shpall se në Kosovë vazhdojnë turbullira serioze.* ***Nijazi Saraçoglu*** *dhe* ***Shaban Jilldirim*** *u arrestuan në Prishtinë kur po kalonin nëpër Jugosllavi, duke u kthye nga Gjermania. Sipas disa lajmeve të tjera komunikacionet me Mitrovicën, Pejën, Prizrenin, Gjilanin e Gjakovën janë ndërpre plotësisht. Në Prishtinë shkollat dhe ndërtesat publike janë rrethua nga policia. Nxitësi kryesor i tërë kësaj thuhej se është Adem Dema-Demaçi, i cili kishte botua më 1958 romanin anti-komunist "Gjarpinjtë e gjakut". Për këtë vepër ai edhe u dënua me katër vite burg deri më 1962" shkruan gazeta "Sabah"."* (Përpjekjet e gazetës "Përpjekja Kosovare" në mërgim (III), www.zemrashqipatre.net, 24 dhjetor 2011)

Aktakuzë**: "***Nijazi Saraçoglu, nëpunës nga Stambolli, i lindur në Prishtinë më 1933, nga babai Shabani dhe nëna Xhevahire Abidi, shtetas i Turqisë.*

... Në muajin gusht të vitit 1963, me kërkesë të akuzuarit Adem Dema-Demaçi, i cili, lidhur me këtë i ka dërguar letër përmes të akuzuarit Tefik Sahiti, e që ishte e adresuar në emër të vëllait të tij, Tefik Saraçoglu, në Stamboll të Turqisë, ka pranuar të punojë për grupin ilegal armiqësor në Prishtinë kundër Jugosllavisë dhe, menjëherë pas kthimit në

Jugosllavi të të akuzuarit Tefik Sahiti, ka dërguar përmes tij 200 lira turke në vlerë rreth 20 000 dinarë për nevoja të grupit ilegal në Prishtinë; pastaj, nga fundi i vitit 1963, sërish ka pranuar në Stamboll një pjesëtar të grupit armiqësor nga Prishtina dhe me te ka zhvilluar disa biseda, duke i premtuar, sikur edhe kur mori letrën nga i akuzuari Dema-Demaçi, se do të organizoj grumbullimin e ndihmës materiale dhe ndihmës tjetër nga të shpërngulurit dhe emigrantët nga Jugosllavia në Turqi, se do të organizojë propagandë të caktuar mes tyre dhe, prandaj, nga fillimi i majit të vitit 1964, kur sërish e vizitoi në Stamboll i njëjti person, ia ka dhënë atij 500 lira turke në vlerë rreth 50 000 dinarë, në emër të ndihmës për organizatën ilegale në Prishtinë, para këto të cilat ai person ia ka dorëzuar të akuzuarit Adem Dema-Demaçi për grupin ilegal, dhe, më në fund, më 27 maj 1964, erdhi nga Turqi në Prishtinë dhe u takuan me të akuzuarin Adem Dema-Demaçi në shtëpinë e të akuzuarit Tefik Sahiti dhe me këtë rast, i ka premtuar se do të punojë edhe më tej për organizimin dhe për përvetësimin e personave në Turqi për bashkëpunim me këtë organizatë ilegale, si dhe për krijimin e lidhjes ndërmjet organizatës ilegale dhe emigrantëve të nacionalitetit shqiptar në Itali, në Gjermani dhe në shtete tjera; prandaj në këtë mënyrë, ka marrë pjesë në formimin e grupit të personave, i cili ka pasur për qëllim të ndërmarrë sulm kundërrevolucionar mbi rregullimin shtetëror e shoqëror të RSFJ, mbi tërësinë e saj territoriale, dhe të shkatërrojë unitetin e popujve të Jugosllavisë, me çka ka kryer vepër penale të bashkimit kundër popullit dhe shtetit, nga neni 117, paragrafi 1, lidhur me nenin 100 dhe 101 të LP." (Aktakuza kundër Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, Kto-Nr. 223/64, Prishtinë)

Nga e majta: Asllan Muharremi, Njazi Straja, Sabri Novosella dhe Ymer Berisha

Emri i Nijazi Saraçoglut ka rëndësi në historinë e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, sepse kur Jusuf Gërvalla arratiset nga Kosova më 14 dhjetor 1979 dhe ndahet nga Sabri Novosella, rivendosja e kontaktit më 14 prill 1981 bëhet përmes Nijazi Saraçoglut. Më

lartë në citatin e Sabile Keçmezit-Bashës, e pamë se së bashku me Nijazi Saraçoglun, në vitin 1964, duke kaluar nëpër Jugosllavi, arrestohet edhe shtetasi turk me prejardhje nga viset shqiptare, Shaban Jilldrim, i cili të paktën në vitet 1980-1984, ka qenë agjent tregtar për plasimin e mallrave të Shqipërisë në Gjermani e Evropë. Shaban Jilldrim, ka vepruar në Munchen dhe zyra e tij ka qenë në këtë adresë: Shaban Yldrim, Bayerstr. 5, 8000 München.

Dhjetë ditë pas ngjarjeve të 11 marsit në Prishtinë, të shtunen më 21 mars 1981, mbahet një panair i artizanatit në München të Gjermanisë ku merr pjesë edhe Shqipëria, dhe kuptohet Shaban Ylldrimi që merret me shitjen e atyre produkteve. Në atë panair merr pjesë Bardhoshi dhe Jusufi. Me rastin e njoftimit të parë me Shaban Ylldrimin, ky Shabani ia jep Bardhoshit adresën e Nijazi Saraçoglut në Stamboll, si adresë kontaktuese me Sabri Novosellën.

Pas dy javësh, 4 prill 1981, Bardhosh Gërvalla ia dërgon këtë letër Nijazi Saraçoglut:

Herrn Nijazi Saracoglu, Mahmut Pasa Çadesi 82, TR-ISTAMBUL, Türkei

I dashur Shoku Nijazi,

dje, pasi e mora lidhjen telefonike me ju, isha shumë i gezuar, sepse kanë kaluar më se 15 muaj që po presim ndonjë lajm nga shoku Bashkim Prishtina, për të cilin ju mund ta dini rastësisht se ku po qëndron. Jusufi, vëllau im para dy ditësh ka shkuar në veri të Gjermanisë tek një nip i yni, kështu që ai nuk mund t`ju shkruan edhe 6 ditë deri sa të kthehet prap këndej.

Ju thatë se e njihni vëllaun tim dhe se keni qenë së bashku në burg, por, vëllau im nuk ka qenë në burg, kështu që ju duhet ta njihni Zeqir Gërvallën, kushëririn tanë. Jusufi u arratis ditën kur u burgos vëllau ynë më i madhi Hyseni, me 14.12.79 dhe ka kërkuar strehim politik në Gjermaninë perendimore. Me Shabanin u njohëm para dy javësh në panairin e artizanatit, ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Ai edhe na dha adresën dhe telefonin tuaj.

Pasi harrova të iu pyes a mos keni pengesa lidhur me letra, sepse mund bëhet që ua kontrollojnë, tani për tani nuk po iu shkruaj më gjërësisht. Për sa i përket qështjes sonë të madhe, ne jemi shumë optimist, sidomos pas ngjarjeve të fundit në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, dhe në Zagreb (sipas gazetës Gjermane studentët shqiptar në Zagreb bënë demonstrata solidarizuese me ato të Kosovës), ku u pa haptazi vullneti dhe gateshmëria e popullit të drejtë shqiptar.

Kishte me qenë mirë sikur edhe Bashkimi të na shkruajë sa më parë. Në fund po iu përshëndes ju me gjithë familjen dhe dashamirët tuaj.

Bardhosh Gërvalla, Habichthöhe 40 D-7101, Untergruppenbach, W. Germany Tel. qyteti Ludwigsburg 7141/26091

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari si pjesë e shkrimit "Kur Jusuf Gërvalla shkruante" në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Më 13 prill 1981, Jusufit i vijnë dy letra të rëndësishme. E para, vendimi me të cilin shteti gjerman ia jep lejen e qëndrimit dhe ia njeh statusin e refugjatit politik. E dyta, pas gjashtëmbëdhjetë muajsh, nga Turqia, falë ndërmjetësimit të Shaban Ylldrimit e Nijazi Saraçoglut, Jusufit i vjen një letër nga Sabri Novosella. Kësaj letre të 13 prillit 1981 (të pabotuar por vetëm të përmendur nga Jusufi), Jusuf Gërvalla i përgjigjet të nesërmen më 14 prill 1981. Kjo pra është rruga e plotë e rivendosjes së kontaktit të Jusufit me Sabri Novosellën, pas 16 muajsh. (14 dhjetor 1979-14 prill 1981)

SARAÇOGLU TEFIK, Tefik Saraçoglu, vëllau i Nijazi Saraçoglut. Në banesën e Tefikut në: *Cigdem sok. Nr. 24/6, Pendik, Istanbul*, gjatë disa ditëve të pushimit dimëror të vitit shkollor 1980/1981, me sa më kujtohet në ditët e para të janarit 1981, i dërguar prej shokëve nga Kosova, për herë të parë jam takuar me Sabri Novosellën. Ky takim disa ditësh me biseda intensive ka qenë faktori që Sabriu të më vendosë në kontakt me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, në fillim të korrikut 1981, kur unë ndodhesha në Zvicër.

secondary group është kundërpol i *primary group* që karakterizohet nga kontakte jo-personale (*kontakt sekundar*), grup me shumë anëtarë, ku kontinuiteti dhe stabiliteti mvaren më shumë nga organizata sociale se sa nga lidhje difuze apo informale në mes anëtarëve. Secondary group është një shembull i *ideal typ* dhe gati nuk ka grup që i përgjigjet krejtësisht këtij definicioni. Organizata dhe shoqata të mëdha, regjimente, sindikata, kooperative konsumatorësh etj., qëndrojnë shumë afër këtë tip ideal.

SELA AGRON, – Agron Sela, lindi në Dibër më 1960. Mbaron shkollën e mesme në vendlindje. Si pjesëmarrës i demonstratave studentore më 1981 në Prishtinë, detyrohet të ndërpresë studimet në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Emigron në Gjermani, ku, përmes Naim Haradinajt, njihet dhe miqësohet me Jusuf Gërvallën. Më 1982 vendoset në Itali dhe një vit më vonë emigron në Amerikë, ku jeton edhe sot. Ka botuar librin me poezi "Këngë në heshtje".

SELA, VËLLEZËRIT, veprimtarë në ShBA. Në vitet 1982-1983 kanë pasur këtë adresë: Vëllezërit Sela, 824 Ceney IslandAve. Brooklyn, N.Y. 11218 USA. Kanë qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

self-realization *vetë-realizim*, zhvillim i balancuar i personalitetit njerëzor, ku asnjë pjesë nuk dominon mbi një tjetër.

SELMANAJ NAZMI – Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Nazmi Selmanaj, student nga f. Gllogjan, KK – Deçan, i lindur më 25 nëntor 1954, në të njejtin fshat. ... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh."*

SELMANI L+Z+N, veprimtarë në Zvicër. Në vitet 1982-1983 kanë pasur këtë adresë: Selmani L+Z+N. Dalipi, 11.Rue Dizernes 1205 Geneve Suisse. Kanë qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

SINISHTAJ GJETO, veprimtar në ShBA. Udhëheqës, në atë kohë i radio-stacionit "Zani i Malësisë". Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Gjeto Sinishtaj, 315 E. 68 St. New York, N.Y. 10021 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 20.

sociability 1. aftësia për t'u shoqëruar me të tjerët,

2. Si koncept psikologjik dhe social-psikologjik, është mekanizmi që e lidhë një pjesë me një tërësi dhe tërësinë me një pjesë. Forma të ndryshme të mvarshmërisë reciproke në mes elementeve të ndryshme të psikikës paraqesin një shembull të sociabilitetit.

social diçka që ka të bëjë me relacionet reciproke në mes individëve që bashkëveprojnë.

social agregate kategori sociale që përbëhet nga individ, ku e vetmja veti e tyre e përbashkët është se ata banojnë afër njëri tjetrit.

social anabolism, ai zhvillim në një shoqëri që bëhet kur idetë, vlerat atitydat dhe sjelljet e reja absorbohen dhe shkrihen me kulturën e shoqërisë.

social anatomy struktura dhe organizata e shoqërisë.

social class *klasë sociale* 1. Familjet të cilat kanë ose gati kanë veti sociale relevante të njejta, përbëjnë një klasë sociale. Shoqëri dhe lloje të ndryshme shoqërish kanë shpesh veti të ndryshme sociale relevante. Në botën perëndimore profesioni, të ardhurat dhe shkollimi janë të një rëndësie të madhe. Në shumë shoqëri tjera prejardhja (fisi, rrënja) ka rëndësi vendimtare. Pastaj ekziston një lloj-llojshmëri e madhe sa i përket numrit të klasave që mund të dallohen në një shoqëri, se sa qartë janë të përkufizuara klasat nga njëra tjetra dhe sa i fortë është *identifikimi klasor subjektiv.* Shumica e sociologëve të sotëm preferojnë të përdorin konceptin klasë-shoqërore në mënyrë *pragmatike*. Një ndarje e shpeshtë e klasave në botën perëndimore është në formën klasa e lartë, klasa e mesme dhe klasa punëtore. Në disa raste është e përshtatshme të bëhet një ndarje klasash në formë më të detajuar, e në raste tjera një ndarje në "punëtorë" dhe "jo punëtor" është e mjaftueshme.
2. Disa sociolog i japin konceptit klasë një domethënie shumë më precize se sa që është thënë më lartë. Më të njohuritë në këtë kuptim janë ndoshta Marksi dhe Weberi. Tek ata, një klasë shoqërore është e njejtë me atë kategori personash të cilët, të gjithë së bashku, qëndrojnë në një relacion të njejtë ndaj aparatit prodhues të shoqërisë.

social climber person i cili shkëputet prej kontakteve të vjetra dhe në vend të tyre qëllimisht fillon të mbjellë kontakte me persona që kanë status më të lartë dhe në këtë mënyrë përpiqet të ngrejë statusin e tij.

social contagion *infektim social* Impulse të llojeve të ndryshme të cilat gjatë ndërveprimit në mes personave shpërndahen në rrethe gjithnjë më të mëdha dhe kanë si rezultat shfaqjen e një modeli të sjelljes identike. Koncepti mund të aplikohet në kuptimin e modave të ndryshme të cilat përhapen shpejt dhe me po atë shpejtësi dalin prej mode apo u del boja, apo edhe tek shpërthimet e panikut në tubimet popullore.

social control të gjitha ato procese me ndihmën e të cilave një shoqëri apo një grup i bënë anëtarët e vet të sillen në përputhje me ato norma që vlejnë për tërë shoqërinë apo grupin në fjalë.

Ekzistojnë dy klasa të kontrollit social:

1. kontroll përmes pushtetit detyrues (coercive control),
2. kontroll përmes bindjes (persuasive control).

Dallimet në mes klasave janë se dhuna fizike apo kërcënimi për përdorimin e dhunës fizike ndeshet tek kontrolli përmes pushtetit detyrues gjë që nuk ndodhë kur është rasti tek kontrolli përmes bindjes, kontroll i cili bazohet në *sanksione* negative dhe pozitive e jo në dhunë. Duhet vënë re se kërcënimi për heqjen e një sanksioni pozitiv (shpërblimi) të cilin individi ka filluar ta konsideroj si normale gjithashtu është një lloj

sanksioni negativ. Përveç llojeve të ndryshme të sanksioneve kontrolli përmes bindjes përfshinë edhe gjëra tjera që ndikojnë tek individi që ai të sillet në mënyrë konforme, p. sh. sugjestionimi dhe imitimi.

Kontrolli social përmes kodeve penale përbëjnë shembull të kontrollit përmes pushtetit detyrues. Zhvillimi në shtetet moderne ka shkuar në atë drejtim që ushtrimi i kontrollit përmes detyrimit duhet patjetër të jetë i sanksionuar, aprovuar, nga shteti.

Një shembull i kontrollit përmes bindjes është kur grupi i shpërblen anëtarët *konformist* me status më të lartë.

SOCIALDEMOKRACIJA E SERBISË; Partia Socialdemokrate e Serbisë (Srpska socijaldemokratska partija – SSDP) ka qenë parti politike e së majtës, që ka vepruar në Serbi në fillim të shekullit XX (nga 1903 deri më 1919).

Partia Socialdemokrate e Serbisë shfaqet si përfaqësuese politike e klasës punëtore në zhvillim e sipër, si korrigjuese, sidomos në luftën për legjislaturën sociale. Duke e pasur parasysh përzierjen etnike të Ballkanit, Partia Socialdemokrate e Serbisë i përmbahet idesë së Federatës Ballkanike. Duke e përkrahur modernizimin e Serbisë, ajo së bashku me disa përfaqësues të partive liberale, në Parlament dhe në shtypin e saj, i kundërvihet militarizimit të shoqërisë serbe dhe luftërave në fillim të shekullit XX.

Gjatë periudhës së vetë të shkurtë të veprimit, në kohës e krizës së aneksimeve, luftërave ballkanike në prag të Luftës së Parë Botërore, kjo parti ka ndjekur një program kundër luftës, të bazuar në idenë e revolucionit klasor dhe bashkimit të popujve të Ballkanit në konfederatë. Partia Socialdemokrate e Serbisë ka hy në historinë e Evropës si partia e vetme e cila në prag të luftës së madhe ka votuar kundër buxhetit të luftës.

Partia Socialdemokrate e Serbisë në udhëheqjen e Dimitrije Tucoviçit ka qenë një ndër partitë punëtore më luftarake në Evropë. Dimitrije Tucoviçi nuk ka qenë dallëndyshja e vetme e Socialdemokracisë së Serbisë, dhe idetë e tij nuk i kanë pikë prej qiellit por prej mjedisit që e ka rrethuar.

Figura të njohura të socialdemokracisë serbe: **Dimitrije Tucović**, Dragiša Lapčević, Triša Kaclerović, **Kosta Novaković, Radovan Dragović (**mësuesi i Dimitrije Tucoviçit), Filip Filipović, Dušan Popović, Miodrag Jeremić, etj.

social determinism pikëpamja sipas të cilës fenomenet sociale në radhë të parë duhet të sqarohen me ndihmën e faktorëve social dhe se p.sh. psikologjia individuale nuk guxon asnjëherë të përdoret si bazë e mjaftueshme për analiza sociale. Durkheim në këtë pikë ka marrë qëndrim ekstrem. Ai mendon se njerëzit çdokund nëpër botë janë të njejtë në pikëpamje psikologjike dhe fiziologjike, dhe për këtë këta faktor nuk mund të përbëjnë bazë për shpjegimin se pse shoqëritë e vendeve të ndryshme tregojnë dallueshmëri kaq të mëdha.

social differentiation *diferencim social* 1. Termi ka të bëjë rëndom me ato pozicione sociale brenda një grupi ose shoqërie. Se një grup ka shkallë të lartë të diferencimit social do të thotë se brenda grupit ka pozita sociale dalluese. Një grup mund të ketë relativisht shumë anëtarë dhe të mos ketë ndonjë shkallë të lartë të diferencimit social. Shembull i kësaj mund të jetë një klasë nxënësish të një shkolle.

2. Termi ka edhe kuptimin e një procesi që çon në atë drejtim kur një grup apo një shoqëri krijohen shumë pozicione sociale.

3. Me këtë term mund të përshkruhen edhe dallimet sociale p. sh. në mes burrave dhe grave apo në mes gjeneratave të ndryshme. Duhet vënë re se jo të gjitha ndryshimet që ekzistojnë në mes individëve paraqesin dallime sociale.

social elements *elementet sociale*, nga pikëpamja sociologjike njësitë më të vogla dhe të pandashme të një sistemi social. Se njësitë janë të pandashme nga aspekti sociologjik do të thotë se një ndarje e mëtejshme apo analizim i mëtejshëm mund të bëhet vetëm me ndihmën e një fushe tjetër shkencore. P.sh. është shumë e rëndomtë që një studiues që ndeshet me një problem sociologjik të detyrohet të merret edhe me aspekte të pastra psikologjike. Por më të rralla janë rastet kur ai shkon edhe më tutje p. sh. për t'i trajtuar elementet psikologjike në aspektin e tyre fiziologjik dhe biokimik.

social evolution *evolucion social* zhvillim i planifikuar apo i paplanifikuar i një fenomeni social. Rëndom me evolucion social mendohet një ndryshim social që është i ngadalshëm, kumulativ, dhe irreverzibil (i pakthyeshëm). Koncepti, në raste të tilla, në mënyrë analoge me evolucionin biologjik. Të ashtuquajturit social-evolucionistët gjatë viteve 1800-të kanë qenë një dukuri paralele me darvinizmin në biologji. Reprezentuesi më i njohur i tyre llogaritet Herbert Spencer.

social fact element i identifikueshëm që në mënyrë të natyrshme është i lidhur me një relacion social, një proces social apo një vlerë.

social interest term përgjithësues për të gjitha ato forca për të cilat thuhet se i motivojnë individët për të krijuar shoqëri apo grupe. Drejtime të ndryshme në mesin e shkencave shoqërore kanë parashtruar teori të ndryshme për social interest. I njohur është p. sh. psikologu Mc Dougall për doktrinën e tij se burimi i krijimit të shoqërive qëndron tek instinkti i kopeizmit tek njeriu.

socialization *proces i socializimit*, ato procese sociale që rezultojnë inplantimin apo *internalizimin* e normave të një shoqërie apo grupi në personalitetin e anëtarëve të tyre. Socializimi kryesor bëhet heret në jetën e një personi. Gjatë fëmijërisë hidhen themelet për shumicën e atyre normave që e drejtojnë shumë individin gjatë jetës së tij si i rritur. Stabiliteti apo grupi i një shoqëria bazohet qoftë edhe pjesërisht, se sa efektiv ka qenë dhe është socializimi. Shkelja e një norma të *internalizuar* rëndom është shumë e mundimshme për ekuilibrin psikik të individit dhe shpesh është e lidhur me *krizë* personale.

social heritage *trashëgimi sociale* të gjitha adetet, *mores*, mënyrat e mendimit dhe dituritë që janë përcjellë prej një gjenerate të vjetër tek e reja.

social medium mjet me ndihmën e të cilit njerëzit komunikojnë me njëri-tjetrin. Mediumi social më i rëndësishëm është natyrisht gjuha.

social nexus lidhje të cilat i mbajnë bashkë individët, grupet dhe shoqërinë dhe të cilat i bëjnë ata reciprokisht të mvarun nga njëri-tjetri.

social organization *organizatë sociale* 1. Në përgjithësi me organizatë sociale mendohet ajo mënyrë përmes së cilës një shoqëri është e ndërtuar dhe ku *normat*, *status-poziticionet*, *grupet, organizatat formale*, dhe institucionet gjithmonë paraqesin gurët e ndërtesës.
2. Nganjëherë termi organizatë sociale përdoret si term përgjithësues për strukturën e një grupi.

3. Tek disa autor termi organizatë sociale ka domethënien e rregullimit shoqëror, ku kemi të bëjmë me *integrim*, me një sjellje në bazë të ligjshmërive dhe me një minimum të konflikteve. E kundërta e kësaj është *dezorganizim social.*
4. Nganjëherë termi organizatë sociale ndeshet si sinonim për *organizatë formale.*

social organism shoqëritë apo grupet thuhet se kanë veti që i bëjnë ato t'u përngjajnë organizmave biologjik. Brenda *funksionalizmit* më parë analogjitë me organizmat biologjik kanë qenë shumë të rëndomta. P. sh. bëhej ngjashmëria e shoqërisë me një trup njeriu organet e të cilit u përgjigjeshin institucioneve të ndryshme në shoqëri dhe këto institucione thuhej se janë të ndërlidhura ashtu siç është shëndeti tek organet tjera në një trup njeriu. Në funksionalizmin modern dhe brenda sociologjisë në përgjithësi analogjia-organizëm përdoret shumë rrallë. Janë shfaqur fakte se analogjia e tillë lehtë i drejton studimet sociologjike në gjurmë të rrejshme.

social participation pjesëmarrje aktive në *organizata formale* vullnetare të llojit të Kryqit të kuq, parti politike, organizata joqeveritare (OJQ) etj.

social pathoplogy studimi i formave të ndryshme të *dezorganizimit social* dhe jo-përshtatjes sociale. Varfëria, kriminaliteti, prostitucioni, vetëvrasjet dhe alkoolizmi janë disa prej çështjeve që tradicionalisht i takojnë fushës së social-patologjisë. Shumë shkencëtar modern mendojnë se ky term duhet të hiqet nga përdorimi sepse implikon një analogji të rrezikshme dhe të rrejshme me patologjinë biologjike.

social pattern formë ndërveprimi që shpesh përsëritet dhe që mund të thuhet se është tipike për një pjesë të madhe të popullsisë së një shoqërie apo të një grupi p. sh. me e vizituar farefisin të dielleve, me shkua me të dashurën apo një shoqe të shtunave në biograf apo me i takua të njohurit në një kafé pas përfundimit të ditës së punës.

social polarity forcat që në një *aggregat-social* tërheqin në drejtime të ndryshme dhe me këtë e balancojnë njëra-tjetrën duke e mbajtur agregatin në ekuilibër. Shembuj të social polarity përbëjnë vendet në të cilat politikisht forcat e majta janë përafërsisht të barabarta me krahun e djathtë.

social position pozitë në një strukturë hierarkike. Një person, rëndom, merr shumë pozicione sociale. Ai merr pozita në strukturën e profesionit, të të ardhurave, të pasurisë, etj. Për çdo pozicion janë të lidhura të drejtat dhe detyrat ndaj të tjerëve. Në trajtesat e ndryshme moderne sociologjike përmbajtja në detyrat quhen *roli i pozicionit* ndërsa përmbajtja në të drejtat quhet *statusi i pozicionit*. Në trajtesat e vjetra roli është gati sinonim me pozicionin social dhe për te thuhet se përbëhet prej dy komponentave, të drejtave dhe detyrave. Kohëve të fundit interes është treguar ndaj pasojave kur një person merr pozicione kundërthënëse p. sh. pozicion të lartë profesioni por pozicion të ulët në të ardhura.

social potential ai pushtet apo kapacitet që një individ apo një grup e ka që të mundet me ndikue në një rrjedhë sociale. Liderët në një grup në përgjithësi e kanë potencialin më të madh por edhe anëtarët e tjerë të grupit posedojnë një potencial të caktuar social edhe pse ai në disa situata mund të jetë në bazë të rrethanave gati i parëndësishëm. Por meqenëse një individ në përgjithësi u takon shumë grupeve ai posedon gjithashtu shumë potenciale

të ndryshme sociale. Një individ mundet p. sh. të ketë potencial të madh në familjen e tij, por shumë potencial të vogël kur është puna tek mundësia për të ndikuar në rrethanat e lagjes në të cilën banon.

social process Me proces social mendohet në përgjithësi një seri e ngjarjeve të cilat çojnë në një rezultat specifik dhe të parashikueshëm. Me proces-social praktikohet të mendohet para së gjithash se ato ngjarje që ndodhin kur lloje të ndryshme të *relacioneve-sociale* krijohen gjatë ndërveprimit. Mvarësisht nga vetitë dhe produktet finale tek llojet e ndryshme të ndërveprimit praktikohet që proceseve sociale t'u jepen emra të ndryshëm p. sh. *konkurencë, bashkëpunim, konflikt, asimilim* etj. Një ndarje e jo-hollësishme e këtyre proceseve sociale është se ato mund të jenë ose asociative ose dissociative. Me llojin e parë mendohet në procese sociale që kanë ndikim bashkues, me llojin e dytë mendohet në procese sociale që kanë efekt përçarës.

Në *ekologjinë-klasike* ka qenë bërë një dallim i madh në mes proceseve sociale dhe proceseve ekologjike. Me llojin e dytë (me proceset ekologjike) është menduar në ngjarje të cilat nuk kanë përfshi ndërveprimin-social por që kanë ndodhur në një nivel subsocial dhe që kanë pasur si rezultat fenomene të ndryshme hapsinore shumë të rëndësishme. Në mesin e këtyre proceseve ekologjike praktikohet të llogariten *segregacioni, koncentracioni, centralizimi, invazioni dhe succesioni*. Tani në përgjithësi ekziston dyshimi me rastin e distinkcionit në mes proceseve sociale dhe atyre ekologjike. Mendohet se relacionet sociale dhe subsociale gjendet si tek proceset sociale ashtu dhe tek ato ekologjike.

social product 1. Në kuptimin më preciz (*stringent*) një produkt social është rezultat i një *procesi-social*. P. sh. bashkëpunimi çon në krijimin e një grupi me veti specifike. Konkurenca çon tek një tjetër strukturë etj.

2. Nganjëherë *social product* ndeshet si term për rezultatin material të ndërveprimit social apo ekonomik.

social propagation ka përafërsisht të njejtin kuptim *si infektim social*, ku përhapja e ideve, idealeve, atitudave, adeteve etj. bëhet prej personi në person duke përfshi rrathë gjithnjë më të mëdhenj.

social psychology është një fushë studimi në kufirin në mes *sociologjisë* dhe psikologjisë dhe mund të konsiderohet si fushë speciale nën të dy lamitë. Nga pikëpamja psikologjike, social-psikologjia është studimi i efekteve të krijuara tek një individ gjatë mekanizmit apo proceseve të ndërveprimit me individët tjerë. Nga pikëpamja sociologjike, social-psikologjia është përafërsisht e njejtë me studimin e fenomeneve sociale në nivelin individual apo në mikro-nivel.

social rank *rangu social* 1. sinonim me *social-position* do me thënë pozitë në një strukturë sociale hierarkike, p. sh. në strukturën e profesionit apo në strukturën e të ardhurave.

2. Nganjëherë përdoret rangu social në një kuptim më specifik dhe me atë rast mendohet në ate se si një individ apo një grup vlerësohen në krahasim me individët apo grupet tjera, p. sh. se si një individ vlerësohet në krahasim me shokët e tij të punës apo se si vlerësohet një shoqatë në pikëpamje sociale në krahasim me shoqatat tjera. Një individ rëndom u takon shumë grupeve dhe rrjedhimisht shumë renditjeve të rangut. Kombinimi i rangjeve të shumta praktikohet të përshkruhet si *prestigji* i individit.

social relationship është ai *stimulus-respons* model që vjen me rastin e *ndërveprimeve* sociale. Relacionet sociale mund të thuhet se janë elemente apo komponenta themelore të *proceseve sociale*. Relacionet sociale mund të jenë të shumë llojeve të ndryshme, prej atyre të përkohshme deri tek ato shumë të qëndrueshme, prej bashkëpunimit deri tek konflikti më i thellë etj. Ato relacione që zhvillohen në një grup dhe për të cilat mund të thuhet se e konstituojnë një grup janë një nënkategori e konceptit më të gjerë *relacione sociale.* Studimi i relacioneve sociale përbënë një bërthamë për sociologjinë.

social situation shuma e atyre relacioneve sociale të cilat, në një moment të caktuar kohor vlejnë, janë në fuqi, për një individ, një grup, një shoqëri apo një agregat social.

social status 1. Në trajtesat më të vjetra social status është përdorë si sinonim me *social-position* apo *social-rank*.

2. Duket se tani është më e rëndomtë që fjalës status t'i epet një kuptim më specifik, pra *statusi* së bashku me *rolin* janë dy komponente të një pozicioni social. Statusi social thuhet se është i barasvlershëm me ato të drejta që një pozicion social ia jep poseduesit (të pozicionit). Me fjalë tjera statusi i një personi është i barabartë me obligimet e personave tjerë që kanë ndaj tij.

social strata Ato *pozicione sociale* në një grup apo në një shoqëri kanë *status social* të njejtë apo përafërsisht të njejtë thuhet se e krijojnë një social stratum. P.sh. profesorët në Gjermani thuhet se paraqesin një social stratum. Në natyrën e termit është nënkuptimi se fjala është për një hierarki të status-niveleve. Termi social strata konsiderohet më neutral se sa koncepti i ngjashëm *klasë-shoqërore*.

social structure Struktura e një ndërtese përbëhet nga pjesë-ndërtimore të cilat janë lidhë në mënyra të ndryshme për ta krijuar një ndërtesë. Në të njejtën mënyrë një *sistem social*, p. sh. një shoqëri, e ka një strukturë. Praktikohet të bëhet dallimi në mes shumë llojesh të strukturave sociale.

1. Në një kuptim, sistemi social konsiderohet si i përbërë prej pjesëve në formë të grupeve dhe individëve. Ato ndër-relacione më stabile në mes tyre (individëve dhe grupeve), në këto raste, përbëjnë strukturën sociale.

2. Në një kuptim tjetër struktura sociale mendohet si e përbërë prej pjesësh në formë të *normave, vlerave, institucioneve, ligjeve, roleve*, e kështu me radhë, të cilat përbëjnë ato karakteristikat më stabile në sjelljet sociale dhe të cilat gjithashtu janë të integruara dhe ndër-relacionuara me njëra-tjetrën. Kjo mund të quhet struktura analitike e sistemit social.

3. Nganjëherë ndodhë që të bëhet përpjekja për t'i kombinuar të dy aspektet e lartpërmendura.

social symbol një simbol i cili nuk ka kuptim vetëm për një person, por e ka të njejtin kuptim edhe për shumë veta në një shoqëri, një grup apo një *agregat social*. Një reprezentim kolektiv është një lloj simboli, kur diçka nga vetë grupi simbolizohet. Shenja më e rëndomtë e simboleve sociale është natyrisht gjuha e përditshme e cila kuptohet nga të gjithë në një shoqëri.

social system Ky term në sociologji përdoret në shumë rrethana të lloj-llojshme. Në përgjithësi është një shprehje e përbashkët për të gjitha format e agregateve sociale, në të cilat veprimet e individëve pjesëmarrës ndikojnë tek njëri-tjetri në një mënyrë apo tjetër.

Kështu p. sh. mund të flitet për familjet, lagjet e banimit, shoqëritë lokale (qytezat) dhe shoqëritë (shtetet), si sisteme sociale.

social telesis veprim i planifikuar në drejtim të qëllimeve shoqërore.

social tension Ndërveprim social që karakterizohet nga ndjenja të pakëndshme tek ata që janë të përzier në ndërveprime. Shkolla funksionaliste i kushton rëndësi të madhe kapacitetit - aftësisë të një grupi apo të një shoqërie për t'u përballur me tensione sociale.

social units njësi sociale, elemente sociale ose kombinim i elementeve sociale që në përbërje të përgjithshme gjatë krahasimit janë të plota dhe që mund të maten dhe për këtë shkak janë të përshtatshme si objekte studimi. Shembuj të njësive sociale janë individi, familja, krimi, atityda, shoqëria etj.

society *Shoqëri* 1. Në kuptimin sociologjik shoqëri do të thotë ata njerëz të cilët e kanë të njejtën, e ndajnë të njejtën kulturë. Duhet vënë re se fjala shoqëri në përdorim të përditshëm shoqëri-rreth, në gjuhësinë sociologjike i përgjigjet shprehjes shoqëri lokale (anglisht: community),
2. Në ekologjinë klasike termi shoqëri (society) paraqet atë organizatë njerëzish në një *habitat* e cila ndërtohet përmes bashkëpunimit të vetëdijshëm, ndërsa tek shoqëria lokale (community) paraqet atë organizatë njerëzish në një habitat, e cila është zhvilluar në mënyrë automatike përmes forcave *subsociale* dhe ku të dobëtit janë detyruar t'u përshtaten të fuqishmëve.

sociology *sociologji* studimi shkencor i ndërveprimeve sociale (*social interaction*) si dhe i atyre fenomeneve që janë pasojë e këtyre ndërveprimeve. Termi sociologji është krijuar nga filozofi francez Auguste Comte (1798-1857), por studime sociologjike janë bërë edhe më parë. Në sociologji hasen shumë shkolla të cilat përdorin metoda të ndryshme për arritjen e diturive mbi relacionet sociale.

sociology of law studimi i sistemit legal si institucion në shoqëri dhe relacionet e tij me institucionet tjera. Vëmendje u kushtohet ligjeve dhe prejardhjes e mbështetjes sociale, relacionet e sistemit të drejtësisë me ekonominë, ndarjes së pushtetit dhe mbajtja e këtij pushteti përmes sistemit ligjor, mbështetjes së sistemit ligjor për sistemin familjar dhe atë farefisnor etj.

SPAHIU HYSEN, – Hysen Spahiu, veprimtar nga Dibra, i cili së bashku me Agron Selën, në vitin 1981 e 1982 kanë qenë në rrethin e Vëllezërve Gërvalla. Emigroi në Amerikë (ShBA) ku më duket se jeton tani.

stereotype *stereotip* 1. një paramendim tepër i thjeshtësuar dhe plotë paragjykime mbi vetitë e një individi, kategorie apo dukurie sociale. Stereotipet kanë shpesh atë formë sa një person i konsideron të gjithë individët e një kategorie sikur ata të kishin pasë të njejtin personalitet. Termi në këtë kuptim rëndomë ka ngarkesë negative.
2. Një kuptim më shkencor dhe më neutral është se termi stereotip paraqet një model të thjeshtësuar dhe nganjëherë fals të cilin e kemi në brendinë tonë rreth dukurive të ndryshme, në botën që na rrethon. Ato modele thuhet se na ndihmojnë për t'i përballuar shumë situata kur ndodhemi para fenomeneve që në të vërtetë janë shumë të komplikuara. Kjo vlen edhe në ato raste kur

stereotipi është në shumë pjesë të tij, fals (i rrejshëm). Ky përdorim i termit është bërë së pari nga Walter Lippmann në librin *Public Opinion* (1922). Termi në këtë kuptim ka lidhshmëri me *ideologji* dhe *racionalizim*.

STUDENTENWOHNHEIM, Eduard-Spranger-Straße 7, D-71634 Ludwigsburg. Konvikt studentësh në Ludvigsburg. Në këtë konvikt, në adresën e lartpërmendur, falë komunikimeve e ndërmjetësimeve që kishte Bardhoshi, na u krijua mundësia të banojmë ne disa të rinjve, si Agron Selës, Hysen Spahiut, Haxhi Berishës, Naim Haradinajt, Hasan Rrahmanit dhe mua Xhaferi Durmishit. Sa i përket pjesës sime, unë banova në këtë adresë prej korrikut 1981 deri në korrik 1982. Shokët e tjerë, disa kanë banuar aty edhe më heret, e ndoshta ndonjë edhe më vonë.

subculture 1. pjesë e sistemit kultural që është specifike për një grup të caktuar. Subkulturat zhvillohen sidomos në grupe që ndiejnë solidaritet të madh të brendshëm. Kështu përpiqen p. sh. partitë politike integruese të krijojnë një mjedis kuluror për anëtarët e tyre që dallohet nga ajo *modale*.
2. në kultur-antropologji mendohet nganjëherë në disa tendenca që shfaqen tek të gjitha kulturat. Me këtë kufizohet edhe mundësia për variacione kulturore.

SUFTA HASIM, shtetas i Turqisë me prejardhje shqiptare apo nga viset shqiptare. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Hasim Sufta, 1145 sok. No.94 Yeniseheir, Izmir-Türkiye. *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës i është dërguar për ta informuar me gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi.

SURROI SEZAI, për Sezai Surroi Jusuf Gërvalla shkruan shkruan në Lajmëtarin e lirisë të janarit, 1981.

Jusuf Gërvalla: "*Me gjasë, anonimiteti ofendues e shëmtia e madhe e emrit Petar Përla, që mban Shkolla Fillore e Irzniqit, paskësh zgjuar neveri e mllef te banorët e këtij fshati, apo të ndonjë fshati tjetër përreth. Ose, ndoshta, edhe aksioni për të cilin do të bëjmë fjalë këtu, është vepër e rinisë së organizuar.*

Sido që të jetë, aty në të aguar të 25 nëntorit të vitit që shkoi, busti i Petar Përlës, në oborrin e shkollës së Irzniqit, u gdhi për faqe të zezë: pa atë kokën e tij të shëmtuar e anonime.

Pas kësaj, UDB-ja e Deçanit dhe e Pejës maltretoi shumë njerëz, ndër ta edhe vëllain e kryetarit të Komunës së Deçanit, i cili kishte bërë rojë, vetë treti, natën që busti mbeti pa kokë. Tash, hetimet po bëhen edhe më të ethshme. Po gjurmët e aktorëve – as për ilaç! Sa më i madh po bëhet tërbimi i UDB-së, aq më shumë po i hipën vlera kokës anonime të Përlës dhe aq më e urryer po bëhet për armikun tonë koka e të riut tonë, që ia mori kokën e shëmtuar bustit. Nga burime të sigurta jemi informuar se UDB-ja e ka qitur fjalën në rrethin e besimtarëve të vet se ai që e zë aktorin e heqjes së kokës nga busti, do të shpërblehet me – 200 milionë dinarë!

Urdhëroni, turruni gjahtarë skalpesh të shqiptarëve! Për kokën e metaltë të një sllavi anonim, do të shpërbleheni me 200 milionë dinarë po të keni sukses t'ia merrni kokën nga krahët një shqiptari të gjallë. Me këto para mund të bleni, sa t'ju dojë shpirti, deterxhente, kripëra, vajra, sheqerëra e ashkla, që Jugosllavia titiste s'po mund t'ua sigurojë shtetasve as me shkopin dhe strajcën e lypës. Për ju është kujdesur UDB-ja, ajo ka para, sa të doni, vetëm ju punoni si ju porosit ajo, dhe do të shpërbleheni në kurriz të djersës e të gjakut të popullit.

Por, qëkur u hipi kështu vlera kokave të metalta?! Parvjet, kur u bë busti i heroit shqiptar, ***Sezai Surroi*** *në një fshat të Opojës, autori i projektit pat marrë shpërblim vetëm*

1 milion dinarë, kurse gjithë projekti pat kushtuar vetëm afro 3 milionë. Natyrisht, pa llogaritur ahengjet e pangopshme të renegatëve kosovarë, që erdhën në solemnitetin e zbulimit të bustit për t'i fryrë bulshinjtë dhe barkun si babëzinj të dorës së parë…

Por, si guxojmë të gabohemi! Atëherë ishte puna për një kokë hekuri të shqiptarit, tash për një kokë të tillë të sllavit. Dhe, këto s'e kanë çmimin e njëjtë as të shkrira në metal. Dhe kjo është gjëja më e rëndomtë në kushtet e jetës së sotme të shqiptarit në robërinë sllave." (Lajmëtari i lirisë, janar 1981-Shtojca)

SYLA GANI, SHALANI MUHARREM DHE MALIQI HAXHI

Jusuf Gërvalla: "*Një muaj më vonë po kjo gazetë solli edhe lajmin nga Gjyqi i Qarkut të Shkupit, i cili, për të njëjtën vepër, kishte dënuar 3-6 vjet burg të rëndë Gani Sylajn, Muharrem Shalanin dhe Haxhi Maliqin. As te grupi i parë as te i dyti (dhe as te afro 2000 të burgosurit e tjerë politikë shqiptarë, që i burgosi vjet UDB-ja), nuk janë kapur materiale armiqësore të dënueshme me ligjet ndërkombëtare, të cilat i ka nënshkruar edhe vetë Jugosllavia në Helsinki, para disa vjetësh. Të burgosurit në fjalë janë privuar lirie vetëm për deklarata verbale ose shkresa unike apo të shumëzuara me dorë e makinë shkrimi – dhe kjo gjë është në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare. (Por, kush do ta detyrojë Jugosllavinë të përgjigjet për këto krime, në mos e detyrofshim ne vetë."* (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, f. 2)

SYLA LEKË, veprimtar në Austri. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Lekë Syla Hasengasse 33, 1100 Vien-Austri. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

SYLÇA NIJAZI, personalitet kulturor me prejardhje shqiptare apo nga viset shqiptare, në Turqi, shtetas i Turqisë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Nijazi Sylqa, Gülvenik Cad. Yaylagül, sok. No.3/19-20, Asagi Ayranci Ankara. *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës i është dërguar për ta informuar me gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi.

SYLEJMANI NUHI - Nuhi Sylejmani është lindur më 10 maj 1943, në fshatin Stanec, Lagjja Lesbaliu. Shkollën tetëvjeçare e kreu në Caravajkë. Që nga 22 maji 1969 është punëtor në Gjermani. Ka nënshkruar librin "Vrasja e trefishtë", Prishtinë 2010.

Është bërë jashtëzakonisht i njohur në qarqet patriotike si dhe të hyqmetit si ***Luani i papërkulur i inferioriteteve vandale*** për shkak të mosaftësisë për pengimin e veprimeve të gabueshme e fatale. Si luan i inferioriteve vandale është zgjedhur nga Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka për bashkëpunim të barabartë, pasi ata nuk kanë mund me gjetë ndonjë Luan tjetër që mund t'ia kaloj këtij në inferiritetet vandale. Tre heronjtë, duke e zgjedhur për bashkëpunëtor të barabartë Luanin e inferioriteve vandale kanë treguar se janë të pazëvendësueshëm.

SH

SHABANI MILAIM, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Milaim Shabani, Cite Ouest « G » 1196 Gland (VD) Suisse. Ka qenë një ndër pikat në Zvicër prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

SHABANI SHAQIR, – Shaqir Shabani, aktivist në rrethin e Gjenevës. Aktive kanë qenë edhe lidhjet e tij në Gjermani dhe Francë. Në dasmën e Kadri Zekës dhe Saime Isufit, ia ka dhurua një revole gruas së Kadriut – Saimes.

SHALA BAJRAM, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Bajram Shala, Schmiden str.90 D-7000 Shtutgart +49-711563927. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

SHARAJ R., veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: R. Sharaj, 21 Kristin Dr. 822 Schaumburg Ill, 60195 USA. Ka qenë një ndër pikat në ShBA prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

SHEHU BRAHIM, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Brahim Shehu, Kastellstr.11, D-7972 Allgäu. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

SHTETI

Shteti (nga latinishtja status, rregullim i fort) është një grup institucionesh që janë autoritet, që kanë përgjegjësi, për të përcaktuar rregullat dhe qeverisur popullin në një apo shumë vende, dhe që ka sovranitet intern dhe ekstern mbi një rreth të caktuar gjeografik.

a) Një shoqëri e organizuar politike e pamvarun, me fjalë më të përafërta organizimi politik i pamvarur i një shoqërie të tillë, që është e krijuar përmes një sistemi të vetë juridik dhe një qeverisje qendrore, dhe që e ushtron sovranitetin mbi një territor të caktuar.

b) Sistemi i institucionave politike të cilat përmes strukturës së tyre autoritative ushtrojnë pushtetin sovran apo përfundimtar në një shoqëri.

c) Një aparat institucional i përmbledhur (centralizuar) i cili në një masë më të madhe ose më të vogël rregullon apo zotëron marrëdhëniet në mes individëve dhe grupeve në një shoqëri.

Kjo mund të kuptohet në mënyra krejtësisht të ndryshme:

– Si domosdoshmëri, por principialisht një instrument i kufizuar pushteti i paraparë që të siguroj një rend juridik që mbron lirinë e individit (liberalizmi);

– Si një pushtet ose aparat shtypës që krijon dallime në mes shtypësve dhe të shtypurëve në një shoqëri (anarkizmi);

– Si një pushtet ose aparat shtypës që i shërben klasës ekonomikisht dominuese në një shoqëri (marksizmi).

Në dy rastet e fundit (tek anarkizmi dhe marksizmi), shteti kritikohet nga një paramendim ideal për një shoqëri pa aparat shtetëror (në marksizmin klasik flitet për "shuarjen" e shtetit).

Vetë aparati shtetëror institucional mund të bëhet objekt i luftës për pushtet në mes interesave (grupeve) të ndryshme në shoqëri. Kjo ka sjellur deri tek mendimi se shteti nuk është asgjë tjetër përveç proces në rrjedhje e luftës institucionale për pushtet në mes grupeve të ndryshme të interesit në një shoqëri (p. sh. A. F. Bentley, H. Lasswell). Kjo do të thotë se nuk ekziston diçka që mund të quhet e mirë e përbashkët të cilën shteti do ta mbronte.

d) Një njësi politike dhe sociale që qëndron mbi interesat e veçanta të individëve dhe grupeve të ndryshme, dhe me këtë shpreh pjesërisht unitetin e shoqërisë, pjesërisht

përcaktimin e individit si esenca shoqërore (Aristoteli, Rousseau). Këtu shteti bëhet një çështje rreth të përgjithshmes, do me thënë rreth përcaktimit moral të njeriut. Ky kuptim merret në shqyrtim dhe riformohet nga Hegeli, i cili mendon se shteti është një tërësi mbiindividuale, në të cilin liria merr vërtetësi, liria vërtetësohet.

Qysh Aristoteli ka treguar se njeriu gjithmonë ka jetuar në shoqëri, por këtyre shoqërive tek popujt primitiv u mungon karakteri shtetëror i shkolluar. Shteti kërkon kontinuitet dhe rregullat e tij ligjore vlejnë në atë territor ku banojnë anëtarët e shtetit (nënshtetasit) pamvarësisht nga prejardhja e tyre. Kur personat e marrin ligjin në duart e veta, në kundërshtim me shtetin, në mënyrë individuale apo përmes ushtrive jo-shtetërore, kjo konsiderohet si shembje e shtetit

Në të drejtën ndërkombëtare, njohja e pamvarësisë së një shteti prej shteteve tjera konsiderohet si çelës për sovranitetin. Pasi një shtet ka shumë detyrime të cilat duhet të administrohen dhe të financohen, shtetet kanë të drejtë për vjeljen e tatimeve, dhe funksionojnë si punëdhënës (mendohet në sektorin publik).

Përmbajtja

1. Konventa e Montevideos
2. Zhvillimi i konceptit të shtetit
2.1 Lashtësia dhe antikiteti
2.2 Mesjeta
2.3 Koha moderne
2.4 Nacionalizmi
3. Shtetet e botës
4. Format shtetërore
5. Relacioni ndaj nështetasve (bashkështetasve)
6. Koncepti i shtetit në shkencë

1. Konventa e Montevideos

Një prej kritereve të cilat rëndomë citohen gjatë aspiratave shtetërore, për shkak të vështirësive për të fituar njohje ndërkombëtare, është Konventa e Montevideos. Kjo konventë është nënshkruar më 26 dhjetor 1933 nga SHBA, Hondurasi, El Salvadori, Republika Dominikane, Haiti, Argjentina, Venezuela, Uruguaji, Paraguaji, Meksikoja, Panamaja, Bolivija, Guatemala, Brazili, Ekuadori, Nikaragua, Kolumbia, Çile, Peruja dhe Kuba, por nuk është aprovuar nga të gjithë ndërkombëtarisht. Konventa e Montevideos i ka katër kritere të domosdoshme dhe të mjaftueshme në mënyrë që një entitet të ketë mundësinë për t'u njohur si shtet:

-një popullsi permanente
- një territor të definuar
- një qeveri
- kapacitet për të lidhur relacione me shtete tjera.

Këto kritere janë formulim i një praktike ndërkombëtare të aplikuar qysh më heret. Kjo Konventë është aprovuar në Ligën e Kombeve (League of Nations Treaty Series, vëll. 165, faqe 20-43). Për shkak se këto kritere janë relativisht të lehta për t'u arritur, Konventa e Montevideos nuk është aprovuar nga bashkësia botërore si një definicion i përgjithshëm dhe shumica e vendeve në vend të kësaj e përdorin teorinë konstruktiviste mbi statusin e shtetit si pikë fikse.

2. Zhvillimi i konceptit të shtetit

2.1 Lashtësia dhe antikiteti

Burimet më të vjetra për konceptin e shtetit përmbajnë një teori shtetërore të qartë teokratike, se pushteti është i bazuar në një prejardhje hyjnore. Kështu ka qenë në rastin e Babilonisë, Egjiptit të lashtësisë dhe Izraelit të Dhiatës së Vjetër. Në Egjipt teokratizmi është shprehur në atë formë, që mbreti është konsideruar pasardhës i zotërave, dhe në të dy rastet tjera (Babiloni dhe Izrael) se mbreti e ka marrë autorizimin për të ushtruar pushtet nga zoti. Përmes krishterimit është përhapur pikëpamja teokratike hebreje nga Lindja në pjesët e tjera të botës. Një dëshmi e një trashëgimie të tillë është kurorëzimi (i mbretit). Si një konsekuencë e kësaj edhe ligjet janë konsideruar se kanë prejardhje hyjnore, me ç'rast çdo princip juridik është kuptuar si urdhër hyjnor.

Koncepti "shtet" rrjedh nga antikiteti dhe qytetet-shtete në Vendet Mesdhetare. Para së gjithash përmes veprave nga Platoni dhe Aristoteli, vështrimi mbi shtetin dhe synimet e tij janë ruajtur prej asaj kohe; në bashkangjitje të teorive politike janë rritur e zhvilluar edhe shtetet përmes një ndikimi reciprok, rritje e zhvillim i cili do të mund të bëhej edhe më i komplikuar me rezonimet ideologjike. Karakteristike për kuptimin e shtetit ka qenë trajtimi i tij si një rend, rregullim natyror.

Aristoteli e fillon librin e tij *Politika* me një definicion për shtetin: një shtet është një bashkim politik i ndonjë lloji, dhe bashkimi bëhet për shkak se njerëzit kanë një synim të mirë, të cilin duan ta arrijnë (përmes bashkimit). Se çka mendohet me "shtetin" në këtë rast, a mendohet sundimtari apo ka një kuptim më të gjerë, ka qenë çështje e diskutueshme qysh nga koha e Aristotelit. Luigji XIV i Francës, thuhet p.sh se është shprehur: "L'État, c'est moi" (Shteti jam unë). Aristoteli mendon se një shtet karakterizohet nga ajo se ai ka nënshtetas (bashkështetas); ata banojnë në një territor, kanë të drejta politike të ndryshme në forma të ndryshme shtetërore, por vetëm ata me të drejta politike janë nënshtetas (bashkështetas). Se çka mendohet me "shtet" mund të ketë shumë dallime në forma të ndryshme shtetërore: në një demokraci ata që kanë pushtet janë shumë dhe në bazë të kësaj pikëpamje edhe vetë organi shtetëror është më i madh. Një rreth me vetëm një sundimtar dhe skllevërit e tij, në bazë të kësaj pikëpamje të Aristotelit nuk është shtet. Ky konkludim ndahet edhe nga Platoni i cili në librin Shteti (II) mendon se shteti më i vogël përbëhet nga katër ose pesë individë, por ai vjen deri tek ky konkludim duke u nisur nga baza të tjera: minimumi për një shtet është që ai të ketë një bujk, një ndërtimtar, një endës tekstilesh, një këpucëtar dhe mundësisht ndonjë tjetër mjeshtër. Për Platonin, shteti konstituohet nga një ndarje e punës dhe jo nga instancat e pushtetit; primare është ndarja e punës dhe organizata, dhe jo vullneti, etja për pushtet tek një apo shumë individ: "Një shtet lind kur secili prej nesh veç e veç nuk është i mjaftueshëm për vetveten apo nuk mund të mbijetojë vetëm, por ka nevojë për shumë." Në bazë të idealit organik të shtetit të Aristotelit, shteti është mbi individin, pasi shteti krahasohet me trupin dhe individët me gjymtyrët e ndryshme të trupit: "nëse krejt trupi prishet atëherë nuk mbetet këmbë apo dorë" (I:II). Shteti, pra, thuhet se është konkret, vetë organi për pushtetin shtetëror (qeveria, administrata, si në kuptimin "shteti shqiptar"), por edhe diçka më shumë dhe më abstrakt se kjo (kushtetuta e tij).

Shteti është për Aristotelin i natyrshëm, dhe ai i konsideron hierarkinë, ndarjen e punës dhe delegimin në shtet si gjëra të natyrshme. Drejtësia, rendi juridik dhe administrimi i drejtësisë (funksionimi i aparatit juridik) i lidhë në mes veti individët me shtetin. Ky këndvështrim në shtetin natyror dhe raportit të tij me ligjin dhe të drejtën praktikohet të thuhet se paraqesin lindjen e të drejtës natyrore, dhe definicioni i tij në shkallë të lartë ka ndikuar në zhvillimin e konceptit të shtetit duke filluar nga mesjeta, kohë kjo kur janë themeluar shumë shtete Evropiane.

Në bazë të traditës aristoteliane, shteti duhet t'u ofroj njerëzve një ndarje të natyrshme të pasurive materiale, drejtësisë dhe mbrojtjes, por edhe kultivimin moral. Për t'u mbrojtur ndaj fuqive tjera, shteti duhet të ketë një armatë.

Një shtet pra ka një kushtetutë, e cila dallohet në bazë të formës (rregullimit) shtetëror dhe vendit. Por sipas Aristotelit, të gjitha kushtetutat i kanë tri elemente:

– Caktimi i një instance të pushtetit e cila vendosë për luftë dhe paqe ndërshtetërore, dhe që brenda shtetit shqipton dënime,

– Një rregullore mbi atë se cilët janë ata që kanë të drejtë të gjykojnë, dhe si vendosen njerëzit në këto poste,

– Një rregullore për atë se si pushteti juridik dhe ai gjyqësor duhet të organizohen.

2.2 Mesjeta

Me daljen në skenë të Kishës, hyn në fuqi koncepti teokratik i shtetit duke filluar prej Konstantinit të Madh. Në të njejtën kohë, kisha katolike-romake fiton një pozitë si fuqi botërore, por në realitet papa ka qenë shpesh i mvarun prej atyre perandorëve (kajzerëve) të cilët i ka kurorëzuar, të cilët kanë themeluar shoqëritë feudale. Gjatë tërë mesjetës është zhvilluar një luftë për pushtet në mes kishës dhe shtetit, dhe palët rivalizuese kanë përfaqësuar dy teori të ndryshme teokratike, sepse si shteti ashtu edhe kisha kanë pretenduar se në shtetet e tyre, e drejta e zotit është në anën e tyre. Të dy këto teori teokratike mbi shtetin janë bazuar në të drejtën natyrore teokratike. Augustinus dhe Thomas Aquinas janë dy interpretuesit kryesor të teokratizmit kishtar. Gjatë tërë Mesjetës, Kisha luftoi për formimin e perandorisë romake botërore, një monarki universale, dhe krijimi i Perandoria e Shenjtë Romake (anglisht; Holy Roman Empire; gjermanisht: Heiliges Römisches Reich Deutscher Nation) mund të quhet një rezultat i kësaj lufte.

2.3 Koha moderne

Me përfundimin e mesjetës, fitoi teokratizmi perandorak mbi atë kishtar, dhe shtetet legjitimohen nga Dei gratia, pra si mbretëri të mëshirës së Zotit. Këto mbretëri (anglisht: Divine right of kings) janë një princip legjitimiteti ku parimi themelor është se mbreti është i caktuar në detyrën e tij nga Zoti. Mbreti është përgjegjës vetëm para zotit. Në raport me shoqërinë, institucionet e saj dhe individët, mbreti ka pushteti absolut. Kjo teori është historikisht një prej atyre që kanë bërë motivimin e monarkisë absolute. Ky princip është i formuluar kështu në një prej fjalive themelore:

Nga Zoti e kemi mbretin, nga mbreti e kemi ligjin.

Me këto pretendime të pushtetit mbreti ka qenë krijues i vetëm i ligjit.

Në bazë të një mendimi, i cili është i diskutabil, është Nikolo Makiaveli ai i cili e ka lansuar fjalën shtet në kuptimin "një forcë sovrane territoriale" më 1532 në librin *Princi*. Më parë me "shtet" janë menduar qytetet-shtete, por prej kohës së Makiavelit kjo fjalë fillon të paraqet një vend dhe një udhëheqje krejt tjetër, në atë mënyrë që fjala kuptohet në përdorimin modern gjuhësor. Në kapitullin e parë (të librit *Princi*) paraqet qëndrimin se ekzistojnë dy lloj shtetesh: republika dhe principata. Në mënyrë pak të modifikuar ky klasifikim ka mbetur i qëndrueshëm, nëse me "principata" mendohen monarkitë.

Vepra e Jean Bodin mbi marrëveshjet në Paqen e Vestfalisë përgjithësisht praktikohet të konsiderohet si konstituese e konceptit shtet dhe të sovranitetit të shteteve, në atë mënyrë siç çoi zhvillimi kur perandoritë u shndërruan në shtete kombëtare. I ndikuar nga këto marrëveshje (pakte), Emerich de Vattel, një prej baballarëve të së drejtës ndërkombëtare dhe të ligjeve të luftës, mendon se "shteti" ka dy kuptime të pandashme. Nga njëra anë shteti është një konstituim politik, dhe nga ana tjetër një shoqëri njerëzore në të cilën njerëzit janë të bashkuar në aspiratën e tyre që me forca të përbashkëta të

arrijnë siguri të përbashkët dhe benificione të përbashkëta. Autoritetin (fjalën përfundimtare) në një shoqëri të tillë e ka konstitucioni politik, e ka sovrani që ka sovranitet mbi shoqërinë. Një shtet sovran (shtet i pamvarun) sipas Emerich de Vattel, është një bashkim i tillë, që është i pamvarun nga shtetet tjera dhe që qeverisë mbi vetveten. de Vattel i definon shtetet e tilla të pamvaruna si persona juridik.

Me sekularizimin e të drejtës natyrore si dhe me paraqitjen e principit të sovranitetit të popujve vjen tek cungimi i pushtetit shtetëror, dhe nënshtetasve të shtetit u njihet e drejta për revolucion kundër tij (shtetit). Shteti, në bazë të këtij kuptimi të ri, mbahet lidhur, unik në bazë të kontratës shoqërore dhe jo prej të drejtës së një sunduesi.

Koncepti i shtetit, i filozofit gjerman G. W. F. Hegel, ka qenë në radhë të parë i rëndësishëm për nacionalistët e llojeve të ndryshëm dhe për marksistët. Shteti, shkruan Hegeli në Filozofinë e së drejtës, është një ide etike që materializohet përmes vullnetit (§ 257) në një "në vetvete tërësi totale të pamvarun" (§ 330). Vullneti etik është plotësisht racional, dhe është ai që e përbën unitetin në mes kolektives dhe individuales, për ç'arsye nënshtetasit janë të obliguar t'i përmbahen (§ 258). Por ideja etike nuk është e njejta gjë si baza historike e shtetit apo e legjitimitetit të tij; ajo është shpirti që e realizon vetveten duke u aktualizuar në mënyrë të pandërprerë tek individi. Vetëm brenda shtetit individi mund të jetë i lirë. Forma politike e shtetit është organizata e shtetit (§ 271), dhe funksionet e shtetit janë pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ (§ 272).

2. 4 Nacionalizmi

Që nga romantizmi dhe vitet 1800 lindi një nacionalizëm, pjesërisht prej teorive të Hegelit, por ndoshta edhe me një ndikim më të madh nga Franca, i cili aspironte për të krijuar shtete kombëtare, do me thënë shtete të "natyrshme" të cilat legjitimohen në bazë të asaj se popullsia i takon të njejtit komb. Në bazë të kësaj shtetet fillojnë të definohen në bazë të etnicitetit të nënshtetasve, dhe para krijesave shtetërore shtrohen kërkesa të reja. Në bazë të këtij ideali kufizohen të drejtat qytetare të minoriteteve në disa vende.

Mendimet mbi atë se çka janë shtetet kombëtare, mund të ndahen në dy grupime kryesore: *primordalism* dhe *kostruktivism*.

Primordalistët e shohin kombin si fillestar, si burim, i parakushtëzuar nga prejardhja, religjioni, gjuha amtare ose "raca". Me fjalë tjera primordalistët thonë se është kombi ai që e formon shtetin, apo ia jep emrin shtetit. Këto mendime rrjedhin nga Jean-Jacques Rousseau dhe ideologjia e tij "T'i kthehemi natyrës", "Natyra është burimi ynë". Në mesin e primordalistëve shqiptar, në fushën e luftës me penë, mund t'i përmendim p. sh. Jusuf Gërvallën dhe Koço Danajn.

Konstruktivistët i shohin kombet si krijesa politike brenda shteteve. Me fjalë tjera konstruktivistët mendojnë se është shteti ai që e formon kombin, që po t'i ndjekim konsekuencat e këtij mendimi edhe më tej, do të thotë se është shteti ai që ka të drejt të krijoj dhe t'u jep emër të caktuar kombeve. Konstruktivist të njohur janë Benedict Anderson dhe Eric Hobsbawm. Ata të cilët propagandojnë apo thonë se me krijimin e shtetit të Kosovës është krijuar kombi kosovar, apo Republika e Kosovës e ka për obligim ta krijoj kombin kosovar, mund të thuhet se i takojnë rrymës konstruktiviste.

Këto teori kanë fituar rëndësi të madhe për definimin e shtetit, lidhur me çështjen se a është primar, më i rëndësishëm, kombi apo shteti. Është e vërtetë se kombet më pak apo më shumë janë krijuar që nga vitet 1800 në Evropë, kur "bujqit u shndërruan në francezë" apo kombet tjera përmes sistemeve shtetërore të shkollimit, administrimit dhe drejtësisë. Duke filluar nga revolucioni francez (1789) kryhet edhe një rivlerësim i shtetit, si shtet i popullit (principi i sovranitetit të popullit) dhe jo të një sovrani.

Max Weber, në fillim të viteve 1900 lansoi një definicion të vetin mbi atë se çka është një shtet, të lidhur me mendimin perëndimor social: ai mendon se shteti është një

bashkim politik i një shoqërie njerëzore që ka të drejtë ekskluzive (vetëm shteti dhe askush tjetër) të ushtroj dhunë legjitime brenda një territori, dhe një ambicie e tillë ekskluzive është e suksesshme. Që e drejta ekskluzive të jetë legjitime do të thotë se banorët në shtet e aprovojnë atë, pamvarësisht se nga cilat principe nisen kur e bëjnë këtë. Nëse e drejta ekskluzive nuk mund të mbrohet, shteti kalon në anarki ose në duart e tjetër kujt.

Në bazë të një pikëpamje dominuese, me "shtet" mendohet një krijesë shoqërore; një territor në të cilin ka nënshtetas; që shteti bënë pretendime për sovranitet të jashtëm dhe të brendshëm, ku gjendet një udhëheqje rregullat dhe normat e së cilës nënshtetasit janë të obliguar t'i respektojnë, dhe me këtë edhe mjetet detyruese të shtetit (p. sh. masat e kryera nga policia). Në shtetin modern ekzistojnë edhe institucione në të cilat kryhet veprimtaria politike (qeveria, organizatat etj.).

3. Shtetet e botës

Pas pjesës së fundit të viteve 1800 faktikisht çdo pjesë tokësore e banueshme në botë është copëtuar në shtete. Para kësaj kohe kanë ekzistuar territore të mëdha ndaj të cilave askush nuk ka pasur pretendime apo kanë qenë pa popullsi, ose të populluara nga nomadë pa shtet të organizuar. Për momentin ekzistojnë më shumë se 200 bashkime politike të cilat ose pretendojnë se janë shtete apo veç janë shtete të njohura ndërkombëtarisht. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) i ka 193 shtete vende anëtare. Përveç këtyre 193 shteteve anëtare, Selia e shenjtë (Karriga e shenjtë - Shteti i Vatikanit) është një shtet që nuk ka të drejtë vote në OKB, por ka vetëm statusin e vëzhguesit. Vatikani, statusin e vëzhguesit e ka zgjedhë me dëshirën e vetë, por nuk ka të drejtë vote. Pamvarësia e shtetit të Vatikanit ndërkombëtarisht është e njohur që nga viti 1929; përveç kësaj Vatikani ka autoritet për zgjidhjen e çështjeve kontestuese religjioze në Itali.

4. Format shtetërore

Një shtet mund të jetë i organizuar në shumë mënyra të ndryshme, gjë që mund të analizohet prej shumë këndvështrimeve të ndryshme. Një klasifikim tradicional, që ka pasuar pas punës së Makiavelit, është klasifikimi se shtetet mund të jenë ose monarki ose republika, mvarësisht prej titullit dhe cilin pushtet e ka shefi i shtetit. Monarkitë mund të nën-ndahen në perandori, mbretëri, principata dhe emirate.

Një pikëpamje që ka fituar teren gjatë viteve 1900 është ajo e ndarjes së shteteve në demokraci dhe diktatura, në mvarëshmëri prej shkallës së reprezentimit politik në organe legjislative, barazi politike dhe të drejtë vote, vendime të marra në bazë të shumicës, si dhe liri dhe të drejta demokratike (pra të drejtat e njeriut). Kjo pikëpamje mund të jetë kontraverze, pasi demokracitë e vendeve perëndimore në kuptimin global dhe ideologjik nuk merren si forma e vetme e drejtë, edhe pse kjo formë është dominuese, sidomos në botën perëndimore. Marksistët, demokracinë liberale e quajnë demokraci borgjeze, dhe e kanë një pikëpamje tjetër për te. Që një shtet të quhet demokratik, në botën perëndimore parashihet si rregull që ai të ketë një sistem shumëpartiak, ndërsa sistemet njëpartiake, që nganjëherë nga përfaqësuesit e tyre janë quajtur "demokraci popullore", rëndom janë kuptuar si diktatura. Një shenjë dalluese për një demokraci, sipas një pikëpamje që bazohet në mendimtarin politik liberal Karl Poper, është se në një demokraci, për popullin është e mundur që ta ndërroj udhëheqjen në mënyrë paqësore. Në bazë mësimeve të Montesquieus, liberalët shpesh marrin parasysh atë që quhet ndarje-pushtetesh (tradicionalisht mendohet në ndarjen e pushtetit shtetëror në tri pjesë: në pushtetin ekzekutiv – qeveria apo presidenti; në pushtetin legjislativ – parlamenti ose kongresi dhe në pushtetin gjykues – sistemi i gjykatave) kur bëjnë analizimin e demokracisë.

Forma shtetërore, mundet më tej, të kategorizohet në bazë të përbërjes apo lidhjes organizative, në shtete unitare (anglisht: Unitary state), konfederata dhe federata. Shtetet unitare karakterizohen nga drejtimi qendror, megjithëse një shkallë e delegimit me vetëqeverisje lokale mund të ndeshet, siç është p. sh. rasti i Suedisë dhe komunave të saj. Një konfederatë është bashkim i disa shteteve sovrane, siç është p. sh. Beneluksi. Me federatë mendohen shtetet federale në të cilat shtetet përbërëse (shtetet e federuara) kanë të drejtë të nxjerrin ligje, por e ndjekin një politikë të përbashkët në disa çështje, siç është rasti me Gjermaninë dhe SHBA.

Në periudha të ndryshme, çështja se a është një shtet kushtetues apo jo nuk ka qenë e vendosur në plan të parë. Me këtë mendohet se a ka shteti kushtetutë, apo në të kundërtën udhëhiqet në mënyrë autoritative, sepse mungesa e një kushtetute rëndom haset tek ato shtete që nuk kanë ndarje të çartë të pushteteve.

Mvarësisht se prej llojit të qeverisë që ekziston në një vend, vendet mund gjithashtu të ndahen në presidencialiste si p. sh. SHBA, ku presidenti në të njejtën kohë është edhe shef i shtetit edhe kryeministër) apo parlamentariste (ku shefi i shtetit ka funksione ceremoniale, ndërsa qeveria e ka pushtetin ekzekutiv, si p. sh. Suedia, Norvegjia, Danimarka, Gjermania), si dhe semipresidencialiste, një përzierje në mes presidencializmit dhe parlamentarizmit (me president dhe kryeministër – Franca, Federata Ruse, Finlanda).

Presidencializmi haset, si rregull, vetëm në republika, pasi presidenti si rregull është shef i shtetit, ndërsa parlamentarizmi haset edhe tek monarkitë kushtetuese. Monarkitë absolute nuk e ndjekin këtë model perëndimor, siç është p. sh. rasti me Emiratet e Bashkuara Arabe.

Ekzistojnë shumë mënyra tjera për kategorizimin e shteteve, prej të cilave një pjesë, p. sh. ato që i ka bërë Aristoteli, nuk janë më relevante për shkak të ndryshimit të gjendjes në botë. Kultur-gjeografët dhe humanistët mund të kenë kritere tjera të klasifikimit për dallim prej atyre që merren me shkenca politike, dhe ata mund të fokusohen tek pozita e shtetit (shtete pa dalje në det, shtete-ujdhesa, vende teokratike etj.) apo shtrirjes së tyre (Qytete-shtete – City state, perandori).

5. Relacioni ndaj nënshtetasve (bashkështetasve)

Pasi është detyra e shtetit për t'u ofruar siguri nënshtetasve në kuptime të ndryshme, shteti ka të drejtën e caktimit të tatimeve për të financuar policinë, ushtrinë, shkollimin, sigurinë sociale dhe rrogat për ata që shtetin e kanë si punëdhënës. Obligime të tilla brenda shtetit vlejnë në radhë të parë për nënshtetasit. Se cilët llogariten si nënshtetas, është rëndom çart e definuar në regjistra, dokumente të identifikimit dhe pasaporta. Vetëm nënshtetasit kanë të drejtë të banojnë dhe punojnë brenda territorit të shtetit pa leje të veçantë. Ata njerëz që nuk janë nënshtetas në një shtet quhen persona pa shtetësi. Përmes konventave ndërkombëtare, si p. sh. Konventa Evropiane (European Convention on Human Rights) shtetet prapë se prapë kanë disa obligime ndaj të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh nënshtetësinë.

Relacioni në mes shtetit dhe nënshtetasve qëndron në kontrollin e shtetit dhe ndërveprimin me nënshtetasit, dhe të drejtat dhe detyrat e nënshtetasve. Se çka përfshijnë në vetvete këto fusha në masë të madhe mvaret prej vendimeve politike, të cilat në anën e tyre janë të ndikueshme nga veprimet e grupeve të ndryshme të interesit dhe kornizave ndërkombëtare.

Që shteti të ketë mundësi t'i kontrolloj nënshtetasit kërkohet regjistrim i popullsisë, prej nga duket se cilët fëmijë duhet të përfshihen në obligimin shkollor, cilët

nënshtetas duhet të thirren në shërbim ushtarak, sa të holla kanë nënshtetasit të cilat duhet të përfshihen nga sistemi tatimor, etj. Veprimtaria kontrolluese përfshin edhe ndërmarrjet dhe organizatat në vend. Në shtete me korporativizëm (ku individët në masë të madhe janë pjesëtar të grupeve e shoqatave të ndryshme), siç është Suedia, ku grupet e interesit kanë lidhje të ngushta me shtetin, zhvillimi çon në një shtet intervencionistik, përderisa në një numër vendesh të tjera mbahet dallimi i kjart në mes shtetit dhe nënshtetasve. Në shtetet me sektor të madh publik, prapë si në shembullin e Suedisë, tatimet janë të larta por shteti u siguron shtetasve disa benificione. Veçanërisht liberalët dhe vendet që janë qeverisur në periudha të gjata nga partitë liberale, kërkojnë më pak tatime dhe përgjegjësi më të madhe nga individi për sigurinë e tij. Shkalla të larta të tatimit motivohen nga socialistët dhe socialdemokratët me atë se ato funksionojnë për nivelizime politike dhe i zvogëlojnë hendeqet sociale në shoqëri. Ky polarizim ideologjik lidhur ma shkallët tatimore të shtetit ka ardhë në shprehje pas Luftës së Dytë Botërore.

Çështje tjera në këtë drejtim janë se në çfarë mënyre duhet të bashkëveprojnë nënshtetasit me shtetin apo me organizatën e brendshme burokratike: centralizim apo decentralizim, demokraci reprezentative apo demokraci direkte, socializim apo privatizim, drejtim deri në hollësitë apo drejtim kah synime të caktuara. Mjetet kryesore të shtetit për drejtim, udhëheqje, janë ligjet dhe organet shtetërore. Shteti ka të drejtë ekskluzive për nxjerrjen e ligjeve, gjë që është e lidhur me monopolin për të përdorë forcën. Përmes ligjeve kemi rrjedhimet kur disa veprime deklarohen si kriminale për të cilat ekzistojnë dënimet e caktuara; respektimi i ligjeve është obligim i nënshtetasve. Gjykimet e gjykatave për vepra penale dhe ekzekutimi i dënimeve për këtë arsye bëhen pjesë të veprimtarisë shtetërore.

Në të drejtën e nënshtetasve hyn e drejta për t'u shkolluar. Shkollimi shërben edhe si kanal përmes të cilit ligjet e shtetit dhe traditat u mësohen gjeneratave të reja të popullsisë, si dhe si një proces rekrutimi kur nënshtetasit zgjidhen e caktohen në fusha të ndryshme në shoqëri dhe shtet. Ajo mbrojtje sociale që shteti e garanton si këmbim për tatimet, më tej mund të përfshij përkujdesjen për të varfrit, përkujdesjen për pleqtë dhe përkujdesjen shëndetësore. Në përgjegjësinë e shtetit hyn edhe ruajtja e peizazhit (ang: *landscape*) social, siç janë rrugët e vendit, parqet, muzeumet, ligjet e komunikacionit, dhënies së përparësisë nacionalizmit të brendshëm duke përfshi këtu përkujdesjen për gjuhën dhe kulturën.

Të gjitha shtetet e botës janë punëdhënës përmes sektorit publik. Në vende me socializim të përhapur, sikurse në ish-Bashkimin Sovjetik, pjesa më e madhe e nënshtetasve e kanë pasur shtetin si punëdhënës. Rregullimi i raporteve të pronësisë, doganave dhe tregtisë së jashtme, pushtetit ekonomik, vlerës së parasë, kushteve të punës për të punësuarit dhe konkurencës në mes ndërmarrjeve janë detyra fundamentale të cilat shteti i ka.

6. Koncepti i shtetit në shkencë

Fundi i viteve 1900 karakterizohet nga globalizimi ekonomik botëror, nga qarkullimi i njerëzve dhe kapitalit, si dhe nga krijimi i shumë institucioneve ndërkombëtare. Të gjithë këta faktor kanë kontribuar në zvogëlimin e lirisë, apo në kufizimin e lirisë së manovrimit të shteteve. Por, edhe më tutje shteti është njësia elementare politike në botë, ashtu siç ka qenë që nga vitet 1500. Për këtë arsye shteti është koncepti primar në shkencat politike dhe studimi i politikës dhe definicionit të tij janë lëndë e nxehtë për debat. Sociologët politik si Karl Marksi dhe Max Weber, preferojnë si rregull, një definicion të gjerë me vëmendje të posaçme tek aspekti i përdorimit të dhunës dhe mjeteve të detyrimit. Ekonomistët e ekonomisë kombëtare si Milton Friedman, mendojnë se shteti në natyrën e tij është i keq (anglisht: *evil*) dhe ai duhet të mbahet sa

më i vogël që të jetë e mundur, dhe Ludwig von Mises, i cili mendon se pushteti i tij duhet të kufizohet vetëm tek mbrojtja e jetës së popullit dhe pasurisë. Personalitete tjera qendrore në shkencat politike janë John Locke, Thomas Hobbes, Jean-Jacques Rousseau dhe Robert Nozik.

Me rastin e studimeve shkencore mbi shtetin, si kontrast i tij (shtetit) merret shpesh shoqëria. Përmes principit të sovranitetit popullor, dallimi në mes këtyre dy koncepteve (shtet dhe shoqëri) është bërë më i papërcaktuar dhe që të dyjat bëhet secilën herë më vështirë që të definohen. Gjatë shekullit të fundit fenomenet siç janë privatizimi, nacionalizimi dhe mundësia për instanca të reja kontrolli, kanë bërë që kufijtë e shtetit të jenë të pakjart. Në këto rrethana Jürgen Habbermas ka kontribuar në shkencë duke e futur në përdorim shprehjen "sferë publike" (gjermanisht: *Öffentlichkeit*) për ta definuar shtetin, dhe këtë në kundërshtim me definicionet klasike të bëra nga Hobbes dhe G. W. F. Hegel të cilët e shohin shtetin në prizmin e sovranitetit të tij.

Një pjesë e marksistëve si Antonio Gramsci, e venë në pikëpyetje dallimin në mes shtetit dhe shoqërisë, përderisa të tjerë, si Louis Althuser, mendojnë se institucionet si shkolla, bashkimet profesionale dhe kisha janë një pjesë e aparatit ideologjik të shtetit.

Anarkistët dhe sindikalistët e hedhin krejtësisht poshtë shtetin, sepse atë e konsiderojnë si parakusht të shoqërisë me klasa, të dhunës dhe të shtypjes ekonomike. Ata mendojnë në krejt forma tjera organizative sociale, për shembull në këshilla direkte demokratike të punëtorëve, të federuar në nivel lokal, regjional dhe nacional.

Disa prej rrymimeve më të rëndësishme në teorinë moderne të shtetit janë marksizmi (p. sh. Ralph Miliband dhe Nicos Poulazantas), pluralizmi (Robert Dahl) dhe institucionalizmi (Theda Skocpol).

SHTUFI NIKOLLË, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Nikole Shtufi, Hercherstr. 1B Hanover (tel. 0511-323372). Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

SHUFLAJ MILAN (MILAN ŠUFFLAY), lindi në Lepoglavë më 9 nëntor 1879 - vdiq në Zagreb, 19 shkurt 1931). Ishte një historian kroat, shkrimtar dhe politikan nacionalist, i njohur si një nga themeluesit e albanologjisë, një nga viktimat më të famshme politike të dhunës gjatë *diktaturës së gjashtë janarit*. Me diktaturën e gjashtë janarit mendohet periudha nga 6 janari 1929 - 3 shtator 1931, periudhë në të cilën mbreti Aleksandër I Karagjorgjeviq e ka shpërnda parlamentin.

Në vitin 1929, Akademia Vjeneze e Shkencave i propozon dr. Shuflajt që të vazhdonte vjeljen e lëndës arkivore për vazhdimin e botimit të *"Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia"*, vëllimet III-V. Këtë iniciativë e përkrahu edhe qeveria e Mbretërisë Shqiptare, e cila shprehu gatishmërinë e saj që të hiqte shpenzimet për një ndërmarrje të tillë kaq serioze dhe të vlefshme. Dr. Milan Shuflaj ftohet të vizitojë Shqipërinë.

Pas shumë peripecish rreth pajisjes me pasaportë, ai arrin në Shqipëri më 12 janar të vitit 1931. Vritet më 18 shkurt të vitit 1931, një ditë pas kthimit nga Shqipëria, duke lënë pas shumë studime të papërfunduara në dorëshkrim, një pjesë e mirë e të cilave ruhet në Arkivin Shtetëror të Kroacisë në Zagreb. Për vrasjen e dr. Shuflajt kanë reaguar shumica e intelektualëve të kohës, në mesin e të cilëve edhe shkencëtari i njohur Ainshtain.

Vrasja e Jusuf Gërvallës në shtëpinë e tij në Untergruppenbach, edhe pse krahasimet janë të vështira, si goditje serbomadhe kundër individëve të caktuar, mund të krahasohet si një lloj sinteze me vrasjet kundër Shuflajt dhe Andrija Hebrangut.

SHYTI MUSTAFË, - Mustafë Shaqir Shyti (10.10.1945 – 22.9.1998)

Qemal Aliu: ”Në mesin e intelektualëve dhe veprimtarëve të mirënjohur, që u inkuadruan në radhët e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte edhe Mustafë Shyti, profesor, krijues dhe veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare.

Ai lindi më 10 tetor të vitit 1945 në fshatin Ashlan të Vushtrrisë në një familje me tradita atdhetarie. I ati Shaqiri dhe nëna Ajete me mund të pakursyer i rritën bijtë e bijat e tyre.

Mustafa shkollën fillore e mbaroi në vendlindjen e tij, në Ashlan, ndërsa shkollën normale e kreu në Mitrovicë. Në vitin shkollor 1965/66 fillon të punojë mësues, meqë asokohe ndihej mungesë e madhe e mësuesve shqiptarë nëpër shkollat tona.

Mustafë Shyti

I pajisur me ndjenja atdhetare dhe i etur për dije, Mustafë Shyti qysh heret fillon të shkruajë skica, poezi dhe rrëfime, të cilat kohë pas kohe i boton në shtypin ditor dhe në atë periodik, si Rilindja, Zëri i Rinisë etj Për shkak të një shkrimi satirizues, në të cilin kishte stigmatizuar imponimin e gjuhës serbe, nga policia politike e kohës, merret në hetime nga inspektorët e UDB-së. Krahas aktiviteteve shkrimore Mustafa kishte pasion këngën atdhetare dhe instrumentet muzikore me të cilat ekzekutonte nëpër koncerte dhe programe të ndryshme kulturore.

Në vitin 1967 për shkak të veprimtarisë së tij atdhetare ishte dënuar me burg. Në fillim të viteve shtatëdhjetë të shekullit XX, Krahas punës në arsim, Mustafa regjistrohet në Fakultetin Filozofik, të Universitetit të Prishtinës, Dega gjuhë dhe letërsi shqipe. Ishte

regjistruar me korrespondencë me qëllim që të mos ndahej nga puna, meqë me të ardhurat të cilat i realizonte me punën e tij në arsim ai mbante edhe famljen.

Krahas angazhimeve në punë dhe në studime, Mustafë Shyti kontakton edhe me veprimtarë të lëvizjes së rezistencës. Në vitin 1976, së bashku me veprimtarin Ismet Saraçi nga fshati Burim, (Bivolak) dhe me Xhafer Durmishin nga Stanoci i Ulët veprojnë në radhët e organizatës e cila quhej Lëvizja Naciolançlirimtare e Kosovës dhe e viseve Shqiptare në Jugosllavi. Në kuadër të kësaj organizate, Mustafa shkruan dhe shpërndan broshura e pamflete me përmbajtje revolucionare të rizgjimit kombëtar. Broshurat, me karakter militant çlirimtar i kishte shpërndarë në Vushtrri, në Mitrovicë dhe në Kastriot (Obiliq). Ishte i vetëdijshëm se veprimi ilegal kërkonte syçeltësi, vigjilencë e mbi të gjitha konspiracion të thellë. Falë gjeturisë së tij kishte vepruar shumë kohë ilegalisht. Edhe pse merret në hetime dhe maltretohet nga inspektorët e UDB·së, nuk zbulohet veprimtaria e tij atdhetare.

Në nëntor të vitit 1968, Mustafa ka marrë pjesë aktive në demonstratat e studentëve në Prishtinë. Ai përkrah kërkesat e studentëve për barazi dhe liri. Veprimtari të veçantë atdhetare, pedagogjike e edukative Mustafë Shyti ka zhvilluar sidomos me nxënësit, te të cilët kishte kalitur ndjenjat patriotike, përmes leximit të literaturës kombëtare, aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe tematike. Edhe në kryengritjen e rinisë militante të Marsit dhe të Prillit të vitit 1981, Mustafë Shyti merr pjesë aktive në mesin e demonstruesve.

Fillimi i luftës në Drenicë, lufta dhe heriozmi i legjendarit Adem Jashari dhe i luftëtarëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Mustafë Shytin e gjen të përgatitur shpirtërisht dhe fizikisht për t u radhitur në njësitet e luftëtarëve të lirisë. Fillimisht angazhohet në pikën ushtarake të UÇK-së në vendlindjen e tij në Ashlan. Në atë njësit vendor ishin edhe bashkëluftëtarët: Bekim Shyti, Vesel Shyti, Adnan Shyti e të tjerë.

Në kohën e ristrukturimit të UÇK-së, Mustafë Shyti sistemohet në Njësitin e Parë, të Batalionit të Dytë të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës, ku kryen detyra ushtarake me përgjegjësi. Me rastin e fillimit të ofensivës së forcave ushtarake dhe policore serbe në shtator të vitit 1998, Mustafa ishte në vijën e parë të frontit, në pozicionet e para në Ashlan. Së bashku me dalëzotësit e tjerë të atdheut, ai rezistoi në mbrojtje të pozicioneve dhe të popullatës civile e cila ndodhej nën rrethim nga forcat serbe. Duke përshkruar luftimet fyt për fyt dhe heroizmin e luftëtarëve të lirisë, bashkëluftëtari i Mustafës, Vesel Shyti thotë:

Atë ditë, më 22 shtator në vendin e quajtur Kodra e Vogël, takova Mustafën. Ai mbante automatikun e tij dhe dy bomba. Ishim të rrethuar nga të katër anët. Meqë pozicioni ynë ishte vënë në shënjestër të armës armike, u detyruam të tërhiqemi te vendi i quajtur Guri i Nezirit. Mustafa godet me mitraloz forcat armike në distancë prej 200 metrash. Gjitnjë në sulm të furishëm dhe në tërheqje taktike arrijmë deri te vendi që quhet Uji i Sokolave, ku ishte pozicionuar një masë e madhe e të zhvendosurve. Lufta zhvillohej fyt për fyt, meqë forcat policore serbe bënin përpjekje për të depërtuar te popullata civile. Mustafa plagoset por nuk e lëshon pozicionin. Me bomba dore arrin të shpartallojë disa policë, të cilët tërhiqen me humbje nga fushëbeteja. Edhe nga ana jonë pati të rënë. Mustafa ishte plagosur rëndë dhe nuk kishim arritur ta tërheqim. Tërë natën i plagosur kishte qëndruar në fushëbetejë në shi dhe lagështirë të tokës. Në mëngjesin e hershëm të 23 shtatorit e gjeta të plagosur dhe të molisur. Ia laga faqet me ujë, ndërsa ai më pyeti:-Vesel a ka shpëtuar shkolla? I tregova se shkolla nuk ishte dëmtuar shumë, ndërsa ai po mundohej të mos jepej.

Për shkak se luftëtarët e lirisë ndodheshin në rrethim të hekurt nga forcat serbe, Mustafë Shytit iu bë e pamundur çdo ndihmë mjekësore. Bashkëluftëtarët trupin e tij të molisur nga plagët e vendosin në bodrumin e një shtëpie, duke u përkujdesur për të dhe për të

plagosurit e tjerë. Derisa Ashlani i tij i dashur po digjej flakë nga zjarri i barbarisë serbe, Mustafë Shyti thith sasinë e fundit të ajrit të vendlindjes të përzier me tym e barut.

Më 26 shtator të vitit 1998, bashkëluftëtarët e tij trupin e dëshmorit Mustafë Shyti dhe të 16 dëshmorëve dhe martirëve të tjerë të Ashlanit me nderime ushtarake, nën predhat dhe detonimet e
fuqishme të armikut, i varrosin në varrezat e fshatit Ashlan. Në dyvjetorin e rënies së tij heroike, më 26 shtator të vitit 2000, trupin e dëshmorit bashkëluftëtarët dhe pjesëtarët e familjes së tij e rivarrosin në Varrezat e Dëshmorëve në vendlindjen e tij, në Ashlan. Nga kjo familje përveç Mustafës, nga arma serbe është martirizuar edhe Bahtir Shyti, ndërsa janë plagosur edhe shumë të tjerë, ndër ta edhe djali i dëshmorit Berat Shyti. Mustafa ka lënë pas bashkëshorten, Elhemen, bijtë: Beratin dhe Kushtrimin si dhe bijat: Vjollcën, Meritën, Jehonën dhe Sarandën. Në vitin 2001 janë botuar dy vepra poetike të dëshmorit: Pranverë gjaku dhe Dallgë jete. Pas çlirimit të Kosovës për jetën dhe veprën e dëshmorit janë botuar shkrime në shtypin tonë ditor dhe në atë periodik. (radiokosovaelire.com, 22 shtator 2016 dhe albaniapress.com, 22 shtator 2019)

***

Sabile Basha: Mustafë Sh. Shyti – Dritë e pashuar në altarin e lirisë

E marte, 11.03.2025, 08:36 PM, zemrashqiptare.net

MUSTAFË SH. SHYTI – DRITË E PASHUAR NË ALTARIN E LIRISË
(Bedri Tahiri, FLAKADANI I LIRISË: Monografi për mësuesin, poetin dhe dëshmorin Mustafë Shyti, Armagedoni, Prishtinë, 2025)
Nga **Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha**

Jehonën, mikeshën time të çmuar, e mbart në zemër me një afeksion të veçantë – një afeksion që buron jo vetëm nga miqësia, por nga ajo lidhje e padukshme që ngjizet mes shpirtrave që e kuptojnë njëri-tjetrin edhe përtej fjalëve. Kur mora ftesën për të marrë

pjesë në promovimin e librit për babin e saj, Mustafë Shytin, ndjeva një ngacmim të thellë në brendinë time, si një dorë e heshtur që tërheq telat më të hollë të shpirtit. Një dhembje e pazëshme u ngjit përmes gjoksit, si një melodi e trishtë që s'kishte nevojë për fjalë, por vetëm për ndjesi.
I çuditshëm është ky univers i emocioneve – ndonjëherë kam përshtypjen se askush tjetër s'mund ta kuptojë më mirë se unë dhembjen për një prind të humbur. Është një lloj dhimbjeje që nuk e mëson dot nga jashtë, por që e rrit brenda vetes si një pemë e heshtur, me rrënjë në kujtime dhe degë në mall. Ndoshta sepse rrëfimet tona personale, udhëtimet tona shpirtërore, kanë një ngjashmëri të çuditshme – një paralelizëm të heshtur në historitë e baballarëve tanë. Si të ishin shkruar me të njëjtën dorë, nga e njëjta kohë, nga i njëjti mallëngjim.
Dhe në atë çast, nuk isha thjesht një mike që pranon një ftesë. Isha një zemër që rreh për një tjetër zemër, një kujtim që i përkulet një kujtimi tjetër, një dhimbje që ndriçon në pasqyrën e një dhimbjeje të afërt. Në heshtjen e asaj ftese, dëgjova jehonën e baballarëve tanë që flasin përmes librave, përmes nesh – të gjallë në dashurinë tonë, të pavdekshëm në kujtimin tonë.
Dhe ja, sot u nisa drejt promovimit… një udhëtim që nuk ishte thjesht fizik, por edhe një udhëtim i brendshëm, i heshtur, drejt një emocioni të thellë e të papërcaktuar. Hapat e mi, megjithëse të vendosur, bartnin brenda vetes një drojë të pazakonshme — një ndjesi që nuk buronte nga ceremonia në vetvete, por nga takimi me vetë Jehonën. Nuk është gjithmonë e lehtë të përballesh me një shpirt që pasqyron dhimbjen tënde, që risjell kujtime që i ke strehuar thellë, me një përkujdesje të heshtur për t'i mos trazuar.
Nganjëherë, lotët kanë një jetë të vetën — dalin pa trokitur, pa paralajmërim, siç vjen një stuhi në mes të një dite të qetë. Ata lindin nga thellësia e një ndjenje që fjalët nuk mund ta përkufizojnë, nga ajo plagë e heshtur që e mbajmë me dinjitet, por që gjithsesi pulson në çdo kujtim, në çdo përqafim, në çdo fjali që përmend fjalën "baba".
Por këtë herë, mblodha veten si një degë që nuk dorëzohet përballë erës. E përmbajta shpërthimin e shpirtit dhe e mbështolla me një buzëqeshje të ngrohtë. E përgëzova Jehonën me gjithë zemër, jo vetëm për librin për babin e saj, por për përkushtimin që kishte derdhur në çdo detaj, për organizimin që reflektonte një dashuri të thellë për figurën e të atit, për një ndjeshmëri që vetëm një zemër bije mund ta thurë me aq mjeshtëri.
Ishte një promovim i ndjeshëm, i bukur në thelbin e tij, por edhe një pasqyrë e ndjenjave që na lidhin si njerëz — dhimbja, dashuria, kujtimi… dhe mbi të gjitha, guximi për t'i kthyer ato në fjalë që prekin zemrat e të tjerëve.
Procesi i promovimit nuk ishte thjesht një ngjarje formale, një ceremoni e njohur që ndjek një rrjedhë të zakonshme të fjalimeve e përshëndetjeve, por u shndërrua në një çast që i ngjante më shumë një riti shpirtëror, një përulje ndaj fjalës së shkruar dhe ndaj kujtesës që ajo mban brenda vetes. Aty, fjalët nuk ishin thjesht tinguj që shpërndaheshin në sallë — ato u bënë zë i një ndjenje të thellë, jehonë e një të kaluare që kërkon të mos mbetet në harresë.
Në këtë peizazh të ngrohtë fjalësh dhe ndjesish, doli me një qetësi dinjitoze botuesi Berat Dakaj — jo si orator i zhurmshëm, por si një mjeshtër i heshtur që di t'i japë librit peshën që meriton, pa e rënduar me fjalë të tepërta. Me një finesë që vetëm dashuria për librin dhe për historinë mund ta mëkojë, ai i dha promovimit një ndjesi solemne, thuajse prekëse, si një dorë që prek faqet e një kujtese të gjatë, të dhimbshme e të bukur njëkohësisht.
Nuk foli shumë, por çdo fjalë e tij ra si një gur i rëndë në ujërat e mendimit të dëgjuesve. Në ato pak fjalë, ai vuri në qendër figurën e Mustafë Shytit — një emër që ende nuk është njohur siç duhet, një atdhetar që historia nuk do e lë në hije, por që libri kërkon ta sjellë më në dritë, e ta vendosë në piedestalin që meriton.

Ishte një ftesë për reflektim, një thirrje e heshtur për të ndalur dhe për të pyetur veten: si është e mundur që një njeri me kaq vlerë, me aq dashuri për atdheun, të mos jetë njohur siç duhet nga brezat që erdhën pas tij? Dhe pikërisht aty, në atë ndalesë të shkurtër por të thellë, promovimi fitoi kuptim — si një akt drejtësie për një shpirt të madh dhe si një dëshmi se libri ende ka fuqinë të zbulojë të pathënat dhe të rikthejë njohjen më të mirë të atdhetarit.

Pastaj, siç e kërkon rendi dhe tradita e një përurimi ku libri bëhet qendër graviteti e mendjes dhe ndjesisë, fjala iu dha recensentit të librit — studiuesit të historisë, Miftar Kurtit. Me një qetësi të pjekur dhe me autoritetin që buron jo vetëm nga dija, por edhe nga përkushtimi i tij shumëvjeçar ndaj të vërtetës historike, ai mori fjalën jo si një analist teknik, por si një dëshmitar i jetës, një rrëfimtar që i jep zë kujtimeve dhe pasazheve të heshtura të kohës.

Në fjalën e tij, nuk kishte vetëm analizë — kishte mall dhe nderim, kishte ndjesi të rrënjosura thellë, që ngjallnin respekt për figurën që libri e sjell në dritë. Ai nuk foli thjesht për faqe, kapituj e struktura — por për jetën që pulson brenda rreshtave, për biografinë që nuk është vetëm një renditje faktesh, por një udhëtim shpirtëror përmes dekadash të pluhurosura nga harresa.

Duke ndarë edhe takimet e tij personale me patriotin Mustafë Shyti, ai nuk rrëfente vetëm çaste — ai ringjallte prani, sillte pranë të pranishmëve një njeri që kishte ndikuar me fjalën, qëndrimin dhe qëndresën e tij. Aty ku fjalët e zakonshme do të mund të zbeheshin, zëri i Miftar Kurtit bëhej si një urë ndërmjet lexuesit dhe jetës së patriotit — një urë që kalon përmes kujtimit dhe e shpie dëgjuesin drejt një njohjeje më të thellë, më intime dhe më njerëzore me figurën që libri dëshiron ta ringjallë në ndërgjegjen kolektive.

Fjalimi i tij qe si një mozaik i ndërtuar me kujtime dhe studim, me ndjenja dhe fakte, ku çdo gur zinte vendin e vet për të formuar një portret të ndritshëm të një burri që kishte jetuar me dinjitet e kishte frymëzuar me atdhedashuri. Dhe kështu, lexuesi nuk njihej vetëm me një libër — por me një shpirt, me një kohë, me një vlerë që nuk duhet të harrohet.

Dhe në mbyllje të kësaj ngjarjeje të mbushur me fjalë e ndjenja, siç i ka hije çdo përurimi ku fjala bëhet homazh për jetën dhe kujtesën, vjen çasti që mban brenda vetes peshën më të thellë — fjala e vetë autorit. Sepse, në fund të fundit, gjithçka nisi nga pena e tij, nga përkushtimi i tij për ta nxjerrë në dritë figurën e ndritur të një mësuesi, poeti dhe dëshmori. Libri i sapobotuar, me titullin simbolik dhe përflakës "FLAKADANI I LIRISË – Monografi për mësuesin, poetin dhe dëshmorin Mustafë Shytin", botuar nga shtëpia botuese ARMAGEDONI, më 2025, është një dëshmi jo vetëm për një jetë të jetuar me ndjenjën e lirisë, por edhe për një rrugëtim të gjatë të autorit nëpër gjurmët e kësaj jete.

Dhe fjala e tij qe një mrekulli e qetë, një rrjedhë fjalësh që nuk ngriti zë, por preku zemra. Ai foli me një qetësi që buron nga thellësia e përjetimit, me një gjuhë të pastër dhe të ngrohtë, që sikur dilte drejtpërdrejt nga zemra dhe ngjitej në zemrat e dëgjuesve. Ishte një udhëtim rrëfimtar përmes shtigjeve të kërkimit, një rrëfim mbi netët e gjata të leximit, mbi hulumtimet nëpër arkiva, mbi takimet me njerëz që ruanin copëza kujtese, mbi përpjekjet për të lidhur fijet e së kaluarës me penën e së tashmes.

Në atë rrëfim të qetë por të thellë, u ndien peripecitë që kishte kaluar autori, pengesat që i kishin dalë përpara, dilemat që i kishte bartur në shpirt, dhe sfidat që i kishte kapërcyer me një këmbëngulje që vetëm dashuria për të vërtetën mund ta ushqejë. Por ai nuk u ndal në vështirësitë — përkundrazi, si një njeri që e njeh vlerën e përbashkësisë dhe të mirënjohjes, ai mbylli fjalën e tij me falënderime të sinqerta për të gjithë ata që në një mënyrë apo tjetër i kishin qëndruar pranë, që kishin kontribuar me dije, me fjalë, me zemër, në rrugën e gjatë të shkrimit të kësaj monografie.

Ishte një fund, por edhe një fillim — sepse libri tashmë ishte lëshuar në udhëtimin e tij, për të ndriçuar mendjet, për të trazuar ndërgjegjen, për të sjellë pranë brezave të sotëm një figurë që digjet në faqet e historisë si një flakadani i lirisë, që nuk shuhet kurrë.
Por ndër të gjitha fjalët që u thanë atë ditë, ndër të gjitha zërat që rridhnin mes solemnitetit dhe ndjenjës, pati një moment që preku një thellësi tjetër, një vibrim të veçantë që ndoshta më shumë se çdo gjë tjetër e bëri të dridhej shpirti i pranishëm. Ishte fjala e vëllait të dëshmorit — një zë që nuk vinte vetëm si pjesë e ceremonisë, por si jehonë e gjakut, si dhimbje që flet, si kujtim që s'mund të shuhet.
Ai foli në emër të familjes, por fjalët e tij tejkaluan kufijtë e përfaqësimit familjar — ato u bënë fjalë të zemrës njerëzore, të nderit dhe të krenarisë. Nuk foli gjatë, por secila fjali e tij ishte e mprehtë si thika që hap plagët e kujtesës, dhe e ngrohtë si një dorë që ledhaton shpirtrat e ndjeshëm. Ishin fjalë që lëviznin si valë në heshtjen e sallës, që nuk kishin nevojë për dekorime retorike, sepse kishin peshën e së vërtetës dhe mallin e mungesës.
Në ato pak çaste, ai falënderoi me një ndjeshmëri të thellë të gjithë të pranishmit — jo thjesht për praninë fizike, por për vëmendjen shpirtërore, për respektin ndaj kujtimit të një biri të rënë për lirinë. Ishte një falënderim që ngjante më shumë me një përqafim të heshtur — një shenjë mirënjohjeje që lindte nga plagë të paqepura, por që prapë gjente forcë të nderojë.
Dhe ndërsa ai zbriste nga foltorja, në ajër mbetën ende drithërimat e asaj fjale — të thjeshtë, por të paharrueshme — që dëshmoi se përtej fjalës së shkruar, përtej analizës dhe studimit, ekziston edhe fjala që lind nga zemra dhe mbetet në zemër.
Ndërsa folësit ndërroheshin njëri pas tjetrit në foltore, secili duke shtuar një fije tjetër në këtë thurje të kujtesës dhe nderimit, sytë e mi, pa dashur, rrëshqisnin herë pas here nga podiumi drejt një figure që qëndronte hijerëndë në një cep të sallës — mikesha ime, Jehona, bija e dëshmorit. Nuk kishte nevojë të fliste. Qëndrimi i saj, qëndresa e saj e qetë dhe burrërore, ishte vetë një fjalim i heshtur që depërtonte thellë në mendjen dhe zemrën time.
E pashë ashtu, më këmbë, pa lëkundje, me sytë e saj të ngulur në çdo fjalë që shqiptohej në nderim të të atit — një qëndrim që nuk kërkonte vëmendje, por që rrezatonte një dinjitet të rrallë. Ajo nuk ishte thjesht një dëgjuese. Ajo ishte pjesë e secilës fjalë, e secilës ndjenjë, e secilës pëshpëritje që ngrihej mbi këtë atmosferë përkujtimore. Ajo e mishëronte atë për të cilin po flitej — një vazhdimësi gjaku, kujtese, krenarie.
Mendja më ndaloi për një çast në atë figurë të heshtur, dhe vetvetiu pyesja veten: si po i përjeton ajo gjithë këto fjalë miradije? Si ndihen në shpirtin e saj këto fjali që përmbajnë vlerësim, mall, nderim për babanë e saj — atë që ajo nuk mundi ta njohë gjatë, por që jeton përmes fjalëve të të tjerëve, përmes kujtimeve të atyre që patën fatin ta njohin dhe ta ndjejnë madhështinë e tij?
Jehona, fisnikja ime e heshtur, nuk u ligështua nga emocioni, por u bë gur i qëndrueshëm në atë mozaik nderimi. Qëndresa e saj ishte homazh më i fuqishëm se çdo fjalë — një prani që mbushte hapësirën me dinjitet të trashëguar, me krenari që nuk ka nevojë të shpallet me zë të lartë, por që lexohet në qetësinë e syve dhe në mënyrën si qëndron përballë kujtimit të një figure që ka lënë gjurmë në historinë e një populli.
Në ato çaste, ndërsa e shikoja nga larg, ndihesha sikur isha në lëkurën e saj. E ndjeja peshën e emocioneve që ajo mbante brenda vetes, atë përzierje të brishtë mes dhimbjes dhe krenarisë, mes mungesës që djeg e nderimit që ngroh shpirtin. Nuk ishte e lehtë të qëndroje ashtu, e palëkundur, përballë kujtimit të një babai që tashmë është bërë simbol, figurë kombëtare, por mbi të gjitha, mbetet plagë intime e zemrës.
E megjithatë, Jehona, si gjithmonë, qëndronte me një qetësi që nuk buron nga mungesa e ndjeshmërisë, por nga forca e brendshme që vetëm shpirtrat fisnikë e njohin. Ishte burrërore në qëndrimin e saj, krenare në heshtjen e saj, dhe dinjitoze në secilën lëvizje.

Ajo nuk kishte nevojë për fjalë të mëdha — vetë prania e saj ishte një fjalim i pathënë, një dëshmi se trashëgimia e gjakut të pastër mund të jetojë jo vetëm në libra, por në qëndrime, në shikime, në përballje të heshtura me dhimbjen.
Ajo ishte, pa dyshim, përfaqësimi më i bukur dhe më i fuqishëm i gruas shqiptare — jo thjesht si trashëgimtare e një historie të përgjakur, por si bartëse e dinjitetit dhe krenarisë që rrjedh përmes brezave. Në të shihje qëndresën e nënave tona, urtësinë e motrave tona, dhe krenarinë e grave që kanë qenë gjithmonë shtylla të heshtura të kombit, por që në çaste të tilla shkëlqejnë me gjithë madhështinë e tyre.
Të lumtë, Jehona! Mikja ime e devotshme, je një emblemë e nderit, një dritë që nuk shpërthen me zhurmë, por që ndriçon rrugët e kujtesës me një butësi të thellë e fisnike. Në ty flet historia, në ty pulson shpirti i një atdheu që nuk e harron asnjëherë të bijtë e vet — dhe që përmes bijave të tilla, vazhdon të ngrihet me dinjitet dhe krenari.
Krejt në fund, si një gjest i bukur përmbyllës, të gjithë të pranishmëve iu dhurua nga një libër — një dhuratë që nuk ishte thjesht send, por një copë kujtese, një gur në themelet e ndërgjegjes sonë kolektive. Ishte një simbolikë fisnike, një akt që mbante brenda vetes një domethënie të thellë: libri nuk është vetëm për të lexuar, por për të kujtuar, për të zgjuar ndërgjegjen, për të lidhur brezat përmes fjalës së shkruar me të kaluarën që s'duhet të harrohet kurrë.
Dhurimi i librit, sidomos kur ai është një homazh për heronjtë tanë, është një thirrje e heshtur që të mos lejojmë që kujtimet të pluhurosen në harresë. Është një ftesë që çdo faqe e lexuar të bëhet dritë për mendjet e reja, një rrugë për të kuptuar se kjo liri që sot e jetojmë, nuk erdhi si një dhuratë e rastit, por si fryt i një sakrifice të shenjtë, si lulëzim mbi gjakun e derdhur të dëshmorëve tanë.
Këto libra janë më shumë se rrëfime — janë gurë kujtese në altarin e lirisë. Dhe është detyrë e brezave që vijnë t'i lexojnë, t'i ndjejnë, t'i bartin me vete si një testament të gjallë. Sepse vetëm atëherë kur brezat e rinj e kuptojnë se asgjë nuk është falur lehtë, por është fituar me dhimbje dhe me gjak, liria merr kuptim të plotë. Ajo nuk është një privilegj i vetëkuptueshëm, por një borxh që duhet ruajtur me vetëdije dhe respekt.
Prandaj, ai akt i thjeshtë i dhurimit të një libri, në të vërtetë ishte një rit i heshtur i kujtesës, një dëshmi se fjala e shkruar mund të bëhet urë mes kohërash, dhe se përmes saj, emrat e dëshmorëve nuk do të zbehen kurrë. Ata do të jetojnë në faqet e librave, në mendjet që lexojnë dhe në zemrat që e kuptojnë vërtet çfarë do të thotë liri.
Sapo u ktheva në shtëpi, me një mall të pashpjegueshëm në duar mbaja librin që ende mbante aromën e përurimit, si një gjethe që sapo është këputur nga pema e kujtesës. Nuk prita as të ndërroja rrobat e ditës, as të shpërqendrohesha me zhurmat e zakonshme të përditshmërisë — ishte një thirrje e brendshme, një etje që më shtynte të nis leximin menjëherë, siç niset dikush drejt një burimi uji pas një rrugëtimi të gjatë nëpër etje shpirtërore.
Faqet e para rrëshqitën shpejt në duart e mia, dhe më pas çdo rresht, çdo fjali, më thithte si një magnet i padukshëm. Ishte një lexime që ndodhte "me një frymë" — jo sepse ishte i lehtë, por sepse ishte i thellë, rrjedhshëm i ndërtuar dhe plot jetë në çdo fjalë. Çdo paragraf më dukej si një gur i çmuar në një mozaik të skalitur me përkujdesje dhe pasion. Dhe në thellësi të këtij përjetimi, më shoqëronte bindja se kjo magji e rrëfimit nuk ishte rastësi.
I njihja veprat e autorit që e kishte shkruar — dora e Bedri Tahirit, një autor që nuk shkruan vetëm me mendje, por me shpirt, që nuk ndërton fjali, por rrëfen me gjak të zemrës. E dija që ai nuk mund të sillte asgjë më pak se përsosmëri, sepse ai ka bërë nga fjala një altar të përkushtimit, nga rrëfimi një akt dashurie ndaj historisë, ndaj kujtimit, ndaj atyre figurave që nuk duhen harruar.

Prandaj nuk u befasova nga thellësia, nga qartësia, nga bukuria që dilte nga çdo faqe. Leximi nuk ishte thjesht një proces — ishte një përjetim, një udhëtim shpirtëror përmes gjurmëve të së kaluarës, të sjella me mjeshtri nga një autor që di të ndriçojë kujtesën me dritën e fjalës së vërtetë.

Në dorën e mjeshtrit të fjalës, Bedri Tahirit, ky libër nuk është thjesht një vepër e radhës — është një akt përkushtimi, një vepër e shpirtit e derdhur me kujdes nëpër faqet që bartin peshën e një emri të madh: atdhetarit Mustaf Sh. Shyti. Ishte një punë e madhe, një mundim i vyer që nuk i shërben vetëm kujtimit të një njeriu të shquar, por bëhet pasuri për të gjithë kombin — një dhuratë për ndërgjegjen kombëtare, një dritë e re që ndriçon rrugët e kujtesës sonë kolektive.

Me një strukturë të menduar me maturi, autori nuk mjaftohet vetëm me një rrëfimi të zakonshëm. Përveç Hyrjes, ai e ka konceptuar librin në gjashtë pjesë, secila me peshën e saj, me thellësinë e vet, me kujdesin që vetëm një penë e përkushtuar mund ta bartë. Ky organizim nuk është vetëm rend formal — është një ndarje e menduar që ndihmon lexuesin të udhëtojë nëpër shtigjet e jetës së një figure që nuk i përket vetëm së kaluarës, por vazhdon të jetojë në vetë qenien tonë si populli.

E drejtë të thuhet: nuk është e lehtë të shkruash për një personalitet si Mustafë Shyti. Është thuajse e pamundur të mbërthesh në fjalë madhështinë e një njeriu që e deshi lirinë më shumë se jetën, që flijoi gjithçka për idealin më të shenjtë — lirinë e Kosovës. Çfarëdo të thuash, sado të përpiqesh, sado të kërkosh fjalën më të bukur, mendimin më të ndjerë, ndjesinë më të thellë — gjithmonë do të duket se ke thënë pak, se gjithmonë ka edhe diçka më shumë që ende rri e pathënë, që endet në horizontin e mendimit si një ndjenjë që nuk arrin të marrë formë të plotë.

Sepse ka figura që i tejkalojnë fjalët, ka emra që janë më të mëdhenj se çdo fjali, ka jetë që nuk mund të përmblidhen as në një libër, as në një monografi, por vetëm në përuljen dhe mirënjohjen që brezat duhet ta ndjejnë përjetë.

Dhe pikërisht aty qëndron madhështia e veprës së Bedri Tahirit — jo vetëm në fjalët që ka shkruar, por në përpjekjen për të kapur peshën e një figure që do të mbetet përherë flakadan në altarin e lirisë sonë.

Rrjedha e librit nis me një kapitull që ngërthen në vetvete jo vetëm një rrëfim biografik, por një udhëtim të thellë përmes kohës, tokës dhe shpirtit të një njeriu që nuk ishte thjesht individ, por simbol i një ideali. “Jeta dhe vepra e Mustafë Sh. Shytit” është jo vetëm një titull hyrës, por një derë që hapet drejt një rruge të gjatë, të mbarsur me sakrificë, përkushtim dhe dashuri të pafund ndaj atdheut.

Ky udhëtim fillon aty ku çdo rrënjë gjen tokën e vet — në fshatin Ashlan, vendlindja e tij, një copëz dheu që nuk është thjesht një emër gjeografik, por një vatër që ka ushqyer me frymë shqiptare shumë breza. Ashlani nuk paraqitet vetëm si pikënisje fizike, por si djep shpirtëror, si vendi ku ndërthuren natyra dhe historia, ku gjaku i tokës rreh në damarët e identitetit.

Nga kjo vatër e vogël, por me shpirt të madh, rrëfimi shtrihet tutje — duke ndjekur trungun e lashtë atdhetar, rrënjët e një familjeje që brez pas brezi ka ushqyer idealin e

lirisë, që ka mbajtur gjallë flakën e qëndresës dhe amanetin e shqiptarisë. Në këtë kapitull të parë, lexuesi nuk përballet vetëm me datat e jetës, por me gjurmët e një trashëgimie të thellë që Mustafë Shyti e mori si barrë dhe e shndërroi në mision.
Jeta e tij nuk paraqitet vetëm si një vazhdë ngjarjesh, por si një poemë e heshtur sakrifice, si një fije drite që përshkon errësirat e kohëve të vështira. Dhe libri, që nga kjo pikënisje, nis të ndërtojë një mozaik të madh ku çdo gur, çdo kujtim, çdo rrëfim, është një pjesëz e portretit të një njeriu që jetoi jo për vete, por për të tjerët, për popullin, për atdheun.
Ky fillim nuk është vetëm hyrje në jetë, por hyrje në thelbin e qëndresës sonë kombëtare — një ftesë për ta njohur më thellë një njeri që rrjedh nga rrënjët e një trungu të fortë, dhe që vetë u bë degë e krenarisë shqiptare.
Një tjetër gur i rëndësishëm në mozaikun e këtij kapitulli është titulli që ngërthen në vetvete dramën, qëndresën dhe guximin e një kohe të përflakur — "Në luftë me çetnikët". Kjo pjesë nuk është vetëm një rrëfim historik, por një pasqyrë e qartë e një realiteti të ashpër, ku jeta nuk kishte më përditshmëri të qetë, por vetëm sfida, përplasje dhe përballje me të keqen.
Aty nuk flitet thjesht për armë dhe beteja. Flitet për qëndresën e shpirtit, për trimërinë që lind në kushte ekstreme, për burrërinë që nuk matet me forcën e krahut, por me peshën e idealit që mban në zemër. Lufta me çetnikët nuk ishte vetëm një ballafaqim i drejtpërdrejtë fizik, por një përleshje e përditshme midis dritës dhe errësirës, midis një populli që donte të jetonte i lirë dhe dhunës që kërkonte ta nënshtrojë.
Mustafë Sh. Shyti nuk ishte thjesht një pjesëmarrës në këtë luftë — ai ishte pishtari që ndriçonte rrugën e rezistencës, një zë që nuk heshti as kur armiku rrethonte çdo shpresë, një figurë që me trimërinë e tij mishëroi guximin e një populli që refuzonte të nënshtrohej. Kjo pjesë e librit e vesh rrëfimin me një dramë të fuqishme, por edhe me një ndjenjë të thellë nderimi për të gjithë ata që u ngritën, luftuan dhe ranë — jo për lavdi personale, por për të mbrojtur nderin, tokën, identitetin. Dhe mbi të gjitha, për të mbrojtur të ardhmen e një populli që duhej të jetonte me kokën lart.
Lexuesi ndalet këtu jo vetëm për të kuptuar ngjarjet, por për të ndjerë pulsin e asaj kohe, për të dëgjuar britmën e maleve, për të përfytyruar betejat që nuk janë thjesht në faqe libri, por që jetojnë ende në gjakun dhe kujtesën e brezave.
Ky kapitull është një kujtesë e fortë se liria nuk është trashëguar lehtë, se ajo është larë me gjak, me mundim, me plagë që ende nuk janë shëruar. Dhe përmes këtij rrëfimi, autori Bedri Tahiri nuk sjell vetëm historinë e një njeriu — ai risjell në jetë historinë e një qëndrese kolektive, e cila meriton të kujtohet me përulje dhe respekt të përhershëm.
Pas rrëfimeve të përflakura të luftës, pas jehonës së përplasjeve dhe peshës së sakrificës, libri kalon butësisht në një kapitull që mbart një ndjeshmëri të thellë dhe një simbolikë të veçantë — "Djaloshi që trashëgoi emrin e gjyshit". Është një ndalesë e ëmbël, por njëkohësisht e thellë, në këtë udhëtim të rrëfyer me ndjenjë, ku historia ngjizet me jetën, dhe trashëgimia nuk është vetëm gjak, por edhe emër, kujtim, vazhdimësi.
Ky djalosh i ri, që mban emrin e të parit, nuk është thjesht një përkthim i një brezi në tjetrin — ai është urë ndërmjet kohërave, mishërim i një trashëgimie që nuk shuhet, por përsëritet, lulëzon, rritet dhe merr frymë në forma të reja. Emri i gjyshit nuk është vetëm tingull, nuk është vetëm një thirrje në regjistër — ai është një thirrje e shpirtit, një amanet i heshtur që kërkon të mbahet gjallë në jetë dhe vepër.
Në këtë pjesë të rrëfimit, lexuesi ndalet për të reflektuar mbi kuptimin e thellë të trashëgimisë — jo si një detyrim, por si një dhuratë. Të trashëgosh emrin e një njeriu që ka jetuar me nder, që ka sakrifikuar për lirinë, është më shumë se një privilegj: është një përgjegjësi fisnike, një ftesë për të ecur me dinjitet në hapat e atij që të ka paraprirë.
Autori sjell me delikatesë këtë lidhje mes brezave — një lidhje që nuk matet me vite, por me vlera. Dhe në këtë djalosh, ai sheh vazhdimin e një zjarri që nuk shuhet, por që bartet

nga një dorë në tjetrën, nga një zemër në tjetrën, duke e mbajtur gjallë atë flakadanë qëndrese që ka ndriçuar historinë tonë.

Është një përkujtim i butë, por i fuqishëm: se atdhetarët nuk jetojnë vetëm në përmendore, por në emrat që ringjallen, në shikimet që ngjajnë me të parët, në hapat që vazhdojnë rrugën e nisur. Dhe ky djalosh, që mban emrin e gjyshit, është dëshmi e gjallë se liria nuk mbaron me një brez — ajo vazhdon të mbillet në gjirin e të rinjve që e trashëgojnë, e ruajnë dhe e nderojnë me krenari.

Në mozaikun e jetës së Mustafë Sh. Shytit, një nga pjesët më të ndritshme, më të guximshme dhe më përfaqësuese të shpirtit të tij kryengritës është ajo që autori e ka titulluar me shumë ndjeshmëri e simbolikë: "Normalisti kryengritës". Kjo nuk është vetëm një metaforë — është një përkufizim që ngërthen në vete kontrastin e bukur dhe të fuqishëm mes dijes dhe rezistencës, mes bankës së shkollës dhe barrikadave të mendimit të lirë, mes mësuesit dhe luftëtarit të fjalës.

Në këtë pjesë, autori na zbërthen me ndjeshmëri dhe saktësi një faqe të veçantë të jetës së Mustafës — kohën kur ai, ende në moshën e formimit, në gjurmët e dijes dhe në rrugët e ndërgjegjësimit, bëhet pjesë e ilegalitetit atdhetar, duke u rreshtuar në radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të Viseve Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVShJ). Ai nuk ishte thjesht një emër në një listë aktivistësh — ai ishte një zë që ngjitej përmes errësirës, një shpirt që nuk pranoi të heshtte përballë padrejtësisë, një dritë që lëvizte nën hije, por me besim të plotë në dritën e lirisë që do të vinte.

I përkushtuar dhe me bindje të thella, Mustafë Shyti angazhohej në treshen ilegale së bashku me Ismet Saraçin dhe Xhafer Durmishin — një treshe që nuk bashkonte vetëm emra, por zemra që rrihnin për të njëjtin ideal, për të njëjtën ëndërr të madhe: çlirimin e shqiptarëve nga zgjedha jugosllave. Ata ishin ushtarë të heshtur të fjalës dhe veprimit, të shpërndarjes së vetëdijes dhe të kultivimit të rezistencës në rrënjë të popullit.

Por ajo që e bënte Mustafën të veçantë, ajo që e ngrinte përtej strukturave organizative, ishte mënyra e tij e veprimit — dialogu i qetë, biseda e mençur, komunikimi i ngrohtë me nxënësit e tij. Ai nuk shpërndante vetëm trakte, ai shpërndante mendim të lirë, vetëdije kombëtare, frymë që ngjallte pyetje dhe zgjonte ndërgjegje. Me fjalë të buta dhe zemër të zjarrtë, ai mbillte në shpirtin e të rinjve farën e atij mendimi të rrezikshëm për regjimin, por të shenjtë për popullin — se shqiptari duhet të jetojë i lirë në tokën e vet.

Në këtë pjesë, lexuesi sheh jo vetëm një veprimtar të guximshëm, por një mësues që bënte mësim edhe në errësirë, një njeri që e përdorte fjalën si armë të vetme për të përballuar

një sistem të tërë shtypës. Dhe kjo e bën Mustafën jo vetëm "normalist" në kuptimin shkollor të fjalës, por kryengritës të mendimit, mësues të rezistencës dhe kalorës të heshtur të lirisë.
Me përkushtimin e një pende që nuk shkruan vetëm me bojë, por me shpirt të thellë dhe ndjenjë të rrënjosur në rrëfimin e së vërtetës, autori vazhdon rrugëtimin e tij përmes faqeve të librit, duke e thelluar edhe më tej portretin kompleks dhe të ndritshëm të Mustafë Sh. Shytit. Në pjesët që pasojnë — "Arsimtari i 'Papërshtatshëm'", "Pajtimtar gjaqesh e ngatërresash", dhe "La ditarin, rroku pushkën" — ai na sjell para syve një njeri që ishte shumë më tepër sesa një figurë historike; ai ishte një hero i heshtur i jetës së përditshme, një shpirt i madh që jetonte dhe vepronte përtej kufijve të zakonshmërisë.
Në pjesën "Arsimtari i 'Papërshtatshëm'", zbulojmë një realitet tronditës dhe një ironi të hidhur: si është e mundur që dija, ndërgjegjja dhe vetëdija kombëtare të cilësohen si të rrezikshme? Por pikërisht kështu ndodhi me Mustafën, i cili për mendimin e lirë, për bisedat ndriçuese me nxënësit, për qëndrimin e tij dinjitoz përballë pushtetit, u shpall i papërshtatshëm për sistemin, ndonëse ishte më i përshtatshmi për popullin. Ai nuk ishte një mësues që përçonte vetëm mësime shkollore — ai ishte një udhërrëfyes shpirtëror, një flakadan që ndizte vetëdijen e brezave të rinj në një kohë ku errësira përpiqej ta mbyste dritën.
Në pjesën tjetër, "Pajtimtar gjaqesh e ngatërresash", shfaqet një tjetër dimension i thellë i shpirtit të tij njerëzor — ai i ndërtuesit të paqes, i urtarit që ndërmjetësonte jo me fjalë boshe, por me autoritet moral e me zemër të madhe. Ai e dinte se një komb që përçahet nga brenda nuk mund të ngrihet i fortë përballë armikut. Prandaj ai nuk luftoi vetëm me armë e mendim, por edhe me zemër, për të afruar të ndarët, për të shuar hakmarrjet, për të shtruar rrugën e bashkimit në zemrat e njerëzve. Dhe ky rol i tij, ndonëse shpesh i heshtur dhe i padukshëm në faqet e historisë zyrtare, është një akt i lartë atdhetarie dhe maturie kombëtare.
E së fundi, vjen kapitulli që i jep këtij rrëfimi peshën e fundit, peshën e gjakut dhe të flijimit — "La ditarin, rroku pushkën". Kjo është çasti i madh i kthesës, kur njeriu i dijes, i fjalës dhe i mendimit, e kupton se ka ardhur koha që edhe fjala duhet ta veshë petkun e armës. Ai nuk braktisi idealin e dijes, por e ngriti në një nivel më të lartë — në vetëmbrojtje të atdheut. Ai nuk e ndërroi misionin — thjesht e zgjeroi. Nga mësuesi i klasës u bë ushtar i lirisë, nga pajtimtari i fjalës u shndërrua në dëshmor i pushkës.
Në të gjitha këto pjesë, autori e përshkruan Mustafën si një hero të plotë — me mendje të ndritur, me zemër të madhe dhe me krahë të gatshëm për flijim. Një figurë që nuk mund të mbetet e mbyllur në kornizat e një monografie, por që ngrihet si një simbol i përjetshëm i dinjitetit shqiptar. Një jetë që nuk lexohet vetëm, por ndjehet, frymëzon dhe ngjiz ndërgjegje të reja.
Ndër të gjitha faqet e këtij libri, ndër të gjitha ndalesat e rrëfimit që ndërthurin dritë e dhembje, më e dhimbshmja dhe njëkohësisht më e lavdishmja është pjesa "Varrimi, rivarrimi dhe përjetësimi" — një kapitull që rrëfen fundin tokësor të një jete të shenjtëruar dhe fillimin e amshimit të saj në ndërgjegjen kombëtare. Këtu fjala ndalet për të heshtur, për të përkulur kokën para një sakrifice që nuk vdes me trupin, por që ngrihet mbi kohën si një testament i pavdekshëm.
Autori, me një ndjeshmëri të thellë dhe një përkushtim të rrallë, na sjell me hollësi të gjalla çastet e fundit të jetës së atdhetarit të devotshëm, Mustafë Sh. Shyti — çastet kur heroizmi takon përjetësinë, kur lufta për liri merr formën e përgjakur të flijimit. Ishte një ditë që mbeti e shënuar me gjëmë në historinë e një populli dhe në zemrat e bashkëluftëtarëve — 22 shtatori i vitit 1998, kur beteja mes luftëtarëve të UÇK-së dhe forcave armike u zhvillua në kufijtë e njeriut, fyt për fyt, shpirt për shpirt.

Në atë përplasje të egër dhe heroike, Mustafë Shyti, si gjithmonë në vijën e parë, nuk kurseu as jetën. Aty mori plumbin vdekjeprurës, por jo për t'u zhdukur, për të heshtur — përkundrazi, ai ra për t'u ringjallur si simbol, si flamur, si kujtim i përjetshëm i një qëndrese të paepur.
Por historia nuk mbaron me rënien. Me një respekt të thellë dhe një mall që nuk shterohet, më 26 shtator të vitit 2000, bashkëluftëtarët, familjarët dhe mbarë qytetaret e rivarrosin trupin e tij në tokën që e kishte lindur — në Ashlanin e dashur, atje ku nisën hapat e parë, ku u formuan ëndrrat, ku u ndez flakadani i idealit që ai do ta bartte deri në frymën e fundit. Në varrezat e dëshmorëve, ai gjeti jo vetëm pushimin e trupit, por banesën e përhershme të kujtesës kombëtare.
Dhe kështu, rrëfimi për Mustafë Shytin merr formën e një rrugëtimi që nuk mbyllet me vdekjen, por rifillon me përjetësimin. Ai nuk është më vetëm një emër në gur memoriali, por frymë që rreh në zemrat e atyre që jetojnë me ideal, me dinjitet, me kujtesë të pastër për ata që flijuan gjithçka për lirinë tonë. Emri i tij është tashmë pjesë e pandashme e historisë, një jehonë që nuk shuhet, një dritë që vazhdon të ndriçojë gjeneratat e reja me mësimin e qëndresës, të sakrificës dhe të dashurisë për atdheun.
Në udhëtimin e këtij libri, ndërsa fjalët rrjedhin me peshën e kujtesës dhe ndjenjës, vijnë njëra pas tjetrës edhe faqe të heshtura por elokuente — faqet ku fotografia bëhet dëshmi, ku imazhi flet më shumë se fjalët, ku koha ndalet për një çast për të ruajtur një gjurmë, një shikim, një çast të përjetësuar.
Fotografitë që shoqërojnë këtë vepër nuk janë thjesht ilustrime — ato janë urë mes së kaluarës dhe së tashmes, pasqyra të një jete të mbushur me dinjitet, me përkushtim, me gjurmë që nuk shlyhen lehtë. Në secilën prej tyre ndjehet prania e një shpirti që ka jetuar me ndjenjën e përhershme të shërbimit ndaj atdheut. Ato janë si dritare të vogla nga ku lexuesi mund të sodisë fytyrën e njeriut që ky libër e përjetëson, të ndjejë atmosferën e kohës, të preket nga gjurmët e një jete të shndërruar në simbol.
Krahas këtyre imazheve që flasin me heshtjen e tyre, vijojnë në libër edhe shumë mirënjohje dhe nderime, të cilat nuk janë vetëm dëshmi formale, por vlerësime që dalin nga zemra e një populli mirënjohës. Mes tyre, spikasin falënderimet dhe çmimet e dhëna nga Komuna e Vushtrrisë, si dhe mirënjohja e veçantë e vetë Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi — një nder që ngrihet mbi protokollin dhe merr peshë të thellë kur lidhet me një jetë të flijuar për liri.
Këto faqe janë si një kurorë e artë mbi veprën e jetës së Mustafë Sh. Shytit — një dëshmi se figura e tij nuk është harruar, por ka hyrë në kujtesën institucionale dhe popullore si një emër që duhet të mbahet gjallë, të përmendet me nderim dhe të merret si shembull për brezat që rriten në frymën e lirë që ai dhe të tjerët si ai e fituan me gjak.
Në këtë mënyrë, fotografitë dhe mirënjohjet bëhen gurë të tjerë në mozaikun e përjetësimit — jo vetëm si kujtim për një jetë të shkuar, por si frymëzim për një të ardhme që duhet të ecë mbi themelet e qëndresës dhe të sakrificës. Ato flasin qartë: se nderimi i një dëshmori është detyrë e përhershme, se kujtimi i tij është një formë e gjallë e lirisë që e gëzojmë sot.
Pas pjesës së parë, ku lexuesi udhëton nëpër jetën, veprën dhe flijimin e një njeriu të jashtëzakonshëm, libri hap një tjetër horizont ndjeshmërie — një hapësirë ku fjala nuk thotë vetëm, por këndon; ku ndjenja nuk përshkruhet vetëm, por shpërthen si melodi shpirti. Pjesa e dytë e librit, e titulluar *"Bota poetike e Mustafë Shytit"*, është një dritare tjetër, një portë që çon drejt shpirtit të thellë të këtij atdhetari që dinte jo vetëm të luftonte për lirinë, por edhe ta shprehte atë me vargje të ngrohta e të ndiera.
Këtu, Mustafë Shyti na shfaqet jo më me pushkë në dorë, por me penën në zemër — poeti që i këndoi lirisë, atdheut dhe dashurisë për tokën ku u lind e u rrit, me një përmallim që vlonte si prush i heshtur nëpër vargjet e tij. Poezitë e tij nuk janë vetëm krijime letrare,

por përrenj ndjenjash të thella, të derdhura nëpër faqe si rrjedhë zemre që kërkon të preket, të ndjehet, të kuptohet me shpirt.
Në çdo varg të tij ndjehet dashuria e pamasë për vendin, për rrënjët, për gjuhën, për historinë, për tokën që e rriti dhe e mëkoi me ndjenjën e përkatësisë. Atdheu në poezinë e Mustafës nuk është vetëm hapësirë gjeografike, por është zemër që rreh, është frymë që pulson, është nënë, është varr, është ëndërr dhe plagë. Ai nuk e përfytyron lirinë si një nocion abstrakt — ai e ndjen, e jeton dhe e lartëson me fjalë të buta, por të ngarkuara me madhështi dhe taban.
Në këto poezi, lexuesi nuk gjen vetëm rimë dhe metaforë — gjen shpirtin e një njeriu që fliste me gjakun e dhembjes dhe ngazëllimit kombëtar, që shihte te fjala një mënyrë tjetër të rezistencës, një mënyrë tjetër për të ndërtuar urat mes brezave, për të mbjellë ndjenjën e dashurisë ndaj tokës së vet në shpirtin e lexuesit.
Krijimtaria poetike e Mustafë Shytit është breg i dytë i të njëjtit lumë të qëndresës, një tjetër formë e luftës, më e butë në tingull, por po aq e fortë në mesazh. Aty ku pushka pushon, nis fjala e vargut — si një jehonë që nuk vdes kurrë, si një tingull që shkon përtej dhimbjes dhe bëhet himn i dashurisë së pastër për lirinë.
Në një kapitull që vjen si një mozaik i ndjenjës dhe kujtesës së gjallë, libri përmbyllet me një pjesë që të prek thellë në zemër: *"Kujtime, Mendime dhe Vargje për dëshmorin Mustafë Shyti"*. Këtu, fjala nuk rrjedh më vetëm nga pena e autorit, por zgjerohet në shumë zëra që bashkohen si një kor shpirtëror nderimi, ku secili flet nga një cep i veçantë i jetës, nga një këndvështrim i thellë e personal, duke ndërtuar me fjalët e tyre një portret të përbashkët, të ndritshëm dhe të paharruar të një atdhetari që jeton në kujtesën e të gjithëve.
Më shumë se tridhjetë miq, kolegë, familjarë dhe bashkëluftëtarë japin dëshminë e tyre — jo si dëshmi të thata arkivore, por si copëza zemre, kujtime të mbështjella me ndjenjë, mendime të ngjizura në dhimbje dhe krenari, në mall dhe në respekt të përjetshëm. Çdonjëri, me sinqeritetin e një përjetimi të vërtetë, sjell para lexuesit një faqe tjetër të Mustafë Shytit — atdhetarin e palodhur, shokun besnik, kolegun e ndershëm, bashkëshortin e dhembshur, babain e përkushtuar, vëllain fisnik.
Në këto rrëfime nuk shohim vetëm nderim — shohim dashuri që nuk shuhet, kujtime që nuk zbehen, fjalë që vijnë si lotë të heshtur mbi faqet e një historie që flet vetë. Secili zë shton një gur në mozaikun e përjetësisë së tij, e secila fjali është si një petale mbi varrin e një njeriu që nuk vdiq kurrë në zemrat e njerëzve që e njohën dhe e deshën.
Kjo pjesë është si një amshim kolektiv i kujtesës, një dëshmi që figura e Mustafës nuk u përket vetëm faqeve të historisë, por jeton në mendimet, ndjenjat dhe zemrat e atyre që ndanë rrugëtimin e jetës me të. Lexuesi këtu nuk mëson vetëm për të — ai e ndjen Mustafën, e sheh në sytë e të tjerëve, e dëgjon në zërat e bashkëkohësve, e ndjek në kujtimet që ndizen si yje në qiellin e rrëfimit.
Në këtë simfoni fjalësh dhe emocionesh, shpaloset njeriu i plotë — atdhetari dhe njeriu i zemrës, luftëtari dhe poeti, mësuesi dhe babai, idealisti dhe i përkushtuari. E kjo është ndoshta forma më e bukur e përjetësisë — kur një njeri nuk jeton më vetëm në libra, por në kujtimet e të tjerëve, në fjalët që pëshpëriten me mall dhe krenari, në ndjenjat që mbijetojnë përtej kohës dhe vdekjes.
Në mozaikun emocional të pjesës së fundit të librit, aty ku fjalët nuk janë vetëm rrëfime, por frymëmarrje të shpirtit të afërt, autori ka përfshirë një pjesë të veçantë që e ka pagëzuar me një titull prekës e domethënës: *"Rikujtime dhe plotësime"*. Këtu nuk flasin studiuesit, as historianët, por zemrat që kanë rrahur më pranë Mustafës, ata që e kanë njohur jo vetëm si atdhetar dhe dëshmor, por si vëlla, si burrë, si baba, si njeri i përditshmërisë.

Në këtë pjesë janë shkruar fjalë që burojnë nga dhimbja, nga kujtesa intime dhe nga dashuria që nuk shteron asnjëherë. Motra, vëllezërit, e mbi të gjitha bashkëshortja e tij, zonja Elhame Shyti, ndajnë kujtime që nuk janë vetëm rrëfime të së shkuarës, por plotësime të jetës së një burri që u përjetësua në idealin e lirisë. Çdo fjalë e tyre është si një gur i çmuar i vendosur me kujdes në themelin e përjetësisë së tij.
Në mënyrë të veçantë, në rreshtat e kësaj pjese ndriçon figura e zonjës Elhame, bashkëshorte dhe shoqe jete, trime e heshtur e përkushtuar në hije, e cila ishte jo vetëm pranë tij në vitet e jetës, por edhe pas rënies së tij, mbeti si shtyllë e pathyeshme e familjes, si bartëse e atij amaneti të shenjtë që burri i saj i kishte lënë: se "atdheu është gjaku ynë që nuk falet".
Pata fatin ta takoj këtë zonjë fisnike në promovimin e librit. Aty ku fjalët e të tjerëve lavdëronin, qëndrimi i saj fliste më shumë se çdo fjalë — një qëndrim i qetë, i dinjitetshëm, me atë madhështi të heshtur që vetëm gratë me rrënjë të thella atdhetarie dinë ta mbajnë. Në sytë e saj lexohej historia, në buzëqeshjen e saj hijerëndë ndjehej një jetë e tërë përballje e përkushtimi, ndërsa në heshtjen e saj — një dhimbje e madhe, e përzier me një krenari të pashoqe.
Pas rënies së bashkëshortit, ajo nuk u mbyll në dhembje, por u bë shëmbëlltyrë e vazhdimit të idealit — duke rritur fëmijët e saj në frymën e atdhedashurisë, në nderin e emrit që mbartnin, dhe në dritën e kujtimit që nuk zbehet kurrë. Ishte ajo që e ruajti shpirtin e Mustafës në çdo vështrim të fëmijëve të saj, në çdo fjalë që u mëkoi, në çdo hap që i drejtoi me kujdes drejt udhës së ndritur të idealit prindëror.
Sepse zonja Elhame, ashtu si burri i saj, buronte nga një trung atdhetar, nga një familje me rrënjë të thella në dashurinë për tokën, për lirinë, për flamurin. E nuk kishte si të ndodhte ndryshe: kur dardha bie, bie nën dardhë, siç thotë urtësia popullore — dhe Mustafë Shyti nuk ishte vetëm i tillë nga natyra, por edhe nga bashkimi i fatit me një grua që ishte mishërimi i së njëjtës vlerë, i të njëjtës përkushtim.
Në këtë kapitull, libri merr frymën më të butë dhe më të thellë njëherësh, sepse është vetë familja që flet — jo për t'u dukur, por për të plotësuar portretin e njeriut që nuk ishte vetëm dëshmor i kombit, por edhe dashuri e përditshme, jetë e ndarë në detaje, ëndërr e jetuar mes njerëzve të tij.
Ndër të gjitha fjalët që u thanë me përkushtim e mall në nderim të figurës së Mustafë Shytit, do të ndalesha vetëm pak, me një ndjeshmëri të veçantë, tek rrëfimi i mikes sime të dashur, Jehona Shyti — bijës së dëshmorit, që nuk flet vetëm me fjalë, por me zemër, me shpirt dhe me rrënjët më të thella të kujtesës familjare.
Në mes të kujtimeve të saj të ndjera, ajo thotë me një thjeshtësi që prek thellë: *"Babi – njeri me zemër të madhe e me shpirt të fortë.*" Një fjali e shkurtër, por që përmbledh gjithçka. Një fjali që është një botë më vete, sepse kur një bijë flet për të atin me këtë ndjeshmëri, ajo nuk përshkruan thjesht një figurë prindërore, por një model jete, një pishtar frymëzimi, një burim që nuk shteron kurrë.
Jehona, me një ndjeshmëri të rrallë, rikujton kohën e fëmijërisë së saj — kohë e lumtur, e rrethuar me dashurinë e prindërve, me ngrohtësinë e vëllezërve dhe motrave. Ajo e sjell këtë kujtim jo si një rrëfim nostalgjik, por si dëshmi të një jete të thjeshtë e të bukur, në të cilën rritej dashuria për atdheun njësoj si dashuria për shtëpinë. Dhe pikërisht nga vetë babai i saj, ajo mësoi mësimin më të madh: si të duash atdheun me gjithë shpirt, dhe nëse vjen dita, si të vdesësh për të me dinjitet e pa drojë.
Kjo është trashëgimia më e vyer që një prind mund t'i lërë një fëmije — jo pasuri, jo lavdi, por frymë, ideale dhe dritë që ndriçon edhe rrugët më të errëta të jetës. Jehona e di këtë dhe e mban si amanet në zemrën e saj. Ajo e ndjen praninë e babait jo vetëm në kujtime, por në mënyrën se si jeton, mendon, vepron.

Me gjithë qenien e saj, ajo pohon se dje, sot, dhe gjithmonë, do të jetë krenare për atë baba që ishte mësues i fjalës, poet i shpirtit dhe luftëtar i lirisë. Një figurë që nuk mbaron me kohën, por rritet me të, dhe që është gdhendur në të gjitha shtresat e ndërgjegjes së saj.
"Për çdo ditë që kalon," — shton ajo — "përpiqem të jetoj me frymën e babit, me atë që ai na nguliti në zemër." Dhe me këtë fjali, Jehona mbyll rrëfimin, por hap një dritare të përjetësisë. Sepse, kur një bijë jeton me frymën e babait të saj, atëherë ai nuk është vetëm një kujtim — ai është një prani e përhershme, një jetë që vazhdon përmes jetës së saj.
Dhe kur faqet e librit mbyllen, kur zërat e fjalimeve shuhen në heshtjen që mbetet pas një promovimi solemn, lind natyrshëm një pyetje që nuk mund të anashkalohet, një pyetje që tingëllon si një jehonë e ndërgjegjes së përbashkët: A mjafton vallë vetëm kaq për një atdhetar?
A mjaftojnë vetëm disa rreshta të bukur nëpër libra, disa fjali të ndiera në podiume, disa çaste nderimi të rastësishëm që vijnë e ikin nëpër kalendarë përvjetorësh?
A mjafton vallë t'i kujtojmë vetëm nëpër promovime, në ceremoni të rralla që ndizen për një çast dhe pastaj treten në harresën e përditshmërisë sonë? A mjafton që kujtimi për ta të mbetet vetëm brenda mureve të familjes, të ushqehet e ruhet vetëm nga njerëzit më të afërt, ndërsa shoqëria përreth kalon tutje, e zënë me ngutjet e ditës?
Jo. Jo, nuk mjafton. Sepse atdhetarët nuk kanë sakrifikuar për të mbetur vetëm një emër në letër, një kujtim privat, një fotografi në një cep të dhomës familjare. Ata kanë dhënë jetën për të gjithë ne — për atdheun, për brezat që vinë, për një liri që nuk ka pronar, por që është e të gjithëve. E prandaj, kujtesa për ta duhet të jetë po ashtu kolektive, publike, përherë e gjallë dhe e përgjegjshme.
Unë mendoj se ende ka shumë për të dëshiruar, shumë për të bërë, shumë për të reflektuar si shoqëri. Sepse një komb që nderon të kaluarën e tij vetëm me ceremoni simbolike, por nuk e ruan me përkushtim në vetëdijen e përditshme, rrezikon të humbasë thelbin e qëndrueshmërisë së vet.
Ne kemi nevojë për kujtesë të gjallë, për sistem të qëndrueshëm nderimi, për përfshirje të brezave të rinj në rrëfimet e së shkuarës, që historia të mos mbetet një kapitull i harruar, por një burim frymëzimi për të tashmen dhe të ardhmen.
Po, libri është një fillim i mirë, një dritë që ndriçon, por dritat duhen ushqyer vazhdimisht që të mos shuhen. Sepse heronjtë tanë nuk jetojnë vetëm në përkujtim, ata kërkojnë të jetojnë në ndërgjegjen tonë, në sistemin tonë arsimor, në kulturën tonë të përbashkët, në çdo hap të qytetarisë që dimë të ndërtojmë mbi gjakun e tyre.
Dhe derisa kjo të ndodhë, do të mbetet gjithmonë ajo thirrje e heshtur që na e përsërit ndërgjegjja: ka ende shumë për të dëshiruar, shumë për të bërë, shumë për të kujtuar — sepse ata nuk dhanë pak… ata dhanë gjithçka.
Lavdi emrit të pavdekshëm të atdhetarit Mustafë M. Shyti!
Ky emër nuk është thjesht një tingull që shqiptohet me respekt — është një jehonë që vjen nga thellësia e historisë sonë, një dritë që ndriçon kujtesën kolektive të një populli që ka jetuar gjatë në përballje me padrejtësinë, por që ka pasur gjithnjë burra si ai që e kanë mbajtur të gjallë frymën e lirisë.
Mustafë Shyti nuk ishte thjesht një njeri mes të tjerëve — ai ishte një flamur i gjallë i atdhedashurisë, një fjalë e kthyer në vepër, një ëndërr e kthyer në sakrificë, një jetë që e vendosi veten mbi barrikadat e idealit dhe nuk u tërhoq për asnjë çast përballë rrezikut, përballë armikut, përballë vdekjes.
Lavdia që i përmendim nuk është një stoli e zbrazët e fjalëve — është mirënjohja e përjetshme që duhet të mbetet e skalitur në shpirtin e çdo brezi që sot frymon në liri falë njerëzve si ai. Ai jetoi për atdheun, luftoi për lirinë, dha gjithçka për kombin — dhe për këtë, historia i është në borxh të përhershëm.

Lavdi Mustafë Shytit do të thotë: të mos harrojmë se liria nuk është dhuratë, por trashëgimi e mbushur me gjak e dhembje. Do të thotë: të kujtojmë me përkulje burrat që flijuan jetën për të na dhënë një të ardhme. Do të thotë: të jetojmë me dinjitetin që ai na mësoi, me guximin që ai e mishëroi, me idealin që ai e mbrojti deri në fund.
Emri i tij është kambanë që na zgjon nga harresa, është pishtar që ndriçon udhën e kombit, është amanet që nuk duhet të shuhet në heshtjen e kohës. Dhe sa herë ta shqiptojmë, le ta bëjmë me zemër plot: Lavdi përjetë Mustafë M. Shytit — figurës që nuk vdes, sepse jeton në ndërgjegjen e një kombi që di të nderojë bijtë e tij më të mirë.

T

TAFALLARI FARIDIN - Faridin Tafallari ka lind në fshatin Struzhë të Prizrenit më 1 shkurt 1951. Jeton në Gjermani nga viti 1973. Deri më ka deri më tani ka botuar 5 libra dhe shumë artikuj të ndryshëm. Librat e botuar deri më tani janë: 1) Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997; 2) Dhimbje Krenare, Tiranë 1998; 3) Zot të kësaj toke jemi ne, Prizren 2003; 4) Fat Lumbardhi dhe Struzha e tij, Tiranë 2008; 5) Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010.

Sa i përket librave të tij sidomos dy librave të parë *Terror Dhimbje Qëndresë* Tiranë 1997 dhe *Dhembje Krenare* Tiranë 1998, unë veç jam shërbyer shumë dhe jam referuar e i kam cituar në atë masë që nuk e ka bërë deri sot askush më shumë. Në këtë kuptim, mund të thuhet se unë kam folur mjaft për Faridinin, sidomos nëse i marrim parasysh fjalët e njërit prej personaliteteve më të mëdha kulturës dhe gjuhës angleze, Samuel Johnson i cili thotë: "Komplimenti më i mirë që mund të epet një shkrimtari është duke e cituar atë."

Sa i përket aktivitetit politik unë nuk mundem me e përfshi sepse ai shtrihet për një periudhë 30 vjeçare, periudhë të cilën nuk kam mund me e përcjell drejtpërdrejt, me përjashtim të leximit të librave, e gjithashtu në një shkrim të shkurtër si ky nuk mund të përfshihet. Por mua ma merr mendja se mund të them diçka më mirë se të tjerët për atë kohë që e kam njohur dhe që kemi vepruar bashkarisht nga gushti 1981 e janari 1982 - mars 1984.

Për herë të parë Faridinin e kam takuar në verën e vitit 1981 në studion e punës së Jusuf Gërvallës. Në atë kohë Jusufi takohej çdo vikend me shokët e tij, aktivistët kryesor të Shtutgartit. Kjo ishte njëra anë e çështjes. Ana tjetër ishte se Jusufi, me idetë e tij të pashtershme që i sillte aktiviteti në çdo hap megjithatë gjendjen time në këtë rreth si të ardhur nga Kosova e konsideronte njëfarë freskie për te edhe në atë mënyrë, duke ma dhënë fjalën me dëshirë që të tregoj për gjendjen në Kosovë prej të cilës ai ishte largua para 20 muajsh, periudhë në të cilën kishin ndodhë aq gjëra të mrekullueshme edhe për meritën e Jusufit, meritë të cilën jam aq krenarë që ia kam përcjellë. Në një nga këto ndeja jam njohur me Remzi Ademin, Mejdi Rexhën, Nami Ramadanin, Nuhi Sylejmanin etj. Në një prej këtyre takimeve në shtëpi të Jusufit jam njohur me Faridin Tafallarin me të cilin do të njihesha shumë më tepër pas 17 janarit 1982. Ata që i kanë lexuar shkrimet e Jusufit e dinë mirë se si ka shkruar Jusufi për femrën shqiptare. Por Jusufi kishte edhe disa referime për burrërinë që edhe pse rrallë, me shijen e përsosur të humorit e mirësisë i përdorte. Në tetor 1981 më ka pas rënë të shkoj me te tek një shok gati 200 km nga

Shtutgarti. Nga ai shok na u dha një ndihmë të cilën nuk isha fare i përgatitur ta prisja. Të nesërmen i thash Jusufit se ndihem shumë i befasuar, për të mirë nga ai aktivist. Jusufi m'u përgjegj: -Ndihesh i befasuar sepse po duket se ty nuk të ka ra ende rasti me ndejtë me burra.

ZADE DHE FARIDIN TAFALLARI

Gjatë punës që bënim në përgatitjen e Zërit të Kosovës, në kohën pauzave e kafeve e pyesja për shokët e Organizatës.

- A ka diçka me rëndësi për mua që kishe me ma thënë për Faridinin? - i thash një ditë.

- Faridini është kallap burri! - mu përgjegj Jusufi.

Këtë shprehjen *kallap burri* nuk e harroj kurrë pasi Jusufi e ka përdorë rrallë. Të njejtën shprehje e ka përdor kur më ka folë një herë për Peter Platzamanin, që në atë kohë ka qenë Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri.

Pas 17 janarit 1982 Faridini dhe Remzi Ademi ka qenë shtyllat kryesore të rrethit të Shtutgartit. Si në rrethin e Shtutgartit, si në Gjermani e jashtë Gjermanisë rrugët më të shumta, gjatë vitit 1982 i kam bërë së bashku me Faridinin.

Me Faridinin kam qenë shok i ngushtë dhe e di si është kur është i tillë kur kemi vepruar së bashku sidomos në vitet 1982-1983. Në vitin 1984 unë u largova nga rrethi i Shtutgartit e Gjermania dhe pas një qëndrimi disa muajsh në Paris u vendosa në Suedi. Divergjencat natyrale dhe artificiale të asaj kohe ndikuan në shkëputjen e kontakteve dhe Faridini u gjet në një mjedis që ishte kundër asaj veprimtarie në qendër të së cilës situata më kishte sjell të jem unë. Si shok e kam parë nga afër. Si person me të cilin rrymimet politike të sjellin në kundërshtime nuk kam pasur rastin ta shoh nga afër për shkak të shpërnguljes time prej Gjermanisë. Zhvillimet e peripetitë e jetës ndikojnë që shumë kontakte të shkëputen edhe me persona që nuk ke pasur asnjë divergjencë. Në vitin 1997,

i udhëhequr nga dashuria e qëllimi i mirë, ai botoi librin e tij më të mirë *Terror-Dhimbje-Qëndresë* së bashku me dokumente të rëndësishme të asaj kohe duke ruajtur një shkallë të lartë të objektivitetit për të gjithë shokët. Në këtë libër shkëlqen respekti për heronjtë e vrarë. Nga ky libër megjithatë, në këtë rast dua ta analizoj një citat që më duket më i rëndësishmi.

Faridin Tafallari: :"*Jusufi kur fliste për shokët e vet, i ngrinte ata shumë dhe për veten e vetë fliste shumë i përmbajtur. Shumë herë në të tilla momente, e kam kundërshtuar duke i thënë: "Ne derisa të kemi ty, nuk po na lypen të tjerë. ." Por ai ngulte këmbë në mendimin e vet, duke lartësuar shokët e vet në Kosovë."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 28)

Në lexim të parë të duken aq të thjeshta e aq të rëndomta sa mendon se janë fjalët më të përditshme që i dëgjon. Po t'i analizosh më thellë dalin se janë ndër fjalët më të jashtëzakonshme dhe më origjinale, dhe ky dialog prej tri fjalive ka aq shumë përmbajtje, sa të futë në mendime e të shtron aq shumë çështje në të cilat mundesh me hy por nuk e din se ku të qesin. Fjalë e mendime të tilla nuk mund të mësohen e kopjohen nga librat. Fjalë e mendime të tilla t'i jep jeta. Ndoshta edhe mund të thuhet se fjalë e mendime të tilla i flet Natyra kur ajo don të shprehet me gojën e dikujt që ajo e zgjedhë vet.

Marrë guximin të them se krejt historia e jetës njerëzore dhe sidomos ajo e shkruara në këto gjashtëmijë vjetët e fundit, në njëfarë mënyre mundet me u mbështjellë apo munden me u bërë shumë e shumë reflektime vetëm nga citati e mësipërm.

Jusufi Gërvalla fitohet përshtypja se është përfaqësues i prishjes së rendeve e rregullit dhe në të njetën kohë deklaron se: Unë nuk jam rendi ideal, unë nuk jam më i miri, rendin e rregullin më të mirë mund t'ua ofrojnë të tjerët! Të tjerët janë më të mirë se unë. A ka ndonjë liderë politik që guxon, "me vetëbesimin" e vetë, të deklaroj se: Unë nuk jam më i miri! Të tjerët janë më të zotët se unë! Vetëm fjalia "Por ai ngulte këmbë në mendimin e vet, duke lartësuar shokët e vet në Kosovë" do të mjaftonte për të treguar pse UDB-ja e kishte në shënjestër Jusufin dhe shtëpinë e tij.

Faridin Tafallari e kundërshton dhe nuk e pranon Jusufin si prishës të rendit e të stabilitetit të tij. Ti je rendi, rregulli, stabiliteti e qetësia të cilën e kam pritë dhe kërkuar. Ne derisa të kemi Ty nuk po na lypen të tjerë!

Ne derisa e kemi rendin dhe stabilitetin tënd nuk po na lypen të tjerë.

Edhe pse në dukje e me fjalë nuk e pranon, në të vërtetë Jusufi është ashtu siç e kupton Faridini, përfaqësues i rregullit e rendit, por ajo që e dallon Jusufin, është se ai e lenë derën gjithmonë të hapur për ata që janë më të mirë se ai.

Një shtet, një sistem, apo një perandori e cila me mjetet e saj, me agjentët e saj, me Sadik Blakajt me kompani, i vërsulet një personi siç ka qenë Jusuf Gërvalla, kjo nuk tregon asgjë tjetër përveç faktit se ai sistem, sado i përhapur e kancerogjen që të jetë, e ka të vizatuar shenjën e vdekjes së ballë.

Në emër të luftës për rend e rregull, prishet çdo rend e rregull, bëhen atentate dhe Faridinit me shokë nuk u mbetet tjetër veçse ta vazhdojnë luftën pa qen të sigurt se në cilën kohë, dhe kur do ta takojnë herën tjetër, apo a do ta takojnë fare një person, a do ta arrijnë prapë atë ekuilibër, sa të mund t'a përsërisin fjalën, t'a përsërisin besën e kundërshtimin e tyre:

Ne deri sa të kemi Ty nuk po na lypen të tjerë!

Është lehtë me e gjetë dikend që din me i rendit fjalët më mirë se sa Faridin Tafallari, - por është shumë vështirë me u gjetë ai të cilit i vlon më shumë zjarri në gji për

luftëtarët e lirisë në përgjithësi e sidomos për të vrarët në sulmin serbomadh kundër shtëpisë së Jusuf Gërvallës.

Me Faridinin më ka njoftuar Jusuf Gërvalla. Valët e jetës na kanë provuar në mënyra të ndryshme. Veprimtarët e ndryshëm politik, sidomos ata që veprojnë në emigracion ka shumë mundësi që në situata të ndryshme t'i japin "komplimente" të ndryshme njëri-tjetrit. Pas 25 vitesh (nga viti 1984-2009) nëpërmes Nami Ramadanit ramë në kontakt, i cili më duket se qe shumë i frytshëm në ndriçimin e veprës dhe historisë së Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, e cila na lidh aq shumë.

Një meritë e jashtëzakonshme e Faridin Tafallarit është ruajtja me vëmendje e arkivit të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës dhe lëvizjes patriotike në përgjithësi, sidomos të periudhës 1980-1989. Në vitet 1980-1984 ka banuar në këtë adresë: Faridin Tafallari, Haiterbacherstr. 75, D-7270 Nagold.

TAFALLARI RAMIT, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ramit Tafallari, Karthauserstr. 40, D-5503 Konz. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

TAFALLARI SEFIDIN - Sefidin Tafallari ka lindur më 7 gusht 1943, në fshatin Struzhë të Prizrenit. Ai, ishte anëtar i Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës, që nga 7 dhjetori i vitit 1981, ku në një ditë të paharruar, të atyre viteve të stuhishme, Jusufi e fton, së bashku me vëllanë e tij Faridinin dhe një grup shokësh, të shkonin tek Ai në Untergruppenbach. Atje, bashkë me Faridinin dhe disa shokë, me dëshirën e madhe bënë betimin një nga një, para Flamurit Kuq e Zi dhe Jusuf Gërvallës.

Disa ditë më vonë, për t'ia lehtësuar punën dhe për t'ia dhënë një pasqyrë të saktë Jusufit për rrethin e tij, për ata që janë betuar në shtëpinë e tij, Sefedin Tafallari i shkruan këta rreshta për veten, të cilat i kishte planifikuar t'ia jepte Jusufit në takimin e sërishëm. Dhe ja sesi i shkruan Sefidini të dhënat e tij biografike pas betimit:

"Unë Sefidin Tafallari, i lindur më 7 gusht 1943, në fshatin Struzhë të Prizrenit, baba i 5 fëmijëve, dhashë betimin, BETOHEM para Flamurit Kombëtar dhe shokëve të mi se, që nga kjo ditë jap kontributin tim për çështjen e shenjtë të Atdheut tim për çlirim e liri të Kosovës e Bashkimin me shtetin mëmë Shqipërinë. Do ti mbetem besnik i shokëve për çështjen patriotike deri në fund pa kursyer as gjë dhe as jetën time. Më 5 janar 1982 Dekenpfron-Untergrupenbach." (Marrë nga dorëshkrimi i tij origjinal)

Sefidini ishte më parë, u bë dhe mbeti një bashkëveprimtar i vendosur e besnik i Jusuf Gërvallës, duke i kryer të gjitha obligimet dhe detyrat që i ngarkoheshin nga udhëheqësi ynë Jusufi. Ai i ka shërbyer me shumë vullnet dhe dashuri të madhe çështjes madhore të kombit shqiptar dhe atdheut të tij, çlirimit të vendit dhe pavarësisë së Kosovës, duke sakrifikuar shumëçka për çlirimin e Kosovës, si me pjesëmarrjen e rregulltë të tij nëpër demonstrata kudo që, ato janë mbajtur jashtë atdheut, në Perëndim.

Sefidini ka sakrifikuar jashtëzakonisht shumë edhe për futjen e shtypit ilegal brenda në Kosovë, si për librin „Këngët e Lirisë", të Hydajet Hysenit me shokë, për gazetën "Lajmëtari i Lirisë" të Jusuf Gërvallës, për shtypin e marrë nga shteti amë Shqipëria.

Kështu, në vjeshtën e vitit 1983, kur mërgimtarët shkonin për të pushuar në vendlindje, atij iu gjet një pako me libra dhe shtyp ilegal, që ishte botuar nga Jusuf Gërvalla. Gjatë kontrollit nga milicia kufitare, në kufirin Austri-Slloveni, në ish-Jugosllavinë e atëhershme, ia gjejnë ato materiale dhe që nga aty, duarlidhur, i shoqëruar me milici, me tren e përcjellin deri në Prizren, duke ia dorëzuar Sigurimit famëkeq të atëhershëm, të Milicisë (SUP-it).

Ia dorëzojnë ish kryeudbashit Vesel Krasniqit dhe Asllan Skenderit, ku torturohet e maltretohet barbarisht. Gjatë qëndrimit në burg, i bëhen edhe bastisje të shumta në familje. Udbashët Vesel Krasniqi dhe Asllan Skenderi-Torbeshi e kanë rrahur egërsisht në burg.

Pas shumë torturash, po në burg i ofrojnë lirimin me kusht, me qëllim që ta detyrojnë që ai të bëhej bashkëspiun dhe bashkëpunëtor i atyre udbashëve, për të kallëzuar e spiunuar se, kush po i organizon demonstratat në Perëndim etj, etj. Sefidini nuk e pranon asesi atë turp e detyrë dhe për këtë ia marrin pasaportën, ia prishin letrat e punësimit në Gjermani. Sefidini u përgjigjet udbashëve se,…" sikur edhe shpirtin po të ma merrni, unë kurrë nuk do t'i spiunoj dhe as do t'i tradhtoj shokët!"

Kështuqë, SEFIDINI, pa i marrë parasysh të gjitha vështirësitë e rreziqet, rrezikoi pa ju trembur syri deri aty, sa e lenë të papunë në Prizren. Dhe, nga ato tortura e maltretime, që i përjetoi, vdes nga infarkti, në moshën 51 vjeçare, duke i lënë gruan dhe pesë fëmijët e tij, në gjendje shumë të rëndë e tejet të vështirë ekonomike. Këtë vit, më 7 gusht 2013, Sefidin Tafallari, mbush 70 vjetorin e lindjes. Përjetësisht dhe me krenari e kujtojmë ne, shokët që e takuam në shtëpinë e Jusufit dhe në ballë të demonstratave shqiptare nëpër Evropë.

TAFALLARI ZADE, – Zade Tafallari, gruaja e Faridin Tafallarit. Grua e palodhshme fisnike që ishte mbështetje e fuqishme e Faridinit, brenda mureve të shtëpisë dhe jashtë saj, kahdo që shkoi edhe Faridini. Na priti ne shokëve të Faridinit me bujari ndoshta edhe shumë më të madhe se sa e kemi merituar.

TAKIMI I STAMBOLLIT. Takim në Stamboll në mesin e tetorit 1981, në mes Sabri Novosellës dhe Kadri Zekës. Bardhosh Gërvalla, i pranishëm në këto bisedime, formalisht, nuk ka qenë i detyruar me qenë neutral, por asnjë ndërhyrje prej tij nuk ka qenë e nevojshme. Roli i tij ka mbetur si roli i dëshmitarit më besnik.

Jusuf Gërvalla: *"Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit.*

... Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z.), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z (Kadri Zeka-shën i X.D.). Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por megalomaninë e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981: Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 273-274)

TEORI term shumëkuptimësh i cili ka kuptime të ndryshme në rrethana të ndryshme. Me teori mund të mendohet:

1. Ajo pjesë e punës shkencore që merret me organizimin e fakteve veç të fituara. Në këtë kuptim teoria shihet si e kundërta e empirisë.
2. Fjali e cila e jep relacionin në mes dy variablave, do me thënë një përpjekje për ta sqaruar një relacion. Në këtë kuptim teoria nuk dallohet në mënyrë vendimtare prej *hipotezës*.
3. Një numër fjalish të cilat krijojnë në tërësi të harmonizuar logjikisht. Termat dhe konceptet duhet t'i mbulojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të atyre fenomeneve, që teoria duhet t'i sqaroj. Teoria ideale është teoria e

aksiomatizuar, prej të cilës nxirren fjali të reja (*teorema*). Ky lloj përdorimi i konceptit të teorisë është ai që pranohet më së shumti.

TERROR një gjendje e frikës dhe tmerrit e krijuar me qëllim nga pushtetarët në një shoqëri apo prej ndonjë organizate. Gjendje karakterizuese është se askush nuk mund ta ndiej veten të sigurtë se nuk do të goditet nga ndonjë dënim. Esenca nuk qëndron në radhë të parë tek sasia e dhunës të cilën ata që e kanë pushtetin e kanë ndërmend ta përdorin, por tek krijimi i ndjenjës tek individët se ata nuk mund të jenë kurrë të sigurtë, se dhuna nuk do të drejtohet edhe kundër tyre.

TETË PIKAT E JUSUF GËRVALLËS

Demonstrata në Frankfurt, 7 qershor 1981; Sefidin Tafallari me grushtin lartë duke brohoritur "Kosova–Republikë!"

Jusuf Gërvalla: "*Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi,* ***ne - një pjesë e pararojës patriotike e komuniste të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi*** *– dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme:*

1) Pa iu njohur Kosovës statusi i Republikës në kuadër të federatës jugosllave;

2) Pa iu njohur shqiptarëve në Jugosllavi statusi i kombit dhe, rrjedhimisht, e drejta demokratike e leniniste për vetëvendosje deri në shkëputje;

3) Pa u marrë masat konkrete të të gjithë bashkësisë jugosllave që ritmi i zhvillimit të Kosovës të shpejtohet së paku në shkallën e parashikuar dhe të premtuar nga federata – do të thotë 60 për qind mbi mesataren jugosllave;

4) Pa u marrë masa të menjëhershme kundër papunësisë katastrofike në viset shqiptare, që në afatin sa më të shpejt të inkuadrohet krahu i lirë (ekzistues) i punës dhe të tërhiqen punonjësit tanë të shkapërderdhur në Perëndim dhe nëpër Republikat e zhvilluara të Jugosllavisë;

5) Pa shpalljen e amnistisë së përgjithshme, me të cilën do të liroheshin menjëherë dhe pa kusht të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë, që vuajnë dënime të rënda nëpër kazamatet jugosllave;

6) Pa marrë nga populli dënimin e merituar të gjithë ata udhëheqës politiko-shoqërorë, publicistë e njerëz të tjerë, qofshin nga Kosova ose republikat e Jugosllavisë, që janë implikuar në një mënyrë a në një tjetër në tragjedinë më të re të Kosovës, në fushatën e tërbuar antishqiptare të serbomëdhenjve, duke i shkaktuar popullit tonë plagë të reja dhe duke ndërsyer kundër tij popujt jugosllavë, të nxitur nga propaganda;

7) Pa formimin e një komisioni të posaçëm, që do të studiojë me themel dhe në hollësi aksionet shtetërore jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve, para e pas lufte, gjë që presupozon edhe publikimin e dokumenteve të fshehta shtetërore (të vjetra e të reja), që kanë të bëjnë me aksionin në fjalë; pa marrë dënimin e merituar të gjithë aktorët e gjallë (Çubrilloviçi me shokë) dhe të vdekur (Andriç, Vukotiçi etj.) të këtij akti barbar të gjenocidit; pa iu marrë e drejta qytetare publike të gjitha atyre veprave letrare (Duçiçi, Laliçi, Çosiçi, Bulatoviçi), kuazishkencore (Gjorgjeviçi, Cvijiçi etj.) e publicistike, në të cilat pasqyrohet përçmimi kombëtar e synimet antishqiptare, dhe mbi to të vihet embargo e përhershme jo vetëm në Kosovë po në mbarë Jugosllavinë;

8) Pa u rivendosur e pa u zhvilluar më tej marrëdhëniet e filluara kohë më parë mes popullit shqiptar (dhe popujve tjerë) në Jugosllavi me shtetin dhe me popullin shqiptar në RPS të Shqipërisë, të ndërprera në mënyrë të njëanshme arbitrare e me qëllime thellësisht antishqiptare –

– Pa këto masa të menjëhershme, rigorozisht të plota, populli shqiptar i martirizuar nuk do ta ketë as satisfaksionin më të vogël për krimet e vazhdueshme 70-vjeçare të gjenocidit nën regjimet e egra jugosllave, sidomos nën regjimin e vetëquajtur socialist dhe vetadministrues të klikës titiste-rankoviçiste, rrjedhimisht, nuk do të qetësohet deri në ngadhënjimin e plotë të të drejtave dhe të lirisë së tij." (*Zëri i Kosovës*, nëntor 1981, faqe 2-3)

TËRNAVA MUHAMET, – Muhamet Tërnava, historian i shquar shqiptar.

Jusuf Gërvalla: "*Kërkonin prej meje makinën tjetër të shkrimit, atë të punës (makinën ilegale e kishin gjetur). Atë makinë e kisha në banesë të Muhamet Tërnavës, e*

Muhameti ishte zyrtarisht në Gjermani. Pasi nuk e gjetëm të vëllain, që të na e çelte derën e banesës, inspektorët e SPB-së shkuan dhe e morën një mjeshtër, e çelën derën me dhunë, e morën çantën, dhe ata i vunë derës dry të ri, e çelësat m'i dhanë mua." (Shënime nga Ditari)

TËRPEZA HAJRULLA, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Hajrulla Tërpeza, D-8264 Waldkraiburg, Rangenueg. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

TITO, – JOSIP BROZ TITO, (Kumrovec, Austro-Hungaria, lindi më 7 maj, 1892 - Lubjanë, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, më 4 maj, 1980). Ishte Presidenti i Republikës "Socialiste" Federative të Jugosllavisë në periudhën 1953-1980, kreu i Partisë "Komuniste" të Jugosllavisë (më pas Lidhjes "Komuniste" të Jugosllavisë), komandant suprem i forcave të armatosura të Jugosllavisë.

Jusuf Gërvalla, mendimet për satrapin Josip Broz Tito, në mënyrë të përsosur i ka të përmbledhura në dy punime: I pari; Letër e hapur satrapit J. B. Tito, **Njeriu ka një të metë: ai di të mendojë!,** Janar, 1980, që është botuar në gazetën *Bashkimi*, Organ i Frontit të Kuq, shkurt 1980, faqe 1. Punimi i dytë; Rekuiem për një monark, është botuar në *Lajmëtari i lirisë*, gusht 1980, faqe 6-8.

Jusuf Gërvalla: "*REKUIEM PËR NJË MONARK*

Me rastin e vdekjes së monstrumit revizionist, J. B. Tito, këtij armiku të përbetuar të popullit shqiptar

I teket burrit të botës për të vdekur. Një e drejtë e amshueshme, e patjetërsueshme. As arsyet nuk mungojnë. Jeta – halle shumë. Dergja e gjatë e ka përpirë edhe pikën e fundme të durimit. Pastaj mosha, more vëlla. S'janë shaka 88 vjet!

Patjetër duhet të vdes, thotë ai.

Menjëherë!

Dhe, një ditë prej ditësh, ndërsa Konziliumi i mjekëve po i injektonte në trup pikën e fundme të gjakut të stërnipërve të tij dhe thërminë e fundme të truve të zogjve të Ballkanit, ai, pa një pa dy, ia dha në dorëzim djallit shpirtin e vet prej përbindëshi. Mbi mbeturinat e kurmit të tij të qelbur mbetën pezull raskapitja disamujore (disavjeçare?) e Konziliumit të mjekëve dhe hutesa e Familjes së Pikëlluar.

Po era e thatë e ditës së shënuar dimërore, 14 shkurt A.D. 1980 e humbi gjithë athëtimën e përparshme, dhe moti i zënë pisk deri më atë çast sikur u çmpi e mori frymë thellë.

Kish vdekur satrapi monstruoz, Josip Broz- Tito!

Kush ma zuri diellin…

Nga çmpirja e përgjithshme, që erdhi papritmas si dhunti hyjnore në këtë pjesë të Evropës, qielli sikur u kthye në elementin e vet: barkun do t'ia stolisnin sërish zogjtë e lirë të gadishullit Ilirik. Sikur u shkrinë gur e dru: nuk do t'i përdhoste më hapi i rëndë i përbindëshit. U gëzua shpirti i ri: nuk do t'i merrnin më gjak për të mbajtur gjallë fosilet e monstrumit. Fëmijët ia thanë këngës:

Kush ma zuri diellin,

Ia zëntë therra shpirtin!

Po Familja e Pikëlluar ra në hall.

I vdekuri kishte pasur hije të rëndë dhe kishte lënë prapa shumë ngatërresa.

Veç kësaj, gjatë dergjës së përbindëshit, në kufij ishte dukur një përbindësh tjetër, më i madh e më i tmerrshëm, me disa kambiale, që i tundte në erë si somnambul.

Dhe u mblodhën kokë më kokë anëtarët e Familjes së Pikëlluar. "Si guxoi të na linte kaq paturpshëm, në ditë kaq të ligë!"

Vërtet, si kishte guxuar ai të vdiste pa pyetur njeri, dhe ç'vdekje na qenka vdekja në pikë të dimrit?! A s'ka thënë mirë poeti: "Dua të vdes në pranverë!"

Po udhët e të madhërishmit janë shumë.

I vdekuri, me shkopin dhe me strajcën e lypës në dorë, kishte bërë për të gjallë të vet një arkë të madhe. Paraja ka pushtet. Mashën ta bën tangar. Pos parasë, ai kish lënë trashëgim edhe një mekanizëm të përsosur për shfrytëzimin maksimal të të mirave që sjell gënjeshtra dhe demagogjia.

Kështu, po në frymën e ish zotit të shtëpisë, Familja e Pikëlluar, me paratë e lypura dhe me arsenalin e pasur të gënjeshtrës, e ktheu në gjysmë të rrugës tellallin që ishte nisur të shpallte ngordhjen e përbindëshit.

Dy datëlindje – dy datëvdekje

Dhe vdekja, që s'kishte si të mos quhej vdekje, sepse kish vdekur trupi, kish tretur edhe shpirti (a kishte fare shpirt?), me emrin e zotit dhe të Xhebrailit, që e ngrënkan shumë ryshfetin, u bëj jo vdekje. U shty për tre muaj!

Më 4 maj A.D. 1980, tellalli doli dhe e pështyu fjalën e përpirë, të përtypur me mundim tre muaj rresht.

U shtrua ngeshëm sofra e zisë dhe erdhën sa çel e mbyll sytë edhe të ftuarit, që, për çudi, kishin qenë të gatshëm: të larë e të lyer, të veshur e të mbathur.

Në rekuiemin e monstrumit ia behën pothuaj të gjitha specimenet e kësaj bote. Thua se ky rekuiem ishte një Barkë e dytë e një Noe të dytë.. Me kucë e me mace. Zonja dhelpër e Brigjeve Britanike. Gjeldeti i larëm dhe i butë i Brigjeve të Azyrit; çakalli i Jermanisë; pumat, anakondat dhe kameleonët e Andeve. Nuk munguan as specimenet ngjyrë pjeshke të papjekur nga Dheu i Largët i Diellit në Lindje. Dhe, siç është fare e kuptueshme, Ariu Plak i Siberisë. Kish disa muaj që ata e kishin lënë takimin te kufoma e qelbur e përbindëshit të ngordhur.

Sa lotin e derdhi Krokodili i Nilit! Të mëshirohen gur e dru. Sa shlirshëm u derdhën inxhinjtë e sinqeritetit të Zonjës Dhelpër! Të të shkrihet shpirti. Besëlidhja ndërmjet maces dhe miut, që u bënë pikërisht në këtë sofër zie, premtonte se nuk do të thyhej përjetë fjala e dhënë një herë në kuvend… Kurse Ariu i Siberisë, i cili disa muaj më parë e kishte vënë shputën e madhe kaba në kufijtë e Familjes së Pikëlluar, betohej se as që i ka shkuar dhe as i shkon mendja për ndonjë prapti arinjsh!

Privilegjin për të pasur dy vdekje, më saktësisht, dy data të vdekjes, dy datëvdekje; një të hershme, orë e pa kohë- prandaj edhe të vërtetë. Dhe më vonë të dytën, datëvdekjen artistike- me mot të porositur (maj, pranverë, romantikë…) një privilegj të tillë nuk mund ta gëzojë kushdo.

Ta vdesësh një herë faktikisht trupin më 14 shkurt 1980, është dashur të kesh lindur faktikisht 88 vjet më parë, më 7 maj. Të të bëjnë me vdekje të dytë artistike, më 4 maj, është dashur të ta kenë kremtuar një ditëlindje të dytë, artistike, atëherë kur s'e ke pasur – do të thotë më 25 maj. (Maj, maj… vetëm maj. Ç'kërkon këtu shkurti kryengritës, si një bisht i këputur!) Pra, për të gëzuar dy datëvdekje, duhet të kesh gëzuar dy datëlindje.

Dy emra, shumë fytyra

Gjatë këtij shekulli, një nga kushtet për të vdekur dyfish ka qenë edhe ky: mos të të mjaftojë një emër i vetëm. Ta zëmë: Josip Broz. Një emër i tillë, ndoshta, ka mjaftuar për të hyrë së prapthi në një parti dhe në një luftë. Por ai nuk mjaftoi dot për t'u mbajtur në krye të një partie dhe në një luftë. Por ai nuk mjaftoi dot për t'u mbajtur në krye të një partie dhe të një shteti revizionit – siç doli puna pastaj. Për këtë duhej një emër i dytë, përkëdhelës, sugjestionues: Tito.

Kusht i posaçëm për ta gëzuar me popullaritet këtë emër, ka qenë që t'i shërbesh afro dyzet vjet, me përunjësi të pashembullt, imperializmit dhe kapitalizmit botëror, e në anën tjetër ta mbash ndezur dritën e drejtimit të socializmit. Dhe të mos mjaftohesh me kaq. Për maskë, të krijosh edhe një bllok, me emrin e çuditshëm: të painkuadruarit!

Me një fjalë, për ta gëzuar me jetë të gjatë emrin e dytë artistik – Tito, ishte e domosdoshme të kishe jo një po shumë fytyra, që të bëje pa pengesa flirte të pashoqe, të apasionuara, per amica silentia lunae, me atë që është çuar i pari! Për të mos vdekur kur ke vdekur, rëndësi të posaçme ka që, në kohën e sundimit tënd prej monarku fashist, të kesh çuar jetë sa më të shfrenuar. Të kesh pasur në pronën e madhe mbretërore ullishte e vreshta, pyje si Igallo dhe, mundësisht ndonjë ishull të tërë, si Brioni. Disa dhjetëra vila! Këto mund t'i ketë edhe një drejtor i thjeshtë. Por, bën të kesh pasur pallate me qindra e qindra dhoma. Secila dhomë një krua dhe secili krua një çep të artë!

Ndër të tjera, duhet të kesh qenë lahper. Të kesh futur nën kurorën mbretërore së paku pesë gra, të tjerat në harem, mundësisht sa më të reja, për salltanet, dhe rrallë e rrallë për – punët e natës!

Por, as këto nuk do të bëheshin kabull në çfarëdo kohe dhe në rrethana çfarëdo. Kusht i posaçëm është që vendin ta kesh futur deri në fyt në borxhe që arrijnë shifra astronomike. P.sh. 14.000.000.000 dollarë amerikanë! Që, sipas kursit të sotëm, bëjnë 36.400.000.000.000 dinarë të vjetër. Pra – 36 bilionë e 400 miliardë dinarë!

Trashëgimi madhështore për një rekuiem edhe më madhështor, që ia bëri monarkut Familja e Pikëlluar! (Pra, Kryesia e Federatës, se më në fund po i heqim dorëzat. S'ka lezet të flasim edhe më tutje me mesele).

Dy e dy bëjnë – 10 muaj me ajër të pastër!

Mendoj se ata që nuk bëjnë pjesë në Familjen e Pikëlluar – e të tillë jemi ne, shqiptarët e Kosovës, si dhe popujt e pafajshëm të Jugosllavisë – kanë edhe kohë për të bjerrë edhe deponime të sigurta për të mos u mërzitur. A s'jemi vallë duke jetuar në një regjim papunësie të shkallës më të lartë në Evropë, ndër më të lartat në botë?!10 Sidomos ne, shqiptarëve, koha na del e na tepron. Prandaj, mund të merremi edhe me "dokrra".

Për fillim, pakëz matematikë. Ndiqmëni me kujdes! Së paku me kujdesin, me të cilin e ndiqni një ndeshje futbolli.

Nëse Titua, me përkrahjen e zëshme të aparatit shtetëror revizionist të Jugosllavisë, për shtetin e vet 22-milionësh ka marrë hua te imperializmi dhe te kapitalizmi botëror 36 bilionë e 400 miliardë dinarë, atëherë ai çdo banor të Jugosllavisë, madje edhe Bali Katravellën tim kërthi, e ka ngarkuar me nga 1 654 550 dinarë borxh. Ju pyes: me se do ta lajë këtë borxh Bali Katravella im, të cilit e ëma ia lan tri herë në ditë mendelat e fëlliqura? Madje pa deterxhent!(Deterxhenti, siç e dimë, me vdekjen e parë faktike dhe me vdekjen ne dytë artistike të të përkëdhelurit Tito, humbi si shurra e pulës.)

Vazhdojmë!

Nëse gjendesh në ballë të një shteti me 22 milionë banorë, prej të cilëve ke inkuadruar vetëm 5 milionë e 612 mijë banorë, atëherë, me ç' banorë, prej të cilëve ke inkuadruar vetëm 5 milionë e 612 mijë banorë, atëherë, me çfarë shume të hollash e ke ngarkuar çdo të inkuadruar në larjen e borxheve prej 36 bilionë e 400 miliardë dinarësh?

Përgjigja e saktë është: çdo i inkuadruar duhet të paguajë nga 6 milionë e 486 mijë e 100 dinarë. Po nëse këtij të inkuadruari nuk i ke dhënë të ardhura mujore më të larta se 607 300 dinarë (mesatarja jugosllave), atëherë, për sa kohë mund ta lajë ai pjesën e vet të borxhit?

Matematika, punë e rëndë prej së cilës mund të të dhembë koka.

Përgjigja e saktë për pyetjen e mësipërme është se të gjithë punëtorët jugosllavë së bashku, për ta larë borxhin, me të cilin i ka ngarkuar ata Titua me titistët e vet, duhet t'i japin gjithë të ardhurat e tyre mujore në një periudhë kohore prej dhjetë muajsh e gjysmë! Pa lënë asnjë metelik anash.

Supozojmë se prej kësaj matematike i dhemb koka edhe Kryesisë së Jugosllavisë.

Së paku sot. Jo edhe kur merrte hua.

Bile, ka indikacione se edhe atëherë edhe sot, që ajo po hy në borxhe të reja të imperializmit dhe të kapitalizmit botëror, ka harruar që "S'ka mbetë borxh pa u kthye, ja me pare ja me krye".

Nuk është qejf i vogël të kesh një mecenë të madh, i cili e hap kuletën posa ta kesh hapur ti gojën për t'i lypur gjësend për mëshirë. Dhe klika titiste kotet dhe ëndërron se Amerika është aq zemërgjerë sa mezi pret ta shpenzojë dollarin e vet për t'u blerë sheqerka fëmijëve të llastuar. Ose cigare të trasha, të gjata – "tompus", për monarkun Tito, me të cilat ky pat fituar në botë popullaritetin e një kryepari të fisit, që e rreshk llullën e paqes pranë zjarrit indian, në një kohë që amerikani ia merr pëllëmbë-pëllëmbë gjithë tokën, kurse atë, indianin, e mbërthen në rezervate!

Po nëse një ditë mecena i madh kërkon t'i lahen me cenë borxhet?

Atëherë, sipas matematikës reale, dy e dy që bëjnë gjithmonë katër, do të na dalin diçka tjetër.

Ose duhet t'ia lëshosh shtëpinë, që e ke ngritur me të hollat e tij, ose t'ia thajsh paret në dërrasë. E, "për t'ia tharë paret në dërrasë", të gjithë të inkuadruarit në Jugosllavi, siç u tha më sipër, duhet të punojnë për mecenën dhjetë muaj e gjysmë! Pa ngrënë e pa pirë, pa u veshur e pa u mbathur. Ose duke ngrënë çka s'blehet me pare dhe duke veshur ç'ka s'blehet me pare…

Banorët e Jugosllavisë, pra, pasi ta kenë ngrënë gjithë gjënë e gjallë, gjithë barishtet, lëvoret e verrave dhe të kërpnajave; pasi të kenë veshur dhjetë muaj e gjysmë gjethe gështenjash, për të mbuluar pjesët e turpshme të trupit, si Adami e Eva; pasi të kenë kaluar me banim në shpellat e dashura të të parëve të vet – se banimi në kushtet moderne kërkon shpenzime, pasi t'i kenë ngrënë edhe milionat e produksioneve me portretin e përbindëshit Tito në teknikën bardh-e zi-kolor, madje megjithë korniza, do të mund të kthehen e të hanë kulumria!

Diçka, megjithatë, u mbetet badihava titistëve: Ajri! Dhe ajri nuk është artikull jetësor pa rëndësi.. Ai na e mban gjallë frymën. Pos kësaj, në mos i gjetshin vetes tjetër çare, titistët mund ta shfrytëzojnë ajrin edhe për ndonjë udhëtim në kozmos. Deri në Mars, bie fjala. E, për një udhëtim të tillë ata do të kenë nevojë të madhe.

Pse?

Pjesën dërmuese të firmave, Jugosllavia i ka ndërtuar me investime të përbashkëta me imperializmin. Mecena mund të mos lejojë t'i lahen borxhet duke shfrytëzuar objektet e tij industriale etj.

Por, s'ka gjë.

Siç e dimë, titistët janë shumë të shkathët në shpikjen e termave të ndryshme politike e legjislative. Ka mundësi që, kur të kenë arritur në Mars (prapë me fluturake amerikane), të shpikin edhe atje një vend, një Amerikë të Marsit ta zëmë, ku do të mund të marrin në të ardhmen hua për shpenzimet e mëdha që i duhen borgjezisë së këtushme!

Rrugë të mbarë, pra, titistë jugosllavë!

A mbahet shpirti me kulumria?

Nuk them që rruga e titistëve dhe e titizmit është njëherit edhe rruga e të gjithë qytetarëve të Jugosllavisë fashiste. Sidomos klasës punëtore dhe fshatarësisë së mashtruar, besoj, nuk do t'i shkonte aspak për lale një udhëtim i tillë në uri, në paqenësi. Udhëtim kah gjumi dimëror i arushës! Por, në rast të tillë, ata duhet të dinë se për çdo sëmundje ka ilaç. Mund të thonë shkurt: "Hiqe piten e ligë dhe sille të mirën!" Por, kjo gjë kërkon ca mundime. Ta zëmë, ndonjë kryengritje masive, eventualisht një revolucion të ri.

Apo mos edhe punëtorisë dhe fshatarësisë jugosllave titistët ua kanë prerë rrënjë, si me brisk, motivin e kryengritjes dhe të revolucionit?!

Kjo s'përputhet me asnjë ligj të shoqërisë, prandaj nuk do t'i besojë as Bali Katravella im.

Po ne, vëllezër shqiptarë. Do të udhëtojmë edhe ne tok me jugosllavët? Fadili, Mahmuti, Xhaviti, Xhevdeti… thonë se "rruga e Titos është rruga jonë". Dhe duhet t'u besojmë. Vërtet, nuk di a mund të ketë rrugë tjetër për këta renegatë me kompani, pos rrugës së titizmit? Rruga e kryengritjes dhe e revolucionit është rruga e vdekjes së tyre.

Prandaj, nuk e kam me ta po me ju: me punëtorinë, fshatarësinë, me inteligjencën, me popullin e robëruar shqiptar të Kosovës.

Na pyeti vallë Titua kur na e shkeli vendin? Kur hyri borxh te imperializmi? A na pyeti ai kur me pasuritë tona ngriti strofullin e çetnikëve – Beogradin, duke na e marrë kafshatën nga goja? U dashka tani që ne të marrim pjesë në larjen e borxheve të Jugosllavisë titiste?

Nuk di a na mësojnë kështu historia dhe tradita luftarake e popullit tonë, a na mësojnë kështu rrugët revolucionare të popullit tonë dhe të popujve të botës, që kanë hequr qafe përbindësh shumë më të mëdhenj se titizmin, i cili i ka të cekëta rrënjët.
Nuk di, më në fund, a kemi hesap – thjesht, të udhëtojmë bashkë me Jugosllavinë titiste, duke larë borxhe tërë jetën!

Ose, ndoshta, ende nuk na u mbush mendja se nuk mbahet shpirti me kulumria! (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 6-8)

TOFAJ SAHIT – Sahit Tofaj, aktivist i rrethit të Shtutgartit nga Juniku. Pjesëmarrës i demonstratave dhe i shumë aktiviteteve.

TOSKA RASIM – Rasim Toska, nga Gjilani, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

TOSKA TAIP, – Taip Toska, aktivist i dalluar i rrethit të Shtutgartit.

"Ndryshe nga Suzana, Tusha kishte vendosur të kthehej në Kosovë. Për t'i dalë në ndihmë kishte ardhur nga Kosova babai i saj, Haxhi Tahiri. Ishte e qartë se pas ikjes së Tushës duhej liruar banesën ku kishte jetuar familja Gërvalla. Të shtunën e 8 majit në mbrëmje, derisa po bisedonim rreth kësaj çështjeje, në familjen Gërvalla erdhën për vizitë Nami Ramadani, Fahredin Tafallari dhe Sahit Tofaj. E vazhduam bisedën me brengën se pasi të largohej Tusha, gjithsesi duhej liruar banesa. Aty kishte shumë materiale. Kishte parulla, afishe, flamuj e materiale të tjera propagandistike që duhej larguar. Ishte makineria radhitëse e shtypshkronjës së Jusufit dhe disa gjëra tjera ndoshta edhe të panevojshme. Propozova që punën e parullave të ma linin mua për ruajtje të sigurt. Nuk pranoi Xhafer Durmishi, duke e arsyetuar kundërshtimin e vet me atë se gjoja unë nuk marrkam vesh në këto punë të thella!

Ishin përgatitjet e fundit të Tushës për të udhëtuar në Kosovë. Ne e angazhuam ***Taip Toskin****, që ditën e shtunë, të 15 majit 1982, t'i bartte me veturën e tij. Pasi i kishte*

përgatitur valixhet, u mor me përgatitjen e tre fëmijëve, Mirjetës, Visarit dhe Bardhoshes së porsalindur. Me mundësitë e mia ia dhurova 500 marka. Pastaj u përshëndeta me ta." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.137-138)

TOSKIQ ALIJA, djalë 22 vjeçar nga Priboji, i mbytur nga dhuna e policisë jugosllave. Për te shkruan Jusuf Gërvalla në Lajmëtarin e lirisë, në artikullin: *Lugati në këndin e parë të rrugës.*

Jusuf Gërvalla: *"Sa vlen jeta e qytetarit në sytë e policisë fashiste Jugosllave*

Alija Toskiqi, djalë 22 vjeç nga Priboji, as që do ta ketë marrë me mend sa lehtë është të t'i shëmtojnë ato pak stinë behari dhe të ta shuajnë fare jetën e njomë. Tragjikën e beftë të kësaj mundësie, që të kërcënohet në çdo kënd të rrugës ai e kuptoi vonë: kur po vdiste për gazep në grushtat, shkelmat dhe kërbaçët e tre policëve. Në pikë të ditës!

Tragjika e Alija Toskiqit në krahasim me fatin e shumë qytetarëve të tjerë që e kanë pësuar njësoj ose edhe më keq se ai, ka megjithatë një satisfaksion të vockël. Krimi i policëve mbi këtë jetë të njomë u shqyrtua në forume të larta dhe bëri njëfarë buje edhe në shtypin revizionist jugosllav." (Lajmëtari, tetor 1980, f. 11)

total institutions rregullime të shoqërisë si janë shtëpitë e pleqve, spitalet psikiatrike, sanatoriumet, burgjet, kazermat ushtarake, shkollat-internate dhe manastiret. Një dukuri e përbashkët për këto institucione është se ato, për ata që janë nën kulmin e tyre, në masë të madhe i thyejnë ato barriera, të cilat në raste të rëndomta ekzistojnë në mes gjumit, kohës së lirë dhe punës. Të gjitha format e këtyre aktiviteteve kryhen në të njejtin vend dhe nën të njejtave autoritete. Aktivitetet zhvillohen së bashku me shumë individë të tjerë, të cilët trajtohen në të njejtën mënyrë. Të gjitha aktivitetet bëhen sipas orarit, dhe një kor i të punësuarve i mbikëqyrë në mënyrë ato të kryhen me kohë dhe sipas rregulloreve të caktuara. Ato aktivitete të cilat, për ata që gjenden në këto institucione, janë të detyrueshme, kombinohen sipas një plani racional që ka për qëllim përmbushjen e detyrave zyrtare të institucionit. Këto dukuri veç e veç mund të gjenden tek institucione tjera, por të gjitha së bashku ekzistojnë vetëm tek një institucion total.

TUCOVIÇ DIMITRIJE – Dimitrije Tucoviç (1881-1914) teoricien i dalluar dhe udhëheqës i lëvizjes punëtore në Mbretërinë e Serbisë, themelues i Partisë Socialdemokrate të Serbisë, gazetar dhe redaktor i "Radniçke novine" dhe "Borba". Vepra e tij më të rëndësishme është libri "Serbija dhe Shqipëria", një prej studimeve të hershme për popullin shqiptar.

TH

THAÇI SYLË, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sylë Thaçi, Kolskstr. 26, 46. Dortmund. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 40.

U

UKËHAXHAJ HASAN – Aktgjykim: "*Në bazë të aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Pejë, P. nr. 106/81; Të akuzuarit Hasan Ukëhaxhaj, nga f. Carabreg, KK – Deçan, i lindur më 15 mars 1943, në të njejtin fshat, me profesion profesor i gjuhës shqipe pranë QAMO "Vëllezërit Frashëri" në Deçan,... i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vjetësh.*"

universalism tendencë tek një person që e ka një rol që të veproj në bazë të disa rregullave, pamvarësisht se ndaj kujt i është drejtuar veprimi. P. sh. nga një gjykatës pritet që ai të gjykoj, rigorozisht në bazë të rregullave, pamvarësisht se cili është personi i dënuar. E kundërta e universalizmit është *partikularizmi*.

utilitarism drejtim filozofik që potencon se një veprim është i drejtë, nëse ai çon tek lumturia më e madhe e mundshme për numrin më të madh të mundshëm të njerëzve. Ky princip utilitaristik, autori i tij, filozofi anglez Jeremy Bentham (1748-1832), mendon se është i mundur të aplikohet në të gjitha rregullat e sjelljes njerëzore. Utilitarizmi ka pasur rëndësi të madhe veçanërisht në zhvillimin e ekonomive kombëtare.

V

valence *valencë* në social-psikologji paraqet atë ngarkesë që një objekt e ka për një individ. Nëse individi ka përvoja pozitive prej një dukurie, ngarkesa bëhet pozitive, nëse përvojat janë negative ngarkesa bëhet negative. Valenca mund të shihet edhe si veti tek një atitud. Valenca nuk tregon vetëm atë se a është një atityd pozitive apo negative por edhe sa pozitive e sa negative ajo (atityda) mund të jetë.

value *vlerë* term qendror në sociologji që mund të ketë kuptimet vijuese:

1. Emërtim për objekte që konsiderohen se kanë relevancë për atitydat dhe nevojat e një individi apo grupi.
2. Emërtim për atë apo ato pjesë të një objekti, që konsiderohet se kanë relevancë për atitydat dhe nevojat e një individi apo grupi. Vlera në këtë kuptim, e shprehur në mënyrë të thjeshtë është, gjithçka që një individ apo një grup ka një atitud ndaj diçkaje.
3. Veti tek një objekt apo tek një pjesë, apo tek disa pjesë të një objekti, që ndikojnë, që objekti të bëhet relevant për një individ apo një grup.
4. Emërtim i atyre normave themelore në një shoqëri apo në një grup. Në këtë kuptim, më të rëndomtin, të gjitha vlerat janë norma, por të gjitha normat nuk janë vlera. Vlerat shërbejnë si udhëzime për një individ ose një grup me rastin e zgjedhjes në mes alternativave të ndryshme të veprimit, apo orientimeve të ndryshme. Shembuj për vlera në këtë kuptim janë ndershmëria, në disa kultura suksesi dhe rezultatet e mëdha, demokracia, drejtësia etj.

value orientation veti tek një individ për të zgjedhur disa vlera para të tjerave, si udhëzim për sjelljet e tij. P. sh. një zyrtar që merret me çështje sociale mund të ketë; orientim-klienti, d. m. th. sjellja e tij diktohet në radhë të parë nga kujdesi për klientin, ose orientim-procedural, d. m. th. sjellja e tij diktohet në radhë të parë nga rregullat ekzistuese.

variable *variabël* një veti e matshme, e cila mund të merr vlera të ndryshme tek objektet e ndryshme që hulumtohen. Ato veti që nuk mund të maten në mënyrë kvantitative quhen variabla kvalitative, dhe ato të cilat mund të marrin vetëm dy vlera quhen atribut. Kombësia (nënshtetësia) është një variabël kvalitative, dhe gjinia është një atribut. Veti

që mund të marrin vlera numerike quhen variabla kvantitative. Bëhet dallim në mes variablave kontinuale, që mund të marrin vlera të shumta, pa një kufi si p. sh. gjatësia, dhe variabla diskrete, të cilat mund të marrin vetëm disa vlera, p. sh. variabla numri i banorëve që mund të ketë vetëm numra të plotë. Një klasifikim i variablave mund të bëhet në bazë të relacionit të tyre me variablat tjera. Një variabël që ndikon në të tjerat quhet *variabël e pamvarur* dhe ajo që ndikohet quhet *variabël e mvarur.*

VARREZAT kryesore të Shtutgartit, Hauptfriedhof, Steinhaldenstrasse 52, 70378 Stuttgart, ku nga 5 shkurti 1982 deri më 24 shkurt 2002 ishin të varrosur Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Weltanschauung, term i dituri-sociologjisë që paraqet masën e grumbulluar të diturisë së një kulture. Kjo masë diturie rritet organikisht dhe ndryshon shumë ngadalë. Ato elemente që hyjnë në Weltanschauung përgjithësisht ndahen në:

A) *Mite* dhe legjenda.

B) Dituri që është e gatuar në folklorin popullor.

C) Njohuritë fetare, prej atyre më të thjeshta e deri tek sistemi kompleks i dogmave.

D) Dituri me karakter të misticizmit.

E) Dituri filozofike dhe metafizike.

F) Dituri shkencore në matematikë, shkencat natyrore dhe shkencat kulturore.

G) Dituri teknologjike dhe dituri mbi aplikimin e atyre diturive që u përmendën nën pikën F.

Llojet e diturisë janë renditur prej atyre më primitive deri tek ato më të avancuarat. Sa më i avancuar që të jetë një lloj i diturisë aq më shpejt ndryshon ai.

verification *verifikim* ai proces përmes të cilit një deklarim sqarohet si i vërtetë. Deklarimi formulohet si *hipotezë* apo pohim. Dukuritë që kanë lidhje me deklarimin vrojtohen, vrojtimet analizohen dhe bëhet hulumtimi se si, deklarimet e pohimet, i përgjigjen realitetit të cilin ato përpiqen ta reprezentojnë. Funksioni më i rëndësishëm i verifikimit në metodën shkencore është futja e gjykimeve të reja në teoritë ekzistuese, vërtetimi i një gjykimi shkencor në mënyrë aq themelore sa ai gjykim të konsiderohet ligj shkencor dhe të shtojë masën e diturive shkencore. Nganjëherë bëhen këto dallime në mes formave të verifikimit:

A) Verifikim-replikativ, me domethënien se vërtetohet edhe një gjykim shtesë për ta rritur vlershmërinë.

B) Verifikim-konstistenc. Bëhet hulumtim se deri në çfarë shkalle një pohim logjikisht është i lidhur me një teori ekzistuese.

C) Verifikim-korrespondues, ku provohet vlershmëria e një teorie me anën e hulumtimit, se deri në çfarë shkalle përputhet ajo më të dhënat empirike.

verstehen metodë sociologjike e introduktuar nga sociologu gjerman Max Weber. Me verstehen Weber e mendon pjesërisht një proces dhe pjesërisht rezultatin, cakun final të këtij procesi, sqarimin e një sjelljeje, në të cilin procesi rezulton. Weber mendon se shkencëtari, përveç sqarimit të sjelljes në mënyrë racionale, përmes intuitës e vendosë veten në vendin e atij individi, sjelljen e të cilit don ta sqaroj. Përmes verstehen aktuale ai e sqaron përmbajtjen e veprimit, përmes verstehen sqaruese, ai (shkencëtari) i sqaron ato motive, që përbëjnë bazën e një veprimi.

vertical mobility lëvizshmëri sociale në drejtim të lartë dhe të poshtëm. Martesa me një person të një klase më të lartë është mobilitet vertikal, si dhe avancimi në vendin e punës, ashtu siç është shkarkimi nga detyra-puna.

VESELAJ HASAN, – Hasan Veselaj, aktivist i rrethit të Shtutgartit i cili mori pjesë në shumë aktivitete.

VËRTETA, (e vërtata- ang. *truth*, fr. *verite*, lat. *veritas*, gjerm. *Wahrheit*) përcaktim, mbishkrim i "të vërtetës" si e kundërta e "asaj që është false".

1. Në kuptim më të gjerë mund flitet për një shtet të vërtetë, një jetë të vërtetë, një vepër të vërtetë arti, e kështu me radhë, me ç'rast mendohet se shteti, jeta apo vepra e artit janë të vërteta ashtu siç duken në pamje, që ekzistojnë dhe mund perceptohen me anë të shqisave, apo janë të këndshme.

Nëse ky kuptim i gjerë i fjalës "e vërtetë" lidhet me një teori idesh atëherë mund të flitet për diçka se a është e vërtetë nëse përputhet me idenë e vetë (p. sh. Platon, Hegel dhe Kierkegaard). Më tej vlen në mënyrë të veçantë, se një vepër arti mund të thuhet se është e vërtetë nëse ajo në një apo tjetër kuptim është paraqitje e besueshme e realitetit (ose paraqitjen faktike ashtu siç duket, ose një realitet esenacial). Si minimum, këtu duhet patjetër të kërkohet që vepra e artit të mos shpreh diçka që është në kundërshtim me ligjet e realitetit.

2. Në kuptim më të ngushtë, e vërteta është një përcaktim ose tek aktet dhe gjendjet mentale (gjykime, parafytyrime besimesh) ose diçka gjuhësore (siç janë fjalitë indikative) ose tek të thëniet-deklarimet.

Teoritë më të rëndësishme rreth të vërtetës, në mesin e këtyre kuptimeve më të ngushta janë si vijon:

Teoria korresponduese për të vërtetën (nga latinishtja co- me dhe respondere- përgjegj) do me thënë teoria e adekuatshmërisë për të vërtetën, në bazë të së cilës diçka është e vërtetë nëse "përgjigjet ndaj" apo "është adekuate" me atë që thuhet. P. sh. thënia "Diametri i diellit është 1400 000 km" është e vërtetë, vetëm dhe vetëm nëse thënia është adekuate me realitetin. Teoria korresponduese për të vërtetën gjurmohet në të kaluarën deri tek Aristoteli, por formulimin klasik e ka marrë së pari tek Thomas Aquinas përmes formulës "Veritas est adaequatio rei et intelectus" ("e vërteta qëndron në adekuatshmërinë në mes sendeve dhe intelektit").

Diskutimi modern mbi këtë teori përpiqet veçanërisht të precizoj se çka do të thotë se diçka "është adekuate" me diçka tjetër. Tek Wittgenstein dhe Russell teoria korresponduese e merr një formulim me ç'rast shtrohen kërkesa të forta, ku adekuatshmëria kuptohet si një relacion në mes dy gjërave: *ajo çka është e vërtetë* (një thënie, një parafytyrim besimi, një pohim e kështu me radhë) dhe atë që e *bënë të vërtetë* (një ngjarje, një fakt, një rrethanë). Adekuatshmëria qëndron në atë se dy "gjërat" kanë *strukturë* të njejtë, në atë mënyrë që mund të thuhet se një deklarim e "kopjon" apo "pasqyron" stukturën e një fakti.

Ky interpretim i teorisë korresponduese është kritikuar ashpër dhe tani shumica e filozofëve janë larguar prej këtij interpretimi. Kritika pos të tjerash ka parashtruar, se struktura në një shprehje informative (p. sh. raporti në mes kryefjalës dhe kallëzuesit në fjalinë "Toka është një planet") është e një lloji krejt tjetër nga strukturat dhe relacionet në atë realitet për të cilit bënë fjalë fjalia. Pastaj është nënvizuar vlershmëria se një "send" ose një "fakt" nuk mund të identifikohen pamvarësisht prej shprehjeve të tyre specifike. Domethënie e kësaj është se "realiteti" dhe "gjuha" nuk përbëjnë dy dimenzione të pamvaruna, kontigjencë të jashtme - "relacion korrespondues".

Për t'iu shmangur këtyre vërejtjeve, teorisë korresponduese shpesh i jepet një formulim më i lirë, ku thuhet se një shprehje informative është e vërtetë, nëse ajo në një apo tjetër kuptim mund të "korrespondohet" me një fakt. (p. sh. tek Poper).

Teoria koherente për të vërtetën (nga latinishtja co- së bashku me, dhe haerere, e lidhur fortë) do me thënë jokontradiktore për të vërtetën, në bazë të së cilës një shprehje informative është e vërtetë, nëse ajo, në mënyrë të liruar prej kundërthënieve "është e lidhur" dhe e bashkueshëm me më të madhin sistem përfshirës të fjalive. Në fund të fundit, jo fjalitë e veçanta, por sistemi i lidhur i shprehjeve informative është ajo që është e vërtetë. Për këtë arsye mund të flitet për *shkallë të së vërtetës*, krejt sipas asaj se nëse një teori (do me thënë një shumë e shprehjeve të lidhura logjikisht) është sa pak apo sa shumë afër atij sistemi gjithëpërfshirës të shprehjeve të vërteta informative.

Teoria koherente për të vërtetën e ka marrë formulimin e saj klasik nga Leibniz dhe gjendet në forma të ndryshme tek filozofët idealist si Hegeli, Bradley dhe Blanshard. Teoria rëndom kritikohet për atë se nuk ka mundësi të sqaroj më afër se çka menedohet me "lidhshmëri" në mes shprehjeve informative, përveç asaj se ato përbëjnë një sistem të liruar prej kundërthënieve. Më tutje thuhet se mungojnë dëshmitë se do të ishte e pamundur për t'i ndërtuar dy sisteme të papajtueshme, të barabarta për nga gjerësia, të cilat të vështruara veç e veç do të përbënin një tërësi të përmbledhur.

Teoria evidente për të vërtetën (nga latinishtja *evidentia*; *ex* jashtë nga, dhe *videre*, shiko). do me thënë teori mbi atë se e vërteta është ajo që mund të tregohet në një përvojë evidente. Përvoja evidente mund të interpretohet si gjendje psikologjike – gjë që mohohet nga Brentano dhe Husserl. Brentano e mohon atë se do të kishte qenë e mundur për të përpunuar një teori rreth të vërtetës dhe evidencës e që nuk do të ishte një sjellje në rreth. Kështu e vërteta si evidencë merr karakterin e një koncepti themelor. Tek Husserl e vërteta definohet si "përputhmënia e plotë në mes asaj që mendohet dhe asaj që ipet", ndërsa evidenca definohet si përvoja e kësaj përputhmënie.

Argumentet kundër teorisë evidente për të vërtetën u përgjigjen fillim e mbarim argumenteve kundër asaj që mendohet si evidente.

Tek Heidegger zavendësohet teoria evidente me një teori mbi të vërtetën si aletheia (*a*-, jo, dhe *lathein*, mbulue) do me thënë e vërteta është diçka që nuk është e fshehur, nuk është e mbuluar, është ajo që është e zbuluar, demaskuar. Heidegger mendon se me këtë ka rizbuluar kuptimin mbi të vërtetën që ka ekzistuar para Aristotelit.

Teoria pragmatiste për të vërtetën (*pragma*, veprimtari) do me thënë kuptimi se diçka është e vërtetë nëse ajo është e frytshme dhe e dobishme në praktikë – ose nga këndvështrimi i jetës ose nga ai i shkencave. Krahasime në këtë pikë mund të bëhen me mendimet e Niçes. Tek Pierce dhe Apel teoria pragmatiste për të vërtetën lidhet me **teorinë konsensusale për të vërtetën** (nga latinishtja consesus, përputhmëni, unitet) do me thënë teoria mbi atë se e vërteta është ajo që një numër i pambarim i njerëzve kishte me ardhë në përfundim, nëse ata do të kishin mundësi që përjetësisht ta kontrollojnë një deklarim. Një deklarim për këtë arsye është i vërtetë, nëse ai mund në mënyrë të dobishme të hyj në kuadrin e një procesi të tillë pambarim shkencor.

Përveç këtyre në literaturë ndeshet **teoria redundante për të vërtetën, no truth teoria për të vërtetën, teoria performative për të vërtetën, dito teori për të vërtetën.**

Në gjykata e në drejtësi, kur nga dëshmitarët kërkohet ta bëjnë këtë betim: "***Unë N.N., betohem dhe ju siguroj në nderin dhe ndërgjegjen time se do ta them krejt të vërtetën, asgjë nuk do të lë në heshtje, asgjë nuk do të shtoj dhe asgjë nuk do të ndryshoj***" mendohet në teorinë korresponduese për të vërtetën, dhe në ato raste dëshmitarët nuk pyeten se sa janë të informuar me konceptet filozofike për të vërtetën,

por ta tregojnë atë të vërtetë që e dinë, në mënyrë që, në raste të rënda kriminelët të dënohen dhe t'u prehet mundësia për të bërë krime tjera.

white collar crime emërtim për krime që mund të kryhen vetëm nga individët e shtresave të larta të shoqërisë gjatë ushtrimit të profesioneve të tyre. Shembuj të *white color crime* janë përvetësimi, thyerja e besimit, e deri dikur edhe deklarimi i rrejshëm i pasurisë. Shumat të cilat vidhen në forma të ndryshme janë shumë herë më të mëdha se sa ato që vidhen në mënyrë konvencionale. Krimet gjegjëse në klasën punëtore quhen **blue collor crime**. Kundërvajtje të tilla janë p.sh. vjedhje veglash (e një sharre, çekani) apo materiali (një thes beton etj.).

wildcat strike grevë lokale, spontane apo e inicuar nga sindikata lokale, pa aprovimin apo informimin e sindikatës qendrore (bashkimit profesional).

XH

XHAFERI SAMI, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sami Xhaferi, 1902 Brandley Dr. 60538 Montgomery Ili., USA. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 2.

XHEVITI MUSA, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Musa Xheviti, Militet str. 10 Delroth, 4047 Dormagen 11. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 2.

Y

yellow-dog contract, në ShBA një marrëveshje jo-ligjore në mes ndërmarrjeve dhe punëtorëve, ku këta të fundit për të pasur mundësi që të punësohen zotohen se nuk do të bëhen anëtarë të ndonjë bashkimi profesional.

YLDRIM SHABAN, ka qenë tregtar me shtetësi turke, i mallrave shqiptare, me banim në Munchen. Është personi që përmes Nijazi Saraçoglut, i ka ndihmuar Jusufit të marrë kontakt me Sabri Novosellën në Turqi, duke ia dhënë adresën e Nijaziut, Bardhoshit e Jusufit, në panairin e artizanatit, të mbajtur në Munchen më 14 mars 1981. Në vitet 1980-1984 (e ndoshta edhe më gjatë) firma e tij e ka pasur këtë adresë:

Shaban Yldrim, Bayerstr. 5, 8000 München

Jusuf Gërvalla: *"Këtu kam një propozim. Ai shoku në Mynhen, përmes të cilit e* ***mora lidhjen me Ty***, ***Shabani****, është një milioner. Nëse shokët që ke Ti atje kanë ndikim në të, atëhere ai do të mund të na ndihmonte në blerjen e një makine të tillë, bile nuk do t'i ndiente shpenzimet. Por, kjo është çështje që duhet ta vendosni ju."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 265)

YLLI "*Psikologjia fashiste është e dukshme edhe atëherë kur mbi kapelën e bartësve të saj nuk qëndron kryqi i thyer nazifashist po ylli i tradhtuar e i përdhosur proletar."* (Jusuf Gërvalla)

Z

ZENELAJ A. (për Shaqir Shabanin), veprimtar në Francë. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: A. Zenelaj, 8 Avenue Maurice Thorez 69120 Voulx EN VELIN Lyon France. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

ZENELI SADIK, veprimtar në Gjermani, në komunën e Vëllezërve Gërvalla. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Sadik Zeneli, (Uka) Münzerstr. 12, Bö 7100 Heilbronn. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 5.

ZEQIRI BRAHIM, veprimtar në Zvicër. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Brahim Zeqiri, Av Du LIGNON 21 Geneve SUISSE tel.564011. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës.

ZEQIRI SHAIP, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Shaip Zeqiri, Herrenbergerstr. 40. Zim, 305, 7400 Tübingen. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

ZULFAJ MAKSUT, veprimtar në Gjermani. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Maksut Zulfaj, Vulkan str. 32 D-2820 Bremen 70. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 15.

ZH

ZHARKU AHMET, veprimtar në ShBA. Në vitet 1982-1983 ka pasur këtë adresë: Ahmet Zharku, 207 E.Mosholu Pkwy Bronx, N.Y.10467 U.S.A. Ka qenë një ndër pikat prej nga është shpërnda *Zëri i Kosovës* me fjalët kushtrimtare të Jusuf Gërvallës. Numri i ekzemplarëve të porositur prej tij ka qenë 30.

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013

16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: *"Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror."* (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Maj 2013-Shkurt 2026